



RAPORTI I AUDITIMIT NË SPITALIN UNIVERSITAR TË TRAUMËS

Mbi zbatimin e auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë në Spitalin Universitar të Traumës, Tiranë.

Përgatitur nga data 05.06.2018 deri më 14.06.2018.

Auditimi është kryer në bazë të programit të auditimit nr. 68/1, datë 23.01.2018 i ndryshuar, me nr. 68/2, dt. 23.03.2018 miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Auditimi është kryer nga:

1-Z. Bexhet Zeqiri (*përgjegjës grupi*),

2-Znj. Mariola Llanaj anëtar,

3-Znj. Eni Kabashi anëtar,

4-Z. Aldo Kume anëtar,

Auditimi ka filluar më 26.01.2018

Auditimi ka përfunduar më 17.04.2018

Tiranë, Qershor 2018

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT****RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN UNIVERSITAR TË TRAUMËS”**

	PËRMBAJTJA	Faqe
I	Përmbledhje.	2 - 8
II	Gjetjet kyçe dhe impakti te pasqyrat financiare.	8 - 13
III	Rezultatet e auditimit:	13 - 107
	<i>I. Zbatimit të detyrave të lëna në Auditimin e mëparshëm.</i>	13 - 15
	<i>II. Planifikimi i buxhetit, në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Financave për përgatitjen e buxhetit të shtetit, i kriterëve në çeljen e buxhetit,</i>	15 – 19
	<i>b. Përputhshmëria ligjore për marrëdhëniet e punës dhe të pagave, realizimi i fondit të pagave .</i>	19 – 23
	<i>c. Hartimi dhe plotësimi i pasqyrave financiare përkatëse në përputhje me UMF nr. 14, datë 28.12.2006, Ligjshmëria dhe saktësia e plotësimit të dokumentacionit bazë të kontabilitetit (fletëhyrje, fletëdalje, faturë, mandatarkëtim, mandatpagesë, urdhër shpenzim, etj.)</i>	23 – 40
	<i>d. Auditim mbi evidentimin dhe administrimin e vlerave materiale në magazinë, farmacinë qendrore, farmacitë spitalore në pavijone për barnat, materiale mjekësore, në sektorët e shërbimit për mjetet e pastrimit, mirëmbajtjes, etj. Mbi inventarizimin e aktiveve në zbatim të UMF nr. 30, datë 27.12.2011.</i>	
	<i>III. Përputhshmëria ligjore dhe rregullshmëria financiare në planifikim dhe në realizimin e prokurimit të fondeve publike për mallra, punë dhe shërbime.</i>	40 – 46
	<i>IV. Krijimi dhe përdorimi i të ardhurave të krijuara nga veprimtaritë dytësore të institucionit, qiratë dhe donacionet e ndryshme në përputhje me dispozitat ligjore.</i>	46 – 82
	<i>V. Auditimi i lidhjes dhe zbatimit të kontratave të shërbimeve dhe blerjeve të institucionit.</i>	82 – 84
	<i>VI. Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në përputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.</i>	84 – 96
	<i>VII. Auditimi mbi funksionimin e Auditimit të brendshëm.</i>	97 – 104
		105 - 107
IV	Gjetjet nga auditimi dhe rekomandimet.	107 -120
V	ANEKSET	121 - 123



I. Hyrja.

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH) auditoi veprimtarinë e Spitalit Universitar të Traumës (këtu e në vazhdim SUT), duke i kushtuar vëmendje të veçantë çështjeve që lidhen me zbatimin e procedurave ligjore e nënligjore, në menaxhimin financiar dhe kontrollin, në hartimin dhe zbatimin e buxhetit, në miratimin e respektimit të strukturës organike dhe të nivelit të pagave sipas klasifikimit të funksioneve, në organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit, në administrimin e vlerave materiale e monetare, në prokurimin e fondeve publike etj.

Auditimi u krye me zgjedhje për pasqyrat financiare të vitit 01.01.2016, deri 31.12.2017.

Bazuar të dhënave të marra në subjekt, fondet e trajtuar, botimet në mediat e shkruara, ndjeshmërinë publike dhe të grupeve të interesit, riskun, u identifikuan fushat e auditimit të cilat janë;

- a. planifikimi i buxhetit, në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Financave për përgatitjen e buxhetit të shtetit dhe nivelet e realizimit të planit përfundimtar;
- b. marrëdhëniet e punës dhe të pagave, realizimi i fondit të pagave, kontributin e sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe tatimin mbi të ardhurat personale, krijimi dhe përdorimi i fondit të veçantë, etj.;
- c. hartimi dhe plotësimi i pasqyrave financiare përkatëse në përputhje me UMF nr. 14, datë 28.12.2006 i ndryshuar me UMF nr. 26, datë 27.12.2007. Ligjshmëria dhe saktësia e plotësimit të dokumentacionit bazë të kontabilitetit;
- d. planifikim dhe realizimi i prokurimit të fondeve publike për mallra, punë dhe shërbime;
- e. planifikimi dhe miratimi i programeve vjetore dhe strategjike të auditimeve, realizimi i tyre.
- f. menaxhimi financiar dhe kontrollit, Mjedisi i kontrollit, menaxhimi i riskut, aktivitetet e kontrollit, informim komunikimi, monitorimi, mbi bazën e të cilave u hartua edhe programi i auditimit.
- g. Lidhja e kontratave me subjektet private për shërbimet e furnizimin me ushqime (*shërbimet e kateringut*), shërbimi i lavaxerisë, mirëmbajtje gjelbërim, shërbimi i mirëmbajtjes së pajisjeve mjekësore, etj.
- h. Dhënia me qira subjekteve private të ambienteve, respektimi i tarifave të qirasë si dhe ndjekja e arkëtimit të të ardhurave nga qiratë.

Informacion i përgjithshëm:

Spitali Universitar i Traumës është person juridik, publik, buxhetor, në varësi administrative të Ministrisë së Shëndetësisë. SUT është pjesë e rrjetit të integruar të shërbimit mësimor e kërkimor-shkencor dhe spitalor në Republikën e Shqipërisë, funksionon si strukturë shëndetësore universitare e përgjithshme, e cila realizon funksione diagnostikuese e trajtuese në përmbushje të ofrimit të kujdesit shëndetësor terciar, si pjesë e ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, si dhe funksione mësimore e kërkimore-shkencore për të realizuar formimin universitar të specialistëve të shëndetësisë, si pjesë e Universitetit të Mjekësisë Tiranë dhe ndjek e zbaton aktet ligjore e nënligjore në fushën e shëndetësisë. Funksionimi i tij kryhet në përputhje me VKM nr. 357, datë 18.7.2002 “Për dhënien e statusit *“spital universitar”, spitalit ushtarak qendror*”, ligji nr. 9106, datë 17.7.2003, “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr. 1001, datë 02.12.2015 “Për integrimin e spitalit universitar të traumës dhe spitalit ushtarak të forcave të armatosura në një strukturë të bashkuar”, VKM nr. 657, datë 10.11.2017 “Për miratimin, si strukturë shëndetësore universitare, të spitalit universitar të traumës”.

Objekti i veprimtarisë së Spitalit Universitar të Traumës është:

SUT shërben si Qendër Kombëtare e Traumës me funksion mjekësor, mësimor e kërkimor-shkencor dhe ka përgjegjësi për:

- a) Ofrimin e shërbimit të urgjencës mjekësore në nivelin më të lartë të saj në rang kombëtar;
- b) Përkujdesjen shëndetësore për personelin e Forcave të Armatosura që ka statusin e ushtarakut;
- c) Dhënien e kontributit me kapacitete shëndetësore në përgjigje të detyrimeve të Shqipërisë, si vend anëtar në NATO.



c) Ofrimin e veprimtarisë akademike, mësimore e kërkimore-shkencore në funksion të realizimit të procesit mësimor dhe kërkimor në fushën e shëndetësisë.

Struktura organike e integruar e Spitalit Universitar të Traumës hartohet nga ministri i Shëndetësisë dhe ministri i Mbrojtjes, sipas përgjegjëseve specifike, dhe miratohet nga Kryeministri.

Në strukturën organike të integruar të Spitalit Universitar të Traumës parashikohen funksione për personel civil dhe për personel ushtarak. Personeli civil është nën përgjegjësinë e planifikimit dhe të menaxhimit të ministrit të Shëndetësisë. Personeli ushtarak është nën përgjegjësinë e planifikimit dhe të menaxhimit të Ministrisë së Mbrojtjes.

Drejtori dhe nëndrejtori civil i Spitalit Universitar të Traumës emërohen nga ministri i Shëndetësisë.

Shefi i Njësisë së Mjekësisë Ushtarake është njëkohësisht edhe nëndrejtor ushtarak i Spitalit Universitar të Traumës i cili emërohet nga ministri i Mbrojtjes.

Personeli tjetër mjekësor dhe administrativ i Spitalit Universitar të Traumës emërohet sipas kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi.

Planifikimi buxhetor për funksionimin normal të Spitalit Universitar të Traumës kryhet nga Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Mbrojtjes, sipas përgjegjëseve përkatëse.

Ministria e Mbrojtjes bën planifikimin buxhetor të NJMU-së, ku parashikohen shpenzimet për personelin ushtarak të Spitalit Universitar të Traumës e për përkujdesjen shëndetësore ndaj personelit me statusin e ushtarakut, si dhe përballimi i shpenzimeve në kuadër të detyrimeve të vendit në NATO. Ministria e Mbrojtjes vë në dispozicion fondin e akorduar për Spitalin Universitar të Traumës, në bazë të rregullave specifike të miratuara me udhëzim të përbashkët të ministrit të Financave dhe ministrit të Shëndetësisë.

Ministria e Shëndetësisë është përgjegjëse për drejtimin, menaxhimin dhe administrimin e përgjithshëm të Spitalit Universitar të Traumës në të gjitha aspektet.

Qëllimi i auditimit.

Auditimi duke qenë pjesë jetike e një sistemi rregullator, ka për qëllim të vlerësojë dhe evidentojë shkeljet e parimeve të ligjshmërisë dhe menaxhimit të shëndosh financiar si edhe shfrytëzimin me efikasitet, efektivitet dhe ekonomicitet të pasurisë shtetërore dhe fondeve publike. Ky sistem bën të mundur ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese sipas rastit, rritjen e përgjegjshmërisë, llogaridhënies, rikuperimin e dëmeve të shkaktuara si dhe parandalimin e shkeljeve, me synim rritjen e vlerës së parasë publike në mbrojtje të interesave të taksapaguesve.

Objektivat e auditimit.

- Dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve, rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord. Nëse të ardhurat dhe shpenzimet kanë qenë në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin; nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik.

- Objektivat specifike të auditimit ose pohimet për marrjen e garancive për besueshmërinë e shpenzimeve dhe të ardhurave janë:

-Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim si; përkatësia, plotësia, saktësia, periudha, klasifikimi, ligjshmëria dhe rregullsia.

-Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës si; ekzistenca, të drejtat dhe detyrimet, plotësia, vlerësimi dhe alokimi.

-Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese si; transaksione, të drejtat dhe detyrimet, plotësia, klasifikimi dhe kuptueshmëria, saktësia dhe vlerësimi.

Metodat e auditimit.

Për arritjen e objektivave, metoda e auditimit u bazua tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit. Në kryerjen e auditimit janë përdorur metoda e bazuar në funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, metoda e bazuar në procedurat bazë dhe në procedurat analitike. Pas



testimit të kryer, për të kuptuar sesi funksionon sistemi i kontrollit të brendshëm dhe pas marrjes së informacionit në mënyre të përgjithshme, në ushtrimin e auditimit për zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë të aktivitetit ekonomik dhe financiar u bënë teste lidhur me zbatimin e ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi.

Puna e auditit të brendshëm u bë pjesë efektive e mjedisit të kontrollit, duke dhënë ndihmesë në drejtim të risqeve të punës në mënyrë të strukturuar dhe dha siguri për operacionet dhe procedurat e kontrollit.

Po kështu nga ana jonë u përshkrua legjislacioni autorizues, rregullat e vendosura sipas legjislacionit autorizues, shumat e autorizuarra për vitet 2016 dhe 2017, caktimi i përgjegjësisë dhe autoritetit, etj.

Baza ligjore e auditimit.

Auditimi bazohet në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Manualin e Auditimit Përputhshmërisë, Manualin e Auditimit Financiar, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 196, datë 29.12.2015, referenca të tjera ligjore dhe në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit:

- ISSAI 100 (*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*) që përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;
- ISSAI 400 (*Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë*) që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
- ISSAI 4000 “*Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë*”;
- ISSAI 1000-2999 “*Udhëzues të Auditimit Financiar*”;
- ISSAI 1300 “*Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare*”;
- INTOSAI GOV 9100 “*Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik*”; INTOSAI GOV 9110 “*Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm*”; ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “*Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë*”; nr. 10296, datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, ligji nr. 147/2015, datë 17.12.2015 “*Për buxhetin e vitit 2016*”, ligji nr. 130/2016, datë 15.12.2016 “*Për buxhetin e vitit 2017*” ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*”, i ndryshuar, ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 “*Për sigurimet shoqërore në RSH*”, të ndryshuar me ligjin nr. 104/2014, datë 31.07.2014, nr. 7870, datë 13.10.1994 “*Për Sigurimet Shëndetësore në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, VKM nr. 135, dt. 20.02.2013 “*Për lejimin e Ministrisë së Shëndetësisë për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të institucioneve të varësisë, për disa mallra e shërbime*”, VKM nr. 555, datë 11.8.2011 “*Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve me arsim të lartë në sistemin e ministrisë së shëndetësisë dhe spitalin ushtarak qendror universitar, në sistemin e ministrisë së mbrojtjes, të punonjësve të infermieristikës në sistemin e ministrisë së shëndetësisë e ministrisë së mbrojtjes, si dhe për trajtimin e mjekëve në strukturat e forcave të armatosura*”, të ndryshuar. VKM nr. 357, datë 18.7.2002 “*Për dhënien e statusit "spital universitar", spitalit ushtarak qendror*”, ligji nr. 9106, datë 17.7.2003, “*Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë*”, VKM nr. 1001, datë 02.12.2015 “*Për integrimin e spitalit universitar të traumës dhe spitalit ushtarak të forcave të armatosura në një strukturë të bashkuar*”, të ligjit nr. 147/2014, “*Për shërbimin e urgjencës mjekësore*”, ligjit nr. 64/2014, “*Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë*”, të ligjit nr. 80/2015, “*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*”, VKM nr. 657, datë 10.11.2017 “*Për miratimin, si strukturë shëndetësore universitare, të spitalit universitar të traumës*”, VKM nr. 18, dt.11.01.2017 “*Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2017*”, VKM



nr. 465, dt. 02.06.2010 “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e spitalit ushtarak qendror universitar”.

Dokumentimi i rezultateve të auditimit.

Dokumentimi i rezultateve të auditimit u mbështetet në kërkesat e Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë, Manualit të Auditimit Financiar, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 196, datë 29.12.2015 si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit ISSAI 1230 “*Dokumentimi i Auditimit*”.

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundur dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet e rëndësishme profesionale të bëra në arritjen e këtyre konkluzioneve.

Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesive dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, rezultateve të akt konstatimeve dhe shqyrtimit të komenteve dhe shpjegimeve të subjektit të dërguara me shkresën nr. 68/4, dt. 31.05.2018 u përgatit Raporti i Auditimit.

Baza për Opinionin

Auditimi u krye në përputhje me kërkesat e manualit të auditimit të përputhshmërisë dhe atij financiar të KLSH si dhe standardet ndërkombëtare të auditimit të zbatueshme për Institucionet Supreme të Auditimit. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë në institucionet buxhetore, KLSH është e pavarur nga Spitali Universitar i Traumës, Tiranë dhe përgjegjësitë e tjera etike janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Ne besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin tonë.

Mbi vlerësimin e riskut.

Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (*analiza*), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm morëm dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ja nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e audituesve.

- U krye planifikimi dhe identifikimi i riskut të auditimit. Njohja me subjektin që auditohet për të kuptuar të gjithë elementët e mjedisit të kontrollit. U identifikuan dhe vlerësuan zonat kryesore të llogarisë dhe shënimeve shpjeguese për të përcaktuar pohimet kryesore të auditimit në bazë të materialitetit të përcaktuar.

-U përcaktua strategjia dhe vlerësimi i riskut duke identifikuar klasat e transaksioneve dhe kontrolleve kyçe. Kuptimi i proceseve të rrjedhjes së punës dhe kontrollet bazë të aplikuara. U përcaktuan kontrollet kryesore për tu testuar dhe vlerësimi paraprak i kombinuar i riskut (*i rishikuar përgjatë gjithë punës audituese*). U përcaktuan testet e kontrolleve dhe testet thelbësore të auditimit që do të kryhen në bazë risku.

- U ekzekutuan procedurat e testimit si testimi i funksionimit të kontrolleve kryesore të entitetit, përfshirë zbatimin e kuadrit rregullator për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe saktësia e veprimeve rregulluese dhe mbyllëse për paraqitjen e pasqyrave financiare.

Më poshtë po citojmë disa ngjarje të konstatuar në projekt auditimin që mund të paraqisnin një risk të gabimit material:

- Për periudhën 01 dhjetor 2017 deri 31 mars 2018 subjekti “A.H” sh.a. ka përdorur sipërfaqe të ndërtuara mbi ambientet ekzistuese të spitalit, për të cilin institucioni nuk ka



dokumentacion, si leja ndërtimore apo kontratë, si platforma në nivelin e katit të parë me konstruksion çeliku në një sipërfaqe **160 m²** dhe **42 m²**.

- Nga auditimi mbi menaxhimin financiar në Spitalin Universitar të Traumës, ka rezultuar se organizimi dhe veprimtaria administrative, mbështeten në një rregullore të brendshme të vitit 2010. Nga SUT është përgatitur draft rregullorja e re, e cila nuk është miratuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

- Nga SUT nuk janë hartuar raportet e monitorimit të shpenzimeve për vitin 2016 dhe 2017, me informacionin e plotë me shpjegimet përkatëse lidhur me ndryshimet e PBA, buxhetit nga plani fillestar deri në atë përfundimtar, në nivel programi dhe artikulli, lidhur me ndryshimet e planit të produkteve, si në sasi dhe në vlerë në përputhje me Udhëzimet e Ministrit të Financave për zbatimin e buxhetit të shtetit.

- Referuar procedurës dhe procesverbaleve të nxjerrjes jashtë përdorimi dhe asgjësimit në vlerën 49,854,683 lekë nga ana e SUT për asgjësimin e këtyre materialeve nuk ka asnjë dokumentacion lidhur me procedurën e kryer nga komisioni i asgjësimit, si vlerësimi dhe ndarja e materialeve sipas destinacionit të tyre, materiale për ankand ose materialeve që duhet të groposen, mjetin e transportit i cili ka kryer transportin e tyre, si dhe vend ndodhjen e groposjes së tyre, djegien etj. të shoqëruar me fotot përkatëse, duke mos e faktuar nxjerrjen jashtë përdorimi dhe asgjësimin e materialeve në vlerën 49,854,683 lekë në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

A. OPINIONI I AUDITUESIT:

Ne kemi audituar veprimtarinë e Spitalit Universitar të Traumës, Tiranë në mbështetje të ligjit nr. 154/2014, miratuar në datën 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe (ISSAI 1700¹, dhe 4200²) për të cilën do të japim opinion:

Audituesit e KLSH-së nëpërmjet auditimit të realizuar në SUT krijuan bindjet, të cilat do të shprehen në opinionin e grupit të auditimit mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e ndërtimit të pasqyrave financiare, Raportimit Financiar (*kriteret e auditimit financiar*) dhe shkallës së zbatueshmërisë nga subjekti, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (*kriteret e auditimit të përputhshmërisë*), ku u evidentuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (*kriteret*), që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur nuk janë materiale, të cilat konsistojnë si më poshtë:

- Subjekti “A.H” sh.a. ka okupuar ambientet sipërfaqe nën objekt, brenda godinës së SUT në një sipërfaqe totale 1200 m² dhe për periudhën objekt auditimi 01.10.2015 deri 31.03.2018 i detyrohet SUT qira e papaguar për sipërfaqen e okupuar në vlerën 10,800,000 lekë. Ky subjekt ka përdorur një sipërfaqe prej 267.3 m², të cilën e ka ndërtuar mbi ambientet ekzistuese të spitalit, për të cilin institucioni nuk ka dokumentacion, si leja ndërtimore apo kontratë dhe një urë lidhëse ndërmjet godinës së tij dhe spitalit, në vlerën 2,405,700 lekë të ardhura të munguara.

- Nga SUT nuk janë hartuar raportet e monitorimit të shpenzimeve për vitin 2016 dhe 2017, me informacionin e plotë me shpjegimet përkatëse lidhur me ndryshimet e PBA, buxhetit nga plani fillestar deri në atë përfundimtar, në nivel programi dhe artikulli, lidhur me ndryshimet e planit të produkteve, si në sasi dhe në vlerë. Nuk është e paraqitur Performanca e produkteve e lidhur me realizimin e objektivave dhe politikës së programit ku të shpjegohej cilat ishin objektivat sipas PBA, politikat e çdo programi si dhe sa janë realizuar këto objektiva.

¹ ISSAI 1700- Objektiv i audituesit është të formulojë një opinion mbi besueshmërinë e llogarive vjetore dhe llogarive bazuar në një vlerësim të përfundimeve të hartuara nga evidencat e marra të auditimit dhe të shprehë qartë opinionin nëpërmjet një raporti të shkruar që shpjegon bazat e opinionit.

² ISSAI 4200 - Objektiv i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, kur auditimi behet lidhur me auditimin e pasqyrave financiare



- Nga auditimi konstatohet nga SUT gjatë vitit 2017 janë nxjerrë jashtë përdorimit aktive në vlerën 49,854,683 lekë të cilat nuk janë shoqëruar me dokumentacion lidhur me procedurën e kryer nga komisioni i asgjësimit, si vlerësimi dhe ndarja e materialeve sipas destinacionit të tyre, duke mos e faktuar nxjerrjen jashtë përdorimi dhe asgjësimin e materialeve në vlerën 49,854,683 lekë.

- Nga FSDKSH janë likuiduar 81,098,160 lekë për shërbimin e periudhës shtator dhjetor 2017 në zbatim të kontratës e koncesionit/PPP nënshkruar nga MSH në korrik 2015 me kompaninë “S” sh.p.k “Për ofrimin e shërbimeve të integruara të furnizimit të setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale sterile, furnizim me material mjekësor steril të një përdorimesh në sallat kirurgjikale, trajtimin e mbetjeve me rrezik biologjik dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikale” shërbim për të cilin nuk ka asnjë monitorim apo dhe konfirmim nga SUT, të llojit të ndërhyrjes, numrit të operacioneve të kryera, për të cilat koncesionari paguhet.

- Nga SUT janë kryer procedura prokurimi për blerjen e medikamenteve dhe materialeve mjekësore të cilat duhet ti kryente Ministria e Shëndetësisë dhe urdhrat e prokurimit e nxjerra nga SUT janë në kundërshtim me VKM nr. 135, datë 20.2.2013 “Për lejimin e Ministrisë së Shëndetësisë për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të institucioneve të varësisë, për disa mallra e shërbime”.

Opinion:

Nga auditimi i përputhshmërisë dhe rregullshmërisë mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, i kryer në subjektin Spitali Universitar i Traumës, Tiranë nuk u konstatuan devijime/shkelje nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të rëndësisë materiale për të cilën japim **opinion të pakualifikuar**.

Opinion:

Opinionin e dhënë mbi besueshmërinë e llogarive vjetore e mbështesim në konstatimet se; bilancet, deklaratat e të ardhurave, deklaratat e mbajtjes së të ardhurave, banka, janë përfshirë në deklaratat financiare. Janë marrë evidenca të mjaftueshme që të mund të japim një opinion. Deklaratat financiare janë paraqitur sipas ligjit të kontabilitetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave.

“Sipas mendimit tonë, pasi kemi marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, mbështetur në standartet ISSAI 1700³ shprehim një **opinion të kualifikuar** për llogaritë vjetore të Spitalit Universitar të Traumës duke arritur në përfundimin se anomali apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, të përhapura, në llogaritë vjetore”.

II. Më poshtë po paraqesim disa nga gjetjet kyçe të auditimit dhe impakti i tyre tek pasqyrat financiare:

a. Gjetje me dëm ekonomik në vlerën 20,755,387 lekë.

➤ Nga SUT është hartuar kontrata e qirasë me “A.H” sh.a. dt. 30.08.2013 për përdorimin sipas nenit nr. 1, “objekti i kontratës” për 496 m² ambiente brenda godinës SUT. Spitali amerikan okupon ambientet sipërfaqe nën objekt, brenda godinës së SUT një sipërfaqe totale 1696.4 m². Subjekti “A.H” sh.a. për periudhën objekt auditimi i detyrohet SUT qira e papaguar për sipërfaqen e okupuar prej 1200 m² (1696 m²–496 m² = 1200 m²) referuar kontratës së datës 28.08.2013 si më poshtë. Periudha 01.10.2015 deri 31.03.2018 gjithsej 30 muaj.

³ Objektivi i audituesit është të formulojë një opinion mbi besueshmërinë e llogarive vjetore dhe llogarive bazuar në një vlerësim të përfundimeve të hartuara nga evidencat e marra të auditimit dhe të shprehë qartë opinionin nëpërmjet një raporti të shkruar që shpjegon bazat e opinionit.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN UNIVERSITAR TË TRAUMËS”

Sipërfaqja e përdorur $1200 \text{ m}^2 \times 300 \text{ lekë/m}^2$ në muaj = $360,000 \text{ lekë} \times 30 \text{ muaj} = \mathbf{10,800,000}$ lekë e cila duhet të arkëtohet.

➤ Në tenderin e zhvilluar me objekt “*Mirëmbajtja e objekteve ndërtimore në SUT*”, KVO në rastin e operatorit “DC” sh.p.k duhet të kishte pasur parasysh si kriter vlerësimi ofertën më çmimin më të ulët dhe ti kërkonte operatorit analizën e kostos për zërat e tjerë të munguar për të argumentuar çmimet e ofertës dhe të kualifikonte ofertën e këtij operatori në vlerën 2,416,735 lekë pa tvsh si oferta më e ulët. Skualifikimi i ofertuesit të mësipërm ka sjellë një dëm prej **820,265** lekë.

➤ Në tenderin e zhvilluar me objekt “*Blerje materiale mjekësore për Neurokirurgjinë në SUT për periudhën 2 mujore mars - prill 2016*” Tiranë” rezultoi se në fondin e përllogaritur nga grupi i punës me shkresën nr. 53/8, dt. 02.03.2016 nuk janë përdorur çmimet e ofruara nga grupi i punës që ka përllogaritur çmimet mesatare me shkresën nr. 53/6, dt. 01.03.2016 si rezultat fondi limit është përllogaritur më tepër në vlerën **89,928** lekë pa tvsh shumë e cila duhet të arkëtohet.

➤ Nga auditimi i zbatimit të kontratës nr. 416, datë 19.10.2010 me objekt “*Kryerjen e shërbimit të pastrimit të ambienteve të brendshme dhe pastrim sistemim gjelbërim i ambienteve të jashtme të SUT*” rezultoi se vlerat e likuiduara për zërin “*Mirëmbajtje rrugësh 11228 m²*” për vitin 2016 dhe 2017 kanë një risk të trashëguar nga termat e referencave të kontratës nga viti 2010 e në vazhdim, gjatë zbatimit të shërbimit të pastrimit dhe sipërmarrësi “S-A” sh.p.k për 2 vitet (2016 + 2017) e ka përfituar këtë proces pune të paargumentuar apo të pajustificuar me dokumentacion, në vlerën 1,237,662 lekë pa tvsh. (**1,485,194** lekë me tvsh).

b. Gjetje për fonde të trajtuara pa efektivitet dhe ekonomikitet në vlerën **9,482,403** lekë.

➤ Subjekti “A.H” sh.a. ka përdorur një sipërfaqe prej 222.3 m^2 , të cilën e ka ndërtuar mbi ambientet ekzistuese të spitalit, për të cilin institucioni nuk ka dokumentacion, si leja ndërtimore apo kontratë, po kështu ka ndërtuar dhe një urë lidhëse ndërmjet godinës së tij dhe spitalit, me sipërfaqe 45 m^2 , ku edhe për të nuk ka dokumente në SUT. Nëse do të përllogarisnim dhe përdorimin e sipërfaqes së ndërtuar nga vetë Spitali Amerikan për periudhën 01.10.2015 deri 31.03.2018 gjithsej 30 muaj për sipërfaqen e përdorur $267.3 \text{ m}^2 \times 300 \text{ lekë/m}^2$ në muaj = $80,190 \text{ lekë} \times 30 \text{ muaj} = \mathbf{2,405,700}$ lekë të ardhura të munguara për periudhën objekt auditimi.

➤ Gjithashtu për periudhën 01 dhjetor 2017 deri 31 mars 2018 subjekti “A.H” sh.a. ka përdorur sipërfaqe të ndërtuara mbi ambientet ekzistuese të spitalit, për të cilin institucioni nuk ka dokumentacion, si leja ndërtimore apo kontratë, si platforma në nivelin e katit të parë me konstruksion çeliku në një sipërfaqe 160 m^2 dhe 42 m^2 . Nëse do të përllogarisnim përdorimin e sipërfaqes së ndërtuar nga vetë “A.H” sh.a për periudhën e mësipërme prej 4 muaj për sipërfaqen e përdorur $202 \text{ m}^2 \times 300 \text{ lekë/m}^2$ në muaj = $60,600 \text{ lekë} \times 4 \text{ muaj} = \mathbf{242,400}$ lekë të ardhura të munguara.

➤ Nga auditimi i zbatimit të kontratës nr. 416, datë 19.10.2010 me objekt “*Kryerjen e shërbimit të pastrimit të ambienteve të brendshme dhe pastrim sistemim gjelbërim i ambienteve të jashtme të SUT*” rezultoi se vlerat e likuiduara për zërin “*Mirëmbajtje rrugësh 11,228 m²*” për vitin 2010 deri 2015 është likuiduar në vazhdimësi nga subjekti “S-A” sh.p.k i pa shoqëruar me dokumente argumentuese e justifikuese, me efekte financiare në vlerën **2,786,790** lekë, duke marrë për bazë çmimin fillestar. (të pa indeksuar), ($557,358 \text{ lekë/vit} \times 5 \text{ vite} = 2,786,790 \text{ lekë pa TVSH}$).

➤ Nga auditimi në SUT konstatohen rritje të shpenzimeve të konsumit të energjisë elektrike për vitin 2016 në vlerën 20,974,442 lekë dhe për vitin 2017 në vlerën 25,021,955 lekë, respektivisht më tepër **4,047,513** lekë. Kjo për arsyen se SUT-së bazuar në kontratën e koncesionit/PPP nënshkruar nga MSH në korrik 2015 me kompaninë “S” shp.k “*Për ofrimin e shërbimeve të integruara të furnizimit të setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale sterile, furnizim me material mjekësor steril të një përdorimesh në sallat kirurgjikale, trajtimin e mbetjeve me rrezik biologjik dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikale*” neni 19 “*Detyrimet e tjera të palëve*” nënpika 19.5 përcakton: “Në qendrat e BACK-up, përveç qendrës Back-up tek QSUT,



Autoriteti i siguron Koncesionarit energji elektrike, uji, avull, vepra civile, impiante etj, me shpenzime në ngarkim të Autoritetit” i është shtuar dhe furnizimi me energji elektrike i koncesionarit të sterilizimit duke rënduar shpenzimet e SUT, e njëjta situatë dhe për furnizimin me ujë.

c A/2. Gjetje nga auditimi i zbatimit të detyrave të lëna nga auditimet e mëparshme në SUT me shkresën nr. 1115/75, dt. 23.01.2017.

➤ Nga auditimi i ushtruar në zbatim të programit të auditimit u konstatuan raste të mos zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH, me vendimin e kryetarit nr. 192, datë 31.12.2016 të përcjella në SUT me shkresën nr. 1115/75, dt. 23.01.2017 ku është **rikërkuar** marrja e masave për zbatimin e rekomandimeve masave shpërblim dëmi e cila **rezulton e pa zbatuar**; nga subjekti “**S.A**” janë përdorur *pa kontratë dhe pa pagesë sipërfaqja e tepërt prej 1200 m²*, referuar kontratës së qirasë së datës 28.08.2013, të lidhur me ish Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, duke i shkaktuar SUT dëm ekonomik në shumën **7,560,000 lekë**.

d. Disa konstatime dhe gjetje të tjera kyçe.

➤ Nga SUT nuk janë hartuar raportet e monitorimit të shpenzimeve për vitin 2016 dhe 2017, me informacionin e plotë me shpjegimet përkatëse lidhur me ndryshimet e PBA, buxhetit nga plani fillestar deri në atë përfundimtar, në nivel programi dhe artikulli, lidhur me ndryshimet e planit të produkteve, si në sasi dhe në vlerë në përputhje me Udhëzimet e Ministrit të Financave për zbatimin e buxhetit të shtetit. Mungon një analizë me argumentet e plota në lidhje me mosrealizimin e produkteve dhe masat që parashikohen në të ardhmen për realizimin e tyre. Nuk është e paraqitur Performanca e produkteve e lidhura me realizimin e objektivave dhe politikës së programit ku të shpjegohej cilat ishin objektivat sipas PBA, politikat e çdo programi si dhe sa janë realizuar këto objektiva në kundërshtim me udhëzimin e MF nr. 22, datë 17.11.2016 “*Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore*” si dhe referuar nenit 24 “Monitorimi i ligji nr. 10296 datë 08.07.2010 i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 “*Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin*”.

➤ Nga auditimi mbi inventarizimin e aktiveve, konstatohet se në SUT bazuar në kontratat e lidhura nga Ministria e Shëndetësisë referuar Marrëveshjes së kredisë nr. 8098.6 “*Fuqizimi i Qendrës së Traumës*” mes Qeverisë Shqiptare dhe asaj Italiane ka vijuar zbatimi i kontratave të furnizimit me pajisje mjekësore në shumën 613,415,047 lekë si dhe pajisje hotelerie në shumën 93,662,526 lekë. Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga SUT, procesverbaleve të marrjes në dorëzim, kolaudimit dhe instalimit të tyre, **rezulton se këto pajisje kanë ardhur dhe qëndruar në ambientet e SUT nga muaji mars i vitit 2017 deri në muajin qershor 2017 dhe nuk kanë qenë në përgjegjësinë e asnjë personi të SUT.** (procesverbali i parë i marrjes në dorëzim datë 09.06.2017)

- Këto pajisje janë bërë hyrje në magazinë pa çmime dhe pa fature shitje etj. Administrimi i tyre në librat e magazinës kryhej pa përshkruar asnjë të dhënë specifike, kod ose prodhues të pajisjes me qëllim identifikimin dhe shmangien e tjetërsimit të tyre.

- Pajisjet e Hotelerisë janë marrë në dorëzim në muajin gusht nga komisioni i ngritur për marrjen në dorëzim të tyre, **këto pajisje janë bërë hyrje në magazinë vetëm në muajin tetor 2017**, deri në këtë periudhë këto pajisje nuk kanë qenë në përgjegjësinë e askujt dhe nuk është kryer asnjë nga procedurat e parashikuara në Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”.

➤ Nga auditimi konstatohet nga SUT gjatë vitit 2017 janë nxjerrë jashtë përdorimit aktive në vlerën **49,854,683 lekë**. Referuar procedurës dhe procesverbaleve të nxjerrjes jashtë përdorimi dhe asgjësimit nga ana e SUT për asgjësimin e këtyre materialeve **nuk ka asnjë dokumentacion lidhur me procedurën e kryer nga komisioni i asgjësimit**, si vlerësimi dhe ndarja e materialeve sipas destinacionit të tyre, materiale për ankand ose materialeve që duhet të groposen, mjetin e transportit i cili ka kryer transportin e tyre, si dhe vend ndodhjen e groposjes



së tyre, djegien etj. të shoqëruar me fotot përkatëse, duke mos e faktuar nxjerrjen jashtë përdorimi dhe asgjësimin e materialeve në vlerën 49,854,683 lekë në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Komisionet e Vlerësimit të Aktiveve dhe nxjerrjen jashtë përdorimit, në përfundim të procesit të inventarizimit të aktiveve të SUT, nuk kanë përpiluar një raport përmbledhës mbi rezultatin e inventarëve duke krahasuar gjendjen kontabël me atë fizike të raportuar nga komisionet e inventarizimit të aktiveve në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

➤ Nga auditimi i Shpenzimeve për karburant e lëndë djegëse, rezulton se konsumi i tyre kryhet sipas normativave të harxhimit të miratuara në vitin 2010, nga Brigada e Logjistikës e Ministrisë së Mbrojtjes pa u rifreskuar me normativa të reja referuar dhe amortizimit. Me urdhrat përkatës të drejtorit të SUT për vitin 2016 dhe 2017 është vendosur që për ambientet e SUT (Pavionet, Urgjenca e Politraumës dhe Poliklinika) duke filluar nga data 15 e muajit nëntor deri në 15 mars të vitit respektiv, ngrohja të kryhet për 4 orë në ditë nëpërmjet ndezjes së kaldajës qendrore e cila funksionin me lëndë djegëse e llojit naftë, me orar të reduktuar prej dy orësh në mëngjes 06⁰⁰-08⁰⁰ dhe në mbrëmje nga ora 18⁰⁰-20⁰⁰. Për të dy vitet konsumi i lëndës djegëse arrin rreth 11,700 litra, shpenzim që nuk garanton ngrohjen e gjithë ambienteve dhe ofron kushte minimale hospitalizimi duke cenuar sigurinë e shëndetit të pacientëve.

➤ Nga FSDKSH janë likuiduar 81,098,160 lekë për shërbimin e periudhës shtator dhjetor 2017 në zbatim të kontratës e koncesionit/PPP nënshkruar nga MSH në korrik 2015 me kompaninë “S” shp.k “Për ofrimin e shërbimeve të integruara të furnizimit të setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale sterile, furnizim me material mjekësor steril të një përdorimesh në sallat kirurgjikale, trajtimin e mbetjeve me rrezik biologjik dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikale” shërbim për të cilin nuk ka asnjë monitorim apo dhe konfirmim nga SUT, të llojit të ndërhyrjes, numrit të operacioneve të kryera, për të cilat koncesionari paguhet nga FSDKSH. Në bllokun operator vetëm kryheshin rakordime mbi setet e përdorura për çdo ditë, i cili firmosej nga Kryeinfermieri i pavionit dhe personi i autorizuar i koncesionarit. Mos kryerja e monitorimit dhe mos konfirmimi i shërbimit është në kundërshtim me Pikën 11 të kontratës “Raportime”.

➤ SUT ka lidhur marrëveshje kuadër për “furnizimin me pajisje ortopedike për operacionet” që kryen në këtë spital për periudhën 2016-2018. Nga audituesit u përzgjedhën disa komponentë të pajisjeve ortopedike (të cilat janë dhe më të kushtueshme) për të cilat u verifikuan procedura e administrimit të tyre, kërkesa që hartohet nga blloku operator i ortopedisë, furnizimi nga operatori ekonomik, marrja në dorëzim nga Farmacia e SUT-së si dhe verifikimi me librin e Kryeinfermierit për operacionet e kryera dhe vendosjen e pajisjes në trupin e pacientit. Nga kryqëzimi i këtyre dokumenteve rezultoi se pajisjet janë bërë hyrje bazuar në faturat e shitjes, në përmbajtje të të cilave janë përshkrimi i produktit, sasitë, çmimi, vlerën e faturës në total si dhe kodet përkatëse të këtyre pajisjeve. Bazuar në këto kode u bë verifikimi i pajisjeve që bëheshin dalje nga farmacia drejt sallës operatore me fletëdaljet përkatëse nënshkruar nga farmacistja si dhe nga marrësi i produktit kryeinfermieri i bllokut operator ku u konstatua se kodi i pajisjes i bërë hyrje në farmaci dhe për të cilin është paguar furnizuesi nuk korresponдон me kodin e pajisjes së vendosur në trupin e pacientit.

➤ Gjatë viti 2016 dhe 2017 nga SUT janë kryer 31 procedura prokurimi për blerje medikamente dhe materiale mjekësore me fondin limit në vlerën **211,984,364** lekë pa tvsh nga të cilat 7 procedura prokurimi “Procedurë e hapur” në vlerën 55,914,310 lekë, 10 procedura prokurimi “Kërkesë për propozim” në vlerën 39,363,549 lekë, 14 procedura prokurimi “Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës” në vlerën 116,706,403 lekë, të cilat duhet ti kryente Ministria e Shëndetësisë dhe urdhrat e prokurimit e nxjerra nga SUT janë në kundërshtim me VKM nr. 135, datë 20.2.2013 “Për lejimin e Ministrisë së Shëndetësisë për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të institucioneve të varësisë, për disa mallra e shërbime” ku është përcaktuar: *Lejimi i Ministrisë së Shëndetësisë, si organ qendror blerës, për kryerjen e procedurave të prokurimit, në emër dhe për llogari të*



spitaleve publike në varësi të saj, për blerjen e medikamenteve dhe materialeve mjekësore. Pika 4. Organi qendror blerës ka këto detyra dhe përgjegjësi: të zhvillojë procedurat për prokurimin e përqendruar të medikamenteve dhe materialeve mjekësore, për nevojat spitalore, përfshirë procedurat e prokurimit me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit.

➤ SUT ka kryer procedura prokurimi “Procedurë me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit” me vlerën limit 37,236,153 lekë për vitin 2016 dhe 79,470,250 lekë për vitin 2017 ku Njësitë e prokurimit kanë hartuar relacionin drejtuar drejtorit të SUT “Për përzgjedhjen e procedurës së prokurimit “Procedurë me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit” në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 36, “Procedura me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës” pika c) pasi nuk është e argumentuar nevoja ekstreme për materialet mjekësore e medikamentet dhe se neglizhenca apo vonesat në fillimin e procedurave normale të prokurimit nuk janë shkaqe, që argumentojnë zbatimin e kësaj procedure.

➤ Nga auditimi i regjistrit të shërbimit me shtretër për muajin tetor nëntor dhjetor 2017 i cili plotësohet mbi bazën e kartelave të shtrimit simbas pavioneve rezulton se për këta muaj numri i pacientëve të shtruar gjendje çdo mbi bazën e kartelave ditore të shtrimit për pacientët është më i madh se kapacitetet ditore të shtretërve simbas pavioneve. (numri ditor i shtretërve spitalorë është 236).

➤ Nga auditimi i urdhër shpenzimeve për periudhën tetor – dhjetor 2017 për shërbimin e gatimit dhe shpërndarjen e ushqimit rezultoi se pasqyrat e gjendjes e lëvizjes së forcës së SUT-së për çdo datë e cila plotësohet mbi bazën e fletë forcës ditore dhe lëvizjes së forcës gjatë 24 orëve e plotësuar nga kryeinfermieri dhe shefi i shërbimit të çdo pavioni, nuk rakordon me numrin e pacientëve të shtruar në SUT referuar regjistrin të shërbimit me shtretër i cili plotësohet mbi bazën e kartelave të shtrimit simbas pavioneve dhe me forcën e shtruar e likuiduar çdo ditë për ushqimin të plotësuar nga kryeinfermierët dhe shefat e pavioneve. Bazuar në regjistrin e shërbimit me shtretër për muajt tetor, nëntor, dhjetor 2017 i cili plotësohet mbi bazën e kartelave të shtrimit simbas pavioneve rezulton se, për këta muaj numri i pacientëve të shtruar gjendje çdo ditë është më i madh se kapacitetet e shtretërve simbas pavioneve (numri ditor i shtretërve spitalorë është 236) dhe dukshëm më i lartë se forca e shtruar e likuiduar çdo ditë për ushqimin të plotësuar nga kryeinfermierët dhe shefat e pavioneve. Bazuar në regjistrin e shërbimit me shtretër rezulton se një numër i konsiderueshëm pacientësh të shtruar nuk janë trajtuar me shërbimin e ushqimit.

➤ Nga auditimi i likuidimit të shërbimit të lavanderisë për periudhën e përzgjedhur 01.10. 2017 deri 31.12. 2017 rezulton se:

- Sasitë e kërkesave nga pavionet nuk përputhen me sasitë e fletë daljeve të bëra për operatorin.
- Mbi bazën e materialeve të dorëzuara nga kryeinfermierët e pavioneve, komisioni i marrjes në dorëzim të mallit për çdo datë ka hartuar procesverbalin përkatës “mbi pritjen, kontrollin dhe marrjen në dorëzim të materialeve të buta për shërbimin e lavanderisë dhe hotelerisë në SUT, pasi i numëroi, peshoi, kontrolloi cilësinë e materialeve të buta (sipas specifikimeve teknike të përcaktuara në kontratën nr. 132/14, dt. 07.12.2016)”. Ky procesverbal (akt akordimi) shoqërohet me përmbledhësen e shërbimit të lavanderisë të “DEVIS” shpk për pavionet e SUT, për periudhat përkatëse mujore, vetëm me sasitë ditore në kg për çdo artikull, pa sasitë në copë dhe pa numrin e shtretërve për çdo ditë.

- Nuk ka një dokument ku sasitë e trajtuara nga lavanderia të cilat janë marrë në copë të jenë shpërndarë nga sipërmarrësi sipas pavioneve të mara nga kryeinfermierët kjo sipas përcaktimit të kontratës. Si rezultat sasia e pasqyruar në përmbledhësen e shërbimit të lavanderisë, Aktrakordimit mujor për likuidim dhe procesverbaleve ditore të mbajtura nga komisioni nuk përputhen me sasitë e parashikuara, pasqyruara dhe të dorëzuara nga kryeinfermieret e pavioneve.

➤ Nga auditimi i zbatimit të shërbimit të lavanderisë, bazuar në parashikimet e kryeinfermierëve, sasitë në copë të mara nga operatori dhe pasqyrave përmbledhëse në kg të sasive të trajtuara me shërbimin e lavanderisë 2017, rezulton se disa materiale të parashikuara



nuk janë trajtuar me shërbimin e lavanderisë sipas afateve të përcaktuara në kontratë si: “Çarçafë shtrati, i sipërm”, “Çarçafë zarf”, “Jastëkë”, “Mbulesë e gomuar”, “kompresa operacioni”, “Çarçafë operacioni (110-130) dhe Çarçafë operacioni (140-130)”, “Kostume ekipi i sallës”, “Përparëse operacioni”, “Kapuça operacioni”, “Pantofla personeli”. Mos kryerja e shërbimit të domosdoshëm dhe të detyrueshëm të lavanderisë për një sërë artikujsh të parashikuar në kontratë ka cenuar ruajtjen dhe mbrojtjen e shëndetit të pacientëve.

➤ Njësia e Auditimit të Brendshëm verifikoi dokumentacionit ditor që përdorej nga farmacia e SUT dhe konstatoi se në farmaci ndodheshin disa blloqe me emërtimin “*Blloqe tërheqjes së materialeve nga pavioni*” për të gjithë pavionet e SUT. Këto blloqe përdorreshin si dokument dalje ditore nga farmacia për mallrat, që i jepeshin pavioneve, gjë që vërtetohet nga praktikat e dokumentacioneve të verifikuara. Farmacia nuk përdor dokumentin fletëdalje për mallrat që nxirrte nga magazinë, por bazohej në dokumentet e mësipërme pa numër rendor, ku firmosej nga shefi i pavionit kryeinfermieri dhe magazinierja. Sa më lart në kundërshtim me UMF nr. 30 dt. 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitet e sektorit publik*”.

➤ Për vitin 2016 janë realizuar 30 procedura prokurimi të pa planifikuara të pa pasqyruara në regjistrë, në kundërshtim me nenin 57, pika 2, e VKM nr. 914 dt. 29.12.2014 i ndryshuar, pika II/1 germa “i” e Manualit të “*Prokurimit Publik*” i ndryshuar.

- Nga Njësia e Prokurimit për vitin 2016 nuk janë dërguar në APP regjistrat e realizimit 4 mujor të prokurimeve për tremujorin e II, III, IV, janë dërguar vetëm për 4 mujorin parë me nr. 7/2 dt. 02.03.2016, që është në kundërshtim me nenin 12, pika 4, Kreu II, të Ligjit Nr. 9643, 20.11.2016 “*Për prokurimin publik*” i ndryshuar, neni 57, pika 2 e VKM nr. 914, dt. 29.12.2014 i ndryshuar, e cila ngarkon me përgjegjësi Njësinë e Prokurimit të SUT.

- Nuk janë pasqyruar vlerat e fondit limit të prokuruar dhe nuk janë pasqyruar burimi i fondeve për procedurat e prokurimit që nuk janë përfshirë në regjistrat e parashikimeve të prokurimeve për vitin 2016.

➤ Nga auditimi konstatohet se NJAB ka hartuar planin vjetor 2017 me subjektet që do të auditohen, planifikimin e kostove të njësisë, etj. si dhe janë identifikuar dhe vlerësuar risqet kryesore për veprimtarinë e SUT-së. Për vitin 2017 është planifikuar dhe realizuar një mision auditimi përputhshmërie që përfshin 15 fusha auditimi duke lënë jashtë fushës së auditimit administrimin e pronës së SUT-së, mision i filluar në muajin mars dhe i përfunduar në muajin dhjetor 2017. Programimi dhe realizimi i një misioni të vetëm për gjithë njësitë që operojnë brenda SUT, kërkon kohë shumë të gjatë audituese duke mos sjellë efektivitetin e pritshëm për përmirësimin e punës së kryer nga menaxhimi i SUT-s.

➤ Spitali Universitar i Traumës nuk ka përgatitur programin e transparencës ku të përcaktojë kornizën ligjore të veprimtarisë së tij, si një mënyrë konkrete përmes së cilës SUT ndërton dhe rrit transparencën në punën e tij institucionale, nën garancinë e ligjit për të drejtën e informimit duke e përditësuar herë pas here programin e transparencës. Mungon faqja zyrtare në web ku mund të publikohet informacioni i programit që synon të bëjë transparencën e veprimtarisë së punës së SUT-së, nëpërmjet pasqyrimit të detajuar të tij në faqen zyrtare i cili duhet të pasqyrohet në rubrika, tekste/përmbajtje, afat kohor për bërjen publike të tij, mënyrën e bërjes publike si dhe strukturën përkatëse e cila prodhon ose administron dokumentin, ku çdo dokument duhet të jetë i aksesueshëm edhe në skemë. Për sa më lart është vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 119, dt. 18.09.2014 “*Për të drejtën e informimit*”.

Në mënyrë të përmbledhur konstatimet dhe gjetjet si më poshtë:

III. REZULTATET E AUDITIMIT.

I. Zbatimit të detyrave të lëna në Auditimin e mëparshëm.

Në subjektin SUT është ushtruar auditim në zbatim të programit të auditimit nr. 788/1, datë 10.09.2015, “*Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomiko-financiare*”, për



periudhën 01.01.2014 deri 30.09.2015 ku në përfundim të auditimit janë konstatuar disa mangësi dhe shkelje të akteve ligjore e nënligjore në fuqi, të cilat më hollësisht janë trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 171, datë 28.12.2015 të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 788/7, datë 28.12.2015.

Nga auditimi i ushtruar në zbatim të programit të auditimit nr. 1115, dt. 04.11.2016 “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme për 3-mujorin e IV të vitit 2015 dhe 9- mujorin e vitit 2016”, janë konstatuar raste të mos zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH, të cilat më hollësisht janë trajtuar në raportin përfundimtar të auditimit, si dhe në vendimin e kryetarit nr. 192, datë 31.12.2016 dhe janë përcjellë në SUT me shkresën nr. 1115/75, dt. 23.01.2017 ku bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, është **rikërkuar** marrja e masave për zbatimin e rekomandimeve masave shpërblim dëmi si më poshtë:

- Nga SUT, të kontabilizohet dhe të kërkohet në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit ekonomik, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, për rastet e mëposhtme:

1. Nga auditimi konstatohet se, nga subjekti “S.A” janë përdorur pa kontratë dhe pa pagesë sipërfaqja e tepërt prej 1200 m², referuar kontratës së qirasë së datës 28.08.2013, të lidhur me ish Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, duke i shkaktuar SUT dëm ekonomik në shumën 7,560,000 lekë.

Menjëherë

Për vlerën e mësipërme SUT me shkresën nr. 39, dt. 18.01.2016 ka njoftuar subjektin për detyrimin prej 7,560,000 lekë për përdorimin pa kontratë dhe pa pagesë të një sipërfaqe prej 1200 m². SUT nuk ka depozituar kërkesë padi pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë. Gjithashtu vlera e mësipërme nuk është kontabilizuar dhe nuk ka filluar arkëtimi.

Nga auditimi i kryer mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme (masa organizative nr. 6) rezultoi se:

- Spitali Universitar i Traumës, me shkresën nr. 439, dt. 28.03.2017 ka raportuar në KLSH në lidhje me ecurinë e rekomandimeve të lëna nga KLSH-ja me shkresën nr. 1115/75, dt. 23.01.2017 “mbi auditimin e zbatimit të rekomandimeve të mëparshme” ku në lidhje me rekomandimin e mësipërm raporton se: “Në lidhje me këtë pikë SUT ka filluar dhe vazhduar komunikimet dhe takimet me spitalin Amerikan, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes. Pas plotësimit të dosjes me të gjitha kontratat e hershme që janë lidhur midis S.A dhe Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (që nga viti 2006), është proceduar me caktimin e një topografi të licensuar për matjen faktike të sipërfaqeve me kontratë, pa kontratë dhe ndërtime pa leje. Pas përfundimit të këtyre matjeve dhe hartimit të planimetrive për të cilat palët kanë rënë dakord, është dërguar shkresa “Kërkesë për prononcim” në Ministrinë e Shëndetësisë në cilësinë e organit të varësisë administrative të SUT dhe në dijeni të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes në cilësinë e pronarit. Vetëm pas saktësimit të këtyre sipërfaqeve mund të procedohet për pagesat e pa kryera nëpërmjet Marrëveshjeve të mëtejshme mes palëve ku detyrimisht përfshihen edhe Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes. SUT është në pritje të një përgjigje në bazë të shkresës së mësipërme”.

Gjithashtu me shkresën nr. 1054, dt. 12.09.2017 kërkesë për prononcim e ridërguar me nr. 1486, dt. 13.12.2017 e Drejtorit të SUT z. A.Z drejtuar Ministrit të Shëndetësisë, shkresa nr. 359, dt. 15.09. 2017 kërkesë për prononcim e Ministrit të shëndetësisë dhe për dijeni ministrit të MZHETTS ku **kërkohet se në detyrat e KLSH-së** kërkohet: Nga SUT, në bashkëpunim me



Ministrinë e Shëndetësisë si ministria përgjegjëse për administrimin dhe me MZHETTS në cilësinë e pronarit të kërkohet:

- 1- Zgjidhja e statusit të sipërfaqeve të tepërta që administrojnë subjekti “A.H” shpallur deri në lirim të ambienteve ose lidhjen e kontratave për ambientet e shfrytëzuara jashtë kontratës.
- 2- Zgjidhja e statusit të ndërtimeve pa leje dhe pa kontratë të sipërfaqeve të ndërtuara mbi objektet e SUT dhe pagesat për sipërfaqet shtesë dhe të përdorura pa kontratë.
- 3- Pagesa e qirasë nga ana e shoqërisë “A.H” shpallur për periudhën nga viti 2011 e vazhdim, periudhë në të cilën ka vazhduar aktivitetin e saj në ambientet e SUT pa kontratë dhe pa paguar qira.

Pas takimeve të realizuar mes palëve të MZHETTS, caktimit të topografit të licencuar me dakordësinë e të dy palëve, kemi arritur në konkluzionet mëposhtme :

Spitali amerikan okupon ambientet e mëposhtme:

- A. Sipërfaqe nën objekt-brenda godinës së SUT një sipërfaqe totale **1696.4 m²**.
- B. Sipërfaqe të objekteve të ndërtuara pa leje ndërtimi mbi objektet e SUT-së. Në një sipërfaqe **222.3 m²**.
- C. Sipërfaqe të objekteve të ndërtuara pa leje ndërtimi mbi territorin e SUT-se në një sipërfaqe **45 m²**.

II. Përputhshmëria ligjore dhe rregullshmëria financiare në planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit të shtetit me ligjin organik të buxhetit, pagat dhe shpërblimet, organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit.

a. Planifikimi i buxhetit, në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Financave për përgatitjen e buxhetit të shtetit, i kryer në çeljen e buxhetit, detajimi i planit fillestar, kompetencat, domosdoshmëria dhe argumentimi i transferimeve të fondeve buxhetore gjatë vitit ushtrimor dhe nivelet e realizimit të planit përfundimtar, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore. Realizimi i produkteve në nivel programi e shprehur në terma sasiorë dhe në vlerë kundrejt treguesve të planifikuar dhe të pasqyruara në raportet e monitorimit.

a/1. Mbi zbatimin e kryerësve dhe procedurave të hartimit të buxhetit për vitin 2017, në mbështetje të udhëzimeve të Ministrisë së Financave për përgatitjen e buxhetit të shtetit.

Projekt buxheti për vitin 2017, është hartuar konform legjislacionit dhe në hartimin dhe formulimin e deklaratave të politikave të programeve buxhetore, janë mbajtur në konsideratë kërkesat e strategjive sektoriale dhe janë dorëzuar në Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, dërguar për fazën e parë dhe të dytë të PBA 2015-2017 në mënyrë elektronike, brenda afatit. Kërkesat buxhetore përmbajnë raportet standarde të përcaktuara në udhëzimet për hartimin e PBA 2015-2017, si misionin, deklaratat, shpenzimet sipas programeve, artikujve, produkteve, si dhe projektet me financim të brendshëm.

a/2. Çeljen e buxhetit të vitit 2015, detajimi i planit fillestar, zbatimi i buxhetit gjatë vitit, nivelet e realizimit të planit përfundimtar, në mbështetje të dispozitave ligjore e nënligjore.

-Me shkresën nr. 199, dt. 31.01.2018, SUT është dërguar evidenca e shpenzimeve për buxhetin e Ministrisë së shëndetësisë për periudhën Janar–dhjetor 2017 i rakorduar me Degën e Thesarit Tiranë.

Ndryshimet e fondeve buxhetore gjatë vitit 2017, janë në rritje, në vlerë totale për 63,836 mijë lekë, ose 31% më shumë se plani fillestar. Kjo shtesë buxheti është bërë në zërin “paga” në vlerën 24,500 mijë lekë, “sigurime” në vlerën 3,636 mijë lekë, “transferata buxhete familjare, individë” në vlerën 35,700 mijë lekë.

Në mënyrë të përmbledhur ndryshimet e fondeve buxhetore për llogaritë e shpenzimeve paraqiten si në tabelë:

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT****RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN UNIVERSITAR TË TRAUMËS”**

Ministria e Shëndetësisë viti 2017:

000/lekë

LLOG.	EMERTIMI	Plani fillestar	Shtesat	Plani përfundimtar.
600	Paga	68,000	24,500	92,500
601	Sigurime	11,300	3,636	14,936
602	Mallra e shërbime	123,145	0	123,145
606	Transf. Buxhete familjare, individ.	0	35,700	35,700
231	Invest kap. Të trupëzuara	0	0	0
	TOTALI	202,445	63,836	266,281

-Me shkresën nr. 200, dt. 31.01.2018, SUT është dërguar evidenca e Shpenzimeve për buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes për periudhën Janar–dhjetor 2017 i rakorduar me Degën e Thesarit Tiranë. Ndryshimet e fondeve buxhetore gjatë vitit 2017, janë në rritje, në vlerë totale për 114,428 mijë lekë, ose 14% më shumë se plani fillestar. Ko shtesë buxheti është bërë në zërin “paga” në vlerën 30,000 mijë lekë, “sigurime” në vlerën 2,000 mijë lekë, “mallra e shërbime” në vlerën 79,772 mijë lekë, “transferta buxhete familjare, individë” në vlerën 2,656 mijë lekë.

Në mënyrë të përmblëdhur ndryshimet e fondeve buxhetore për llogaritë e shpenzimeve paraqiten si në tabelle:

Ministria e Mbrojtjes viti 2017:

000/lekë

LLOG.	EMERTIMI	Plani fillestar	Shtesat	Plani përfundimtar.
600	Paga	324,230	30,000	354,230
601	Sigurime	58,945	2,000	60,945
602	Mallra e shërbime	425,500	79,772	505,272
606	Transf. Buxhete familjare, individ.	0	2,656	2,656
231	Invest kap. Të trupëzuara	5,000	0	5,000
	TOTALI	813,675	114,428	928,103

Buxheti 2017 sipas akt rakordimeve me thesarin:

000/lekë

Llog.	Emërtimi	Shëndetësia			Mbrojtja			TOTALI		
		P	F	%	P	F	%	P	F	%
600	Paga	92,500	92,500	100	354,230	350,568	99	446,730	443,068	99
601	Sigurime	14,936	14,802	99	60,945	60,000	98	75,881	74,802	99
602	Mallra e shërbime	123,145	122,191	99	505,272	486,881	96	628,417	609,072	97
606	Transf. Buxh. Famil, individ.	36	36	100	2,656	2,656	100	2,692	2,692	100
231	Invest kap. Të trupëzuara	0	0	0	5,000	4,905	98	5,000	4,905	98
	SHUMAT	230,617	229,529	100	928,103	905,010	98	1,158,720	1,134,539	98

a/3. Zbatimi i buxhetit të shtetit, në përputhje me dispozitat ligjore. Monitorimi i menaxhimit të shpenzimeve publike, reflektimi në raportet e monitorimit të performancës së produkteve të buxhetit kundrejt kuotave të planifikuara në nivel programi.

1- Për vitin 2017 Spitali Universitar i Traumës ka pasur një buxhet nga Ministria e Shëndetësisë në vlerën total prej 266,281 mijë lekë, i financuar nga buxheti i shtetit i ndarë:

Llogaria 600 - “Paga për personel të përhershëm”, planifikuar në vlerën 92,500 mijë lekë është realizuar në vlerën 92,500 mijë lekë ose 100%;

Llogaria 601 - “Sigurime shoqërore dhe shëndetësore”, planifikuar në vlerën 14,936 mijë lekë është realizuar në vlerën 14,802 mijë lekë ose 99%;




KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN UNIVERSITAR TË TRAUMËS”

Llogaria 602 - “*Mallra dhe shërbime*”, planifikuar në vlerën 123,145 mijë lekë është realizuar në vlerën 122,191 mijë lekë ose 99% ;

Llogaria 606 - “*Transferta buxhete familjare e individë*”, planifikuar në vlerën 36 mijë lekë është realizuar në vlerën 36 mijë lekë ose 100%.

Paraqitja grafike e realizimit të buxhetit të Ministrisë së Shëndetësisë:



Realizimi i llogarisë 602 – “*Mallra dhe Shërbime*” për 122,191,013 lekë, në mënyra analitike paraqitet si në tabelën e mëposhtme:

lekë

Analiza	ZERAT E SHPENZIMEVE	REALIZIMI
6021	Uniforma dhe të tjera veshje speciale lavanderi	15,901,446
6021	Ilace dhe materiale mjeksore oksigjeni, protoksid	106,097,397
6024	Udhëtime jashtë shtetit	192,170
	TOTALI I PËRGJITHSHËM	122,191,013

Referuar të dhënave të mësipërme vihet re se peshën kryesore në këtë llogari e zë blerja e medikamenteve dhe pajisjeve mjekësore e cila përfaqëson 99% të zërit 602 “*Mallra dhe Shërbime*”.

2- Për vitin 2017 Spitali Universitar i Traumës ka pasur një buxhet nga Ministria e Mbrojtjes në vlerën total prej 928,103 mijë lekë, i financuar nga buxheti i shtetit i ndarë:

Llogaria 600 - “*Paga për personel të përhershëm*”, planifikuar në vlerën 354,230 mijë lekë është realizuar në vlerën 350,568 mijë lekë ose 99%;


Llogaria 601 - “*Sigurime shoqërore dhe shëndetësore*”, planifikuar në vlerën 60,945 mijë lekë është realizuar në vlerën 60,000 mijë lekë ose 98%;

Llogaria 602 - “*Mallra dhe shërbime*”, planifikuar në vlerën 505,272 mijë lekë është realizuar në vlerën 486,881 mijë lekë ose 96% ;

Llogaria 606 - “*Transferta buxhete familjare e individë*”, planifikuar në vlerën 2,656 mijë lekë është realizuar në vlerën 2,656 mijë lekë ose 100%;

Llogaria 231 – “*Investime aktive të qend. Të trupëzuara*” planifikuar në vlerën 5,000 mijë lekë është realizuar në vlerën 4,905 mijë lekë ose 98%;

Paraqitja grafike e realizimit të buxhetit të Ministrisë së Mbrojtjes:





KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN UNIVERSITAR TË TRAUMËS”

Realizimi i llogarisë 602 – “Mallra dhe Shërbime” për 486,880,988 lekë, në mënyra analitike paraqitet si në tabelën e mëposhtme:

lekë

Analiza	ZERAT E SHPENZIMEVE	REALIZIMI
6020100	Kancelari	583,800
6020200	Materiale për pastrim, disinfektim, ngrohje dhe ndriçim	516,000
6020300	Materiale për funksionimin e pajisjeve të zyrës	148,592
6021001	Uniforma dhe të tjera veshje speciale lavanteri	64,828,260
6021003	Ilaçe dhe materiale mjekësore, oksigeni, protoksid	191,805,677
6021004	Furnizime dhe shërbime me ushqim për mensat	59,756,525
6021009	Materiale dhe pajisje laboratorik e të shërb. publik, kitet	3,244,908
6021010	Shpenzime për prodhim dokumentacioni specifik	1,210,200
6022001	Elektricitet	24,707,318
6022002	Ujë	26,194,696
6022003	Shërbime telefonike	300,937
6022004	Posta dhe shërbimi korrier	31,380
6022008	Shërbime të sigurimit dhe ruajtjes	24,512,069
6022009	Shërbime të pastrimit dhe gjelbërimit	40,545,995
6022099	Shërbime të tjera evadim mbeturina	612,535
6023100	Karburant dhe vaj	4,991,604
6023200	Pjesë këmbimi, goma dhe bateri	267,120
6023300	Shpenzimet e siguracionit të mjeteve të transportit	1,184,601
6023900	Shpenzime të tjera transporti	12,495
6024100	Udhëtim i brendshëm	372,500
6025300	Shpenzime për mirëmbajtjen e objekteve ndërtimore	3,164,513
6025500	Shpenzime për mirëmbajtjen e aparateve, pajisjeve teknike dhe veglave të punës	15,418,445
6025600	Shpenzimeve për mirëmbajtjen e mjeteve të transportit	1,660,920
6025800	Shpenzime për mirëmbajtjen e pajisjeve të zyrave	677,000
6026100	Shpenzime për qiramarrje ambientesh	175,200
6027400	Shpenzime për ekzekutim të vendimeve gjyqësore për largim nga puna	18,111,300
6029003	Shpenzime gjyqësore	52,381
6029004	Shpenzime për sigurimin e ndërtesave dhe të tjera kosto sigurimi të ngjashme	0
6029007	Shpenzime për pjesëmarrje në konferenca	1,483,200
6029008	Shpenzime për tatime & taksa të paguara nga institucioni	310,817
	Shuma	486,880,988

Referuar të dhënave të mësipërme vihet re se peshën kryesore në këtë llogari e zënë shpenzimet si më poshtë:

6021001- Uniforma dhe të tjera veshje speciale **lavanteri** 64,828,260 lekë, 13%;

6021003- **Ilaçe** dhe materiale mjekësore, **oksigeni, protoksid** 191,805,677 lekë, 39%.

6021004- Furnizime dhe shërbime me **ushqim** për mensat 59,756,525 lekë, 12%.

6022001- Elektricitet 24,707,318 lekë, 5%.

6022002- Ujë 26,194,696 lekë, 5.3%.

6022008- Shërbime të sigurimit dhe ruajtjes 24,512,069 lekë, 5%.

6022009- Shërbime të **pastrimit** dhe gjelbërimit 40,545,995 lekë, 8%.

6025500- Shpenzime për mirëmbajtjen e aparateve, pajisjeve teknike 15,418,445 lekë, 3.1%.

6027400- Ekzekutim të vendimeve gjyqësore për largim nga puna 18,111,300 lekë, 4%.

Sa shikohet edhe nga pasqyra më sipër vetëm dy zëra shpenzimesh zënë 52% të shpenzimeve për mallra e shërbime:



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN UNIVERSITAR TË TRAUMËS”

- Uniforma dhe të tjera veshje speciale lavanteri 64,828,260 lekë, 13%;
- Ilaçe dhe materiale mjekësore, oksigjeni, protoksid 191,805,677 lekë, 39%.,

a/4. Mbi zbatimin e kriterëve dhe procedurave të hartimit të buxhetit me destinacion fondet e investimeve për vitin 2017, argumentimi i kërkesave për transferimet dhe ndryshimet për shtesa e pakësim të fondeve për investime.

- Çelja e buxhetit për zërin 231 investime me fondet e Ministrisë së Mbrojtjes është për vlerën 5,000,000 lekë dhe i takon projekteve si më poshtë vijojnë:
- Ndërrimi i dyerve të godinës së Spitalit universitar të Traumës për vlerën 5,000,000 lekë i cili është realizuar në vlerën 4,904,880 lekë.

b. Përputhshmëria ligjore për marrëdhëniet e punës dhe të pagave, realizimi i fondit të pagave (plan, fakt dhe në %) dhe krahasimi me vitet e kaluara, kontributin e sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe tatimin mbi të ardhurat personale.

- Organizimi dhe funksionimi i SUT në përputhje me rregulloret e miratuara. Zbatimi i strukturës organizative, organikës.

Bazuar në pikën 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1001, datë 02.12.2015 “për integrimin e Spitalit Universitar të Traumës dhe Spitalit Ushtarak të Forcave të Armatosura në një strukturë të bashkuar” është bërë miratimi i strukturës dhe organikës së SUT-S për vitin 2016, nga Kryeministri me urdhrin nr. 95, datë 07.06.2016, financimi i pagave kryhet nga dy Ministrinë, nga Ministria e Mbrojtjes dhe nga Ministria e Shëndetësisë (FSDKSH).

Sipas bazës ligjore, për vitin 2016, numri i punonjësve në SUT ka qenë 332 për punonjësit civil dhe 124 për punonjësit ushtarak gjithsej 456 punonjës (në fillim të vitit, bazuar në organikën e miratuar të vitit 2015) me një fond page të realizuar prej 365,164,933 lekë duke përfshirë dhe fondin për sigurime shoqërore e shëndetësore 51,624 mijë lekë. Fondi për pagat ka ndryshuar, duke u rritur në 7 milion lekë dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore në 1.2 milion lekë në muajin Gusht dhe janë pakësuar fondi i pagave me 10 milion lekë në fund të vitit dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore me 3,5 milion.

2016	Emërtimi MM +MSH	Plan	fakt	ndryshimi	%
600	Paga, shpërblime	319,406,800	315,726,282	3,680,518	99%
601	Kont.sig. shoq. shëndetësor	51,624,000	49,253,492	2,370,508	95%
606	Fondi i veçantë	558,800	540,935	17,865	97%

Organika e SUT gjatë vitit 2016 ka ndryshua bazuar dy urdhrave të Ministrisë të Shëndetësisë :

- me urdhër të Ministrisë të Shëndetësisë nr. 38, datë 01.02.2016 “Për transferimin e personelit të Shërbimit të Urgjencës Mjekësore” i është shtuar organika me 20 punonjës, të profesioneve mjek, infermier dhe shoferë.

- me urdhër të Ministrisë të Shëndetësisë nr. 573, datë 27.12.2016 sërish Organikës së SUT “Për kalimin e shërbimit të Traumatologji-Ortopedisë, nga Qendra spitalore Universitare Nënë Tereza, në Spitalin e Traumës”, i është shtuar organika me 85 punonjës, shoqëruar me transferimin e fondin përkatës të pagave, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si dhe fondin në zërin “Mallra-shërbime” të nevojshëm për funksionimin e shërbimit të Ortopedi-Traumatologjisë, me efekte financiare të cilat fillojnë nga data 1 janar 2017.

Drejtoria e SUT bazuar në organikën e miratuar ka bërë emërimin e punonjësve për çdo pozicion pune.

Për vitin 2016 bazuar në të dhënat e paraqitura dhe varësinë institucionale, rezulton se kemi ndryshim në numër të punonjësve i cili sipas muajve varion si më poshtë :

Nuri i punonjësve për vitin 2016.

Nr:	Periudha	Emërtimi i Strukturave	OFICERË	N/OFCERE	Ushtare aktive	CIVIL	TOTALI Personel
-----	----------	---------------------------	---------	----------	-------------------	-------	--------------------



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN UNIVERSITAR TË TRAUMËS”

		te varësisë	Limit	Fakt	Limit	Fakt	Limit	Fakt	Limit	Fakt	Limit	fakt
1	Janar	SUT							332	331	332	331
		NJ.M.U	63	58	48	43	1	1	12	11	124	113
		Shuma									456	444
2	Shkurt	SUT							332	330	332	330
		NJ.M.U	63	58	48	42	1	1	12	11	124	112
		Shuma									456	442
3	Mars	SUT							332	329	332	329
		NJ.M.U	63	57	48	42	1	1	12	11	124	111
		Shuma									456	440
4	Prill	SUT							332	328	332	328
		NJ.M.U	63	57	48	41	1	1	12	11	124	110
		Shuma									456	438
5	Maj	SUT							332	331	332	331
		NJ.M.U	63	57	48	41	1	1	12	11	124	110
		Shuma									456	441
6	Qershor	SUT							332	329	332	329
		NJ.M.U	63	57	48	41	1	1	12	11	124	110
		Shuma									456	439
7	Korrik	SUT							332	327	332	327
		NJ.M.U	65	57	51	42	2	0	22	14	140	113
		Shuma									472	440
8	Gusht	SUT							332	328	332	328
		NJ.M.U	65	57	51	42	2	1	22	14	140	114
		Shuma									472	442
9	Shtator	SUT							332	327	332	327
		NJMU	65	60	51	44	2	1	22	21	140	126
		Shuma									472	453
10	Tetor	SUT							332	328	332	328
		NJ.M.U	65	62	51	45	2	1	22	28	140	136
		Shuma									472	464
11	Nëntor	SUT							332	329	332	329
		NJ.M.U	65	60	51	44	2	1	22	32	140	137
		Shuma									472	466
12	Dhjetor	SUT							332	330	332	330
		NJ.M.U	65	60	51	44	2	1	22	32	140	137
		Shuma									472	467

Si dhe vihet re nga tabela, asnjëherë nuk kemi plotësim të organikës së plotë me punonjës, dhe nuk është kaluar limiti i miratuar në numër punonjësish. Por duke e analizuar çdo muaj, rekrutimi i punonjësve për vendet vakante rritet me një ose dy punonjës për punonjës civil, ndërkohë që për punonjës me status ushtaraku, ka muaj që ndryshimi varion nga 1- 10 punonjës të rekrutuar. Kjo tregon se SUT nuk ka pasur një strategji rekrutimi të punonjësve, lënia vakant e posteve të punës tregon se parashikimi i numrit të punonjësve nuk është bërë mbi nevojat reale që i nevojiten SUT, dhe këto poste pune fare mirë janë mbuluar nga punonjës aktual pra në këndvështrimin e dinamikës së lëvizjeve të numrit të punonjësve, për vitin 2016 konstatojmë se nuk ka pasur një studim të thelluar për çdo pozicion pune dhe nevojat reale të personelit që do ti mbulojë ato.

Për vitin 2017, struktura organizative e SUT, është miratuar me urdhrin nr. 30, datë 13.03.2017 të Kryeministrit.

Ky urdher përcakton që numri i punonjësve në SUT do të jetë 630 vetë nga të cilët 141 punonjës janë pjesë e strukturës së spitalit që financohet nga Fondi i Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH). Pra kemi një rritje të numrit të punonjësve me 167 punonjës. Sipas bazës ligjore, në fillim të vitit 2017, numri i punonjësve në SUT ka qenë 463 punonjës me një fond page 446,730, milion lekë dhe sigurime shoqërore e shëndetësore 75,845 milion lekë.

Për vitin 2017 bazuar në të dhënat e paraqitura dhe varësinë institucionale, rezulton se kemi ndryshim në numër të punonjësve i cili sipas muajve varion si më poshtë :

Numri i punonjësve për vitin 2017

Nr:	Periodha	Emërtimi i Strukturave te varësisë	OFICERË		N/OFCIERE		Ushtare aktive		CIVIL		TOTALI Personel	
			Limit	Fakt	Limit	Fakt	Limit	Fakt	Limit	Fakt	Limit	fakt



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN UNIVERSITAR TË TRAUMËS”

1	Janar	SUT							332	329	332	329
		NJ.M.U	62	59	48	42	0	1	40	32	150	134
		Shuma									482	463
2	Shkurt	SUT							332	328	332	328
		NJ.M.U	62	58	48	42	0	1	40	36	150	137
		Shuma									482	465
3	Mars	SUT							332	333	332	333
		NJ.M.U	62	56	48	42	0	1	40	38	150	137
		Shuma									482	470
4	Prill	SUT							332	331	332	331
		NJ.M.U	62	56	48	42	0	1	40	37	150	136
		Shuma									482	467
5	Maj	SUT							332	330	332	330
		NJ.M.U	62	56	48	42	0	1	40	39	150	138
		Shuma									482	468
6	Qershor	SUT							332	330	332	330
		NJ.M.U	62	57	48	42	0	1	40	38	150	138
		Shuma									482	468
7	Korrik	SUT							332	329	332	329
		NJ.M.U	61	57	47	42	0	1	40	38	148	138
		Shuma									480	467
8	Gusht	SUT							332	329	332	329
		NJ.M.U	61	57	47	42	0	1	40	38	148	138
		Shuma									480	467
9	Shtator	SUT							332	328	332	328
		NJMU	61	57	47	41	0	1	40	39	148	138
		Shuma									480	466
10	Tetor	SUT							332	326	332	326
		NJ.M.U	61	57	47	41	0	1	40	39	148	138
		Shuma									480	464
11	Nëntor	SUT							332	327	332	327
		NJ.M.U	61	56	47	41	0	1	40	39	148	137
		Shuma									480	464
12	Dhjetor	SUT							332	327	332	327
		NJ.M.U	61	56	47	41	0	0	40	39	148	136
		Shuma									480	463

Nga tabela, konstatohet se dhe për vitin 2017, asnjëherë nuk kemi plotësim të organikës së plotë me punonjës, dhe nuk është kaluar limiti i miratuar në numër punonjësish. Por duke e analizuar çdo muaj, rekrutimi i punonjësve për vendet vakante rritet me një ose dy punonjës për punonjësit civil, ndërkohë që për punonjësit me status ushtaraku, ka muaj që ndryshimi varion nga 1- 10 punonjës të rekrutuar. Kjo tregon se SUT nuk ka pasur një strategji rekrutimi të punonjësve, lënia vakant e posteve të punës tregon se parashikimi i numrit të punonjësve nuk është bërë mbi nevojat reale që mund ti duhen SUT, dhe këto poste pune fare mirë janë mbuluar nga punonjësit aktual.

Pavarësisht se nga ana jonë u kërkuar propozimi i bërë nga SUT për organikën e miratuar nga Kryeministri, nuk na u vu në dispozicion asnjë dokument mbi bazën e hartimit dhe miratimit të një strukture kaq të madhe dhe komplekse në varësi e saj.

- Në situacionin e të ardhurave dhe shpenzimeve për periudhën janar-dhjetor 2017, për të dy Ministrinë plani për pagat ka qenë 446,730 milion lekë dhe është realizuar 443,068 milion lekë ose 99%. Sigurimet shoqërore e shëndetësore plani 75,845 milion lekë dhe të realizuara 74,802 milion lekë.

Treguesit për pagat, sigurimet shoqërore e shëndetësore, planin, ndryshimet e realizimi për vitin 2017, paraqiten në tabelën në vijim:

Viti 2017	Emërtimi MM+MSH	Plan	Fakt	Ndryshimi	Në %
600	Paga, shpërblime	46,730,000	443,068,114	3,661,886	99%
601	Kont.sig. shoq. shëndetësor	75,845,000	74,802,557	1,042,443	99%
606	Fondi i veçantë	2,697,550	2,691,250	6,300	100%

Veprimet për strukturën, numrin e përgjithshëm të punonjësve, respektimin e fondit të pagave dhe sigurimeve shoqërore e të kujdesit shëndetësor, janë mbështetur plotësisht në bazën ligjore.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN UNIVERSITAR TË TRAUMËS”

Nga kontrolli i kryer, rezulton rregullshmëri në derdhjet bankare, krahasimin e shumave të paguara me kartelat, borderotë dhe pasqyrat përmbledhëse. Siglimi i borderove është bërë sipas rregullave nga Titullari i SUT, shefja e sektorit të financës, specialistja e financës për pagat dhe janë të vulosura nga Dega e Thesarit Tiranë.

Listë pagesat janë plotësuar me të gjitha rubrikat e saj për çdo punonjës duke filluar si nga emërtesa sipas strukturës, paga bazë, ditë pune etj. edhe në rubrikën e “shtesave” apo “ndalesave”.

Është mbajtur libri i pagave dhe është plotësuar për të gjithë punonjësit në marrëdhënie pune, duke pasqyruar të gjitha të dhënat e kërkuara. Tatimi mbi pagë është llogaritur konform ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, ndërsa kontributi i sigurimeve shoqërore është llogaritur në zbatim të Ligjit nr. 10070, datë 05.02.2009 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshimet përkatëse, si dhe janë kryer ndalesat e janë derdhur në Degën Rajonale të Tatimeve. Në dokumentacioni i audituar të pagave të punonjësve, ka rezultuar se nuk ka patur shpenzime për udhëtim e dieta.

-Respektimi i dispozitave ligjore për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë, dhënia e shpërblimeve dhe ndihmave për merita të veçanta në kryerjen e detyrave etj

Gjithashtu konstatohet se janë dhënë ndihma dhe shpërblime për dalje në pension dhe për raste fatkeqësie, konform kërkesave të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 929, datë 17.11.2010 “Për krijimin dhe përdorimin e Fondit të veçantë”, i ndryshuar, ku për çdo rast janë është marrë miratimi nga Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Shëndetësisë dhe nuk u konstatuan shkelje të procedurave nga SUT.

Urdh. Shpen z. Nr.	DATA	Progr. 17 - 1 - 07340 PERSHKRIMI VEPRIMIT	BANKA 520	TOTALI 600
120	17.03.17	Shperb.dalje pens. pleq.Qamil Pasho, Luljeta Xhaferri, Hekuran Braho	128,690	
121	17.03.17	Ndihme e menjehershme ne rast fatkeqesie - Edlira Jahollari	30,000	
122	17.03.17	Ndihme e menjeh. per semundje te rende te bashkeshortit - Dorela Vasha	122,000	
171	19.04.2017	Tatim burimi mjek roje dhe dalje ne pension	36,150	13,440
212	05.05.2017	Shperblim per lirim nga detyra dhe dalje ne rezerve te ioficereve aktiv	177,590	
221	15.05.2017	Ndihme financiare Fatos Zhulali	50,000	
292	16.06.2017	Sig.Shoq.Shendet. & Tatim Page - mj.Maj 2017	10,807,842	5,778,415
293	16.06.2017	Shperblim dalje pension pleqerie Viktor Hondro	37,825	
320	22.06.2017	Ndihme financiare Engjellushe Dino	30,000	
391	01.08.2017	Ndihme ek. Rast fatkeqesie Arjan Furxhi	30,000	
425	07.09.2017	Ndihme ek.per semundje te rende te bashkeshortit te Rudina Hoxhes	159,150	
509	20.10.2017	Shperblim dalje ne pension pleqerie per punonjesen Qendrim Myzyri	35,700	
555	06.11.2017	Tatim burimi mjek roje m.Gusht, Tatim shperblim Qendrim Myzyri	31,020	24,720
594	17.11.2017	Ndihme ekonomike per rast fatekeqesie Eriola Gargaj	320,100	
595	17.11.2017	Ndihme ekonomike per semundje Znj.Edlira Kukeli	382,800	
646	21.12.2017	Ndihme ekonomike per semundje te rende te Znj. Dorela Vasha	401,400	
647	21.12.2017	Ndihme ekonomike per semundje te rende te Znj. Rudina Hoxha	323,400	
664	21.12.2017	Pag. Sherbim mjek roje m. Nentor 2017, shherblim V. Hondro	132,430	125,755
744	"	Pag.Ndihme ekonomike per semundje Z.Ramazan Puma	50,000	
747	29.12.2017	Shperblim personeli ushtarak ne emergjencat civile	290,000	
		Totali		2,655,550

Bazuar në VKM nr. 355, datë 7.7.2000 “Për organizimin e dosjes së regjistrit të personelit”, sipas të cilit janë përcaktuar qartë se çfarë dokumentesh duhet të përmbajë dosja personelit, u audituan dokumentet e dosjeve personale të 10 punonjësve dhe ka rezultuar se në të gjitha dosjet vërehen mangësi mbi;

Fletën e inventarit, me listën e gjithë dokumentacionit që ndodhet në dosje nuk është e firmosur si nga nëpunësi dhe përgjegjësi i sektorit të Burimeve njerëzore.

-Mungon, fleta prezantuese të dosjes teknike të nëpunësit, ku duhet të paraqiten të dhëna për: numrin e identifikimit të nëpunësit, emrin, atësinë, mbiemrin; numrin kombëtar të identifikimit ose një të ngjashëm me të; shtetësinë, gjininë; datëlindjen, gjendjen civile, përbërjen familjare, adresën e vendbanimit të përhershëm apo të përkohshëm, arsimimin, kualifikimet (llojet), gradën



shkencore (titulli) dhe njohuri për gjuhët e huaja, datën e fillimit të punës e pozicionon përkatës, përshkrimin e karrierës, dënimet (masa disiplinore, gjyqësore), paga bazë e shtesat etj.

-Mungon kërkesa me arsyet dhe motivimin e punonjësit për punësim pranë SUT-s.

-në të gjitha dosjet, konstatohet se pjesa më e madhe dokumentacionit të punonjësve lidhur me të dhënat që përmban dosja dhe shoqëruar me dokumentin përkatës që vërteton pohimin e bërë, si;

a) Diploma e shkollës së lartë, lista e notave.

b) Certifikata ose diplomat e kualifikimeve ose specializimeve.

c) Dëshmi e mbrojtjes së gjuhëve të huaja.

d) Dokumenti i laurimit me gradë shkencore.

e) Të tjera.

rezulton të jetë fotokopje e pa noteruara duke i kthyer ato nga ana administrativo ligjore të pavlefshme si dokumente.

c. Hartimi dhe plotësimi i pasqyrave financiare përkatëse në përputhje me UMF nr. 14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësitë që varen prej tyre si dhe njësitë të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj”, i ndryshuar me UMF nr. 26, datë 27.12.2007. Ligjshmëria dhe saktësia e plotësimit të dokumentacionit bazë të kontabilitetit (fletëhyrje, fletëdalje, faturë, mandatarëkëtim, mandatpagesë, urdhër shpenzim, etj.)

Nga auditimi u konstatua se:

Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit është bërë në zbatim të Planit Kontabël të miratuar për institucionet dhe UMF nr. 14, datë 28.12.2006, “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe të njësitë që varen prej tyre”, ndryshuar me UMF nr. 26, dt. 27.12.2007 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të institucioneve qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësitë që varen prej tyre si dhe njësitë të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorët e huaj”

Nga SUT hartohen dy pasqyra financiare vjetore përkatësisht:

-Një për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe një për Ministrinë e Mbrojtjes.

c/1. Pasqyrat financiare për vitin 2017 drejtuar Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale janë hartuar dhe depozituar më datë 27.02.2017 brenda afatit ligjor.

Pasqyrat financiare kanë të plotësuar aktiv-pasivin pasqyrat dhe anekset përkatëse dhe informacionin. Veprimet janë kaluar nga dokumentacioni bazë në ditarët përkatës, në librin e madh dhe më tej në bilanc. Janë mbajtur ditarët e bankës, magazinës dhe të ndryshme.

Partitarët analitik të llogarive janë mbajtur dhe azhornuar, si dhe i llogarive inventarjale të magazinës dhe është bërë rakordimi llogari-magazinë.

Auditimi i aktiveve të qëndrueshme:

a. Objektivat e auditimit të aktiveve të qëndrueshme, janë që të sigurohemi se:

Aktivet ekzistojnë fizikisht; ato i përkasin subjektit; janë të vlerësuara në mënyrë korrekte; janë regjistruar në mënyrë korrekte; është bërë mirë ndarja midis shpenzimeve korrente dhe aktiveve të qëndrueshme; informacionet që ndodhen në aneksin përkatës janë të plota dhe e korrekte.

b. Kontrolle të përgjithshme të llogarive dhe dokumenteve:

Për auditimin e aktiveve të qëndrueshme, paraprakisht u kryen një numër kontrollesh të përgjithshme si:

U verifikua tabela e lëvizjeve të aktiveve të qëndrueshme në raport me gjendjet dhe ndryshimin e tyre gjatë periudhës ushtrimore;

U ekzaminua tabela e lëvizjeve, nëse ka ndodhura ndonjë variacion anormal mbi aktivet e qëndrueshme;



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN UNIVERSITAR TË TRAUMËS”

U ekzaminuan të gjitha shpjegimet që janë paraqitur lidhur me shmangiet dhe përjashtimet e veçanta;

U verifikua nëse parimet kontabël të ndjekura prej subjektit për vlerësimin dhe kontabilizimin janë konform parimeve të përgjithshme të pranura dhe udhëzimeve përkatëse.

U verifikua nëse shifrat e çeljes rakordojnë me ato të mbylljes së ushtrimit të mëparshëm;

U krahasuan investimet e realizuara gjatë ushtrimit me ato të planifikuara në buxhet, evidentimi kontabël.

c. Disa nga parimet e zbatuara për auditimin e aktiveve të qëndrueshme:

1. Gjatë hyrjes së aktiveve në pronësinë e subjektit, duhet të sigurohemi se:

- Aktivet e blera kontabilizohen sipas vlerës së tyre të marrjes. (çmimit të blerjes shtuar shpenzimet e tjera të nevojshme për vënien në gjendje përdorimi të pasurisë);
- Aktivet e prodhuara nga subjekti (Nëse ka) kontabilizohen sipas kostos së tyre të prodhimit.
- Aktivet e marra falas kontabilizohen duke i vlerësuar ato me vlerën e shitjes;
- Aktivet e sjella në subjekt nga të tretët nëse kontabilizohen me vlerën e tyre të sjelljes.

(UMF nr. 30, dt. 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”).

2. Për inventarin, duhet të sigurohemi që subjekti:

- Procedon për regjistrimin dhe vlerësimin e aktiveve të saj të qëndrueshme sipas rregullave kontabël përgjithësisht të pranura;
- Përdor referencat ose teknikat më të përshtatshme për natyrën e pasurisë (çmimi i tregut, tabelat e publikuara, treguesit specifike, etj.);
- Ka ruajtur të njëjtat rregulla vlerësimi nga një inventar në tjetrin.

Nga verifikimi i pasqyrave financiare (bilancit) të vitit 2017 rezultoi:

Në analizë aktivet:

Në formatin nr. 1 “Aktivet e Qëndrueshme të Trupëzuara” në vlerën 2,444,951 mijë janë të pasqyruara sipas zërave më poshtë:

lekë

Nr.	Nr. llog.	EMERTIMI I LLOGARIVE TE AKTIVIT	Ushtrimi i Mbyllur	Ushtrimi i Paraardhës
9	21,23,24,28	II. Akt. Qëndrueshme. të Trupëzuara	2,444,951,123	1,885,119,558
10	210	Toka, troje, Terrene		
11	211	Pyje, Kullota Plantacione		
12	212	Ndërtime e Konstruksione	1,937,958,005	1,937,958,005
13	213	Rruge, rrjete, vepra ujore		
14	214	Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune	1,282,878,807	745,841,704
15	215	Mjete transporti	58,664,931	58,664,931
16	216	Rezerva shtetërore		
17	217	Kafshe pune e prodhimi		
18	218	Inventar ekonomik	146,598,410	64,512,828
19	219	Amortizimi aktiv. Qendr. të trupëzuara (-)	(981,149,031)	(921,857,810)
20	231	Shpenzime proces për rritjen e AQT		
21	232	Shpenzime proces për transferime kapitale		
22	24	Aktive te Qend. te trupëzuara te dëmtuara		
23	28	Caktime		

Zëri “Ndërtime e konstruksione” (llog. 212) për vlerën 1,937,958 mijë lekë është i zbërthyer në mënyre analitike dhe i rakorduar me inventarët e kryer.

Zëri “instalime teknike, pajisje, instrumente dhe vegla pune” (llog. 214) për vlerën 1,282,879 mijë lekë është i zbërthyer në mënyre analitike dhe i rakorduar me inventarët e kryer.

Zëri “Mjete transporti” (llog. 215) është për vlerën 58,665 mijë lekë është i zbërthyer në mënyre analitike dhe i rakorduar me inventarët e kryer.

**KONTROLI I LARTË I SHTETIT****RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN UNIVERSITAR TË TRAUMËS”**

Zëri “*Inventar ekonomik*” (llog. 218) për vlerën 146,598 mijë lekë është i zbërthyer në mënyrë analitike dhe i rakorduar me inventarët e kryer.

Në formatin nr. 1 “*Aktivet e Qëndrueshme të pa Trupëzuara*” në vlerën 597 mijë janë të pasqyruara sipas zërave “*studime dhe kërkime*”.

lekë

Nr.	Nr. llog.	EMERTIMI I LLOGARIVE TE AKTIVIT	Ushtrimi i Mbyllur	Ushtrimi i Paraardhës
1	12	Rezultate të mbartura (saldo debitorë)		
2	A	AKTIVE TË QENDRUESHME	2,445,547,979	1,885,716,414
	20, 230	I. Të pa trupëzuara	596,856	596,856
4	201	Prime të emisionit dhe rimbursimit të huave		
5	202	Studime dhe kërkime	596,856	596,856
6	203	Koncesione, patenta, licenca e tjera të ngjashme		
7	209	Amortizimi i aktiveve qëndrueshme të patrupëzuara(-)		
8	230	Shpenzime për rritjen e aktiv. qendr. patrupëzuara		

Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve të qëndrueshme:

Në formatin 6 kolona 4 “*shtesa pa pagesa brenda sistemit*” për vlerën 677,221 mijë lekë janë pasqyruar shtesat e aktiveve, “*Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune*” në vlerën 583,559 mijë lekë, “*Inventar ekonomik*” në vlerën 93,662 mijë lekë..

Formati 6, kolona 8 pakësime gjatë vitit ushtrimor “*Nxjerrje jashtë përdorimit*” janë pasqyruar pakësime të aktiveve, “*Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune*” në vlerën 38,476 mijë lekë “*Inventar ekonomik*” në vlerën 11,379 mijë lekë.

Nga SUT, Drejtori z. Gj.B janë nxjerrë urdhrat nr. 867, dt. 31.08.2017 “*Për vlerësimin e vlerave materiale në SUT*” ku janë ngritur komisionet për ndjekjen e procesit të vlerësimit i cili duhet të hartojë procesverbalin e vlerësimit dhe në fund relacionin e vlerësimit i cili përmban procedurën e ndjekur për vlerësimin e aktiveve për nxjerrjen jashtë përdorimit, arsyet, efektin ekonomiketj. Urdhri nr. 866, dt. 31.08.2017 “*Për nxjerrjen e aktiveve nga përdorimi në SUT*” ku janë ngritur komisionet për nxjerrjen e aktiveve nga përdorimi të gjitha vlerave materiale të vlerësuara sipas procesverbalit të vlerësimit dhe propozimit të bërë nga Komisionet e vlerësimit për vitin 2017.

Për vlerat e mësipërme sipas procesverbaleve të asgjësimit janë përpiluar fletë daljet me sasitë dhe vlerat përkatëse kontabël. (më gjerësisht është trajtuar në pikën d. (Inventarët)

Kolona 9 pakësime gjatë vitit ushtrimor “*pakësime të tjera*” janë pasqyruar pakësime të aktiveve, “*Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune*” në vlerën 8,046 mijë lekë “*Inventar ekonomik*” në vlerën 198 mijë lekë.

Gjendja në mbyllje të ushtrimit në formatin nr. 6 “*Gjendja edhe ndryshimet e aktiveve të qëndrueshme*” është e njëjtë me vlerat e pasqyruara në formatin nr. 1 në zërin “*Aktive të qëndrueshme*”.

Në lekë

Llog.	Emërtimi	Gjendja në çelje	Aktivi i bilancit	Formati 6 (gjendja e ndrysh. i aktiv)	Diferenca (4-5)
1	2	3	4	5	6
202	Studime e kërkime	596,856	596,856	596,856	
230	Shp.. Për. Rr.Akt. të paqënd.				
210	Toka, troje, terrene				
212	Ndërtime e konstruksione	1,937,958,005	1,937,958,005	1,937,958,005	
213	Rrugë, rrjete, vepra ujore				
214	Ins. Teknike makineri pajisje	745,841,704	1,282,878,807	1,282,878,807	
215	Mjete transporti	58,664,931	58,664,931	58,664,931	
218	Inventar ekonomik	64,512,828	146,598,410	146,598,410	



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN UNIVERSITAR TË TRAUMËS”

	TOTALI	2,743,061,496	3,426,697,009	3,426,697,009	
--	---------------	----------------------	----------------------	----------------------	--

“Amortizimi i Aktiveve të Qëndrueshme të patrupëzuara” (llog. nr. 209) prej 981,149 mijë është pasqyruar në bilanc dhe kuadron me pasqyrën e amortizimit të bilancit në formatin nr. 7, kolona 9.

“Amortizimi i Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara” për 59,291 mijë lekë është llogaritur sipas normave ligjore të miratuara në përputhje me VKM nr. 401, dt. 23.10.1989 dhe është i ndarë në grupe analitike sipas zërave të “Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara”.

Normat e amortizimit janë përllogaritur sipas VKM nr. 401, datë 23.10.1989 “Për llogaritjen e normave të reja të amortizimit të makinerive, të pajisjeve dhe të mjeteve të transportit”, ndërsa për pajisjet informatike dhe elektronike është përdorur ligji aktual fiskal “Për tatimin mbi të ardhurat” ku norma e amortizimit është 25% dhe aplikimi bëhet mbi vlerën e mbetur.

Normat janë:

- 15% për studime dhe kërkime;
- 1% për ndërtesat dhe konstruksionet;
- 3% për inventarin ekonomik;
- 25% për pajisjet informatike, kompjuterike e elektronike;
- 6% për makineritë e pajisjet operacionale, instrumente e vegla; dhe
- 14% për mjetet e transportit.

Nga auditimi i kartelës së llogarisë 219, (formati nr. 1) dhe formati 7, u konstatua se, amortizimi vjetor është llogaritur e kontabilizuar i ndarë si më poshtë,

Llog. nr. 2192 “Amortizim ndërtime dhe konstruksione” = 19,379,580 lekë.

Llog. nr. 2194 “Amortizim Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” = 27,611,137 lekë,

Llog. nr. 2195 “Amortizim Mjete transporti” = 8,095,760 lekë,

Llog. nr. 2198 “Amortizim Inventar ekonomik” = 4,204,644 lekë.

Aktivitet qarkulluese zëri “Objekte inventari” në shumën prej 146,598 mijë lekë, janë pasqyruar në bilanc dhe për këta ka inventar fizik të kuadruar me atë kontabël.

“Kërkesa arkëtimi mbi Debitorët” (Klasa 4) pasqyrohen në bilanc Formatin nr. 2 për vlerën 16,388 mijë lekë ku “Të tjera operacione me shtetin (debitor)” zënë shumën 11,066 mijë e cila në analizë (Inventari i llogarisë 4341 “Të tjera operacione me shtetin” dt. 31.12.2017 në vlerën 2,440 mijë lekë kuadron me llog. 468 “debitorë të ndryshëm”) përbëhet nga detyrimet afatshkurtra të cilat trashëgohen në vitin 2018 si “personeli e llogari të lidhura me to” (llog. 421-423) për 7,680 mijë lekë, “Të drejta dhe taksa për tu derdhur në shtet” (llog. 431) për 840 mijë lekë, për “sigurime shoqërore” (llog. 435) në vlefën 2,230 mijë, “sigurime shëndetësore” (llog. 436) në vlefën 316 mijë, “Kreditorë të ndryshëm” (llog. 467) për 2,882 mijë lekë.

lekë

Nr.	Nr. llog.	EMERTIMI I LLOGARIVE TE PASIVIT	Ushtrimi i Mbyllur	Ushtrimi i Paraardhës
20	Klasa 4	II. Detyrime afatshkurtër	16,561,200	7,224,382
21	419	Klientë (Kreditorë), parapagese pjesore		
22	401-408	Furnitorë e llogari te lidhura me to		
23	42	Personeli e llogari te lidhura me to	7,680,193	1,122,612
24	431	Detyrime ndaj Shtetit për tatim-taksa	839,648	105,494
25	432	Tatime mbledhura nga shteti për llog. Pusht. Lokal		
26	433	Shteti fatkeqësi natyrore		
27	4341	Te tjera operacione me shtetin(kreditor)	2,439,884	2,439,884
28	435	Sigurime shoqërore	2,229,768	345,818
29	436	Sigurime shëndetësore	316,165	47,992
30	437-438	Organizma të tjerë shoqërore		



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN UNIVERSITAR TË TRAUMËS”

31	44	Institucione te tjera publike		
32	45	Marrëdhënie me institucione brenda e jashtë sistemit		
33	460	Huadhënës		
34	464	Detyrime për t'u paguar për blerjen e letra me vlerë		
35	466	Kreditore për mjete ne ruajtje	173,092	280,132
36	467	Kreditore të ndryshëm	2,882,450	2,882,450

Nga auditimi rezultoi se subjekti nuk i ka të konfirmuara (Rakorduara) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose të çdo regjistrimi tjetër.

Në llog. (466) “Kreditore në mjete në ruajtje” në vlerën 173,092 mijë lekë janë pasqyruar gjendja e fondeve të trashëguara (llog. 520 “Disponibilitete në thesar”) formati 5, nga granti.

Në pasiv të bilancit janë paraqitur A/I “fondet e veta” të institucionit që arrijnë në vlerën 2,498,822 mijë lekë e cila konfirmohet si diferencë ndërmjet vlerës së aktivitetit të bilancit 2,515,383 mijë lekë dhe B “detyrimeve” të pasivit në vlerën 16,561 mijë lekë.

Formati 8 “Pasqyra e lëvizjes së fondeve” ku janë pasqyruar tepricat në çelje, lëvizjet për periudhën (debi, kredi) dhe teprica në mbyllje e cila korrespondon me pasivin e bilancit.

lekë

Nr.	Nr.llog.	EMERTIMI I LLOGARIVE TE PASIVIT	Ushtrimi i Mbyllur	Ushtrimi i Paraardhës
1	A	FONDE TE VETA	2,498,822,176	1,998,500,370
2	10	I. Fonde të veta	2,498,822,176	1,998,500,370
3	101	Fonde bazë	2,498,822,176	1,998,500,370
4	105	Grante të brendshme kapitale		
5	106	Grante të huaja kapitale		
6	107	Vlera Akt. Qend.të caktuara në përdorim		
7	109	Rezerva nga rivlerësimi i aktiveve të qëndrueshme		

Në pasqyrën e shpenzimeve të ushtrimit, formati nr. 3/1 janë të pasqyruara shpenzimet korrente të konstatuara si dhe ndryshimi i gjendjes së inventarit në vlerën 298,483 mijë lekë të ndara sipas zërave si;

Llog. (600) “Paga, shpërblime e të tjera shpenzime personeli” në vlerën 100,660 mijë lekë ose 33.7% të totalit të shpenzimeve, ku janë paraqitur shpenzimet për pagat e personelit të përhershëm në vlerën 100,660 mijë lekë, për periudhën 01 janar deri 31 dhjetor 2017.

Llog. (601) “Kontribute për sig. Shoqërore e shëndetësore” në vlerën 16,087 mijë lekë ose 5.3% të totalit të shpenzimeve,

Llog. (602) “Mallra dhe shërbime të tjera” në vlerën 122,191 mijë lekë ose 41% të totalit të shpenzimeve, ku janë paraqitur të gjitha shpenzimet e kryera dhe të faturuara në vitin 2017.

Llog. (606) “Transferta për buxhete familjare e individët” në vlerën 36 mijë lekë ose 0.01% të totalit të shpenzimeve.

Llog. (63) “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” në vlerën 59,510 mijë lekë, përfaqëson ndryshimin e gjendjes së inventarit në magazinën e materialeve dhe objekteve të inventarit të imët në përdorim të punonjësve. Ky ndryshim është regjistruar në llog. 841 “transferim për ndryshim gjendje inventari” në pasqyrën e të ardhurave të ushtrimit në vlerën e mësipërme.

Vlerat e shpenzimeve paraqitura në pasqyrat financiare formati nr. 3/1 “Shpenzimet korrente” sipas bilancit paraqiten në vlerën 238,972,973 lekë si më poshtë:

lekë

Nr.	Nr. llog.	PERSHKRIMI I SHPENZIMEVE TE USHTRIMIT	Viti Ushtrimor	Viti i mëparshëm
-----	-----------	---------------------------------------	----------------	------------------



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN UNIVERSITAR TË TRAUMËS”

a	b	c	1	2
1	Klasa 6	A. SHPENZIMET SHFRYTEZIMI (I - III)	298,482,731	52,252,336
2	60	I. Shpenzime Korrente	238,972,973	56,442,102
3	600	Paga, shpërblime e te tjera personeli	100,659,577	14,253,790
4	6001	Paga, personeli i përhershëm	100,659,577	14,154,085
5	6002	Paga, personel I përkohshëm		99,705
6	6003	Shpërblime		
7	6009	Shpenzime tjera personeli		
8	601	Kontrib.te sig.shoq.e shendets.	16,086,682	485,212
9	6010	Kontribute për sigurimet shoqërore	14,403,205	435,788
10	6011	Kontribute për sigurimet shëndetësore	1,683,477	49,424
11	602	Mallra dhe shërbime te tjera	122,191,014	41,703,100
12	6020	Materiale zyre e te përgjithshme	106,097,398	1,188,806
13	6021	Materiale dhe shërbime speciale	15,901,446	39,225,914
14	6022	Shërbime nga te trete	0	
15	6023	Shpenzime transporti	192,170	119,280
16	6024	Shpenzime udhëtimi		
17	6025	Shpenzime për mirëmbajtje te zakonshme		1,169,100
18	6026	Shpenzime për qiramarrje		
19	6027	Shpenzime për detyrime për kompensime legale		
20	6028	Shpenzime te lidhura me huamarrjen për hua		
21	6029	Shpenzime te tjera operative		
22	603	Subvencionet		
23	6030	Subvencione për difference çmimi		
24	6031	Subvencione për te nxitur punësimin		
25	6032	Subvencione për te mbuluar humbjet		
26	6033	Subvencione për sipërmarrjet individuale		
27	6039	Subvencione te tjera		
28	604	Transferime korrente të brendshme		
29	6040	Transferime korente tek nivele tjera te Qeverise		
30	6041	Transferime korente tek institucione qeveritare te ndryshme		
31	6042	Transferime korente tek Sigurimet Shoqërore e Shëndetësore		
32	6044	Transferime korente tek Organizatat jo fitimprurëse		
33	605	Transferime korrente me jashtë		
34	6051	Transferime Për Organizatat Ndërkombëtare		
35	6052	Transferime Për Qeveritë e Huaja		
36	6053	Transferime Për institucionet jo fitimprurëse te huaja		
37	6059	Transferime Te tjera korrente me jashtë shtetit		
38	606	Transferta për buxh .familjare e individë	35,700	
39	6060	Transferta Te paguara nga ISSH e ISKSH	35,700	
40	6061	Transferta Paguara nga Inst.Tjera e Org.Pusht.Vendor		
41	63	II. Ndryshimi i gjendjeve te inventarit (+ -)	59,509,758	-4,189,766

Në pasqyrën e të ardhurave të ushtrimit formati nr. 3/2 janë pasqyruar llog. 720 financimi nga buxheti i shtetit për vitin 2017 (grant) në shumën 227,907 mijë lekë dhe financimi i pritshëm nga buxheti i shtetit i vitit 2018 në vlerën 11,066 mijë lekë.

Të ardhurat tatimor e jo tatimore janë pasqyruar në bilanc në formatin 3/2 në vlerën 182,799 lekë dhe sipas aktit të rakordimit me Degën e Thesarit Tiranë është po e njëjta vlerë.

Në lekë

34	71	III. TE ARDHUTRA JO TATIMORE (a+b+c)	182,799	0
35	710	a) Nga ndërmarrjet dhe pronësia		
36	7100	- Nga ndërmarrjet. publike jo financiare		
37	7101	- Nga ndërmarrjet. publike financiare		
38	7109	- Te tjera nga ndërmarrjet dhe pronësia		
39	711	b) Shërbime administ. e ardhura sekondare	182,799	
40	7110	- Tarifa administrative dhe rregullatorë		
41	7111	- Te ardhura sekondare e pagesa shërbimesh		



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN UNIVERSITAR TË TRAUMËS”

42	7112	- Takse për veprime gjyqësore e noteriale		
43	7113	- Nga shitja e mallrave e shërbimeve		
44	7114	- Te ardhura nga biletat		
45	7115	- Gjoha dhe kamatëvonesa, sekuestrime e zhdëmtime	182,799	
46	7116	- Te ardhura nga transferimi pronës, legalizimi ndërtimeve pa leje		
47	719	c) Te tjera te ardhura jo tatimore		

Pasqyra e bilancit “Burimet dhe shpenzimet lidhur me investime” zëri “Shpenzime për rritjen e AQ” formati 4/e e plotësuar për shumën 0 lekë në analizë rakordon me vlerën 0 lekë në pasqyrën “gjendja dhe ndryshimet e aktiveve të qëndrueshme” kolona e dytë “Blerjet e krijuara me pagesë” formati 6 .

Formati 4/e:

Nr.	Nr. llog.	EMERTIMI	Teprica Në çelje	Transaksionet e vitit		Teprica në Fund
				Debi	Kredi	
a		b	c	d	e	f
	II	SHPENZIMET PER INVESTIME	0	0	0	0
34	230	Shpenzime për rritjen e AQ të patrupëzuara	0	0	0	0
35	231	Shpenzime për rritjen e AQ të trupëzuara	0	0	00	0
36	2310	Toka, troje e terrene				
37	2311	Pyje, kullota ,plantacione				
38	2312	Ndërtime e konstruksione				
39	2313	Rruge, rrjete dhe vepra ujore				
40	2314	Instalime teknike, pajisje, instrum dhe vegla pune				
41	2315	Mjete te transportit				
42	2316	Rezerva shtetërore				
43	2317	Kafshe pune e prodhimi				
44	2318	Inventar ekonomik				
45	232	Transferimet kapitale	0	0	0	0
46	25	Huadhënie dhe nën huadhënie	0	0	0	0
47	255	Të dala për huadhënie dhe nenhuadhenie të brendsh				
48	256	Të dala për transaksionet e huadhenies se huaj				
49	250	Të hyra nga principlali i huadhënieve te brendshme				
50	251	Të hyra nga principlali i transaks. të huadhe së huaj				
51	26	Pjesëmarrje ne kapitalin e vet	0	0		0
52	265	Të dala për kapitale te veta ne nd. publike jo fitimp				
53	266	Të dala për kapitale te veta ne instituc financiare				
54	267	Të dala për kapitale te veta ne joint venture				
55	269	Të dala për kapitale te veta te tjera				

Formati 12 “Pyetësor dhe shënime shpjeguese” është plotësuar relacioni shpjegues për pasqyrat financiare por nuk janë përfshirë të gjitha informacionet shpjeguese që kërkohen, në pajtim me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar ku të japin informacionet shpjeguese të nevojshme për të arritur paraqitjen e drejtë.

Mbyllja e bilancit për vitin 2016 në përgjithësi është në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 neni 6, me VKM nr. 248, datë 10.4.1998 “Për miratimin e planit kontabël” si dhe UMF nr. 14, datë 28.12.2006, ndryshuar me UMF nr. 26, datë 27.12.2007 dhe plotësimi i tij është bërë në mënyrë manuale, duke rakorduar llogaritë dhe shumat përkatëse.

Veprimet për vitin 2017 janë azhurnuar periodikisht, janë kontabilizuar në ditarët, ku llogaritë në përgjithësi janë në pozicionin e duhur dhe në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 7661, datë 19.01.1993 “Për kontabilitetin” ndryshuar me ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 neni 6, si dhe UMF nr. 14, datë 28.12.2006, UMF nr. 26, datë 27.12.2007.

Ditari i magazinës është mbajtur dhe veprimet hidheshin periodikisht.



Nga auditimi u konstatua se SUT, Sektori i Financës ka hartuar pasqyrat financiare për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të cilat janë me shkresën nr. 374, dt. 27.02.2018, duke mos u përfshirë Përmbledhësja e Thjeshtë për pasqyrat financiare të konsoliduara (formati nr. 10, formati nr. 11) me afat deri 20.04.2017, në përputhje me kërkesat e udhëzimit nr. 14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2016 për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësite që varen prej tyre si edhe njësite të menaxhimit / zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj”, i ndryshuar me udhëzimin nr. 26, datë 27.12.2007.

c/2. Pasqyrat financiare për vitin 2017 drejtuar Ministrinë së Mbrojtjes janë hartuar dhe depozituar më datë 27.02.2017 brenda afatit ligjor.

Pasqyrat financiare kanë të plotësuar aktiv-pasivin pasqyrat dhe anekset përkatëse dhe informacionin. Veprimet janë kaluar nga dokumentacioni bazë në ditarët përkatës, në librin e madh dhe më tej në bilanc. Janë mbajtur ditarët e bankës, magazinës dhe të ndryshme.

Partitarët analitik të llogarive janë mbajtur dhe azhornuar, si dhe i llogarive inventarjale të magazinës dhe është bërë rakordimi llogari-magazinë.

Auditimi i aktiveve të qëndrueshme:

a. Objektivat e auditimit të aktiveve të qëndrueshme, janë që të sigurohemi se:

Aktivet ekzistojnë fizikisht; ato i përkasin subjektit; janë të vlerësuara në mënyrë korrekte; janë regjistruar në mënyrë korrekte; është bërë mirë ndarja midis shpenzimeve korrente dhe aktiveve të qëndrueshme; informacionet që ndodhen në aneksin përkatës janë të plota dhe e korrekte.

b. Kontrolle të përgjithshme të llogarive dhe dokumenteve:

Për auditimin e aktiveve të qëndrueshme, paraprakisht u kryen një numër kontrollesh të përgjithshme si:

U verifikua tabela e lëvizjeve të aktiveve të qëndrueshme në raport me gjendjet dhe ndryshimin e tyre gjatë periudhës ushtrimore;

U ekzaminua tabela e lëvizjeve, nëse ka ndodhura ndonjë variacion anormal mbi aktivet e qëndrueshme;

U ekzaminuan të gjitha shpjegimet që janë paraqitur lidhur me shmangiet dhe përjashtimet e veçanta;

U verifikua nëse parimet kontabël të ndjekura prej subjektit për vlerësimin dhe kontabilizimin janë konform parimeve të përgjithshme të pranuar dhe udhëzimeve përkatëse.

U verifikua nëse shifrat e çeljes rakordojnë me ato të mbylljes së ushtrimit të mëparshëm;

U krahasuan investimet e realizuara gjatë ushtrimit me ato të planifikuara në buxhet, evidentimi kontabël.

c. Disa nga parimet e zbatuara për auditimin e aktiveve të qëndrueshme:

1. Gjatë hyrjes së aktiveve në pronësinë e subjektit, duhet të sigurohemi se:

- Aktivet e blera kontabilizohen sipas vlerës së tyre të marrjes. (çmimit të blerjes shtuar shpenzimet e tjera të nevojshme për vënien në gjendje përdorimi të pasurisë);

- Aktivet e prodhuara nga subjekti (Nëse ka) kontabilizohen sipas kostos së tyre të prodhimit.

- Aktivet e marra falas kontabilizohen duke i vlerësuar ato me vlerën e shitjes;

- Aktivet e sjella në subjekt nga të tretët nëse kontabilizohen me vlerën e tyre të sjelljes.

(UMF nr. 30, dt. 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”).

2. Për inventarin, duhet të sigurohemi që subjekti:

- Procedon për regjistrimin dhe vlerësimin e aktiveve të saj të qëndrueshme sipas rregullave kontabël përgjithësisht të pranuar;

- Përdor referencat ose teknikat më të përshtatshme për natyrën e pasurisë (çmimi i tregut, tabelat e publikuara, treguesit specifike, etj.);

- Ka ruajtur të njëjtat rregulla vlerësimi nga një inventar në tjetrin.

**KONTROLI I LARTË I SHTETIT****RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN UNIVERSITAR TË TRAUMËS”**

Nga verifikimi i pasqyrave financiare (bilancit) të vitit 2017 rezultoi:

Në analizë aktivet:

Në formatin nr. 1 “Aktivet e Qëndrueshme të Trupëzuara” në vlerën 2,444,951 mijë janë të pasqyruara sipas zërave më poshtë:

lekë

Nr.	Nr. llog.	EMERTIMI I LLOGARIVE TE AKTIVIT	Ushtrimi i Mbyllur	Ushtrimi i Paraardhës
9	21,23,24,28	II. Akt. Qëndrueshme. të Trupëzuara	21,241,656	3,645,173
10	210	Toka, troje, Terrene		
11	211	Pyje, Kullota Plantacione		
12	212	Ndërtime e Konstruksione	6,201,569	
13	213	Rruge, rrjete, vepra ujore		
14	214	Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune	13,629,208	2,864,160
15	215	Mjete transporti		
16	216	Rezerva shtetërore		
17	217	Kafshe pune e prodhimi		
18	218	Inventar ekonomik	2,004,217	942,600
19	219	Amortizimi aktiv. Qendr. të trupëzuara (-)	(593,338)	(161,587)
20	231	Shpenzime proces për rritjen e AQT		
21	232	Shpenzime proces për transferime kapitale		
22	24	Aktive te Qend. te trupëzuara te dëmtuara		
23	28	Caktime		

Zëri “Ndërtime e konstruksione” (llog. 212) për vlerën 6,201 mijë lekë është i zbërthyer në mënyre analitike dhe i rakorduar me inventarët e kryer.

Zëri “instalime teknike, pajisje, instrumente dhe vegla pune” (llog. 214) për vlerën 13,629 mijë lekë.

Zëri “Inventar ekonomik” (llog. 218) për vlerën 2,004 mijë lekë.

Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve të qëndrueshme:

Në formatin 6 kolona 2 “blerje e krijuar me pagesë” për vlerën 18,028 mijë lekë janë pasqyruar shtesat e aktiveve, “Ndërtime e konstruksione” në vlerën 6,202 mijë lekë, “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” në vlerën 10,765 mijë lekë, “Inventar ekonomik” në vlerën 1,062 mijë lekë..

Gjendja në mbyllje të ushtrimit në formatin nr. 6 “Gjendja edhe ndryshimet e aktiveve të qëndrueshme” është e njëjtë me vlerat e pasqyruara në formatin nr. 1 në zërin “Aktive të qëndrueshme”.

Në lekë

Llog.	Emërtimi	Gjendja në çelje	Aktivi i bilancit	Formati 6 (gjendja e ndrysh. i aktiv)	Diferenca (4-5)
1	2	3	4	5	6
202	Studime e kërkime	0	0	0	
230	Shp.. Për. Rr.Akt. të paqënd.	0	0	0	
210	Toka, troje, terrene	0	0	0	
212	Ndërtime e konstruksione	0	6,201,569	6,201,569	
213	Rrugë, rrjete, vepra ujore	0	0	0	
214	Ins. Teknike makineri pajisje	2,864,160	13,629,208	13,629,208	
215	Mjete transporti	0	0	0	
218	Inventar ekonomik	942,600	2,004,217	2,004,216	
	TOTALI	3,806,760	21,834,994	21,834,993	



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN UNIVERSITAR TË TRAUMËS”

“Amortizimi i Aktiveve të Qëndrueshme të trupëzuara” (llog. nr. 219) prej 593 mijë është pasqyruar në bilanc dhe kuadron me pasqyrën e amortizimit të bilancit në formatin nr. 7, kolona 9.

“Amortizimi i Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara” për 432 mijë lekë është llogaritur sipas normave ligjore të miratuara në përputhje me VKM nr. 401, dt. 23.10.1989 dhe është i ndarë në grupe analitike sipas zërave të “Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara”.

Normat e amortizimit janë përlllogaritur sipas VKM nr. 401, datë 23.10.1989 “Për llogaritjen e normave të reja të amortizimit të makinerive, të pajisjeve dhe të mjeteve të transportit”, ndërsa për pajisjet informatike dhe elektronike është përdorur ligji aktual fiskal “Për tatimin mbi të ardhurat” ku norma e amortizimit është 25% dhe aplikimi bëhet mbi vlerën e mbetur. Normat janë:

- 15% për studime dhe kërkime;
- 1% për ndërtesat dhe konstruksionet;
- 3% për inventarin ekonomik;
- 25% për pajisjet informatike, kompjuterike e elektronike;
- 6% për makineritë e pajisjet operacionale, instrumente e vegla; dhe
- 14% për mjetet e transportit.

Nga auditimi i kartelës së llogarisë 219, (formati nr. 1) dhe formati 7, u konstatua se, amortizimi vjetor është llogaritur e kontabilizuar i ndarë si më poshtë,

Llog. nr. 2194 “Amortizim Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” = 244093 lekë,

Llog. nr. 2198 “Amortizim Inventar ekonomik” = 349,245 lekë.

Aktivitet qarkulluese zëri “Objekte inventari” në shumën prej 48,278 mijë lekë, janë pasqyruar në bilanc dhe për këta ka inventar fizik të kuadruar me atë kontabël.

“Kërkesa arkëtimi mbi Debitorët” (Klasa 4) pasqyrohen në bilanc Formatin nr. 2 për vlerën 39,375 mijë lekë ku “Të tjera operacione me shtetin (debitor)” zënë shumën 39,196 mijë e cila në analizë (Inventari i llogarisë 4341 “Të tjera operacione me shtetin” dt. 31.12.2017 = 179 mijë lekë në aktiv llogaria 468 “debitorë të ndryshëm”) përbëhet nga detyrimet afatshkurtra të cilat trashëgohen në vitin 2018 si “Furnitorë e llogari të lidhura me to” për 4,211 mijë lekë, (Shoqëruar me pasqyrën analitike të furnitorëve) e “personeli e llogari të lidhura me to” (llog. 421-423) për 24,248 mijë lekë, për “sigurime shoqërore” (llog. 435) në vleftën 7,495 mijë, “sigurime shëndetësore” (llog. 436) në vleftën 1,030 mijë.

lekë

Nr.	Nr. llog.	EMERTIMI I LLOGARIVE TE PASIVIT	Ushtrimi i Mbyllur	Ushtrimi i Paraardhës
20	Klasa 4	II. Detyrime afatshkurtër	16,561,200	7,224,382
21	419	Klientë (Kreditorë), parapagese pjesore		
22	401-408	Furnitorë e llogari te lidhura me to	4,211,361	4,329,406
23	42	Personeli e llogari te lidhura me to	24,248,162	21,111,597
24	431	Detyrime ndaj Shtetit për tatim-taksa	2,210,963	1,616,976
25	432	Tatime mbledhura nga shteti për llog. Pusht. Lokal		
26	433	Shteti fatkeqësi natyrore		
27	4341	Te tjera operacione me shtetin(kreditor)	179,293	398,569
28	435	Sigurime shoqërore	7,494,882	9,408,694
29	436	Sigurime shëndetësore	1,030,233	878,012
30	437-438	Organizma të tjerë shoqërore		
31	44	Institucione te tjera publike		
32	45	Marrëdhënie me institucione brenda e jashtë sistemit		
33	460	Huadhënës		
34	464	Detyrime për t'u paguar për blerjen e letra me vlerë		
35	466	Kreditorë për mjete ne ruajtje	292,309	117,817
36	467	Kreditorë të ndryshëm		



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN UNIVERSITAR TË TRAUMËS”

Nga auditimi rezultoi se subjekti nuk i ka të konfirmuara (Rakorduara) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose të çdo regjistrimi tjetër.

Në llog. (466) “Kreditorë në mjete në ruajtje” në vlerën 292 mijë lekë janë pasqyruar gjendja e fondeve të trashëguara (llog. 520 “Disponibilitete në thesar”) formati 5, nga granti.

Në pasiv të bilancit janë paraqitur A/I “fondet e veta” të institucionit që arrijnë në vlerën 34,124 mijë lekë e cila konfirmohet si diferencë ndërmjet vlerës së aktivitetit të bilancit 2,515,383 mijë lekë dhe B “detyrimeve” të pasivit në vlerën 39,667 mijë lekë (llog. 85 “rezultati i ushtrimit 8,444 mijë lekë (saldo kreditore).

Formati 8 “Pasqyra e lëvizjes së fondeve” ku janë pasqyruar tepricat në çelje, lëvizjet për periudhën (debi, kredi) dhe teprica në mbyllje e cila korrespondon me pasivin e bilancit.

lekë

Nr.	Nr.llog.	EMERTIMI I LLOGARIVE TE PASIVIT	Ushtrimi i Mbyllur	Ushtrimi i Paraardhës
1	A	FONDE TE VETA	34,124,289	3,814,099
2	10	I. Fonde të veta	34,124,289	3,814,099
3	101	Fonde bazë	34,124,289	3,814,099
4	105	Grante të brendshme kapitale		
5	106	Grante të huaja kapitale		
6	107	Vlera Akt. Qend.të caktuara në përdorim		
7	109	Rezerva nga rivlerësimi i aktiveve të qëndrueshme		

Në pasqyrën e shpenzimeve të ushtrimit, formati nr. 3/1 janë të pasqyruara shpenzimet korrente të konstatuara si dhe ndryshimi i gjendjes së inventarit në vlerën 894,051 mijë lekë të ndara sipas zërave si;

Llog. (600) “Paga, shpërblime e të tjera shpenzime personeli” në vlerën 354,416 mijë lekë ose 40% të totalit të shpenzimeve, ku janë paraqitur shpenzimet për pagat e personelit të përhershëm në vlerën 354,416 mijë lekë, për periudhën 01 janar deri 31 dhjetor 2017.

Llog. (601) “Kontribute për sig. Shoqërore e shëndetësore” në vlerën 57,761 mijë lekë ose 6.4% të totalit të shpenzimeve,

Llog. (602) “Mallra dhe shërbime të tjera” në vlerën 491,932 mijë lekë ose 55% të totalit të shpenzimeve, ku janë paraqitur të gjitha shpenzimet e kryera dhe të faturuara në vitin 2017.

Llog. (606) “Transferta për buxhete familjare e individët” në vlerën 2,655 mijë lekë ose 0.3% të totalit të shpenzimeve.

Llog. (63) “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” në vlerën 12,714 mijë lekë, përfaqëson ndryshimin e gjendjes së inventarit në magazinën e materialeve dhe objekteve të inventarit të imët në përdorim të punonjësve. Ky ndryshim është regjistruar në llog. 8423 “transferim për ndryshim gjendje inventari” në pasqyrën e shpenzimeve të ushtrimit në vlerën e mësipërme.

Vlerat e shpenzimeve paraqitura në pasqyrat financiare formati nr. 3/1 “Shpenzimet korrente” sipas bilancit paraqiten në vlerën 906,764,924 lekë si më poshtë:

lekë

Nr.	Nr. llog.	PERSHKRIMI I SHPENZIMEVE TE USHTRIMIT	Viti Ushtrimor	Viti i mëparshëm
a	b	c	1	2
1	Klasa 6	A. SHPENZIMET SHFRYTEZIMI (I - III)	894,051,217	746,856,107
2	60	I. Shpenzime Korrente	906,764,924	747,025,033
3	600	Paga, shpërblime e të tjera personeli	354,416,155	309,124,466
4	6001	Paga, personeli i përhershëm	354,416,155	308,939,307
5	6002	Paga, personel i përkohshëm		185,159
6	6003	Shpërblime		



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN UNIVERSITAR TË TRAUMËS”

7	6009	Shpenzime tjera personeli		
8	601	Kontrib.te sig.shoq.e shendets.	57,761,151	53,009,010
9	6010	Kontribute për sigurimet shoqërore	51,776,047	47,481,102
10	6011	Kontribute për sigurimet shëndetësore	5,985,104	5,527,908
11	602	Mallra dhe shërbime te tjera	491,932,068	384,350,622
12	6020	Materiale zyre e te përgjithshme	2,972,033	1,759,076
13	6021	Materiale dhe shërbime speciale	256,815,549	230,578,970
14	6022	Shërbime nga te trete	185,220,410	123,199,888
15	6023	Shpenzime transporti	6,097,800	605,736
16	6024	Shpenzime udhëtimi	372,500	232,348
17	6025	Shpenzime për mirëmbajtje te zakonshme	20,320,87	21,441,055
18	6026	Shpenzime për qiramarrje	175,200	219,840
19	6027	Shpenzime për detyrime për kompensime legale	18,115,681	3,727,597
20	6028	Shpenzime te lidhura me huamarrjen për hua		
21	6029	Shpenzime te tjera operative	1,842,017	2,586,112
22	603	Subvencionet		
23	6030	Subvencione për difference çmimi		
24	6031	Subvencione për te nxitur punësimin		
25	6032	Subvencione për te mbuluar humbjet		
26	6033	Subvencione për sipërmarrjet individuale		
27	6039	Subvencione te tjera		
28	604	Transferime korrente të brendshme		
29	6040	Transferime korente tek nivele tjera te Qeverise		
30	6041	Transferime korente tek institucione qeveritare te ndryshme		
31	6042	Transferime korente tek Sigurimet Shoqërore e Shëndetësore		
32	6044	Transferime korente tek Organizatat jo fitimprurëse		
33	605	Transferime korrente me jashtë		
34	6051	Transferime Për Organizatat Ndërkombëtare		
35	6052	Transferime Për Qeveritë e Huaja		
36	6053	Transferime Për institucionet jo fitimprurëse te huaja		
37	6059	Transferime Te tjera korrente me jashtë shtetit		
38	606	Transferta për buxh .familjare e individë	2,655,550	540,935
39	6060	Transferta Te paguara nga ISSH e ISKSH	2,655,550	540,935
40	6061	Transferta Paguara nga Inst.Tjera e Org.Pusht.Vendor		
41	63	II. Ndryshimi i gjendjeve te inventarit (+ -)	(12,713,707)	(168,926)

Në pasqyrën e të ardhurave të ushtrimit formati nr. 3/2 janë pasqyruar llog. 720 financimi nga buxheti i shtetit për vitin 2017 (*grant*) në shumën 905,086 mijë lekë dhe financimi i pritshëm nga buxheti i shtetit i vitit 2018 në vlerën 39,594 mijë lekë.

Të ardhurat tatimor e jo tatimore janë pasqyruar në bilanc në formatin 3/2 në vlerën 10,772,484 lekë dhe sipas aktit të rakordimit me Degën e Thesarit Tiranë është po e njëjta vlerë.

Në lekë

34	71	III. TE ARDHUTRA JO TATIMORE(a+b+c)	10,772,484	11,588,504
35	710	a) Nga ndërmarrjet dhe pronësia	6,055,730	6,147,204
36	7100	- Nga ndërmarrjet. publike jo financiare		
37	7101	- Nga ndërmarrjet. publike financiare		
38	7109	- Te tjera nga ndërmarrjet dhe pronësia	6,055,730	6,147,204
39	711	b) Shërbime administ. e ardhura sekondare	4,716,754	5,441,300
40	7110	- Tarifa administrative dhe rregullatorë		
41	7111	- Te ardhura sekondare e pagesa shërbimesh	4,067,357	5,441,300
42	7112	- Takse për veprime gjyqësore e noteriale		
43	7113	- Nga shitja e mallrave e shërbimeve		
44	7114	- Te ardhura nga biletat		
45	7115	- Gjoha dhe kamatëvonesa, sekuestime e zhdëmtime	649,397	
46	7116	- Te ardhura nga transferimi pronës, legalizimi ndërtimeve pa leje		
47	719	c) Te tjera te ardhura jo tatimore		



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN UNIVERSITAR TË TRAUMËS”

Pasqyra e bilancit “Burimet dhe shpenzimet lidhur me investime” zëri “Shpenzime për rritjen e AQ” formati 4/e e plotësuar për shumën 18,028,233 lekë në analizë rakordon me vlerën 18,028,233 lekë në pasqyrën “gjendja dhe ndryshimet e aktiveve të qëndrueshme” kolona e dytë “Blerjet e krijuara me pagesë” formati 6 .

Formati 4/e:

lekë

Nr.	Nr. llog.	EMERTIMI	Teprica Në çelje	Transaksionet e vitit		Teprica në Fund
				Debi	Kredi	
a		b	c	d	e	f
	II	SHPENZIMET PER INVESTIME	0	18,028,233	18,028,233	
34	230	Shpenzime për rritjen e AQ të patrupëzuara	0	0	0	
35	231	Shpenzime për rritjen e AQ të trupëzuara	0	18,028,233	18,028,233	
36	2310	Toka, troje e terrene				
37	2311	Pyje, kullota ,plantacione				
38	2312	Ndërtime e konstruksione	0	6,201,569	6,201,569	
39	2313	Rruge, rrjete dhe vepra ujore				
40	2314	Instalime teknike, pajisje, instrum dhe vegla pune	0	10,765,048	10,765,048	
41	2315	Mjete te transportit				
42	2316	Rezerva shtetërore				
43	2317	Kafshe pune e prodhimi				
44	2318	Inventar ekonomik	0	1,061,616	1,061,616	
45	232	Transferimet kapitale	0	0	0	
46	25	Huadhënie dhe nën huadhënie	0	0	0	
47	255	Të dala për huadhënie dhe nën huadhënie të brendsh				
48	256	Të dala për transaksionet e huadhënies se huaj				
49	250	Të hyra nga principali i huadhëniesve te brendshme				
50	251	Të hyra nga principali i transaks. të huadhe së huaj				
51	26	Pjesëmarrje ne kapitalin e vet	0	0	0	
52	265	Të dala për kapitale te veta ne nd. publike jo fitimp				
53	266	Të dala për kapitale te veta ne instituc financiare				
54	267	Të dala për kapitale te veta ne joint venture				
55	269	Të dala për kapitale te veta te tjera				

Vlera e mësipërme në pasqyrat financiare formati 4/e është paraqitur e gjithë vlera për “Ndërtime e konstruksione” për 6,201 mijë lekë, Zëri “instalime teknike, pajisje, instrumente dhe vegla pune” (llog. 214) për vlerën 10,765 mijë lekë “Inventar ekonomik” për 1,062 mijë lekë kur edhe në pasqyrën “gjendja dhe ndryshimet e aktiveve të qëndrueshme” në formatin 6, kolona e dytë shuma është e ndarë sipas zërave të investimeve në vlerat e mësipërme.

Formati 12 “Pyetësor dhe shënime shpjeguese” është plotësuar relacioni shpjegues për pasqyrat financiare por nuk janë përfshirë të gjitha informacionet shpjeguese që kërkohen, në pajtim me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar ku të japin informacionet shpjeguese të nevojshme për të arritur paraqitjen e drejtë.

Mbyllja e bilancit për vitin 2017 në përgjithësi është në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 neni 6, me VKM nr. 248, datë 10.4.1998 “Për miratimin e planit kontabël” si dhe UMF nr. 14, datë 28.12.2006, ndryshuar me UMF nr. 26, datë 27.12.2007 dhe plotësimi i tij është bërë me programe kompjuterike, duke rakorduar llogaritë dhe shumat përkatëse.

Veprimet për vitin 2017 janë azhurnuar periodikisht, janë kontabilizuar në ditarët, ku llogaritë në përgjithësi janë në pozicionin e duhur dhe në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 7661, datë 19.01.1993 “Për kontabilitetin” ndryshuar me ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 neni 6, si dhe UMF nr. 14, datë 28.12.2006, UMF nr. 26, datë 27.12.2007.

Ditari i magazinës është mbajtur dhe veprimet hidheshin periodikisht.



Nga auditimi u konstatua se SUT, Sektori i Financës ka hartuar pasqyrat financiare për *Ministrinë e mbrojtjes*, të cilat janë me shkresën nr. 375, dt. 27.02.2018, duke mos u përfshirë Përmbledhësja e Thjeshtë për pasqyrat financiare të konsoliduar (*formati nr. 10, formati nr. 11*) me afat deri 20.04.2018, në përputhje me kërkesat e udhëzimit nr. 14, datë 28.12.2006 “*Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2016 për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësite që varen prej tyre si edhe njësite të menaxhimit / zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj*”, i ndryshuar me udhëzimin nr. 26, datë 27.12.2007.

c/3. Mbi raportet e monitorimit të shpenzimeve:

Nuk janë hartuar raportet e monitorimit të shpenzimeve për vitin 2016 dhe 2017, me informacionin e plotë me shpjegimet përkatëse lidhur me ndryshimet e PBA, buxhetit nga plani fillestar deri në atë përfundimtar, në nivel programi dhe artikulli, lidhur me ndryshimet e planit të produkteve, si në sasi dhe në vlerë në përputhje me Udhëzimet e Ministrit të Financave për zbatimin e buxhetit të shtetit. Mungon një analizë me argumentet e plota në lidhje me mosrealizimin e produkteve dhe masat që parashikohen në të ardhmen për realizimin e tyre.

Nuk është e paraqitur Performanca e produkteve “*Planifikim, menaxhim, administrim*” e lidhura me realizimin e objektivave dhe politikës së programit ku të shpjegohej cilat ishin objektivat sipas PBA, politikat e çdo programi si dhe sa janë realizuar këto objektiva.

- Raportet e monitorimit të buxhetit nuk janë publikuar në faqen zyrtare të SUT së ministrisë përkatëse, në përputhje me Udhëzimet e Ministrit të Financave për zbatimin e buxhetit të shtetit. Raportet e monitorimit nuk janë hartuar në kundërshtim me UMF nr. 22, datë 17.11.2016 “*Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit në njësitë e Qeverisjes Qendrore*”.

SUT nuk ka hartuar dhe për pasojë as nuk ka miratuar nga titullari i njësisë raportet e monitorimit lidhur me vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm si dhe raportet 4-mujore dhe vjetore në lidhje me zbatimin e buxhetit në kundërshtim me udhëzimin e MF nr. 22, datë 17.11.2016 “*Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore*” si dhe referuar nenit 24 “Monitorimi i ligji nr. 10296 datë 08.07.2010 i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 “*Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin*”.

c/4 Programi i transparencës për Spitalin Universitar të Traumës.

Spitali Universitar i Traumës nuk ka përgatitur programin e transparencës ku të përcaktojë kornizën ligjore të veprimtarisë së autoritetit në përputhje me ligjin nr. 119, dt. 18.09.2014 “*Për të drejtën e informimit*”

Përgatitja e këtij programi vlerësohet si një mënyrë konkrete përmes së cilës SUT ndërton dhe rrit transparencën në punën e tij institucionale, nën garancinë e ligjit për të drejtën e informimit duke e përditësuar herë pas here Programin e Transparencës.

Mungon faqja zyrtare në web ku mund të publikohet informacioni i programit që synon të bëjë transparencën e veprimtarisë së punës së SUT-së, nëpërmjet pasqyrit të detajuar të tij në faqen zyrtare. Programi i transparencës duhet të pasqyrohet në rubrika, tekste/përmbajtje, afate kohore për bërjen publike të tij, mënyrën e bërjes publike si dhe strukturën përkatëse e cila prodhon ose administron dokumentin. Përveç kësaj, çdo dokument duhet të jetë i aksesueshëm edhe në skemë.

Dokumentacioni i bërë publik, duhet të jetë i përditësuar në formë e përmbajtje. Faqja zyrtare e SUT-së të ndërtohet në atë formë që të mundësojë informacion për publikun pa kërkesë në format lehtësisht të kuptueshëm. Në rubrikat e faqes zyrtare duhet të pasqyrohen edhe informacione që karakterizohen nga kufizime të identifikimit të të dhënave personale për shkak të ruajtjes së privatësisë së individëve/subjekteve të të dhënave, etj.



Në përputhje me programin e transparencës të miratuar SUT të vendosë në dispozicion të publikut në faqen e tij të internetit dhe në mjediset e pritjes së publikut, kategoritë e informacionit si:

- *Strukturën organizative të SUT;*
- *Tekstet e plota, të konventave që janë ratifikuar, të ligjeve, të akteve nënligjore, të kodeve të sjelljes, dokumente politikash, të manualit ose ndonjë dokument tjetër që ka lidhje me ushtrimin e funksioneve të tij dhe që prek publikun e gjerë;*
- *Informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës;*
- *Të dhëna për vendndodhjen e zyrave të SUT-së, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinаторit për të drejtën e informimit;*
- *Të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, sipas ligjit, strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë, si dhe një përshkrim të procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të SUT-së dhe procedurën që ata ndjekin për të marrë vendime;*
- *Mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi SUT-në, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera, si dhe dokumentet që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit;*
- *Të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit.*
- *Informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat, përkatësisht, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9643, dt. 20.12.2006, “Për prokurimin publik”, dhe të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”.*
- *Informacion për shërbimet që SUT i ofron publikut, përfshirë standardet për cilësinë e shërbimit, informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh, çdo informacion tjetër që gjykohet i dobishëm;*
- *AP-ja, gjithashtu, duhet të krijojë dhe arkivojë një kopje digjitale të faqes zyrtare të tij në internet, të plotësuar me informacionin që kërkohet në programin e miratuar të transparencës, si dhe për metodat, mekanizmat dhe periodicitetin e publikimit të informacioneve publike, të cilat vihen në dispozicion të publikut pa kërkesë;*
- *Aktet që përmbajnë rregulla, norma apo kufizime të të drejtave dhe lirive themelore të individit, si dhe me efekt të drejtpërdrejtë për ta, bëhen publike me anë të afishimit apo postimit në faqen zyrtare të internetit..*

c/5. Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve të kryera përmes arkës, bankës në lekë dhe veprimet në valutë. Ligjshmëria dhe saktësia e plotësimit të dokumentacionit bazë të kontabilitetit (fletëhyrje, fletëdalje, faturë, mandatarkëtim, mandatpagesë, urdhër shpenzim, etj.)

Nga auditimi me zgjedhje i kryer në Sektorin e Financës së SUT-s, për veprimet e arkës në valutë dhe veprimet nëpërmjet bankës rezultoi se, veprimet janë kryer konform kërkesave të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 248, datë 10.04.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik të organeve të Pushtetit Lokal, Institucioneve shtetërore qendrore si dhe njësive që varen prej tyre”, i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001 dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore”, i ndryshuar.

Transaksionet janë kontabilizuar në mënyrë kronologjike dhe gjendja e llogarive bankare rakordon me ekstraktet e bankës në fund të çdo muaji. Të gjitha tërheqjet me çek nga banka në lekë dhe valutë, janë bërë hyrje në arkë dhe kontabilizimi i tyre në ditarin e bankës dhe të arkës është bërë në llogarinë 580 “Xhirimi i vlerave monetare”, llogari e cila në fund të periudhës paraqitet e mbyllur.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN UNIVERSITAR TË TRAUMËS”

Pagesat e kryera me urdhër shpenzimi, përgjithësisht janë të shoqëruara me dokumente të rregullta justifikuese. Është bërë regjistrimi dhe kontabilizimi i rregullt dhe në fund të çdo muaji, shuma e pagesave të bankës është e barabartë me ekstraktin e saj, kjo për sa i përket veprimeve të kryera gjatë vitit.

-Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve të kryera nëpërmjet arkës në lekë.

Nga auditimi rezultoi se në Spitalin Universitar i Traumës (SUT) regjistrimet kontabël në ditarin e arkës janë bërë në mënyrë kronologjike e sistematike, veprim për veprim sipas datës së vlerësimit kontabël.

Në Arkën Qendrore, të SUT përveç arkëtimeve ditore nga arka e pritjes së pacientëve bëheshin dhe arkëtimet mujore të qerasë së lokalit për vitin 2016 deri në Tetor 2017 pasi nuk është rinovuar më kontrata. Të gjitha arkëtimet e kryera derdhen në llogarinë bankare të SUT por konstatohet se veprimet e derdhjes në bankë nuk kryheshin çdo ditë, pavarësisht se mbyllja dhe rakordimi i saj kryhej çdo ditë.

Nga auditimi i dokumentacionit të mandat arkëtimeve dhe mandat pagesave nga KLSH ishte lënë detyrë që SUT për arkëtimet e bëra për periudhën objekt auditimi të përdor kase fiskale kjo mbështetje të ligjit nr. 9920, datë 19/05/2008 “Për procedurat tatimore” (i ndryshuar) neni 55 dhe Udhëzimi nr. 24, datë 02/09/2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar), neni 54. “Detyrimi për përdorimin e pajisjeve fiskale” pika 1 citohet “Tatimpaguesit, që kryejnë qarkullimin e mallrave dhe të shërbimeve, për të cilat pagesat nuk kryhen nëpërmjet bankës, janë të detyruar të fusin dhe të përdorin sistemin fiskal, nëpërmjet përdorimit të pajisjeve fiskale, për regjistrimin e pagesave me para në dorë dhe për lëshimin, në mënyrë të detyrueshme, të kuponit tatimor”, gjë e cila është realizuar nga SUT dhe për çdo pagesë, bashkëlidhur gjendet kuponi i casës fiskale.

Nga auditimi i dokumentacionit të Arkës konstatohet se, arkëtimet nga shtrimet e pacientëve në spital janë bërë në përputhje me VKM nr. 383, datë 19.06.2004 Për miratimin e procedurave, tarifave dhe masën e mbulimit të shërbimeve ekzaminuese unike dhe terciare të përfshira në sigurimin shëndetësor i ndryshuar më VKM nr. 592, datë 18.08.2011 si Urdhër nr. 28, datë 26.01.2016 “Për sistemin e referimit dhe tarifat e shërbimit shëndetësor publik” të Ministrit të Shëndetësisë..

Nga auditimi i dokumentacionit Arkës së SUT rezultoi se të gjitha arkëtimet dhe pagesat janë bërë në mënyrë kronologjike. Të gjitha të ardhurat dytësore janë derdhur në Degën e Thesarit Tiranë në llogarinë e SUT. Në periudha të ndryshme të vitit 2016-2017 janë mbajtur procesverbale në lidhje me gjendjen e arkës, ku ka rezultuar se ndërmjet gjendjes së paraqitur në librin e arkës dhe gjendjes fizike nuk ka pasur diferenca.

Nga auditimi i dokumentacionit të mandat arkëtimeve u vu re se në të gjithë mandat arkëtimet nënshkruhen nga personi përgjegjës për vlerat monetare, si dhe nga punonjësi që kryen derdhjen dhe nga nëpunësi zbatues në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” kapitulli “Dokumentimi i vlerave monetare dhe letrave me vlerë”, pika 68.

- Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve të kryera nëpërmjet bankës në lekë.

Spitali Universitar i Traumës (SUT) ka administruar dhe vazhdon të administrojë fondet monetare pranë Degës së Thesarit Tiranë. SUT operon me bankat e nivelit të dytë për shpenzimet e pagave dhe për shpenzimet operative. Në fund të çdo muaji SUT rakordon me Degën e Thesarit Tiranë për gjendjen e llogarisë. Gjendja e llogarisë në fillim të vitit 2016 rezulton të këtë qenë si më poshtë tab. Sipas rakordimit të kryer me DTH Tiranë.

Gjendja 01/01/2016	Ministria e Mbrojtjes	Ministria e Shëndetësisë	TOTALI
Arkëtime	4,664,746	-	4,664,746
Fondi buxhetor korent (600+601+602)	738,510,800	60,520,000	799,030,800
Fonde buxhetore kapitale	-	-	-
Fonde buxhetore të pa përdorura	-	-	-
Arkëtime cash	11,588,504		11,588,504
Totali Fonde	754,764,050	60,520,000	815,284,050



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN UNIVERSITAR TË TRAUMËS”

Pagesa Viti 2016			-
Paga , Sigurime, tatim paga	352,147,552	13,017,381	365,164,933
Investime	3,356,760	-	-
Blerje medikamente dhe pajisje mjekësore	165,401,349	40,533,999	205,935,348
Detyrime të prapambetura ()	-	-	-
Shërbimi i Ushqimit në menca	50,780,652		50,780,652
Shërbim pastrimi	38,033,800		38,033,800
Ujësjiellësi	28,403,580		28,403,580
Ekzekutimi i Vendime gjyqësore	4,760,617		4,760,617
Energjia	20,974,442		20,974,442
Gaz mjekësor	13,316,735		13,316,735
Shërbimi i lavanderisë	13,212,344		13,212,344
Shërbimi i Ruajtjes dhe sigurisë	23,063,918		23,063,918
Të tjera (Mirëmbajtje, Shërbime postare , taksa vendore, kancelari, evadim, konferenca, dokumentacion, etj...)	28,123,316	1,169,100	29,292,416
Total Pagesa	741,575,065	54,720,480	796,295,545
Gjendja me 31/12/2016	13,188,985	5,799,520	18,988,505

Burimi të dhënave nga sektori i financës SUT

Spitali Universitar i Traumës (SUT) edhe për vitin 2017 ka administruar dhe vazhdon të administrojë fondet monetare pranë Degës së Thesarit Tiranë. SUT operon me bankat e nivelit të dytë për shpenzimet e pagave dhe për shpenzimet operative. Në fund të çdo muaji SUT rakordon me Degën e Thesarit Tiranë për gjendjen e llogarisë. Gjendja e llogarisë në fillim të

Gjendja 01/01/2017	Ministria e Mbrojtjes	Ministria e Shëndetësisë	TOTALI
Arkëtime	16,253,250	-	16,253,250
Fondi buxhetor korent (600+601+602)	920,447,000	230,545,000	1,150,992,000
Fonde buxhetore kapitale	5,000,000	-	5,000,000
Fonde buxhetore të pa përdorura	-	-	-
Arkëtime cash	10,123,087	-	10,123,087
Totali	951,823,337	230,545,000	1,182,368,337
Pagesa Viti 2017			-
Paga , Sigurime, tatim tatim paga	410,568,270	107,302,401	517,870,671
Investime	18,014,313	-	18,014,313
Blerje medikamente dhe pajisje mjekësore	191,805,677	106,097,397	297,903,074
Detyrime të prapambetura)	-	-	-
Shërbimi i Ushqimit në menca	59,756,525		59,756,525
Shërbim pastrimi	40,545,995		40,545,995
Ujësjiellësi	26,194,696		26,194,696
Ekzekutimi i Vendime gjyqësore	18,111,300		18,111,300
Energjia	24,707,318		24,707,318
Gaz mjekësor	8,570,080		8,570,080
Shërbimi i lavanderisë	64,828,260	15,901,446	80,729,706
Shërbimi i Ruajtjes dhe sigurisë	24,512,069		24,512,069
Të tjera (Mirëmbajtje, Shërbime postare , taksa vendore,kancelari, evadim, konferenca, dokumentacion,	33,389,027	192,170	33,581,197
Total Pagesa	921,003,530	229,493,414	1,150,496,944
Gjendja me 31/12/2017	30,819,807	1,051,586	31,871,393

vitit 2017 rezulton të këtë qenë simbas tab. Sipas rakordimit të kryer me DTH Tiranë.

Burimi të dhënave nga sektori i financës SUT

Nga auditimi me zgjedhje i veprimeve të kryera nëpërmjet bankës u konstatuan, se të gjitha veprimet e kryera me Degën e Thesarit Tiranë regjistrohen në ditarin e bankës i cili mbahet në programin exel dhe në programin financiar Alfa. Për çdo likuidim të kryer Urdhër shpenzimet shoqërohej me dokumentacionin përkatës.



d. Auditim mbi evidentimin dhe administrimin e vlerave materiale në magazinë, farmacinë qendrore, farmacitë spitalore në pavijone për barnat, materiale mjekësore, në sektorët e shërbimit për mjetet e pastrimit, mirëmbajtjes, etj. Mbi inventarizimin e aktiveve në zbatim të UMF nr. 30, datë 27.12.2011.

d/1. Në zbatim të nenit 16, pika 3, të Ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”⁴, nga raporti i NJAB-së, u konstatua se:

Nga auditimi i librave të llogarisë të SUT u konstatua se librat janë të protokolluar, dhe mbahen në dy modele të ndryshme. Në librin nr. 2 pasqyrohen vetëm veprimet e magazinës (*farmacia qendër*). Shkarkimet mujore në librat e financës për ilaçet, medikamentet dhe materialet e tjera rezultojnë se janë bërë në bazë të pasqyrave të farmacisë qendër, duke u bazuar në blloqet e tërheqjes nga pavionet, të firmosura nga shefat e pavioneve, kryeinfermieret dhe farmacia, të cilat nuk janë fletëdalje, por janë përdorur si të tilla. Në këtë rast vërtetohet vetëm lëvizja e materialeve nga magazina nëpër pavionet e ndryshme, por nuk tregohet konsumi nga pavionet për materialet e tërhequra. Në libra e llogarisë nuk janë bërë veprime për shkarkimet e ilaçeve dhe materialeve nga pavionet, gjithashtu nuk ka të dhëna mbi gjendjen e ilaçeve dhe materialeve që duhet të ketë nëpër pavione. Për muajin Shtator 2017 ishin shkarkuar në librin e llogarisë për llogari të magazinës së farmacisë qendër 146 artikuj bashkëlidhur saj një kopje të bllokut fletësh “*bllok tërheqje malli*” nga pavionët, pa numër rendor. Kjo situatë ka vazhduar prej kohësh përpara. Këto veprime janë në kundërshtim me UMF nr. 30, dt. 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika nr. 26 “Çdo njësi duhet të krijojë dhe të përditësojë një regjistër kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron, apo ka në administrim, përfshi dhe pronat publike nga të cilat siguron të ardhura”.

Pika nr. 28. Regjistri i aktiveve të njësisë, duhet të përfshijë si aktivet afatgjata ashtu edhe aktivet afatshkurtër material dhe monetar, si dhe të specifikojë aktivet të cilat gjenden në pronësi të njësisë dhe ato që gjenden nën administrimin e njësisë në formën e pjesëmarrjeve në kapital”.

Procesverbali i shkarkimit bëhet sipas standardeve, pasi plotësohet miratohet nga personat përgjegjës, dhe përgjegjësi material, bashkëlidhur tij vendosen dokumentet vërtetues dhe sqarues si fletëdalje nga magazine, Fletëhyrjet, stacionet përkatës, bazuar në kartelat dhe librat e pavioneve.

- Nga auditimi në farmacinë dhe pavionet e SUT.

Më datë 11.10.2017 Grupi i auditimit bëri verifikimin e dokumentacionit ditor që përdorej nga farmacia e SUT dhe më tej konstatoi se në farmaci ndodheshin disa blloqe me emërtimin “*Blloqe tërheqjes së materialeve nga pavioni*” për të gjithë pavionet e SUT. Këto blloqe përdorreshin si dokument dalje ditore nga farmacia për mallrat, që i jepeshin pavioneve, gjë që vërtetohet nga praktikat e dokumentacioneve të verifikuara. U konstatua në fakt se farmacia nuk përdor dokumentin fletëdalje për mallrat që nxirrte nga magazinë, por bazohej në dokumentet e mësipërme me fletë “*Blloqe të tërheqjes së materialeve nga pavioni*”, pa numër rendor, ku firmosej nga shefi i pavionit, kryeinfermieri dhe magazinierja.

Nga verifikimi i këtyre blloqeve rezultoi se në për datën 11.10 2017 fletët e mësipërme ishin të firmosura nga kryeinfermieret e pavioneve për mallin që kishin marrë nga farmacia por të tre kopjet ndodheshin në bllokun që gjendeshin në magazinë. Me tej rezultoi se mallrat megjithëse ishin firmosur si të tërhequra nga farmacia, ata ndodheshin në farmaci pa tërhequr dhe po në këtë datë malli “*Metil premizolon*” 10 falkone, është dhënë pa u shoqëruar me faturë. Gjithashtu 13 artikuj të firmosur nga z. P.S ishin firmosur dhe nuk ishin tërhequr nga magazina.

Në bllokun e tërheqjes së barnave të Pavionit të Reanimacionit në fletën e kërkesës janë përfshirë gjithsej për tu tërhequr 16 artikuj nga këto 7 artikuj janë tërhequr ndërsa nga nr. 8-16 materialet

⁴ Mbështetur në ISSAI 1610 “Përdorimi i punës së Audituesve të Brendshëm”.



nuk janë dhënë në fakt dhe kolonat e sasive që duhen për tu tërhequr janë bosh në një kohë që kjo kërkesë është e firmosur nga marrësi P.S.

Udhëzimin nr. 30 dt. 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Pika nr. 10, çdo menaxher, nëpunës i njësisë publike është përgjegjës për ruajtjen dhe mbrojtjen e aktiveve dhe të dokumentacionit të njësisë kundrejt humbjeve, vjedhjeve, keqpërdorimit dhe përdorimit të pa autorizuar të tyre sipas kompetencave që mbulon, duke dokumentuar veprimet e ndërmarra prej tij për të siguruar ruajtjen dhe mirëmbajtjen e aktivitetit që ka në përgjegjësi”. Pika 34, “Veprimet ekonomike që kryhen në njësitë publike, si dhe faktet që kanë sjelle ose mund të sillnin ndryshime në pasurinë që ato kanë në ruajtje, pasqyrohen kurdoherë në dokumentet përkatëse dhe menjëherë pasi kryhet veprimi”. Pika nr. 35 “Regjistrimi veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit bazohet në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim dhe grupohen në: Dokumente autorizuese si urdhërat e blerjeve, kontratat, urdhrin për krijimin e komisioneve, urdhër për nxjerrjen jashtë përdorimit etj”, Dokumente vërtetues si fletëhyrjet, faturat, stacionet e shpenzimeve, fletëdaljet, mandate pagesat, procesverbalet, dhe të tjera akte me natyrë që janë verifikues shpenzimi. Pika nr. 38. “Dalja e aktiveve nga magazina bëhet mbi bazën e urdhërdorëzimit, fletëkërkesë, planit të shpërndarjes, e kartës limit dhe dokumentohet me fletëdaljen ose me dokument tjetër të njësuar, me të sipas specifikimeve teknike të aktiveve”. Pika nr. 39. “Çdo hyrje dalje në magazine dokumentohet menjëherë”.

- Nga pavioni për sëmundjet e brendshme 2. për dt. 11.10.2017 për 7 artikujt medikamente, janë firmosur për tu tërhequr nga magazina, në fakt malli ndodhej në magazine, pa u tërhequr nga znj. A.X.

- Për Pavionin SB-2, 5 artikuj janë firmosur për tu tërhequr nga magazina nga Znj. A.X, në fakt nuk janë tërhequr dhe ndodhen në magazinë. Veprimet në librin e magazinës bëhen 10 ditore duke i bashkëlidhur Fletët e tërheqjes ditore të materialeve nga pavionet.

- Për pavionin e reanimacioni në datën 11.10.2017 është firmosur nga z. P.S për tërheqjen prej 6 artikuj “Helme”, malli nuk është tërhequr nga farmacia.

- Blloku Operator për datën 06.10.2017 janë dhënë nga farmacia 6 artikuj “Helme” dhe 3 artikuj materiale në datë 10.10.2017, 5 artikuj pa firmën e shefit të pavionit z. M.T, marrësi është z. K.L.

- Kirurgjia I, në dt.11.10.2017 fatura është firmosur dhe plotësuar dhe malli nuk është tërhequr nga farmacia nga z.V. B.

- Për pavionin e ORL, në farmaci ndodhej një bllok tërheqje barnash i firmosur nga përgjegjësi z. M.S i pa plotësuar kolona e sasive.

- Për pavioni e Urgjencës për dt. 11.10.2017, 16 artikuj medikamente dhe 16 artikuj materiale, janë firmosur për tu tërhequr nga farmacia, në fakt nuk janë tërhequr nga znj. S.G.

- Nga pavioni i Neurokirurgjisë, për datën 11.10.2017 janë firmosur për tu tërhequr 10 artikuj në fakt nuk janë tërhequr nga znj. F.D. Blloku ka disa fletë boshe të firmosura nga z. A.S.

- Për pavionin Kirurgjia II, Për datën 11.10.2017 Znj. F.D ka firmosur për të tërhequr nga farmacia për 15 artikuj barna dhe 13 artikuj material, në fakt malli ndodhej në magazine pa u tërhequr.

U bë sondazh në depo u bë sondazh për disa artikuj ku rezultoi se nuk kishte diferenca.

Grupi i auditimit auditoi edhe disa pavione e reparte të SUT që merren me administrimin dhe përdorimin e ilaçeve medikamenteve e materialeve të tjera mjekimi nuk njohin gjendjen e materialeve nëpër pavione.

- Nga auditimi në pavionin e ortopedisë rezultoi: Kryeinfermieri dispononte libër llogarie por nuk kryente veprime hyrje e dalje ditore dhe nuk kishte lidhje me llogarinë në financë për lëvizjet dhe shkarkimet mujore të ilaçeve dhe materialeve të tjera. Rezultoi se shkarkimet mujore nuk bëheshin nga ana e tij, por nga magazina. Kryeinfermieri nuk njihte gjendjen e materialeve që kishte në ngarkim, nuk kishte flete inventari për materialet dhe pajisjet e pavionit të tij. Barnat e datës 31.07.2017 janë tërhequr pa kuadruar me kartelat dhe nevojat ditore.

- Në pavionin e ortopedisë II nuk kishte dokumente për regjistrimin shpërndarjen dhe shkarkimet e ilaçeve dhe medikamenteve. Shkarkimet mujore të ilaçeve nuk bëheshin me proces-verbale



shkarkimi nga kryeinfermieri i pavionit të miratuara nga shefi i pavionit. Nuk kishte fletë inventari për materialet dhe pajisjet e pavionit të tij.

- Në pavionin e Kirurgjisë I ilaçet tërhiqeshin nga infermierja pa plan ditor. Nuk dispononin libra e dokumente për mbajtjen e llogarisë materiale për materialet që kanë në inventarë dhe ato që përdoren në aktivitetin e përditshëm. Shkarkimet mujore të ilaçeve nuk bëheshin nga kryeinfermieri me pasqyra shkarkimi të miratuara nga shefi i pavionit dhe të dërgoheshin në llogari për tu shkarkuar. Nuk kishte fletë inventari për materialet dhe pajisjet e pavionit të tij.

d/2. Nga auditimi mbi inventarizimin e aktiveve, konstatohet se në SUT, bazuar në kontratat e lidhura nga Ministria e Shëndetësisë referuar Marrëveshjes së kredisë nr. 8098.6 “*Fuqizimi i Qendrës së Traumës*” mes Qeverisë Shqiptare dhe asaj Italiane ka vijuar zbatimi i kontratave të furnizimit me pajisje mjekësore në shumën 613,415,047 lekë si dhe pajisje hotelerie në shumën 93,662,526 lekë. Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga SUT, procesverbaleve të marrjes në dorëzim, kolauditimit dhe instalimit të tyre, rezulton se këto pajisje kanë ardhur dhe qëndruar në ambientet e SUT nga muaji mars i vitit 2017 dhe deri në muajin qershor 2017 (*ku rezulton procesverbali i parë i marrjes në dorëzim datë 09.06.2017*) këto pajisje nuk kanë qenë në përgjegjësinë e asnjë personi të SUT, asnjë nga administratorët e SUT niveli drejtues manaxherial, nuk ishte në gjendje të na jepte një përgjigje se si këto pajisje janë futur në ambientet spitalore dhe kush i ka administruar përkohësisht ato.

Këto pajisje vetëm në muajt qershor deri në muajin dhjetor referuar Fletë hyrjeve në magazinën e SUT janë bërë hyrje dhe janë ngritur Komisionet e marrjes në dorëzim të tyre për çdo pavion.

Referuar FH të audituara, konstatohet se këto pajisje janë bërë hyrje në magazinë pa çmime dhe pa fature shitje etj.

Administrimi i tyre në librat e magazinës kryhej pa përshkruar asnjë të dhënë specifike, kod ose prodhues të pajisjes me qëllim identifikimin dhe shmangien e tjetërsimit të tyre.

Pajisjet e Hotelerisë janë marrë në dorëzim në muajin gusht nga komisioni i ngritur për marrjen në dorëzim të tyre, këto pajisje janë bërë hyrje në magazinë vetëm në muajin tetor 2017, deri në këtë periudhë këto pajisje nuk kanë qenë në përgjegjësinë e askujt dhe nuk është kryer asnjë nga procedurat e parashikuara në Udhëzimit nr. 30, datë 27/12/2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”. Këto mallra janë bërë hyrje në magazinë pa çmime dhe pa faturat përkatëse të shitësit.

Nga grupi i auditimit u krye verifikimi në pavionin e reanimacionit si dhe në atë të bllokut operator dhe pajisjet ndodheshin të instaluar në gjendje pune në këto ambiente, por nga ana e SUT, nuk ishte marrë asnjë masë që këtyre pajisjeve tu vendosej një barcode me shënimin pajisje pronë e SUT, gjithashtu në pavione nuk ishin të afishuara pasqyra e inventarit me pajisjet dhe materialet në ngarkim.

d/3. Mbi funksionimin e komisioneve të inventarizimit të Aktiveve.

Duhet të theksojmë se pavarësisht se nga Auditimi i KLSH-së për vitin 2015, janë konstatuar dhe vënë në vëmendje të meta dhe mangësi të procesit të inventarizimit të aktiveve të SUT, situata dhe procesi i punës së kryer nga këto komisione është në të njëjtën gjendje, për vitin 2016, grupet e inventarizimit, thjesht kanë bërë numërimin fizik të tyre, në prani të personave përgjegjës, pa vlerësuar dhe ndjekur hapat që parashikon Ligji për menaxhimin financiar si dhe udhëzimi për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik. Nga auditimi për inventarizimin e aktiveve për vitin 2016 konstatohet se:

Me urdhrin nr. 139, datë 01/04/2016 të Drejtorit të SUT për “Inventarizimin e vlerave aktive dhe detyrimeve të SUT për vitin 2016” janë krijuar komisionet e mëposhtme:

1-Për inventarizimin e Hotelerisë: V.S, Kryetar, M.L, M.S, A.Z, E.H. anëtar.

2-Për inventarizimin e Pajisjeve Mjekësore: V.S, Kryetar, N.M, A.T, N.Q, A.I anëtar.

3-Për inventarizimin e Farmacisë dhe Laboratorëve: A.Z Kryetar, N.M, E.O A.L anëtar.

4-Për inventarizimin nuk ka komision të emëruar kryerjes së inventarizimit.



Komisioni i inventarizimit të hotelerisë dhe komisioni i pajisjeve mjekësore nuk kanë mbajtur një procesverbal me përgjegjësin e materiale për të fiksuar numrin rendor të fletëhyrjes dhe fletëdaljes së fundit.

Veprime të tilla bien në kundërshtim me nenin 83 të kapitullit “Përgjegjësitë për inventarizimin” të Udhëzimit nr. 30 datë 27/12/2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” në të cilin citohet: “Para fillimit të inventarit fiksohet numri rendor i flete hyrjes dhe flete daljeve nëpërmjet një proces verbali të mbajtur midis përgjegjësit material dhe komisionit të inventarizimit dhe behet mbyllja dhe dylllosja e magazinës. Hapja dhe mbyllja behet në prani të komisionit dhe përgjegjësit material”.

Komisioni i inventarizimit të hotelerisë, komisioni i pajisjeve mjekësore dhe komisioni i inventarizimit të Farmacisë dhe Kiteve Laboratorike nuk kanë përpiluar një relacion në lidhje me inventarizimin fizik të pajisjeve, për kushtet fizike të ruajtjes së tyre etj.

Ekziston vetëm një relacion drejtuar zv/Drejtorit ekonomik znj. A.H, me nr. prot. 356 datë 22.12.2016 për pjesën e Farmacisë dhe laboratorin Biokimik dhe Bakteriologjik nga komisioni për inventarizimin e Farmacisë: A.Z Kryetar, N.M, E.O A.L anëtar, pra rreth 8 muaj me vonesë nga procesi i kryerjes së inventarizimit, në të cilin nuk paraqitet asnjë rezultat i gjendjes faktike dhe fizike i shprehur në vlerë dhe sasi.

Nga auditimi i fletëve të inventarit të pajisjeve mjekësore të sallave të operacioneve, reanimacionit dhe urgjencës kirurgjikale, rezultoi se këto fletë kanë të plotësuar vetëm kolonën e cila i referohet të dhënave të kontabilitetit .Në këto fletë inventari, mungojnë të dhënat e gjendjes së inventarit fizik të aktiveve si dhe të dhënat e rezultatit të dalë nga inventarizimi.

Veprime të tilla bien në kundërshtim me: nenin 73 të kapitullit “Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve” të Udhëzimit nr. 30 datë 27/12/2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” në të cilin citohet : “Inventarizimi i aktiveve është një element i rëndësishëm kontrolli në kuadrin e menaxhimit të aktiveve të njësisë, i cili kryhet për të vërtetuar saktësinë, cilësinë e gjendjes fizike të aktiveve në një kohë të caktuar si dhe përdorimin në mënyrën e duhur dhe me efience të tyre. Inventarizimi kryhet nën përgjegjësinë dhe sipas procedurave të miratuara me këtë udhëzim dhe nga titullari i njësisë publike”

me nenin 85 të kapitullit “Përgjegjësitë për inventarizimin” të Udhëzimit nr. 30 datë 27/12/2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, në të cilin citohet: “Komisioni i inventarizimit ka përgjegjësinë për :

- a. Verifikimin fizik dhe cilësor të gjendjes së aktiveve në ngarkim/përdorim të personelit të njësisë publike dhe pasqyrimin e të dhënave të inventarizimit në procesverbalin përkatës, i cili ruhet gjatë periudhës së inventarizimit..
- b. Të bëjë krahasimin e gjendjes konkrete të aktiveve me të dhënat përkatëse të librave që mbahen nga punonjësit me përgjegjësi materiale e që janë të përputhura me sektorin e financës, të llogaritë kompensimet e lejueshme, duke marrë edhe mendimin e specialistëve përkatës dhe, për diferencat që mund të dalin pas kompensimeve, të hartojë procesverbalet.
- c. Të përpilojë një raport lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, vlerësim paraprak lidhur me cilësinë dhe kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara, për shkaqet e tyre dhe personat përgjegjës, së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t’ia dorëzojë për veprime të mëtejshme nëpunësit autorizues”.

Për vitin 2017 konstatohet se: Me urdhrin nr. 24, datë 20.01.2017 të Drejtorit të SUT për “Inventarizimin e vlerave aktive dhe detyrimeve të SUT për vitin 2017” janë krijuar komisionet e mëposhtme:

1-Për inventarizimin e Hotelerisë: V.S, Kryetar, M.S, F.C, E.H anëtar.

2-Për inventarizimin e Pajisjeve Mjekësore: V.S, Kryetar, N.M, E.T, S.K, F.C anëtar.

3-Për inventarizimin e Farmacisë: A.Z Kryetar, N.M, Z.H, A.L anëtar.



Nga auditimi i Fletëve të inventarit të mbajtura nga komisionet e inventarizimit të aktiveve rezultuan konstatohet:

Nga auditimi i fletëve të inventarit, rezultoi se këto fletë janë të plotësuar sipas kolonave të formularit dhe referohet të dhënave të kontabilitetit, por në asnjë rast nuk u konstatuan aktive për jashtë përdorimit .

Komisioni i inventarizimit të hotelerisë, komisioni i pajisjeve mjekësore dhe komisioni i inventarizimit të Farmacisë dhe Kiteve Laboratorike kanë përpiluar një relacion në lidhje me inventarizimin fizik të pajisjeve, por pa përshtetur kushtet fizike të ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara, nëse ka, për shkaqet e tyre dhe personat përgjegjës, së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, dhe këto të t'ia dorëzojë për veprime të mëtejshme nëpunësit autorizues.

Veprime këto jo në përputhje me: nenin 73 të kapitullit “Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve” të Udhëzimit nr. 30. datë 27/12/2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik ” në të cilin citohet: “*Inventarizimi i aktiveve është një element i rëndësishëm kontrolli në kuadrin e menaxhimit të aktiveve të njësisë, i cili kryhet për të vërtetuar saktësinë, cilësinë e gjendjes fizike të aktiveve në një kohë të caktuar si dhe përdorimin në mënyrën e duhur dhe me eficiencë të tyre. Inventarizimi kryhet nën përgjegjësinë dhe sipas procedurave të miratuara me këtë udhëzim dhe nga titullari i njësisë publike*” si dhe me nenin 85 të kapitullit “Përgjegjësitë për inventarizimin” të Udhëzimit nr. 30 datë 27/12/2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, në të cilin citohet: “*Komisioni i inventarizimit ka përgjegjësinë për :*

a. Verifikimin fizik dhe cilësor të gjendjes së aktiveve në ngarkim/përdorim të personelit të njësisë publike dhe pasqyrimin e të dhënave të inventarizimit në procesverbalin përkatës, i cili ruhet gjatë periudhës së inventarizimit..

b. Të bëjë krahasimin e gjendjes konkrete të aktiveve me të dhënat përkatëse të librave që mbahen nga punonjësit me përgjegjësi materiale e që janë të përputhura me sektorin e financës, të llogaritë kompensimet e lejueshme, duke marrë edhe mendimin e specialistëve përkatës dhe, për diferencat që mund të dalin pas kompensimeve, të hartojë procesverbalet.

c. Të përpilojë një raport lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, vlerësim paraprak lidhur me cilësinë dhe kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara, për shkaqet e tyre dhe personat përgjegjës, së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t'ia dorëzojë për veprime të mëtejshme nëpunësit autorizues”.

Mbi funksionimin e komisioneve të vlerësimit dhe asgjësimit për nxjerrjen jashtë përdorimi të aktiveve.

Me urdhrin nr. 867, datë 31/08/2017 të Drejtorit të SUT për “*Inventarizimin e vlerave aktive dhe detyrimeve të SUT për vitin 2017*” janë krijuar komisionet e mëposhtme :

1-Për vlerësimin e Hotelerisë : E.R, Kryetar, A.D, B.V anëtar.

2-Për vlerësimin e Pajisjeve Mjekësore: E.R Kryetar, A.T, E.X anëtar.

Nga auditimi i procesverbaleve të mbajtura nga komisionet e vlerësimit të aktiveve të hotelerisë dhe pajisjeve mjekësore u konstatua:

Këto komisione për vlerësimin e Aktiveve për nxjerrjen jashtë përdorimi, nuk kanë pasur një raport të përpiluar nga komisionet e inventarizimit të aktiveve.

Veprime të tilla bien në kundërshtim me nenin 102 të kapitullit “Procesi i vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi në njësi” të Udhëzimit nr. 30 datë 27/12/2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” në të cilin citohet: “*Nëpunësi Zbatues i njësisë, në bazë të gjendjes faktike të aktiveve të rezultuar nga inventarizimi, normave të amortizimit, afatit të skadencës, vitit të vënies në punë, vlerës së shtuar ndër vite, mundësitë për riaftësimin e aktiveve në raport me kosto/ përfitimin për një veprim të tillë, informacionit zyrtar të marre mbi dobishmërinë e aktiveve nga drejtuesit e programeve buxhetore dhe punonjësit e tjerë të njësisë, përcakton gjendjen e aktiveve dhe harton listën e atyre që do të vlerësohen. Lista*



nënshkruhet nga komisioni i vlerësimit dhe përgjegjësi material dhe hartohet në tre kopje, një nga të cilat qëndron në arkiv”

Nga auditimi konstatohet SUT gjatë vitit 2017 ka nxjerrë jashtë përdorimi vlerën në total **49,854,683 lekë**.

Në bilancin kontabël të vitit 2017 ky pakësim i Aktiveve Qarkulluese ka ardhur si pasojë e pakësimit të vlerës së zërit “*Instalime teknike, makineri, pajisje vegla pune*” në vlerën **38,475,836 leke** si dhe pakësimit të zërit “*Inventar ekonomik*” në vlerën **11,378,847 lekë**. Referuar procedurës dhe procesverbaleve të nxjerrjes jashtë përdorimi dhe asgjësimit nga ana e SUT për asgjësimin e këtyre materialeve nuk ka asnjë dokumentacion lidhur me procedurën e kryer nga komisioni i asgjësimit, si vlerësimi dhe ndarja e materialeve sipas destinacionit të tyre, materiale për ankand ose materialeve që duhet të grupohen, mjetin e transportit i cili ka kryer transportin e tyre, si dhe vendodhjen e gruposjes së tyre, djegien etj të shoqëruar me fotot përkatëse, sipas përcaktimeve të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 12.10 2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, duke mos e faktuar nxjerrjen jashtë përdorimi dhe asgjësimin e materialeve në vlerën 49,854,683 lekë.

Komisionet e vlerësimit për nxjerrjen jashtë përdorimi të aktiveve dhe komisioni i asgjësimit të tyre është ngritur referuar Urdhrit nr. 866 datë 31/08/2017 të Drejtorit të SUT “*Për vlerësimin, asgjësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimi të vlerave materiale që kanë plotësuar afatin e përdorimit*”.

Komisioni e ngarkuar sipas urdhrit të mësipërm për ndjekjen e procesit të nxjerrjes së aktiveve jashtë përdorimi të tyre për Hotelerinë është i përbërë nga znj. N.M Kryetar, zj G.L Anëtar, dhe z. E.T Anëtar, zj. D.L, M.D anëtar si dhe për Pajisjet Mjekësore është i përbërë nga znj. A.L Kryetar; S.K anëtar; A.I anëtar; N.Q anëtar; E.K anëtar, si dhe Përgjegjësi i materialeve është z. V.A, F.B.

Komisioni i vlerësimit: E.R Kryetare, ML., B.V.

Për ndjekjen e procesit janë ngarkuar me përgjegjësi Përgjegjësit material; Sektori i Financës; si dhe zv/Drejtori Ekonomik i SUT A.H.

Komisionet e vlerësimit janë ngritur në kundërshtim me nenin 101 të kapitullit “*Përgjegjësitë për nxjerrjen nga përdorimi ose tjetërsimin e aktiveve të panevojshme*” të Udhëzimit nr. 30 datë 27/12/2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” në të cilin citohet “*Për vlerësimin dhe nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve afatgjata me rendësi të veçante për institucionin, komisioni i vlerësimit dhe komisioni i nxjerrjes nga përdorimi përbëhen nga jo më pak se 7 anëtarë dhe në përbërjen e tyre marrin pjesë detyrimisht dy specialistë të lartë të fushës. Kur këto specialistë të lartë nuk mund të sigurohen nga strukturat përkatëse, aktivizohen specialistë të jashtëm sipas procedurave ligjore*”.

Në procesverbalet e vlerësimit konstatohet se për disa aktive të vlerësuara si aktive për tu nxjerrë jashtë përdorimit mungon data e hyrjes së aktiveve, pavarësisht se është shënuar vlera e mbetur e aktivitetit pasi është llogaritur vlera e amortizimit, por nuk ka një vlerësim kosto-përfitim të aktiveve të vlerësuara për tu nxjerrë jashtë përdorimit.

Veprime të tilla bien në kundërshtim me nenin 95 të kapitullit “*Procesi i vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi në njësi*” të Udhëzimit nr. 30, datë 27/12/2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” në të cilin citohet: “*Procesi i vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi në njësi është një proces që kryhet gjatë ose pas procesit të inventarizimit. Mbi bazën e të dhënave kontabël për vitin e vënies në punë, kohën e përdorimit, vlerën fillestare, vlerën e mbetur, vlerën e rivënies dhe mbajtjes në punë, vlerësimin kosto-përfitim, bëhet vlerësimi i aktiveve afatgjata dhe afatshkurtra materiale*”

Nga auditimi rezultoi se komisioni i Vlerësimit të Aktiveve të propozuara për nxjerrjen jashtë përdorimit, nuk ka hartuar një relacion të hollësishëm në lidhje me procedurën që ka ndjekur për vlerësimin e këtyre aktiveve vlerën e tyre dhe me propozimin përkatës, për procedurën që do ndiqej, sidomos për pajisjet të cilësuar hekurishte, apo dhe për inventarin e veshmbathjes etj.

Veprime këto në kundërshtim me nenin 106 të kapitullit “*Procesi i vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi në njësi*” të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për*



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN UNIVERSITAR TË TRAUMËS”

menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” në të cilin citohet: “Relacioni përmban procedurën e ndjekur për vlerësimin e aktiveve për nxjerrje nga përdorimi, arsyet, efektin ekonomik të masave për riaftësimin e tyre dhe propozimin përkatës. Relacioni hartohet në tre kopje dhe nënshkruhet nga kryetari i komisionit të vlerësimit”

III. Përputhshmëria ligjore dhe rregullshmëria financiare në planifikim dhe në realizimin e prokurimit të fondeve publike për mallra, punë dhe shërbime.

Nga SUT për vitet 2016 dhe 2017 janë kryer procedura prokurimesh si më poshtë:

Prokurimet viti 2016:

Nr. tenderave	Procedura	Fondi limit pa tvsh	Vlera e kontratës pa tvsh	Diferenca	lekë
					%
7	E hapur	64,788,926	46,039,921	18,749,005	
15	Kërkesë për propozim	40,514,448	35,371,842	5,142,606	
13	Negocim pa shpallje paraprake	44,452,863	37,933,979	6,518,884	
	Totali	149,756,237	119,345,742	30,410,495	

Prokurimet viti 2017:

Nr. tenderave	Procedura	Fondi limit pa tvsh	Vlera e kontratës pa tvsh	Diferenca	lekë
					%
2	E hapur	26,443,956	25,546,069	897,887	
11	Kërkesë për propozim	36,257,721	36,373,102	+ 15,381	
10	Negocim pa shpallje paraprake	92,301,049	94,016,907	+ 1,715,858	
	Totali	155,002,726	155,936,078	+ 933,352	

Disa konstatime të përbashkëta nga auditimi i prokurimeve për vitin 2016 dhe 2017:

➤ Gjatë viti 2016 nga SUT janë kryer procedura prokurimi për blerje medikamente dhe materiale mjekësore me fondin limit në vlerën **98,709,271** lekë pa tvsh të cilat duhet ti kryente Ministria e Shëndetësisë dhe urdhrat e prokurimit e nxjerra nga SUT janë në kundërshtim me VKM nr. 135, datë 20.2.2013 “Për lejimin e Ministrisë së Shëndetësisë për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të institucioneve të varësisë, për disa mallra e shërbime” ku është përcaktuar: Lejimi i Ministrisë së Shëndetësisë, si organ qendror blerës, për kryerjen e procedurave të prokurimit, në emër dhe për llogari të spitaleve publike në varësi të saj, për blerjen e medikamenteve dhe materialeve mjekësore.

Pika 4. Organi qendror blerës ka këto detyra dhe përgjegjësi: të zhvillojë procedurat për prokurimin e përqendruar të medikamenteve dhe materialeve mjekësore, për nevojat spitalore, përfshirë procedurat e prokurimit me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit.

Nga SUT gjatë vitit 2016 janë kryer procedura prokurimi për medikamente dhe materiale mjekimi në vlerën 98,709,271 lekë sipas procedurave dhe vlerave si më poshtë:

Nr. tenderave	Procedura	Fondi limit pa tvsh	lekë
6	E hapur	42,502,337	
6	Kërkesë për propozim	18,970,781	
9	Negocim pa shpallje paraprake	37,236,153	
	Totali	98,709,271	

➤ Gjatë viti 2017 nga SUT janë kryer procedura prokurimi për blerje medikamente dhe materiale mjekësore me fondin limit në vlerën **113,275,093** lekë pa tvsh të cilat duhet ti kryente Ministria e Shëndetësisë dhe urdhrat e prokurimit e nxjerra nga SUT janë në



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN UNIVERSITAR TË TRAUMËS”

kundërshtim me VKM nr. 135, datë 20.2.2013 “Për lejimin e Ministrisë së Shëndetësisë për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të institucioneve të varësisë, për disa mallra e shërbime” ku është përcaktuar: Lejimi i Ministrisë së Shëndetësisë, si organ qendror blerës, për kryerjen e procedurave të prokurimit, në emër dhe për llogari të spitaleve publike në varësi të saj, për blerjen e medikamenteve dhe materialeve mjekësore.

Pika 4. Organi qendror blerës ka këto detyra dhe përgjegjësi:

a) të zhvillojë procedurat për prokurimin e përqendruar të medikamenteve dhe materialeve mjekësore, për nevojat spitalore, përfshirë procedurat e prokurimit me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit.

Urdhrat e prokurimit dhe shkresat e Ministrisë së Shëndetësisë për lejimin e kryerjes së këtyre procedurave nga SUT është në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” kreu I, Neni 2 “Prokurimi i përqendruar dhe organi qendror blerës”; pika 1, Pika 3. Prokurimi i përqendruar mund të përdoret kur: a) blerja e përqendruar mundëson përfitime ekonomike për shkak të rritjes së sasisë së mallrave, punëve ose shërbimeve homogjene dhe që ofrohen në treg me kushte të ngjashme;

Mos kryerja e prokurimit të përqendruar nga Ministria e Shëndetësisë nuk ka mundësuar përfitime ekonomike të cilat do të vinin për shkak të rritjes së sasisë së mallrave, punëve ose shërbimeve homogjene dhe që ofrohen në treg me kushte të ngjashme;

Nga SUT gjatë vitit 2017 janë kryer procedura prokurimi për medikamente dhe materiale mjekimi në vlerën 113,275,093 lekë sipas procedurave dhe vlerave si më poshtë:

lekë

Nr. tenderave	Procedura	Fondi limit pa tvsh
1	E hapur	13,412,078
4	Kërkesë për propozim	20,392,765
5	Negocim pa shpallje paraprake	79,470,250
	Totali	113,275,093

➤ SUT ka kryer procedura prokurimi “Procedurë me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit” me vlerën limit 37,236,153 lekë për vitin 2016 dhe 79,470,250 lekë për vitin 2017 ku Njësitë e prokurimit kanë hartuar relacionin drejtuar drejtorit të SUT “Për përzgjedhjen e procedurës së prokurimit “Procedurë me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit” në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 36, “Procedura me negocim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës” pika c) pasi nuk është e argumentuar nevoja ekstreme për materialet mjekësore e medikamentet dhe se neglizhenca apo vonesat në fillimin e procedurave normale të prokurimit nuk janë shkaqe, që argumentojnë zbatimin e kësaj procedure.

➤ Në Spitalin Universitar të Traumës (SUT), në cilësinë e Autoritetit Kontraktor (AK), Njësia e Prokurimit (NJP) nuk ka funksionuar më vete në përbërje të strukturës organike, por gjatë vitit, si anëtar të NJP-ve, caktohen punonjës të ndryshëm. Në këtë AK, ka zhvillime tenderash në një numër të konsiderueshëm dhe me procedura të ndryshme. NJP-ja ka shumë përgjegjësi sipas legjislacionit të prokurimit publik në fuqi. Nga NJP-të këto detyra nuk janë realizuar të gjitha dhe mangësitë e shkeljet e konstatuara, mund të ishin shmangur, shumica prej tyre, nëse NJP-ja do të funksiononte si strukturë më vete, si dhe po të ishin kryer edhe trajnimet e nevojshme pranë APP-së.

➤ AK, ka hartuar për periudhën objekt auditimi regjistrat e parashikimeve dhe realizimeve të prokurimeve publike sipas formatit të miratuar nga APP-ja dhe i ka dërguar zyrtarisht në APP-në, ku regjistrat e realizimeve janë plotësuar me mangësi, si: nuk shënohet vlera e fondit limit të prokuruar, nuk janë raportuar disa tendera të zhvilluar e të realizuar gjatë viteve. Mos kryerjet e këtyre veprimeve bien ndesh me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 7, pika 1, neni 9, pika 1 si dhe me udhëzimin



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN UNIVERSITAR TË TRAUMËS”⁵

plotësues të Ministrisë së Financave “Për zbatimin e buxhetit”, të dërguar çdo vit, pika 32 “Mbi limitet e angazhimit”.

➤ Formularët e Deklarimit të Konfliktit të Interesit, nuk janë plotësuar nga anëtarët e KVO-ve, në afatin kohorë të momentit të hapjes së ofertave nëpërmjet platformës elektronike të faqes së APP-së. Këto deklarata janë plotësuar dhe nënshkruar me datën e daljes së urdhër prokurimit, në një kohë, që ofertat hapen nga KVO-të mbas disa ditëve (*datat e caktuar për dorëzimin e ofertave*). Kështu që deklarimet përkatëse nuk janë bërë për pjesëmarrësit në konkurrim, pasi këto pjesëmarrës në prokurim njihen vetëm në ditën e hapjes së ofertave nëpërmjet platformës elektronike të faqes së APP-së.

➤ Për të gjithë tenderat e audituar, NJP-të nuk kanë evidentuar marrjet në dorëzim të paketave të dokumenteve të fitueseve të tenderave, para se të lidhen kontratat përkatëse. Mos kryerja e këtij veprimi bie ndesh me LPP, Kreu II, neni 12 “Përgjegjësia e autoritetit kontraktor”, pika 3, si dhe VKM nr. 914, datë 29/12/2014, i ndryshuar, neni 64, pika 5.

➤ Në zbatim të nenit 16, pika 3, të Ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”⁵, nga raporti i NJAB-së, janë konstatua se:

- Për vitin 2016 janë realizuar 30 procedura prokurimi të pa planifikuara të pa pasqyruara në regjistër, në kundërshtim me nenin 57, pika 2, e VKM nr. 914 dt. 29.12.2014 i ndryshuar, pika II/1 germa “i” e Manualit të “Prokurimit Publik” i ndryshuar.

- Nga Njësia e Prokurimit për vitin 2016 nuk janë dërguar në APP regjistrat e realizimit 4 mujor të prokurimeve për tremujorin e II, III, IV, janë dërguar vetëm për 4 mujorin parë me nr. 7/2 dt. 02.03.2016, që është në kundërshtim me nenin 12 pika 4 Kreu II, të Ligjit Nr. 9643, dt. 20.11.2016 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 57 pika 2 e VKM nr. 914, dt. 29.12.2014 i ndryshuar, e cila ngarkon me përgjegjësi Njësinë e Prokurimit të SUT.

-Nuk është pasqyruar burimi i fondeve për procedurat e prokurimit që nuk janë përfshirë në regjistrat e parashikimeve të prokurimeve për vitin 2016.

-Kërkesat për nevojat për mallra dhe shërbime nuk janë përpiluar nga shefat e pavioneve por janë të përgjithshme.

- Argumentimi dhe llogaritjen e fondit limit bëhen duke u bazuar në procedurat e anuluar, në testimin e tregut, dhe kontratat e ngjashme. Nuk janë marrë të dhëna nga organet statistikore, organet doganore dhe referencat të ndryshme ndërkombëtare, dhe analiza kostosh duke bërë që fondi limit të mos jetë real.

Komente dhe shpjegime:

Për sa konstatuar më sipër subjekti i audituar SUT Njësia e prokurimit me shkresën nr. 732/1, dt. 28.05.2018 ka bërë komente dhe shpjegime, konkretisht:

- Për konstatimin “Për të gjithë tenderat nuk janë evidentuar marrjet në dorëzim të paketave të dokumenteve të fitueseve të tenderave, para se të lidhen kontratat përkatëse”, sqarojmë se: Menjëherë pas Njoftimit të fituesit, OE fitues i procedurës, paraqet pranë SUT dokumentacionin e hedhur në sistemin elektronik, i cili evidentohet nga KVO dhe numerizohet si dhe inventarizohet. Në të gjitha procedurat e prokurimit KVO ka lënë gjurmë duke dokumentuar me një dokument “Inventar i dokumentacionit” dokumentet e paraqitura nga OE me numër faqesh si dhe përcaktimin e dokumenteve.

(konstatimi i NJAB) se:

Për vitin 2016 realizuar 30 procedura prokurimi të pa planifikuara e të pa pasqyruara në regjistër, në kundërshtim me nenin 57, pika 2, e VKM 914 date 29.12.2014, pika II/1 germa ‘i’ e Manualit për Prokurimin Publik i ndryshuar,

-Nuk janë dërguar regjistrat e realizimit për tremujorin e II, III, IV...

-Nuk janë pasqyruar burimi i fondeve....

sqarojmë se: Në regjistrat e parashikimit si dhe të realizimeve për çdo 4-mujor janë parashikuar burimi i financimit, nëse fondet janë nga Buxheti i Shtetit apo nga të Ardhurat Dytësore të Spitalit.

Përsa i përket qëndrimit tuaj (**konstatimi i NJAB**) se:

-Kërkesat për nevoja mallra dhe shërbime nuk janë pasqyruar nga shefat e pavioneve por janë të përgjithshme.

-Argumentimi dhe përllogaritja e fondit limit nuk bëhen duke u bazuar në procedurat e anuluar, në testimin e tregut, dhe kontratat e ngjashme. Nuk janë marrë të dhëna nga organet statistikore, organet doganore.... duke bërë që fondi limit të mos jetë real...

⁵ Mbështetur në ISSAI 1610 “Përdorimi i punës së Audituesve të Brendshëm”.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN UNIVERSITAR TË TRAUMËS”

sqarojmë se: Bazuar në funksionimin e SUT, Sektori i Planifikimit pasi evidenton nevojën për materiale, medikamente apo shërbime të ndryshme dhe pas verifikimeve me Zv. Drejtorin Ekonomik, i drejtohet me shkresë Sektorit të prokurimeve, i cili me indicien e Sektorit të Planifikimit fillon procedurën e prokurimit për plotësimin e nevojave.

Përsa i përket konstatimit tuaj se grupet që kanë kryer argumentimin e fondit limit nuk kanë qenë të specializuara sepse nuk kanë marrë të dhëna nga organet statistikore, doganore dhe referenca të ndryshme ndërkombëtare, Gjithashtu ju sqarojmë se në fillim të çdo Viti të Ri Buxhetor, Ministria e Shëndetësisë i dërgon Autoriteteve Kontraktore nën varësi listën e miratuar me çmimet e barnave dhe materialeve të mjekimit për atë Vit Buxhetor.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Në lidhje me observacionet e bëra nga subjekti i audituar grupi i auditimit nuk i merr parasysh komentet dhe shpjegimet e dhëna. Thëksojmë se:

Konstatim et e mësipërme janë nga raporti i auditimit të Njësisë së Auditimit të Brendshëm të SUT-së të cilat nuk janë observuar nga ana juaj.

Në analizë tenderat si më poshtë:

1-Në tenderin e zhvilluar me objekt “Shërbimi i lavanderisë në SUT për periudhën 08.02.2016 deri 31.12.2016”,

U konstatuan:

Sipas raportit përmbledhës të datës 29.01.2016 mbajtur nga KVO kanë paraqitur ofertat për konkurrim 5 operator nga të cilët 4 janë skualifikuar, i kualifikuar dhe shpallur fitues operatori “D” sh.p.k. me të cilin është lidhur kontrata nr. 195/8, datë 08.02.2016.

Nga auditimi i dosjes së prokurimeve dhe dokumenteve të sjella nga operatori fitues rezultoi:

Me urdhrin e prokurimit nr. 195/3, datë 30.12.2015 nxjerrë nga z. G.B është përcaktuar fondit limit prej 4,625,784.8 lekë pa t.v.sh. (5,550,942 lekë me t.v.sh.) forma e procedurës e tenderit “kërkesë për propozim” ku është përcaktuar Njësia e Prokurimit dhe me urdhrin nr. 195/4, datë 31.12.2015, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” kreu VII, neni 58 “Komisioni i vlerësimit të ofertave, i cili emërohet me urdhrë të veçantë të titullarit të autoritetit kontraktor” dhe neni 60 pika 1 “...titullari i autoritetit kontraktor apo zyrtari i autorizuar nxjerr menjëherë urdhrin e prokurimit...”.

Me urdhrin nr. 474, dt. 11.11.2015 nxjerrë nga z. Gj.B janë ngritur grupet e punës për përgatitjen e specifikimeve teknike për procedurat e prokurimit për kontratat e shërbimeve që do të kryhen në SUT për vitin 2016 ku është ngritur edhe grupi i punës për shërbimin e lavanderisë (M.L, F.B, G.H), në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 61, pika 2 “Në rastet kur njësia e prokurimit nuk ka kapacitetet e duhura për hartimin e kërkesave për kualifikim dhe/ose specifikimet teknike dhe/ose kriteret e vlerësimit, këto përgatiten nga struktura të specializuara për objektin që prokurohet, brenda autoritetit kontraktor apo edhe jashtë tij, kur kjo ekspertizë mungon”.

Ky grup në datën 15.12.2015 ka përgatitur specifikimet teknike për shërbimin e lavanderisë në SUT për vitin 2016 ku citon se është “mbështetur në specifikimet e procedurave të mëparshme, në procedurat e ngjashme të institucioneve të tjera dhe në vetë specifikën që ka ky shërbim”. Në dosje nuk janë bashkëngjitur dokumentet me kërkesat specifike për procedurat e periudhave të mëparshme të kryera në SUT, gjithashtu nuk ka dokumente me kërkesat specifike të aplikuara në procedura të ngjashme nga institucionet e tjera. Këto dokumente do të shërbenin si bazë për përcaktimin e specifikimeve teknike. Për sa më lart mban përgjegjësi grupi i punës për përcaktimin e specifikimeve teknike.

-Përcaktimi i vlerës limit të kontratës publike është kryer nga një komision (V.S, G.H, E.H) i ngritur me urdhrin nr. 195, dt. 30.12.2015 të cilët me shkresën nr. 195/1, dt. 30.12.2015 kanë përllogaritur fondin limit për shërbimin e lavanderisë për periudhën 01 janar deri 31.12.2016 në vlerën 5,217,940 lekë pa tvsh ose 6,261,528 lekë me tvsh, dhe me shkresën nr. 195/2, dt.



30.12.2015 kanë përlogaritur fondin limit për shërbimin e lavanderisë për periudhën 08 shkurt deri 31.12.2016 në vlerën **4,625,785 lekë** pa tvsh ose 5,550,942 lekë me tvsh në datën e nxjerrjes së urdhrin të prokurimit nr. 195/3, datë 30.12.2015 ku sipas VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” kreu II, neni 9 pika 1, “Vlera limit e kontratës publike është shuma totale, pa TVSH, e llogaritur nga autoriteti kontraktor përpara nxjerrjes së urdhrin të prokurimit”, dhe neni 59 “Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrin të prokurimit, duhet të dokumentojë përlogaritjen e vlerës së kontratës”.

Nga komisioni citohet se “në përlogaritjen dhe argumentimin e fondit limit për shërbimin e lavanderisë në SUT janë mbështetur në specifikimet teknike për këtë shërbim dhe në bazë të nevojave dhe konsumit që ka spitali. Periudha për përlogaritjen e fondit limit është 08 shkurt deri 31 dhjetor 2016 dhe si bazë dhe si referencë për llogaritje është marrë konsumi i të njëjtës periudhë për vitin 2015”. Përlogaritja e fondit limit nuk është e dokumentuar, kjo në kundërshtim me nenin 59 “Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrin të prokurimit, duhet të dokumentojë përlogaritjen e vlerës së kontratës”.

Nga Njësia e Prokurimit është mbajtur procesverbali datës 30.12.2015 për hartimin e dokumenteve të tenderit referuar urdhrin të prokurimit nr. 195/3, dt. 30.12.2015 ku janë përcaktuar procedura e prokurimit, data e zhvillimit të tenderit (dt. 14.01.2016), kriteret e kualifikimit, kapacitetet ekonomike financiare, kriteri i vlerësimit dhe kapacitetet teknike e kriteret profesionale, operatorët e ftuar (specifikimet teknike si dhe kriteret teknike janë përcaktuar nga grupi i punës i ngritur me urdhrin nr. 474, dt.11.11.2015) në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 28 “Kontratat e shërbimeve”, neni 61 pika 2 “Në çdo rast, hartimi i kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre”.

Me nr. 195/6, dt. 29.01.2016 nga KVO është hartuar raporti përmbledhës i firmosur nga komisioni i vlerësimit, i miratuar nga titullari i autoritetit kontraktor z. Gj.B në mbi ecurinë e procedurës së tenderit, informacionin mbi kualifikimin e operatorit në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 68 “Komisioni i vlerësimit të ofertave, pas përfundimit të afatëve të ankimit, përgatit një raport përmbledhës dhe ia dërgon për miratim titullarit të autoritetit kontraktor...” dhe 69 “Pas miratimit të raportit përmbledhës autoriteti kontraktor”, si më poshtë:

Ka paraqitur ofertat 5 operatorë:

a-Janë skualifikuar:

1. Operatori “P” sh.p.k ka paraqitur në sistem vetëm certifikatë nipt.
2. Operatori “K” shpk, ka paraqitur në sistem vetëm ekstraktin historik të regjistrin tregtar.
3. Operatori “P.S” shpk, me ofertën 4,305,538.6 lekë pa tvsh ka mungesa në dokumentacionin që vërtetojnë plotësimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit:
 - Mungon kontrata e qirasë ose e pronësisë që vërtetojnë se zotëron ambient ku do të ushtrojë shërbimin e lavanderisë të shoqëruar me leje nga QKL, autorizim mjedisor për aktivitetin e lavanderisë, ka paraqitur një kontratë qiraje apartamenti.

Në specifikimet teknike kërkohet “13. Sipërmarrësi duhet të ketë në pronësi ose me qera një objekt ose sipërfaqe për kryerjen e shërbimit” dhe skualifikimi se nuk ka paraqitur dokument pronësie nuk qëndron pasi ka paraqitur kontratën për dhënie me qira të apartamentit me sipërfaqe 61.4 m². Pra nuk përcaktohet se nëse është apartament nuk pranohet. Ky kriter plotësohet nga operatori.

Nuk janë paraqitur kontrata të ngjashme, nuk ka paraqitur dokumente që vërtetojnë se zotëron makineri dhe pajisje për kryerjen e shërbimit të lavanderisë, nuk ka paraqitur vërtetimin nga OSHE për shlyerjen e detyrimeve të energjisë.



4. Operatori “R.D” (*person fizik*) me ofertën 3,720,000 lekë pa tvsh ka mungesa në dokumentacionin që vërtetojnë plotësimin e kriterëve të përgjithshme e të veçanta të kualifikimit:

Nga auditimi i dokumenteve në formatin elektronik nga operatorët e mësipërm rezulton se s’kualifikimi i operatorëve të mësipërm është në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 66, pika 3. “Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit...”.

b-Janë kualifikuar:

1. Operatori “D” sh.p.k me vlerën e ofertës 4,607,993.3 lekë pa tvsh pasi plotësonte kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor..

Nga auditimi i dokumenteve në dosjen e prokurimit dhe ato në formatin elektronik nga operatori i mësipërm rezulton se kualifikimi i operatorit të mësipërm është në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 66, pika 3. “Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit...”.

Midis operatorit “D” sh.p.k dhe autoritetit kontraktor është hartuar dhe firmosur kontrata nr. 195/8, datë 08.02.2016 për kryerjen e shërbimit të lavanderisë në SUT për sasinë 35,582.96 kg me vlerën 4,607,993.3 lekë pa t.v.sh. ose 5,529,591.9 lekë me tvsh me afat kontrate deri 31.12.2016.

2. Në tenderin e zhvilluar me objekt “Shërbimi i lavanderisë dhe hotelerisë në SUT për një periudhë 4-vjeçare”, deri 06.12.2020 :

U konstatuan:

Sipas raportit përmbledhës të datës 30.11.2016 mbajtur nga KVO kanë paraqitur ofertat për konkurrim një operator, është kualifikuar dhe shpallur fitues operatori “D” sh.p.k. me të cilin është lidhur kontrata nr. 132/14, datë 07.12.2016.

Nga auditimi i dosjes së prokurimeve dhe dokumenteve të sjella nga operatori fitues rezultoi:

Me kërkesën nr. 251/1, dt. 20.11.2015 kryeinfermierët e SUT të cilët “në shërbimin aktual të lavanderisë kanë hasur probleme, baza materiale nuk është e cilësisë së duhur, kemi pasur raste që çarçafët janë grisur dhe duke kryer lëvizjen e pacientit, na ndodh shpesh që materialet që dorëzojmë nuk vijnë të njëjtat (ndërohen) gjithashtu ky problem qëndron edhe me batanijet”.

Me urdhërin e drejtorit z. Gj.B nr. 321, dt. 14.07.2016 është ngritur grupi i punës për kryerjen e studimit të kostos dhe efektivitetin ekonomik e praktik të zgjerimit të shërbimit të lavanderisë së SUT dhe kalimin e tij në shërbim afatgjatë, ku kërkohet nga grupi i punës “të kryejë studim të hollësishëm të shërbimit të Lavanderisë të përcaktojë problematikat dhe shtesat që nevojiten për rritjen e efikasitetit të këtij shërbimi, specifikimet e detajuara, studimin e kostos dhe efektivitetin ekonomik për përmirësimin dhe arritjen e një shërbimi optimal sipas standardeve të përcaktuara në protokollet përkatëse kombëtare dhe ndërkombëtare” ku përcaktohet gjithashtu edhe afati për kryerjen e këtij studimi deri datën 31.07.2016. Ky urdhër është ndryshuar me nr. 321/4, dt. 29.07.2016.

Nga titullari i autoritetit kontraktor z. Gj.B është kërkuar dhënia e çmimit për “Kryerjen e shërbimit të hotelerisë dhe lavanderisë për SUT për një periudhë 4 vjeçare” nga katër operatorë ekonomikë;

- 1- Operatori ekonomik, “A” shpk.
- 2- Operatori ekonomik “P” shpk.
- 3- Operatori ekonomik “U.S” shpk.
- 4- Operatori ekonomik “D” shpk.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN UNIVERSITAR TË TRAUMËS”

Në këto shkresë është kërkuar oferta për sasinë e inventarit që do të blihet, sasia ditore e biankerisë spitalore në 354 kg për shërbimin e lavanderisë, specifikimet teknike të shërbimit dhe të materialeve. Nga operatorët e mësipërm janë ofruar ofertat me shkresat përkatëse.

Me nr. 132/2, dt. 08.08.2016 grupi i punës për kryerjen e studimit të kostos dhe efektivitetin ekonomik e praktik të zgjerimit të shërbimit të lavanderisë së SUT dhe kalimin e tij në shërbim afatgjatë, ka hartuar studimin për shërbimin e lavanderisë dhe hotelerisë në Spitalin Universitar të Traumës Tiranë, ku janë përlogaritur:

- Shpenzimet që i nevojiten spitalit për kalimin në kryerjen e një shërbimi të plotë dhe afat gjatë lavanderie dhe hotelerie (*janë përlogaritur biankeri për tu larë në një ditë në sasinë 354 kg, në një vit 129,310 kg.*) Vlera totale vjetore limit për shërbimin e lavanderisë dhe hotelerisë në SUT është llogaritur në vlerën 45,325,710 lekë pa tvsh, ku ky shërbim do të jetë për një periudhë 4 vjeçare me fondin limit 181,410,840 lekë pa tvsh ose 217,693,008 lekë me tvsh.
- Sasia e materialeve që nevojitet për kompletimin e të gjitha shërbimeve të SUT me materiale të buta cilësore.
- Përcaktimin i specifikave të ofrimit të shërbimit të kërkuar duke u bazuar në problemet e së shkuarës dhe përshtatjen me standartet e institucioneve analoge kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Të përcaktojë detyrat e një shërbimi të organizuar në sipërmarrje private, mënyrën e funksionimit të sipërmarrjes në marrëdhëniet me SUT dhe afatin e kryerjes.

Me urdhrin e prokurimit nr. 132/3, datë 16.09.2016 nxjerrë nga z. Gj.B është përcaktuar fondi limit prej 181,410,840 lekë pa t.v.sh. (217,693,008 lekë me t.v.sh.) forma e procedurës e tenderit “Procedurë e hapur” ku është përcaktuar Njësia e Prokurimit dhe me urdhrin nr. 132/4, datë 19.09.2016, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” kreu VII, neni 58 “Komisioni i vlerësimit të ofertave, i cili emërohet me urdhër të veçantë të titullarit të autoritetit kontraktor” dhe neni 60 pika 1 “... titullari i autoritetit kontraktor apo zyrtari i autorizuar nxjerr menjëherë urdhrin e prokurimit...”.

Nga Njësia e Prokurimit është mbajtur procesverbali datës 19.09.2016 për hartimin e dokumenteve të tenderit (*referuar urdhrin të prokurimit nr. 132/3, dt. 16.09.2016*) ku janë përcaktuar procedura e prokurimit, data e zhvillimit të tenderit (*dt. 17.10.2016*), kriteret e kualifikimit, kapacitetet ekonomike financiare, kriteri i vlerësimit dhe kapacitetet teknike e kriteret profesionale, operatorët e ftuar (*specifikimet teknike si dhe kriteret teknike, fondi limit, janë përcaktuar nga grupi i punës i ngritur me urdhrin nr. 321, dt. 14.07.2016*) në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 28 “Kontratat e shërbimeve”, neni 61 pika 2 “Në çdo rast, hartimi i kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre”. Nga njësia e prokurimit janë hartuar dokumentet standarte të tenderit procedurë e hapur për shërbime të cilat janë printuar, firmosur dhe ndodhen në dosjen e prokurimit.

Autoriteti kontraktor me urdhrin nr. 132/9, dt. 09.11.2016 urdhëron shqyrtimin e ankesës së operatorit “DEVIS” shpk me nr. 1119, datë 08.11.2016 duke ngritur komisionin përkatës dhe me nr. 132/9, dt. 09.11.2016 pezullon procedurën e prokurimit.

Komisioni i shqyrtimit të ankesës me shkresën nr. 132/10, dt. 15.11.2016 i ka rekomanduar titullarit se “*ankesa e operatorit ekonomik “DEVIS” shpk të merret parasysh duke bërë rivlerësimin e procedurës nga ana e KVO-së dhe të shpallet fitues për këtë procedurë prokurimi*”.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN UNIVERSITAR TË TRAUMËS”

Me nr. 132/12, dt. 30.11.2016 nga KVO është hartuar raporti përmbledhës i firmosur nga komisioni i vlerësimit, i miratuar nga titullari i autoritetit kontraktor z. Gj.B në mbi ecurinë e procedurës së tenderit, informacionin mbi kualifikimin e operatorit në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 68 “Komisioni i vlerësimit të ofertave, pas përfundimit të afateve të ankimit, përgatit një raport përmbledhës dhe ia dërgon për miratim titullarit të autoritetit kontraktor...” dhe 69 “Pas miratimit të raportit përmbledhës autoriteti kontraktor”, si më poshtë:

Ka paraqitur ofertat 1 operator:

b-Janë kualifikuar:

2. Operatori “D” sh.p.k me vlerën e ofertës 180,894,000 lekë pa tvsh pasi plotësonte kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor..

Nga auditimi i dokumenteve në dosjen e prokurimit dhe ato në formatin elektronik nga operatori i mësipërm rezulton se:

Në DST është kërkuar: *Operatori ekonomik duhet të disponojë ambientin ku ushtron veprimtarinë e shërbimit të lavanderisë:*

- *Të vërtetuar me dokumentacionin përkatës të pronësisë apo të marrjes me qira (me një afat minimalisht sa koha e vlefshmërisë së kontratës).*
- *Lavanderia duhet të jete në qytetin e Tiranës, kjo distance kërkohet për shkak të specifikës së shërbimit për të cilën kërkohet si dhe urgjencave të parashikuara në Spital.*
- Operatori i mësipërm ka paraqitur kontratën e qirasë të datës 27.08.2015 të notuar ku qiradhënësi znj. K.L i jep me qira “D” shpk. Me administrator znj. K.L sipërfaqen e ndërtesës prej 325 m² për aktivitet tregëtar.

Në kontratën e marrjes me qira të objektit për biznes nuk paraqitet vërtetimi i pronësisë (certifikata e pronësisë). Pra kjo pasuri nuk vërtetohet me dokumente përkatëse pronësie.

Kualifikimi i operatorit të mësipërm është në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 66, pika 3. “Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit...”.

Midis operatorit “D” sh.p.k dhe autoritetit kontraktor është hartuar dhe firmosur kontrata nr. 132/14, datë 07.12.2016 “për kryerjen e shërbimit të lavanderisë dhe hotelerisë për një periudhë 4-vjeçare në SUT” për sasinë 129,210 kg në vit me vlerën totale 180,894,000 lekë pa t.v.sh. ose 217,072,800 lekë me tvsh me afat kontrate deri 06.12.2020.

Komente dhe shpjegime:

Për sa konstatuar më sipër subjekti i audituar SUT me shkresën nr. 732/5, dt. 30.05.2018 ka bërë komente dhe shpjegime, konkretisht:

“Duke qenë se në DST kërkohet të plotësohet të paktën një nga kërkesat (Certifikata e pronësisë ose kontrata e qirasë), me paraqitjen e dokumentit të mësipërm (kontrata e qirasë) KVO e ka vlerësuar si të plotësuar këtë kriter nga ana e operatorit ekonomik sipas kërkesave dhe kriterëve të vendosura në DST”

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Në lidhje observacionet e bëra nga subjekti i audituar grupi i auditimit nuk i merr parasysh komentet dhe shpjegimet e dhëna. Theksojmë se:

“Në kontratën e marrjes me qira të objektit për biznes nuk përcaktohet pronësia duke cituar dokumentin e vërtetimit të pronësisë (certifikata e pronësisë). Pra akti noterial nuk cilëson dokumentin e pronësisë.

3-Në tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje materiale mjekësore për Neurokirurgjinë në SUT për periudhën 2 mujore mars - prill 2016” Tiranë”;

U konstatuan:



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN UNIVERSITAR TË TRAUMËS”

Sipas raportit përmbledhës të datës 15.03.2016 mbajtur nga KVO kanë paraqitur ofertat për konkurrim një operatorë, i kualifikuar dhe shpallur fitues operatori ekonomik “O.D” sh.p.k me të cilin është lidhur kontrata nr. 53/14, datë 15.03.2016.

Me urdhrin e prokurimit nr. 53/10 datë 03.03.2016 nxjerrë nga z. Gj.B është përcaktuar fondi limit prej 7,162,994 lekë pa t.v.sh. (7,731,693 lekë me t.v.sh.) forma e procedurës e tenderit “Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit” ku është përcaktuar Njësia e Prokurimit dhe me urdhrin nr. 53/11, datë 03.03.2016, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” kreu VII, neni 58 “Komisioni i vlerësimit të ofertave, i cili emërohet me urdhër të veçantë të titullarit të autoritetit kontraktor” dhe neni 60 pika 1 “... titullari i autoritetit kontraktor apo zyrtari i autorizuar nxjerr menjëherë urdhrin e prokurimit.....i cili duhet të përmbajë llojin e procedurës së prokurimit dhe arsyet e përdorimit të saj,.....”.

Gjithashtu urdhri i prokurimit është në kundërshtim me VKM nr. 135, datë 20.2.2013 “Për lejimin e Ministrisë së Shëndetësisë për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të institucioneve të varësisë, për disa mallra e shërbime” ku është vendosur: Lejimi i Ministrisë së Shëndetësisë, si organ qendror blerës, për kryerjen e procedurave të prokurimit, në emër dhe për llogari të spitaleve publike në varësi të saj, për blerjen e medikamenteve dhe materialeve mjekësore.

Pika 4. Organi qendror blerës ka këto detyra dhe përgjegjësi:

b) të zhvillojë procedurat për prokurimin e përqendruar të medikamenteve dhe materialeve mjekësore, për nevojat spitalore, përfshirë procedurat e prokurimit me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit.

Në kundërshtim me këtë VKM është edhe urdhri i Ministrit të Shëndetësisë nr. 36, dt. 29.01.2016, (Prot. 600, dt. 29.01.2016) ku urdhëron që institucionet qendrore të cilat në aktivitetin e tyre përdorin materialet e mëposhtme mjekësore të konsumit të zhvillojnë vetë për vitin 2016, procedurat e prokurimit për nevojat vjetore për objektet si më poshtë:

.....Materiale mjekësore specifike për shërbimin e neurokirurgjisë.

- Me urdhrin nr. 53, dt. 22.02.2016 Drejtori z. Gj.B urdhëron të ngrihet grupi i punës për specifikimet teknike “Për blerjen e materialeve mjekësore për neurokirurgjinë në SUT për vitin 2016”.

Bazuar në urdhrin e mësipërm grupi i punës me shkesën nr. 53/1, dt. 26.02.2016 ka përgatitur specifikimet teknike për materialin mjekësor të kërkuar nga Klinika Neurokirurgjisë me shkresën nr. 31, dt. 08.02.2016.

- Me urdhrin nr. 53/2, dt. 26.02.2016 Drejtori z. Gj.B urdhëron të ngrihet grupi i punës për argumentimin e fondit limit “Për blerjen e materialeve mjekësore për neurokirurgjinë në SUT për vitin 2016”, ku citohet se “grupi i punës për të bërë përllogaritjet duhet të mbështetet tek specifikimet teknike të hartuara nga grupi i punës, sasi të që nevojiten dhe çmimit për njësi të mara nga kontratat e ngjashme apo testimi i tregut për ato materiale për të cilat nuk kanë qenë të prokuruar më parë.....”

- Me urdhrin nr. 53/4, dt. 26.02.2016 është ngritur grupi i punës për testimin e tregut “Për blerjen e materialeve mjekësore për neurokirurgjinë në SUT për vitin 2016” ku përcaktohet se “grupi i punës të marrë çmime nga jo më pak se tre operatorë ekonomikë, të nxjerrë çmimin mesatar për çdo artikull të pasqyruar në proces verbal.....”.

Nga grupi janë nisur tre kërkesa për dhënie çmimi të konfirmuara nga operatorët përkatës;

1. “E” shpk,
2. “G” shpk,
3. “O.D” shpk.

- Operatorët kanë paraqitur ofertat për studim tregut “E” shpk ,me shkresën 53/6, dt. 01.03.2016, “G” shpk, me shkresën nr. 53/6, dt. 01.03.2016, “O.D” shpk. Me shkresën 53/6, dt. 01.03.2016.



mbi bazën e të cilave grupi i testimi të tregut ka përgatitur çmimin mesatar të ofertave për të përllogaritur fondin limit. Grupi i punës për argumentimin e fondit limit mbi bazën e çmimeve mesatare dhe ato të kontratave të mëparshme me prot nr. 53/8, dt. 02.03.2016 ka përllogaritur fondin limit për dy muaj në vlerën 7,162,994 lekë pa tvsh dhe 7,731,693 lekë me tvsh në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 9; pika 1. *Vlera limit e kontratës publike, e llogaritur nga autoriteti kontraktor përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit..*

- Nga auditimi i fondit të përllogaritur nga grupi i punës me shkresën nr. 53/8, dt. 02.03.2016 dhe çmimet mesatare të përllogaritura nga grupi i punës me shkresën nr. 53/6, dt. 01.03.2016 rezulton se nga grupi i përllogaritjes së fondit limit nuk janë përdorur çmimet mesatare të ofruara nga grupi i punës që ka përllogaritur çmimet mesatare si më poshtë;

29. Pinca anatomike, gjatësi 200 mm 1 copë = 51,120 lekë /copa pa tvsh,

30. Pinca kirurgjikale, gjatësi 200 mm 1 copë = 53,206 lekë/copa pa tvsh.

54. 9.2 mm to 5.5 mm Rod Konektor 0 copë = 65,730 lekë/copa pa tvsh.

Çmimet mesatare e ofruara nga grupi i punës janë:

29. Pinca anatomike, gjatësi 200 mm 1 copë = 5,120 lekë /copa pa tvsh,

30. Pinca kirurgjikale, gjatësi 200 mm 1 copë = 9,286 lekë/copa pa tvsh.

54. 9.2 mm to 5.5 mm Rod Konektor 0 copë = 63,000 lekë/copa pa tvsh. (Kontrata e mëparshme)

Sa shihet në përllogaritjen e fondit limit nuk janë përdorura çmimet mesatare të ofruara nga grupi i punës me shkresën nr. 53/6, dt. 01.03.2016 si rezultat *fondi limit është përllogaritur më tepër në vlerën 89,928 lekë pa tvsh shumë e cila duhet të arkëtohet.*

29. Pinca anatomike, gjatësi 200 mm 1 copë = $(51,120 - 5,120) = 46,008$ lekë /copa pa tvsh,

30. Pinca kirurgjikale, gjatësi 200 mm 1 copë = $(53,206 - 9,286) = 43,920$ lekë/copa pa tvsh.

Për sa më lart mban përgjegjësi grupi i përllogaritjes së fondit limit znj. E.T, znj. A.Z, z. G.H.

- Me shkresën nr. 53/9, dt. 02.03.2016 njësia e prokurimit (kur urdhri prokurimit është nr. 53/10 datë 03.03.2016) ka hartuar relacionin drejtuar drejtorit të spitalit “Për përzgjedhjen e procedurës së prokurimit “Procedurë me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit me objekt “Për blerjen e materialeve mjekësore për neurokirurgjinë në SUT për periudhën 2 mujore mars prill 2016”, ku argumentohet se si ngjarje e paparashikuar dhe ese kryerja e procedurës normale (procedurë e hapur) kërkon kohë të gjatë . Ngjarja mund të dëmtojë interesat e përgjithshme të një komuniteti të gjerë.

Sa më lart është vepruar në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 36, “Procedura me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës” pika c) Në rastin e një nevojë ekstreme, të shkaktuar nga ngjarje të paparashikuara, që nuk i ngarkohen autoritetit kontraktor. pasi nuk është e argumentuar nevoja ekstreme për materialet mjekësore dhe se neglizhenca apo vonesat në fillimin e procedurave normale të prokurimit nuk janë shkaqe, që argumentojnë zbatimin e kësaj procedure.

Njësia e prokurimit ka vepruar në kundërshtim me VKM nr. 135, datë 20.2.2013 “Për lejimin e Ministrisë së Shëndetësisë për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të institucioneve të varësisë, për disa mallra e shërbime” ku është vendosur: Lejimi i Ministrisë së Shëndetësisë, si organ qendror blerës, për kryerjen e procedurave të prokurimit, në emër dhe për llogari të spitaleve publike në varësi të saj, për blerjen e medikamenteve dhe materialeve mjekësore.

Pika 4. Organi qendror blerës ka këto detyra dhe përgjegjësi:

a) të zhvillojë procedurat për prokurimin e përqendruar të medikamenteve dhe materialeve mjekësore, për nevojat spitalore, përfshirë procedurat e prokurimit me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit.



Nga Njësia e Prokurimit është mbajtur procesverbali nr. 1, datës 03.03.2016 për hartimin e dokumenteve të tenderit *referuar urdhrit të prokurimit nr. 53/10, dt. 03.03.2016* ku janë përcaktuar procedura e prokurimit, data e zhvillimit të tenderit (dt. 10.03.2016), kriteret e kualifikimit, kapacitetet ekonomike financiare, kriteri i vlerësimit dhe kapacitetet teknike e kriteret profesionale, operatorët e ftuar (*specifikimet teknike si dhe kriteret teknike janë përcaktuar nga grupi i punës i ngritur me urdhrin nr. 53, dt. 22.02.2016*) në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 27 “Kontratat e mallrave”, neni 61 pika 2 “Në çdo rast, hartimi i kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre”.

Nga njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit për artikujt e ofruar nuk u janë kërkuar operatorëve ekonomikë katalogët ku të përfshihen edhe specifikimet teknike për secilin artikull.

Në dosjen e prokurimeve ndodhen Dokumentet Standarte të Procedurës kërkesë për propozim të firmosur nga anëtarët e njësisë së prokurimit të cilat janë në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pika 6. “Në rastin e procedurës së prokurimit me negocim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, sipas kushteve të parashikuara në këtë nen, autoriteti kontraktor përdor dokumentet standarde të procedurës me negocim me shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, për sa është e mundur”.

- Nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në datën 10.03.2016 është mbajtur procesverbali nr. 2 për hapjen e procedurës së prokurimit dhe ai nr. 3 për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave të procedurës së prokurimit “Procedurë me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit me objekt “Për blerjen e materialeve mjekësore për neurokirurgjinë në SUT për periudhën 2 mujore mars prill 2016” me fondin limit 7,161,994 lekë. Ku KVO citon se ka shqyrtuar dokumentacionin kualifikues ligjor dhe administrativ (për kërkesat e përgjithshme) dhe kërkesat e veçanta për kualifikim, të paraqitura nga operatori ekonomik “O.D” shpk i cili i plotëson kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit si dhe dokumentacionin e kërkuar sipas dokumenteve të tenderit. Në përfundim KVO e ka shpallur fitues operatorin, “O.D” shpk me ofertën totale 7,152,000 lekë pa tvsh.

Me nr. 53/13, dt. 15.03.2016 nga KVO është hartuar raporti përmbledhës i firmosur nga komisioni i vlerësimit, i miratuar nga titullari i autoritetit kontraktor z. Gj.B në mbi ecurinë e procedurës së tenderit, informacionin mbi kualifikimin e operatorit në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 68 “Komisioni i vlerësimit të ofertave, pas përfundimit të afateve të ankimit, përgatit një raport përmbledhës dhe ia dërgon për miratim titullarit të autoritetit kontraktor...” dhe 69 “Pas miratimit të raportit përmbledhës autoriteti kontraktor”, si më poshtë:

Ka paraqitur ofertat një operator:

- 1- Operatori “O.D” shpk, me ofertën 7,152,000 lekë pa tvsh.

Nga auditimi i dokumente të paraqitura nga operatori i mësipërm rezultoi se janë paraqitur dokumentet standarte të kërkuara.

Në DST në kapaciteti teknik nga njësia e prokurimit është kërkuar pika h: *Të paraqiten mostra për artikujt me shenjën (*) të numri rendor, mostrat duhet të paraqiten ditën e zhvillimit të procedurës në zyrën e sekretarit SUT, shoqëruar me listën inventarizuese. Mos paraqitja e njëjës apo disa mostrave të kërkuara për artikujt me shenjën (*) të përcaktuara në tabelë do të përbënte shkak për skualifikim.*

Në raportin përmbledhës KVO nuk është shprehur nëse operatori i paraqiti mostrat sipas listës ditën e zhvillimit të tenderit dhe nëse ato u verifikuan nga KVO.

Midis operatorit “O.D” shpk dhe autoritetit kontraktor është hartuar dhe firmosur kontrata nr. 53/14, datë 15.03.2016 për furnizimin mallra e materiale për neurokirurgjinë për nevojat e SUT me vlerën 7,152,000 lekë pa t.v.sh. ose 7,718,590 lekë me tvsh me afat kontrate nga dt. 15.03.2016 deri 30.04.2016.



- Me urdhër shpenzimin nr. 165, dt. 26.04.2016 është likuiduar vlera 1,998,975 lekë me tvsh për operatorin “O.D” shpk sipas faturave tatimore nr. 656, dt. 24.03.2016 me vlerë 36,515 lekë me tvsh, faturës tatimore nr. 655, dt. 24.03.2016 për 1,962,460 lekë me tvsh. Materialet e mësipërme janë kontrolluar nga komisioni i pritjes, kontrollit dhe administrimit të mallit i ngritur me urdhrin e titullarit nr. 478, dt. 21.10.2013 dhe për çdo furniturë është mbajtur procesverbali përkatës ku shprehen se materialet u kontrolluan nga komisioni dhe janë sipas standarteve të kërkuara dhe specifikimeve teknike të kërkuara.

- Me urdhër shpenzimin nr. 169, dt. 26.04.2016 është likuiduar vlera 5,079,739 lekë me tvsh për operatorin “O.D” shpk sipas faturave tatimore nr. 693, dt. 01.04.2016 me vlerë 5,079,739 lekë me tvsh. Materialet e mësipërme janë kontrolluar nga komisioni i pritjes, kontrollit dhe administrimit të mallit i ngritur me urdhrin e titullarit nr. 478, dt. 21.10.2013 dhe për këtë furniturë është mbajtur procesverbali përkatës ku shprehen se materialet u kontrolluan nga komisioni dhe janë sipas standarteve të kërkuara dhe specifikimeve teknike të kërkuara.

- Me urdhër shpenzimin nr. 266, dt. 10.06.2016 është likuiduar vlera 639,876 lekë me tvsh për operatorin “O.D” shpk sipas faturave tatimore nr. 814, dt. 15.04.2016 me vlerë 79,200 lekë me tvsh. nr. 789, dt. 13.04.2016 me vlerë 560,676 lekë me tvsh. Materialet e mësipërme janë kontrolluar nga komisioni i pritjes, kontrollit dhe administrimit të mallit i ngritur me urdhrin e titullarit nr. 478, dt. 21.10.2013 dhe për këtë furniturë është mbajtur procesverbali përkatës ku shprehen se materialet u kontrolluan nga komisioni dhe janë sipas standarteve të kërkuara dhe specifikimeve teknike të kërkuara.

-Konstatohet se për zbatimin e kontratës me subjektin e mësipërm nga autoriteti kontraktor janë ngritur komisione për marrjen në dorëzim dhe ka procesverbale të marrjes në dorëzim të mallit sipas kontratës ku shprehen për cilësinë dhe plotësimin e specifikimeve teknike të kërkuara, sipas VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 77, pika 3, “Për t’u siguruar nëse cilësia e punëve, shërbimeve ose e mallrave është e njëjtë me cilësinë për të cilën është shpallur fitues kontraktori, autoriteti kontraktor duhet të monitorojë zbatimin e kontratës dhe në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara zbaton penaltitetet e parashikuara në kontratë. Autoriteti kontraktor, gjatë kryerjes së kontrolleve, mban procesverbal me shkrim në prani të kontraktorit. Në rast se kontraktori nuk është i pranishëm, autoriteti kontraktor ia komunikon me shkrim përmbajtjen e këtij procesverbali”.

Nga autoriteti kontraktor nuk ka një raport përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 77, pika 4. “Në përfundim të kontratës, autoriteti kontraktor përgatit një raport përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës. Një kopje e këtij raporti i jepet edhe kontraktorit, me kërkesë të tij..”

Komente dhe shpjegime:

Për sa konstatuar më sipër subjekti i audituar SUT me shkresën nr. 564/3, dt. 28.05.2018 ka bërë komente dhe shpjegime, konkretisht:

1. “Sa më sipër grupi i argumentimit të fondit limit i është referuar çmimeve të tregut për materiale të cilat nuk kanë pasur kontratë të mëparshme si dhe kontratave me materiale të njëjta që SUT ka lidhur” Nëse i referohemi testimi të tregut SUT nuk i ka marrë parasysh të gjitha çimet por i është referuar dhe kontratave për ato materiale të cilat kanë patur çmim më të ulët sesa ato të ofruara nga testimi i tregut. Diferencat e çmimeve të konstatuara nga ju për dy materialet janë lapsus i bërë nga ana jonë, si rezultat edhe i ngarkesës së madhe.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Në lidhje observacionet e bëra nga subjekti i audituar grupi i auditimit nuk i merr parasysh komentet dhe shpjegimet e dhëna. Theksojmë se:

1. Çmimet mesatare e ofruara nga grupi i punës janë:

29. Pinca anatomike, gjatësi 200 mm 1 copë = 5,120 lekë /copa pa tvsh,

30. Pinca kirurgjikale, gjatësi 200 mm 1 copë = 9,286 lekë/copa pa tvsh.

54. 9.2 mm to 5.5 mm Rod Konektor 0 copë = 63,000 lekë/copa pa tvsh. (Kontrata e mëparshme)



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN UNIVERSITAR TË TRAUMËS”

Sa shihet në përlogaritjen e fondit limit nuk janë përdorura çmimet mesatare të ofruara nga grupi i punës me shkresën nr. 53/6, dt. 01.03.2016 si rezultat *fondi limit është përlogaritur më tepër në vlerën 89,928 lekë pa tvsh pa argumentuar se ku janë bazuar këto çmime..*

4- Në tenderin e zhvilluar me objekt “Mirëmbajtja e objekteve ndërtimore në SUT”:

U konstatuan:

Sipas raportit përmbledhës nr. 20/8, dt. 09.03.2016 mbajtur nga KVO kanë paraqitur ofertat për konkurrim 3 operatorë nga të cilët 2 janë skualifikuar, i kualifikuar dhe shpallur fitues operatori “M” sh.p.k. me të cilin është lidhur kontrata nr. 20/9, datë 11.03.2016.

Nga auditimi i dosjes së prokurimeve në formatin elektronik dhe dokumenteve të sjella nga operatori fitues rezultoi:

Me urdhrin e prokurimit nr. 20/4, datë 10.02.2016 nxjerrë nga z. Gj.B është përcaktuar fondi limit prej 3,333,317 lekë pa t.v.sh. (3,999,980 lekë me t.v.sh.) forma e procedurës e tenderit “kërkesë për propozim” ku është përcaktuar Njësia e Prokurimit dhe me urdhrin nr. 20/5, datë 10.02.2016, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” kreu VII, neni 58 “Komisioni i vlerësimit të ofertave, i cili emërohet me urdhër të veçantë të titullarit të autoritetit kontraktor” dhe neni 60 pika 1 “... titullari i autoritetit kontraktor apo zyrtari i autorizuar nxjerr menjëherë urdhrin e prokurimit...”.

Me urdhrin nr. 20, dt. 11.01.2016 nxjerrë nga z. Gj.B është ngritur grupi i punës për përgatitjen e specifikimeve teknike për procedurat e prokurimit për kryerjen e shërbimit të mirëmbajtjes së objekteve ndërtimore në SUT për vitin 2016 (M.L, A.T, N.Q), në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 61, pika 2 “Në rastet kur njësia e prokurimit nuk ka kapacitetet e duhura për hartimin e kërkesave për kualifikim dhe/ose specifikimet teknike dhe/ose kriteret e vlerësimit, këto përgatiten nga struktura të specializuara për objektin që prokurohet, brenda autoritetit kontraktor apo edhe jashtë tij, kur kjo ekspertizë mungon”.

Ky grup me nr. 20/1, dt. 29.01.2016 ka përgatitur specifikimet teknike për shërbimin e mirëmbajtjes së objekteve ndërtimore në SUT për vitin 2016 ku janë përcaktuar specifikimet e përgjithshme dhe ato të veçanta.

-Përlogaritja dhe argumentimi i fondit limit i kontratës publike është kryer nga një komision (G.H, A.Z, G.H) i ngritur me urdhrin nr. 20/2, dt. 29.01.2016 të cilët me shkresën nr. 20/3, dt. 09.02.2016 kanë përlogaritur fondin limit për shërbimin e mirëmbajtjes së objekteve ndërtimore në SUT për vitin 2016 në vlerën 3,333,317 lekë pa tvsh ose 3,999,981 lekë me tvsh, ku citojnë se për zërat e punës kemi marrë si referencë çmimin më të ulët midis kontratës së mëparshme dhe VKM nr. 629, dt. 15.07.2015.

Përlogaritja edhe argumentimi i fondit limit nuk shoqërohet me projektin e punimeve të mirëmbajtjes së objekteve ndërtimore në SUT si rezultat i të cilit do të dilnin zërat e punimeve të mirëmbajtjes.

Nga Njësia e Prokurimit është mbajtur procesverbali nr. 1, dt. 10.02.2016 për hartimin e dokumenteve të tenderit referuar urdhrin të prokurimit nr. 20/4, dt. 10.22.2016 ku janë përcaktuar procedura e prokurimit, data e zhvillimit të tenderit (dt. 25.02.2016), kriteret e kualifikimit, kapacitetet ekonomike financiare, kriteri i vlerësimit dhe kapacitetet teknike e kriteret profesionale, operatorët e ftuar (specifikimet teknike si dhe kriteret teknike janë përcaktuar nga grupi i punës i ngritur me urdhrin nr. 20, dt. 11.01.2016) në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 28 “Kontratat e shërbimeve”, neni 61 pika 2 “Në çdo rast, hartimi i kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre”.



Në kërkesat e DST nga njësia e prokurimit për kapacitetin teknik është kërkuar, pika 6 “Oferta ekonomike të jetë e shoqëruar me analizë kostoje për çdo zë pune” kjo kërkesë është në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 11 “Përmbajtja e dokumenteve standarde të tenderit” pika 3. Informacioni specifik përmban informacion për kontratat e punëve, mallrave dhe shërbimeve, germa c) Informacioni specifik për kontratat e shërbimeve përfshin të paktën:

- termat e referencës;
- grafikun e ekzekutimit;
- kërkesat për personelin kryesor;
- kërkesat e veçanta për kualifikim dhe kriteret e shpalljes së fituesit;

dhe Neni. 28, “kontratat e shërbimeve” 5. Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla; dhe/ose

c) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për sa më lart mban përgjegjësi njësia e prokurimit; E.T, A.T, A.Z, G.H, G.H.

Me nr. 20/8, dt. 09.03.2016 nga KVO është hartuar raporti përmbledhës i firmosur nga komisioni i vlerësimit, i miratuar nga titullari i autoritetit kontraktor z. Gj.B në mbi ecurinë e procedurës së tenderit, informacionin mbi kualifikimet dhe skualifikimet e operatorëve në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 68 “Komisioni i vlerësimit të ofertave, pas përfundimit të afateve të ankimit, përgatit një raport përmbledhës dhe ia dërgon për miratim titullarit të autoritetit kontraktor...” dhe 69 “Pas miratimit të raportit përmbledhës autoriteti kontraktor”, si më poshtë:

Ka paraqitur ofertat 3 operatorë:

a-Janë skualifikuar:

5. Operatori “D” sh.p.k ka paraqitur ofertën 2,416,735 lekë pa tvsh, me argumentin se: “analiza e kostos nuk është paraqitur për çdo zë pune siç kërkohet në kriteret e DST-së. Ajo përmban 98 nga 198 zëra të kërkuar”.

Nga auditimi i dokumenteve në formatin elektronik nga operatorë e mësipërm rezulton se s`kualifikimi i operatorit të mësipërm është në kundërshtim me ligjin nr. 9643, dt. 20.11.2006 “Për prokurimin publik” Neni 53 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 1. “Autoriteti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në nenet 32 dhe 33 të këtij ligji, nuk duhet të kërkohet, ofrohet apo lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në çmim apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme”.

Gjithashtu është në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 31 “Kriteret për vlerësimin e ofertës”; 1. Për punët/mallrat/shërbimet që kanë specifikime të thjeshta ose standarde teknike të mirënjohura, kriter vlerësimi do të jetë oferta me çmimin më të ulët.

Neni 66, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” pika 3. komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal”.



KVO në rastin e operatorit të mësipërm duhet të kishte pasur parasysh si kriter vlerësimi ofertën më çmimin më të ulët dhe ti kërkonte operatorit analizën e kostos për zërat e tjerë të munguar për të argumentuar çmimet e ofertë dhe të kualifikonte ofertën e operatorit “D” sh.p.k në vlerën 2,416,735 lekë pa tvsh si oferta më e ulët.

Skualifikimi i ofertuesit të mësipërm ka sjellë një dëm prej **820,265** lekë dhe mban përgjegjësi KVO, E.R, M.S, M.L.

6. Operatori “N” shpk, ka paraqitur ofertën 3,172,820 lekë pa tvsh. Me argumentin se: “Nuk ka dorëzuar analizat e kostos siç është kërkuar në DST, mungojnë kontratat e punës ndërmjet OE dhe specialistëve përkatës, OE nuk disponon specialist murator në listpagesa.

b-Janë kualifikuar:

3. Operatori “M” sh.p.k me vlerën e ofertës 3,237,000 lekë pa tvsh pasi sipas KVO oferta e paraqitur është identifikuar si ofertë e suksesshme.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës rezultoi:

Midis operatorit “M” sh.p.k dhe autoritetit kontraktor është hartuar dhe firmosur kontrata nr. 20/9 datë 11.03.2016 për shërbimin e mirëmbajtjes së objekteve ndërtimore në SUT me vlerën 3,237,000 lekë pa t.v.sh. ose 3,884,400 lekë me tvsh me afat kontrate nga dt. 11.03.2016 deri 31.12.2016.

Në nenin 3 “Objekti i kontratës” citohet “Objekti i kësaj kontrate është kryerja e shërbimit për mirëmbajtjen e objekteve ndërtimore në SUT sipas zërave të shërbimit dhe çmimit të përcaktuar në formularin e çmimit të ofertës bashkëlidhur, specifikimeve teknike, afateve të përcaktuara në DST e në këtë kontratë si dhe sipas kërkesës së autoritetit kontraktor”.

Në nenin 9, “Detyrimet e sipërmarrësit”;

- “Sipërmarrësi është i detyruar të sigurojë çdo ditë mjetet dhe pajisjet e nevojshme për kryerjen e shërbimit për mirëmbajtjen e objektit ndërtimor në SUT sipas kushteve të kontratës dhe specifikimeve teknike të cilat janë pjesë e kësaj kontrate dhe gjithmonë sipas kërkesës së autoritetit kontraktor”.

- Operatori ekonomik është i detyruar që të bëjë hyrje mallin në magazinën e SUT-së para se të vendoset në vepër, në mënyrë që të kontrollohet nga personat përgjegjës nëse ai është sipas specifikimeve teknike të kontratës”.

- Duke qenë se nevojat dhe natyra e defekteve në SUT është e paparashikueshme, autoriteti kontraktor nuk është i detyruar të realizojë të gjithë volumet e përcaktuara në preventiv (argumentim). Për çdo zë pune këto sasi ose volume mund të jenë më pak ose më shumë por gjithmonë duke respektuar çmimin për njësi të dhënë nga operatori ekonomik në formularin e ofertës (për çdo zë pune) dhe vlerën totale të kontratës.

Nga auditimi i likuidimit të shërbimit për operatorin “M” shpk rezulton se:

- Bashkëngjitur në urdhrat e shpenzimit janë faturat tatimore, ku faturohet situacioni i mirëmbajtjes, akti i rakordimit i mbajtur nga përfaqësuesit e SUT dhe operatorit “M” shpk, në fillim të çdo muaji për kryerjen e shërbimit të riparim mirëmbajtjes për muajin paraardhës, ku citohet se subjekti “M” shpk gjatë periudhës një mujore ka krye shërbimin e riparim mirëmbajtjes çdo ditë sipas kërkesave të bëra nga pavionet.

- Bashkëngjitur janë edhe pasqyrat përmbledhëse e punimeve të riparim mirë mbajtjes për periudhat përkatëse i mbajtur nga përfaqësuesit e SUT dhe operatorit “M” shpk,

- Nuk ka një urdher nga titullari për ngritjen e një komisioni për marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve.

- Urdhrat e shpenzimit nuk kanë bashkëngjitur një kërkesë nga autoriteti kontraktor për kryerjen e shërbimit për mirëmbajtjen e objekteve ndërtimore në SUT sipas zërave të shërbimit dhe çmimit të përcaktuar në formularin e çmimit të ofertës.

- Urdhrat e shpenzimit nuk kanë bashkëngjitur hyrjen e mallin në magazinën e SUT-së para se të vendoset në objekt.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN UNIVERSITAR TË TRAUMËS”

- Nuk ka një proces verbal për kontrollin dhe marrjen në dorëzim të mallrave nga personat përgjegjës në mënyrë që të kontrollohet nëse ai është sipas specifikimeve teknike të kontratës.

Për sa më lart është vepruar në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 42 “Titullari i njësisë miraton urdhrin për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuara për sasinë, cilësinë, llojin, plotësinë e tyre dhe të dokumentacionit shoqërues”, pika 54 “Për hyrjet që bëhen nga blerjet me fondet buxhetore financat duhet të kontrollojnë nëse fletëhyrja ka bashkëlidhur dokumentacioni justifikues që vërteton marrjen në dorëzim të aktiveve sipas kushteve të kontratës” dhe kontratës nr. 20/9, datë 11.03.2016 për shërbimin e mirëmbajtjes së objekteve ndërtimore në SUT.

Nga autoriteti kontraktor janë likuiduar si më poshtë;

U. Shpenzimi		Vlera me TVSH
Nr.	Dt.	
308	28.06.2018	316,993
309	28.06.2018	548,842
538	18.10.2018	319,973
539	18.10.2016	342,428
625	22.11.2016	275,051
626	22.11.2016	192,988
720	28.12.2016	263,015
721	29.12.2016	445,288
726	29.12.2016	826,267
740	31.12.2016	353,455
Shuma		388,4300

Komente dhe shpjegime:

Për sa konstatuar më sipër subjekti i audituar SUT me shkresën nr. 732/2, dt. 28.05.2018 ka bërë komente dhe shpjegime, konkretisht:

2. Njësia e prokurimit ka kërkuar si kriter që oferta ekonomike të jetë e shoqëruar me analizë kostoje për çdo zë pune.....ky kriter vendoset për të kontrolluar mënyrën e hartimit të ofertës ekonomike dhe shmangies së abuzimeve të çmimeve në zërat e punës të kërkuar për kryerjen e shërbimit objekt i procedurës”.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Në lidhje observacionet e bëra nga subjekti i audituar grupi i auditimit nuk i merr parasysh komentet dhe shpjegimet e dhëna. Theksojmë se:

1. KVO në rastin e operatorit të mësipërm duhet të kishte pasur parasysh si kriter vlerësimi ofertën më çmimin më të ulët dhe ti kërkonte operatorit analizën e kostos për zërat e tjerë të munguar për të argumentuar çmimet e ofertë dhe të kualifikonte ofertën e operatorit “D” sh.p.k në vlerën 2,416,735 lekë pa tvsh si oferta më e ulët”.

2. Nga njësia e prokurimit në kërkesat e DST për kapacitetin teknik është kërkuar, pika 6 “Oferta ekonomike të jetë e shoqëruar me analizë kostoje për çdo zë pune” kjo kërkesë është në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 11 “Përmbajtja e dokumenteve standarde të tenderit” pika 3.

5- Në tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje oksigjen të lëngët (bar) në SUT për periudhën 11.02.2016 deri 15.03.2016” Tiranë”:

U konstatuan:

Sipas raportit përmbledhës të datës 09.02.2016 mbajtur nga KVO kanë paraqitur ofertat për konkurrim një bashkim operatorësh, i kualifikuar dhe shpallur fitues “G” shpk me të cilin është lidhur kontrata nr. 45/8, datë 09.02.2016.

Me urdhrin e prokurimit nr. 45/5 datë 08.02.2016 nxjerrë nga z. Gj.B është përcaktuar fondi limit prej 983,613 lekë pa t.v.sh. për 6550 litra forma e procedurës e tenderit “Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit” ku është përcaktuar Njësia e Prokurimit dhe me urdhrin nr. 45/6, datë 08.02.2016, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014



“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” kreu VII, neni 58 “Komisioni i vlerësimit të ofertave, i cili emërohet me urdhër të veçantë të titullarit të autoritetit kontraktor” dhe neni 60 pika 1 “... titullari i autoritetit kontraktor apo zyrtari i autorizuar nxjerr menjëherë urdhrin e prokurimit.....i cili duhet të përmbajë llojin e procedurës së prokurimit dhe arsyet e përdorimit të saj,.....”.

Gjithashtu urdhri i prokurimit është në kundërshtim me VKM nr. 135, datë 20.2.2013 *“Për lejimin e Ministrisë së Shëndetësisë për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të institucioneve të varësisë, për disa mallra e shërbime”* ku është vendosur: *Lejimi i Ministrisë së Shëndetësisë, si organ qendror blerës, për kryerjen e procedurave të prokurimit, në emër dhe për llogari të spitaleve publike në varësi të saj, për blerjen e medikamenteve dhe materialeve mjekësore.*

Pika 4. Organi qendror blerës ka këto detyra dhe përgjegjësi:

c) të zhvillojë procedurat për prokurimin e përqendruar të medikamenteve dhe materialeve mjekësore, për nevojat spitalore, përfshirë procedurat e prokurimit me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit.

Në kundërshtim me këtë VKM është edhe urdhri i Ministrit të Shëndetësisë Prot. 600/1, dt. 29.01.2016 ku urdhëron që; *institucionet spitalore lejohen të zhvillojnë.. pika b. “Për mbulimin e nevojave për medikamente dhe materiale mjekësore për periudhën fillim viti deri në 15 prill 2016, në pritje të realizimit të procedurave të përqendruara, të prokurimit sipas kërkesës së miratuar për çdo institucion”.*

Nuk ka një urdhër për ngritjen e grupit të punës për specifikimet teknike. Një grup pune me shkesën nr. 45/1, dt. 08.02.2016 ka përgatitur specifikimet teknike për oksigjenin mjekësor i lëngët (bar) të kërkuar nga zv/drejtori ekonomik znj. A.H me shkesën nr. 30, dt. 08.02.2016.

- Me urdhrin nr. 45/2, dt. 08.02.2016 Drejtori z. Gj.B urdhëron të ngrihet grupi i punës për argumentimin e fondit limit *“Për blerjen oksigjen të lëngët (bar) në SUT për periudhën 11.02.2016 – 15.03.2016”*, ku citohet se *“grupi i punës gjatë përcaktimit të fondit limit t ëzbatojë kërkesat e akteve ligjore dhe n/ligjor në fuqi..”*

Grupi i punës për argumentimin e fondit limit mbi bazën e listës së çmimeve të Ministrisë së Shëndetësisë për vitin 2016 nr. 516, dt. 25.01.2016 dhe bazuar në të dhënat e vitit 2015 për sasinë e furnizimit me oksigjen me shkesën nr. 45/3, dt. 08.02.2016 ka përlllogaritur sasinë dhe fondin limit për periudhën 11 shkurt deri 15 mars 2016 në sasinë 6,550 litra në vlerën 983,613.5 lekë pa tvsh në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 9; pika 1. Vlera limit e kontratës publike, e llogaritur nga autoriteti kontraktor përpara nxjerrjes së urdhrin të prokurimit..*

- Me shkesën nr. 45/4, dt. 08.02.2016 njësia e prokurimit (kur urdhri prokurimit është 45/5 datë 08.02.2016) ka hartuar relacionin drejtuar drejtorit të spitalit *“Për përzgjedhjen e procedurës së prokurimit “Procedurë me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit” me objekt “Për blerjen e oksigjenit të lëngët (Bar) në SUT për periudhën 11.02.2016 deri 15.03.2016”, ku argumentohet se si ngjarje e paparashikuar dhe ese kryerja e procedurës normale (procedurë e hapur) kërkon kohë të gjatë . Ngjarja mund të dëmtojë interesat e përgjithshme të një komuniteti të gjerë.*

Sa më lart është vepruar në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 36, “Procedura me negocim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës” pika c) Në rastin e një nevoje ekstreme, të shkaktuar nga ngjarje të paparashikuara, që nuk i ngarkohen autoritetit kontraktor. pasi nuk është e argumentuar nevoja ekstreme për materialet mjekësore dhe se neglizhenca apo vonesat në fillimin e procedurave normale të prokurimit nuk janë shkaqe, që argumentojnë zbatimin e kësaj procedure. (Kontrata shtesë nr. 32/3, dt. 31.01.2016 “Për blerje oksigjen të lëngët (Bar) në SUT ka mbaruar).*



Njësia e prokurimit ka vepruar në kundërshtim me VKM nr. 135, datë 20.2.2013 “Për lejimin e Ministrisë së Shëndetësisë për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të institucioneve të varësisë, për disa mallra e shërbime” ku është vendosur: Lejimi i Ministrisë së Shëndetësisë, si organ qendror blerës, për kryerjen e procedurave të prokurimit, në emër dhe për llogari të spitaleve publike në varësi të saj, për blerjen e medikamenteve dhe materialeve mjekësore.

Pika 4. Organi qendror blerës ka këto detyra dhe përgjegjësi:

a) të zhvillojë procedurat për prokurimin e përqendruar të medikamenteve dhe materialeve mjekësore, për nevojat spitalore, përfshirë procedurat e prokurimit me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit.

Nga Njësia e Prokurimit është mbajtur procesverbali nr. 1, datës 08.02.2016 për hartimin e dokumenteve të tenderit referuar urdhrin të prokurimit nr. 45/5 datë 08.02.2016 ku janë përcaktuar procedura e prokurimit, data e zhvillimit të tenderit (dt. 09.02.2016), kriteret e kualifikimit, kapacitetet ekonomike financiare, kriteri i vlerësimit dhe kapacitetet teknike e kriteret profesionale, (Nuk janë përcaktuar operatorët e ftuar) specifikimet teknike si dhe kriteret teknike janë përcaktuar nga grupi i punës i ngritur me urdhrin nr. 53, dt. 22.02.2016) në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 27 “Kontratat e mallrave”, neni 61 pika 2 “Në çdo rast, hartimi i kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre”.

Nga njësia e prokurimit nuk janë përcaktuar operatorët e ftuar, nuk ka argumentuar dhe dokumentuar përzgjedhjen e kandidatëve të ftuar, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 36 “Procedura me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës” pika 4. autoriteti kontraktor fton jo më pak se 3 (tre) kandidatë, duke garantuar konkurrencë dhe barazi ndërmjet tyre. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përzgjedhjen e kandidatëve që do të ftojë; Pika 5. Kur autoriteti kontraktor përdor procedurën e prokurimit me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, sipas kushteve të parashikuara në këtë nen, duhet të provojë se kandidatët plotësojnë minimalisht kërkesat e nenit 45 të LPP. Në varësi të natyrës dhe përmasave të kontratës që prokurohet, autoriteti kontraktor përcakton kriteret e veçanta për kualifikim, në lidhje me përzgjedhjen e ofertuesve”.

Nga drejtuesi i autoritetit kontraktor janë ftuar tre operatorë me shkresat 45/7, dt. 08.02.2016 pa argumentuar, dokumentuar dhe provuar nëse kandidatët plotësojnë minimalisht kërkesat e nenit 45 të LPP për përzgjedhjen e tyre.

- Nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në datën 09.02.2016 është mbajtur procesverbali nr. 2 për hapjen e procedurës së prokurimit dhe ai nr. 3 për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave të procedurës së prokurimit “Procedurë me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit” me objekt “Për blerjen oksigjen të lëngët (Bar)” për sasinë 6,550 litra me fondin limit 983,613.5 lekë pa tvsh; ku KVO citon se ka shqyrtuar dokumentacionin kualifikues ligjor dhe administrativ (për kërkesat e përgjithshme) dhe kërkesat e veçanta për kualifikim, të paraqitura nga bashkimi i operatorit ekonomik “G”shpk i cili i plotëson kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit si dhe dokumentacionin e kërkuar sipas dokumenteve të tenderit. Në përfundim KVO e ka shpallur fitues operatorin, “G” shpk e ofertën totale 983,613.5 lekë pa tvsh.

Me nr. 45/8, dt. 09.02.2016 nga KVO është hartuar raporti përmbledhës i firmosur nga komisioni i vlerësimit, i miratuar nga titullari i autoritetit kontraktor z. Gj.B në mbi ecurinë e procedurës së tenderit, informacionin mbi kualifikimin e operatorit në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 68 “Komisioni i vlerësimit



të ofertave, pas përfundimit të afateve të ankimit, përgatit një raport përmbledhës dhe ia dërgon për miratim titullarit të autoritetit kontraktor...” dhe 69 “Pas miratimit të raportit përmbledhës autoriteti kontraktor”, si më poshtë:

Ka paraqitur ofertat një operator:

2- Bashkimi i Operatorëve “G” shpk, me ofertën 983,613.5 lekë pa tvsh.

Nga auditimi i dokumente të paraqitura nga operatori i mësipërm rezultoi se janë paraqitur dokumentet standarte të kërkuara.

Midis operatorit “G” shpk dhe autoritetit kontraktor është hartuar dhe firmosur kontrata nr. 45/10, datë 10.02.2016 *Për blerjen oksigjen të lëngët (Bar)*” për nevojat e SUT me sasinë 6,550 litra vlerën 983,613.5 lekë pa t.v.sh. me afat kontrate nga dt. 11.02.2016 deri 15.03.2016.

- Me urdhër shpenzimin nr. 173, dt. 27.04.2016 është likuiduar vlera 898,767 lekë me tvsh për operatorin “M” shpk sipas faturave tatimore nr. 707, dt. 15.02.2016 me vlerë 898,767.45 lekë pa tvsh,. Materialet e mësipërme janë kontrolluar nga komisioni i pritjes, kontrollit dhe administrimit të mallit i ngritur me urdhrin e titullarit nr. 228, dt. 21.06.2015 dhe furniturë është mbajtur procesverbali përkatës ku shprehen se materialet u kontrolluan nga komisioni dhe janë sipas standarteve të kërkuara dhe specifikimeve teknike të kërkuara. Furnitura është shoqëruar edhe me certifikatën e analizave teknike.

Nga autoriteti kontraktor nuk ka një raport përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, neni 77, pika 4. *“Në përfundim të kontratës, autoriteti kontraktor përgatit një raport përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës. Një kopje e këtij raporti i jepet edhe kontraktorit, me kërkesë të tij..”*

6- Në tenderin e zhvilluar me objekt *“blerje oksigjen të lëngët (bar) në SUT për periudhën 01.11.2016 deri 31.12.2016”*:

U konstatuan:

Sipas raportit përmbledhës të datës 10.10.2016 mbajtur nga KVO kanë paraqitur ofertat për konkurrim një operator, i kualifikuar dhe shpallur fitues operatori “M” sh.p.k. me të cilin është lidhur kontrata nr. 141/9, datë 13.10.2016.

Nga auditimi i dosjes së prokurimeve dhe dokumenteve të sjella nga operatori fitues rezultoi:

Me urdhrin e prokurimit nr. 141/4, datë 08.09.2016 nxjerrë nga z. Gj.B është përcaktuar fondi limit prej 2,345,054.72 lekë pa t.v.sh. forma e procedurës e tenderit *“kërkesë për propozim”* ku është përcaktuar Njësia e Prokurimit dhe me urdhrin nr. 141/5, datë 08.09.2016, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”* kreu VII, neni 58 *“Komisioni i vlerësimit të ofertave, i cili emërohet me urdhër të veçantë të titullarit të autoritetit kontraktor”* dhe neni 60 pika 1 *“...titullari i autoritetit kontraktor apo zyrtari i autorizuar nxjerr menjëherë urdhrin e prokurimit...”*. Në urdhrin e ngritjes së KVO procedura e prokurimit është shënuar *“Negocim pa shpallje”*, ku në fakt është *“Kërkesë për propozim”*.

Me shkresën nr. 831, dt. 30.08.2016 Drejtori Gj.B me shkresën nr. 831, dt. 30.08.2016 i drejtohet Ministrit të shëndetësisë me listën e medikamenteve dhe materialeve të mjekimit për prokurim ku ndër të tjera në listë është edhe sasia e *“oksigjen i lëngshëm (bar)”* për 15,616 litra. Në shkresë citohet se sasia e prokuruar për SUT e medikamenteve dhe materialeve të mjekimit për vitin 2016 nuk ka qenë sipas nevojave reale të SUT, Kjo për shkak të fondit të pa mjaftueshëm të akorduar në fillim të vitit, duke detyruar që SUT të reduktojë kërkesat reale të fillimit të vitit deri në masën që e lejonin fondet e akorduar. .. mbetemi në pritje të përgjigjes suaj për mënyrën e procedimit të mëtejshëm për prokurimin e tyre.



Mos kryerja e prokurimit të përqendruar nga MSH nuk ka mundësuar përfitime ekonomike për shkak të rritjes së sasisë së mallrave, punëve ose shërbimeve homogjene dhe që ofrohen në treg me kushte të ngjashme; dhe urdhri i prokurimit është në kundërshtim me VKM nr. 135, datë 20.2.2013 “Për lejimin e Ministrisë së Shëndetësisë për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të institucioneve të varësisë, për disa mallra e shërbime” ku është vendosur: Lejimi i Ministrisë së Shëndetësisë, si organ qendror blerës, për kryerjen e procedurave të prokurimit, në emër dhe për llogari të spitaleve publike në varësi të saj, për blerjen e medikamenteve dhe materialeve mjekësore.

Pika 4. Organi qendror blerës ka këto detyra dhe përgjegjësi:

d) të zhvillojë procedurat për prokurimin e përqendruar të medikamenteve dhe materialeve mjekësore, për nevojat spitalore, përfshirë procedurat e prokurimit me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit.

Në kundërshtim me këtë VKM Ministria e shëndetësisë me shkresën nr. 445/1, dt. 30.08.2016 e Drejtorit të Administrimit Spitalor ka miratuar kërkesën sipas shkresës nr. 831, dt. 30.08.2016 për kryerjen nga SUT i procedurës së prokurimit për blerjen e barnave dhe materialeve mjekësore sipas listave të kërkuara.

Urdhri i prokurimit dhe shkresa e Ministrisë së Shëndetësisë është në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” kreu I, Neni 2 “Prokurimi i përqendruar dhe organi qendror blerës”; pika 1. Në përputhje me nenin 11 të LPP dhe me qëllim realizimin dhe përdorimin më të mirë të fondeve publike, Këshilli i Ministrave mund t’ia ngarkojë rolin e organit qendror blerës një autoriteti tjetër kontraktor për blerjen e mallrave, kryerjen e punëve ose të shërbimeve të njëjta, në emër dhe për llogari të institucioneve në varësi të Kryeministrit dhe ministrave. Çdo autoritet tjetër kontraktor mund të kërkojë dhe, rrjedhimisht, të bjerë dakord me organin qendror blerës për kryerjen e prokurimit në emër të tij. Pika 3. Prokurimi i përqendruar mund të përdoret kur: a) blerja e përqendruar mundëson përfitime ekonomike për shkak të rritjes së sasisë së mallrave, punëve ose shërbimeve homogjene dhe që ofrohen në treg me kushte të ngjashme;

Me një shkresë nr. 158, dt. 06.09.2016 grupi i punës ka kërkuar plotësimin e nevojave me furnizim me oksigjen të lëngshëm (bar) pasi sasia e parashikuar për plotësimin e nevojave me oksigjen të lëngshëm nuk mjafton deri në fund të vitit 2016 pasi konsumi i këtij viti e ka tejkaluar planifikimin e bërë në bazë të konsumit mbi vitin 2015. Ky grup parashikon se për mbulimin e nevojave me “Oksigjen të lëngshëm (Bar)” deri në 31.12.2016 nevojiten edhe 15,616 litra oksigjen përveç sasisë prej 58,549 litra që është parashikuar në kontratën nr. 59, dt. 15.03.2016

Gjatë vitit 2016 nga autoriteti kontraktor para kësaj procedure janë lidhur kontratat “Për blerjen oksigjen të lëngët (Bar)” për si më poshtë:

1- Midis operatorit “G” shpk dhe autoritetit kontraktor është hartuar dhe firmosur kontrata nr. 45/10, datë 10.02.2016 “Për blerjen oksigjen të lëngët (Bar)” për nevojat e SUT me sasinë 6,550 litra vlerën 983,613.5 lekë pa t.v.sh. me afat kontrate nga dt. 11.02.2016 deri 15.03.2016.

2- kontrata nr. 59, dt. 15.03.2016 për sasinë 58,549 litra (Procedurë e përqendruar nga MSH).

Me urdhrin nr. 141, dt. 06.09.2016 nxjerrë nga z. Gj.B është ngritur grupi i punës për përgatitjen e specifikimeve teknike për procedurën e prokurimit (A.T, D.P, E.K), në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 61, pika 2 “Në rastet kur njësia e prokurimit nuk ka kapacitetet e duhura për hartimin e kërkesave për kualifikim dhe/ose specifikimet teknike dhe/ose kriteret e vlerësimit, këto përgatiten nga struktura të specializuara për objektin që prokurohet, brenda autoritetit kontraktor apo edhe jashtë tij, kur kjo ekspertizë mungon”.



Ky grup me shkresën nr. 141/1, dt. 08.09.2016 ka përgatitur specifikimet teknike për blerjen e oksigjenit mjekësor i lëngët (Bar) për SUT.

-Përcaktimi i vlerës limit të kontratës publike është kryer nga një komision (M.S, A.Z, G.H) i ngritur me urdhrin nr. 141/2, dt. 08.09.2016 të cilët me shkresën nr. 141/3, dt. 08.09.2016 kanë përllogaritur fondin limit për blerje oksigjen të lëngët (dar) për SUT për periudhën 01 nëntor deri 31 dhjetor 2016 për sasinë 15,616 litra në vlerën 2,345,054.72 lekë pa tvsh në datën e nxjerrjes së urdhrit të prokurimit nr. 141/4, datë 08.09.2016 ku sipas VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” kreu II, neni 9 pika 1, “Vlera limit e kontratës publike është shuma totale, pa TVSH, e llogaritur nga autoriteti kontraktor përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit”, dhe neni 59 “Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës”.

Nga Njësia e Prokurimit është mbajtur procesverbali datës 14.09.2016 për hartimin e dokumenteve të tenderit referuar urdhrit të prokurimit nr. 141/4, dt. 08.09.2016 ku janë përcaktuar procedura e prokurimit, data e zhvillimit të tenderit (dt. 26.09.2016), kriteret e kualifikimit, kapacitetet ekonomike financiare, kriteri i vlerësimit dhe kapacitetet teknike e kriteret profesionale, operatorët e ftuar (specifikimet teknike si dhe kriteret teknike janë përcaktuar nga grupi i punës i ngritur me urdhrin nr. 141, dt. 06.09.2016) në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 28 “Kontratat e shërbimeve”, neni 61 pika 2 “Në çdo rast, hartimi i kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre”.

Me nr. 141/8, dt. 10.10.2016 nga KVO është hartuar raporti përmbledhës i firmosur nga komisioni i vlerësimit, i miratuar nga titullari i autoritetit kontraktor z. Gj.B në mbi ecurinë e procedurës së tenderit, informacionin mbi kualifikimin e operatorit në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 68 “Komisioni i vlerësimit të ofertave, pas përfundimit të afateve të ankimit, përgatit një raport përmbledhës dhe ia dërgon për miratim titullarit të autoritetit kontraktor...” dhe 69 “Pas miratimit të raportit përmbledhës autoriteti kontraktor”, si më poshtë:

Ka paraqitur ofertat një operator:

b-Janë kualifikuar:

4. Operatori “M” sh.p.k me vlerën e ofertës 2,345,054.72 lekë pa tvsh pasi plotësonte kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor..

Nga auditimi i dokumenteve në dosjen e prokurimit dhe ato në formatin elektronik nga operatori i mësipërm rezulton se kualifikimi i operatorit të mësipërm është në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 66, pika 3. “Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit...”.

Midis operatorit “M” sh.p.k dhe autoritetit kontraktor është hartuar dhe firmosur kontrata nr. 141/9, datë 13.10.2016 për furnizimin me oksigjen të lëngët (Bar) për SUT për sasinë 15,616 litra me vlerën 2,345,054.72 lekë pa t.v.sh. me afat kontrate nga data 01.11.2016 deri 31.12.2016.

Deri 31.12.2016 janë likuiduar vlera me urdhër shpenzimet si më poshtë:

- Me urdhër shpenzimin nr. 604, dt. 11.11.2016 vlera 867,232 lekë pa tvsh; fatura tatimore nr. 23, dt. 01.11.2016 për 5,775 litra oksigjen në vlerën 867,231.75 lekë pa tvsh,, procesverbali i kontrollit dhe administrimit të mallit i mbajtur nga komisioni i ngritur më vendimin nr. 369, dt.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN UNIVERSITAR TË TRAUMËS”

28.07.2016. ku shprehet se “malli u kontrollua nga komisioni dhe u konstatua që është sipas standarteve dhe specifikimeve teknike brenda afatit të kërkuar”.

- Më urdhër shpenzimin nr. 687/1, dt. 20.12.2016 vlera 940,965 lekë pa tvsh; fatura tatimore nr. 5939, dt. 21.11.2016 për 6,266 litra oksigjen në vlerën 940,965 lekë pa tvsh., procesverbali i kontrollit dhe administrimit të mallit i mbajtur nga komisioni i ngritur më vendimin nr. 369, dt. 28.07.2016. ku shprehet se “malli u kontrollua nga komisioni dhe u konstatua që është sipas standarteve dhe specifikimeve teknike brenda afatit të kërkuar” dhe certifikata e analizës.

- Me urdhër shpenzimin nr. 710, dt. 27.12.2016 vlera 536,857 lekë pa tvsh, fatura tatimore nr. 6249, dt. 07.12.2016 për 120 litra oksigjen në vlerën 18,020 lekë pa tvsh., fatura tatimore nr. 6350, dt. 12.12.2016 për 3,455 litra oksigjen në vlerën 518,837.35 lekë pa tvsh., procesverbali i kontrollit dhe administrimit të mallit i mbajtur nga komisioni i ngritur më vendimin nr. 369, dt. 28.07.2016. ku shprehet se “malli u kontrollua nga komisioni dhe u konstatua që është sipas standarteve dhe specifikimeve teknike brenda afatit të kërkuar” dhe certifikata e analizës.

Komente dhe shpjegime:

Për sa konstatuar më sipër subjekti i audituar SUT me shkresën nr. 568/2, dt. 28.05.2018 ka bërë komente dhe shpjegime, konkretisht:

1. “.....Ministria e Shëndetësisë me shkresën nr. 4450/1 ...i drejtohet SUT për akordimin e fondeve për realizimin e nevojave të SUT për periudhën e mbetur të vitit 2016 si dhe na drejtohet që të marrim masa dhe të kryejmë procedurat për blerjen e materialeve dhe medikamenteve mjekësore pjesë e të cilave është edhe oksigjeni”.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Në lidhje observacionet e bëra nga subjekti i audituar grupi i auditimit nuk i merr parasysh komentet dhe shpjegimet e dhëna. Theksojmë se:

1. Urdhri i prokurimit dhe urdhri i Ministrisë janë në kundërshtim me VKM nr. 135, datë 20.2.2013 “Për lejimin e Ministrisë së Shëndetësisë për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të institucioneve të varësisë, për disa mallra e shërbime” ku është vendosur: Lejimi i Ministrisë së Shëndetësisë, si organ qendror blerës, për kryerjen e procedurave të prokurimit, në emër dhe për llogari të spitaleve publike në varësi të saj, për blerjen e medikamenteve dhe materialeve mjekësore.

Pika 4. Organi qendror blerës ka këto detyra dhe përgjegjësi:

b) të zhvillojë procedurat për prokurimin e përqendruar të medikamenteve dhe materialeve mjekësore, për nevojat spitalore, përfshirë procedurat e prokurimit me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit.

7-Në tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje materiale mjekësore për Neurokirurgjinë në SUT për periudhën e mbetur 2016” Tiranë”:

U konstatuan:

Sipas raportit përmbledhës të datës 16.06.2016 mbajtur nga KVO kanë paraqitur ofertat për konkurrim një operatorë, i kualifikuar dhe shpallur fitues operatori ekonomik “O.D” sh.p.k me të cilin është lidhur kontrata nr. 104/6, datë 17.06.2016.

Me urdhrin e prokurimit nr. 104/1 datë 12.05.2016 nxjerrë nga z. Gj.B është përcaktuar fondi limit prej 13,906,642 lekë pa t.v.sh. (14,935,157 lekë me t.v.sh.) forma e procedurës e tenderit “procedurë e hapur” ku është përcaktuar Njësia e Prokurimit dhe me urdhrin nr. 104/2, datë 10.05.2016, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” kreu VII, neni 58 “Komisioni i vlerësimit të ofertave, i cili emërohet me urdhër të veçantë të titullarit të autoritetit kontraktor” dhe neni 60 pika 1 “... titullari i autoritetit kontraktor apo zyrtari i autorizuar nxjerr menjëherë urdhrin e prokurimit.....i cili duhet të përmbajë llojin e procedurës së prokurimit dhe arsyet e përdorimit të saj,.....”.

Gjithashtu urdhri i prokurimit është në kundërshtim me VKM nr. 135, datë 20.2.2013 “Për lejimin e Ministrisë së Shëndetësisë për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të institucioneve të varësisë, për disa mallra e shërbime” ku është vendosur: Lejimi i Ministrisë së Shëndetësisë, si organ qendror blerës, për kryerjen e procedurave të



prokurimit, në emër dhe për llogari të spitaleve publike në varësi të saj, për blerjen e medikamenteve dhe materialeve mjekësore.

Pika 4. Organi qendror blerës ka këto detyra dhe përgjegjësi:

e) të zhvillojë procedurat për prokurimin e përqendruar të medikamenteve dhe materialeve mjekësore, për nevojat spitalore, përfshirë procedurat e prokurimit me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit.

Në kundërshtim me këtë VKM është edhe urdhri i Ministrit të Shëndetësisë nr. 36, dt. 29.01.2016, (Prot. 600, dt. 29.01.2016) ku urdhëron që institucionet qendrore të cilat në aktivitetin e tyre përdorin materialet e mëposhtme mjekësore të konsumit të zhvillojnë vetë për vitin 2016, procedurat e prokurimit për nevojat vjetore për objektet si më poshtë:

.....Materiale mjekësore specifike për shërbimin e neurokirurgjisë.

- Procedura e mësipërme janë përgjegjësi dhe detyrë e organit qendror blerës në këtë rast Ministria e Shëndetësisë e cila ndër të tjera duhet të shqyrtojë dhe të miratojë specifikimet teknike, të dërguara nga autoritetet kontraktore.

d) të unifikojë specifikimet teknike për mallra dhe shërbime të të njëjtit lloj, në përputhje me standardet e miratuara, në bashkëpunim me specialistët e fushave, të institucioneve përgjegjëse ose specialistë të jashtëm, vendas a të huaj.

dh) të bashkërendojë punën për testimin e tregut për përllogaritjet e të dhënave sasiore për mallrat, që do të prokurohen, para publikimit të tenderit.

- Me urdhrin nr. 53, dt. 22.02.2016 Drejtori z. Gj.B urdhëron të ngrihet grupi i punës për specifikimet teknike “Për blerjen e materialeve mjekësore për neurokirurgjinë në SUT për vitin 2016”.

Bazuar në urdhrin e mësipërm grupi i punës me shkesën nr. 53/1, dt. 26.02.2016 ka përgatitur specifikimet teknike për materialin mjekësor të kërkuar nga Klinika Neurokirurgjisë me shkresën nr. 48, dt. 18.02.2016.

- Me urdhrin nr. 53/2, dt. 26.02.2016 Drejtori z. Gj.B urdhëron të ngrihet grupi i punës për argumentimin e fondit limit “Për blerjen e materialeve mjekësore për neurokirurgjinë në SUT për vitin 2016”, ku citohet se “grupi i punës për të bërë përllogaritjet duhet të mbështetet tek specifikimet teknike të hartuara nga grupi i punës, sasitë që nevojiten dhe çmimit për njësi të mara nga kontratat e ngjashme apo testimi i tregut për ato materiale për të cilat nuk kanë qenë të prokuruar më parë.....”

- Me urdhrin nr. 53/4, dt. 26.02.2016 është ngritur grupi i punës për testimin e tregut “Për blerjen e materialeve mjekësore për neurokirurgjinë në SUT për vitin 2016” ku përcaktohet se “grupi i punës të marrë çmime nga jo më pak se tre operatorë ekonomikë, të nxjerrë çmimin mesatar për çdo artikull të pasqyruar në proces verbal.....”.

Nga grupi janë nisur tre kërkesa për dhënie çmimi të konfirmuara nga operatorët përkatës;

“E” shpk,

“G” shpk,

“O.D” shpk.

- Operatorët kanë paraqitur ofertat për studim tregut “E” shpk, me shkresën 53/6, dt. 01.03.2016, “G” shpk, me shkresën nr. 53/6, dt. 01.03.2016, “O.D” shpk. Me shkresën 53/6, dt. 01.03.2016. mbi bazën e të cilave grupi i testimit të tregut ka përgatitur çmimin mesatar të ofertave për të përllogaritur fondin limit me shkresën nr. 53/7, dt. 02.03.2016.

- Grupi i punës për argumentimin e fondit limit mbi bazën e çmimeve mesatare dhe ato të kontratave të mëparshme me prot nr. 104, dt. 09.05.2016 ka përllogaritur fondin limit për periudhën e mbetur të vitit 2016 në vlerën 13,906,642 lekë pa tvsh dhe 14,935,157 lekë me tvsh në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 9; pika 1. Vlera limit e kontratës publike, e llogaritur nga autoriteti kontraktor përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit..



Nga Njësia e Prokurimit është mbajtur procesverbali nr. 1, datës 10.05.2016 për hartimin e dokumenteve të tenderit *referuar urdhrin të prokurimit nr. 104/1, dt. 10.05.2016* ku janë përcaktuar procedura e prokurimit, data e zhvillimit të tenderit (dt. 06.06.2016), kriteret e kualifikimit, kapacitetet ekonomike financiare, kriteri i vlerësimit dhe kapacitetet teknike e kriteret profesionale, operatorët e ftuar (*specifikimet teknike si dhe kriteret teknike janë përcaktuar nga grupi i punës i ngritur me urdhrin nr. 53, dt. 22.02.2016*) në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 27 “Kontratat e mallrave”, neni 61 pika 2 “Në çdo rast, hartimi i kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre”.

Me nr. 104/5, dt. 16.06.2016 nga KVO është hartuar raporti përmbledhës i firmosur nga komisioni i vlerësimit dhe miratuar nga titullari i autoritetit kontraktor z. Gj.B mbi ecurinë e procedurës së tenderit, informacionin mbi kualifikimin e operatorit në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 68 “Komisioni i vlerësimit të ofertave, pas përfundimit të afateve të ankimit, përgatit një raport përmbledhës dhe ia dërgon për miratim titullarit të autoritetit kontraktor...” dhe 69 “Pas miratimit të raportit përmbledhës autoriteti kontraktor”, si më poshtë:

Ka paraqitur ofertat një operator:

3- Operatori “O.D” shpk, me ofertën 13,850,000 lekë pa tvsh.

Nga auditimi i dokumente të paraqitura nga operatori i mësipërm rezultoi se janë paraqitur dokumentet standarte të kërkuara.

Në DST në kapaciteti teknik nga njësia e prokurimit është kërkuar pika i: *Të paraqiten mostra për artikujt me shenjën (*) të numri rendor, mostrat duhet të paraqiten ditën e zhvillimit të procedurës në zyrën juridike, shoqëruar me listën inventarizuese. Mos paraqitja e njërës apo disa mostrave të kërkuara për artikujt me shenjën (*) të përcaktuara në tabelë do të përbënte shkak për skualifikim.*

Në raportin përmbledhës KVO nuk është shprehur nëse operatori i paraqiti mostrat sipas listës ditën e zhvillimit të tenderit dhe nëse ato u verifikuan nga KVO dhe nëse po a janë tërhequr nga operatori mbas plotësimit të kontratës..

Sa më lart mbajnë përgjegjësi KVO; Irgen Hodaj, E.T, E.O.

Midis operatorit “O.D” shpk dhe autoritetit kontraktor është hartuar dhe firmosur kontrata nr. 104/6, datë 17.06.2016 për furnizimin mallra e materiale për neurokirurgjinë për nevojat e SUT me vlerën 13,850,000 lekë pa t.v.sh. ose 14,867,119 lekë me tvsh me afat kontrate deri 31.12.2016.

8-Në tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje medikamente mjekësore për SUT deri 15 prill 2017 ndarë në lote (një bar një lot)” Tiranë”:

U konstatuan:

Sipas raportit përmbledhës të datës 03.02.2017 mbajtur nga KVO kanë paraqitur ofertat për konkurrim 7 operatorë, të kualifikuar dhe shpallur fitues me të cilët janë lidhur kontratat me vlerën totale **56,068,151** lekë pa tvsh.

Me urdhrin e prokurimit nr. 37/3 datë 30.01.2017 nxjerrë nga z. Gj.B është përcaktuar fondi limit prej 57,935,468.63 lekë pa t.v.sh forma e procedurës e tenderit “Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit” ku është përcaktuar Njësia e Prokurimit dhe me urdhrin nr. 37/4, datë 03.01.2017, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” kreu VII, neni 58 “Komisioni i vlerësimit të ofertave, i cili emërohet me urdher të veçantë të titullarit të autoritetit kontraktor” dhe neni 60 pika 1 “... titullari i autoritetit kontraktor apo zyrtari i autorizuar nxjerr menjëherë urdhrin e



prokurimit.....i cili duhet të përmbajë llojin e procedurës së prokurimit dhe arsyet e përdorimit të saj,.....”.

Urdhri i prokurimit është në kundërshtim me VKM nr. 135, datë 20.2.2013 “Për lejimin e Ministrisë së Shëndetësisë për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të institucioneve të varësisë, për disa mallra e shërbime” ku është vendosur: Lejimi i Ministrisë së Shëndetësisë, si organ qendror blerës, për kryerjen e procedurave të prokurimit, në emër dhe për llogari të spitaleve publike në varësi të saj, për blerjen e medikamenteve dhe materialeve mjekësore.

Pika 4. Organi qendror blerës ka këto detyra dhe përgjegjësi:

f) të zhvillojë procedurat për prokurimin e përqendruar të medikamenteve dhe materialeve mjekësore, për nevojat spitalore, përfshirë procedurat e prokurimit me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit.

Në kundërshtim me këtë VKM është edhe urdhri i Ministrit të Shëndetësisë nr. 27, dt. 20.01.2017, (Prot. 256/1, dt. 20.01.2017) ku urdhëron që “institucionet spitalore në pritje të përfundimit të procedurave të përqendruara të prokurimit për barna dhe materiale mjekësore, lejohen të zhvillojnë vetë procedurën e prokurimit me negociim për sasi të artikujve të sipërcituar, planifikuar për mbulimin e nevojave deri në 15 prill 2017.....”

- Me urdhrin nr. 37, dt. 27.01.2017 Drejtori z. Gj.B urdhëron të ngrihet grupi i punës për specifikimet teknike “Për blerjen e medikamenteve mjekësore për nevojat e SUT për vitin 2017”. Bazuar në urdhrin e mësipërm grupi i punës me shkesën nr. 37/1, dt. 30.01.2017 ka përgatitur specifikimet teknike për medikamentet mjekësore të kërkuar me shkresën nr. 23, dt. 27.01.2017. Me shkresën nr. 23, dt. 27.01.2017 nga përgjegjësi i sektorit të planifikimit znj. E.O drejtuar sektorit të prokurimeve në SUT është kërkuar prokurimi i barnave dhe medikamenteve të SUT deri me 15 prill 2017 shoqëruar me listën e kategorizuar ku janë përcaktuar llojet e medikamenteve, dozat, sasi të, çmimet dhe fondi limit në një kohë kur specifikimet teknike dhe formë/doza dhe njësitë janë përcaktuar nga grupi i punës në datën 30.01.2017 pra 3 ditë më mbas. Në këtë shkresë nuk argumentohet se ku janë referuar ose bazuar në hartimin e çmimeve dhe dozave për përllogaritjen e fondit limit, pra për të bërë përllogaritjet e fondit limit nuk janë mbështetur tek specifikimet teknike të hartuara nga grupi i punës, sasi të që nevojiten dhe çmimit për njësi të mara nga kontratat e ngjashme apo testimi i tregut për ato materiale për të cilat nuk kanë qenë të prokuruar më parë ose listave të çmimeve të medikamenteve.

Nga autoriteti kontraktor nuk është ngritur grup pune për argumentimin e fondit limit “Blerje medikamente mjekësore për SUT deri 15 prill 2017”,

- Me shkresën nr. 37/2, dt. 30.01.2017 njësia e prokurimit (kur urdhri i prokurimit është nr. 37/3, datë 30.01.2017) ka hartuar relacionin drejtuar drejtorit të spitalit “Për përzgjedhjen e procedurës së prokurimit “Procedurë me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit me objekt “Për blerjen e medikamenteve mjekësore për plotësimin e nevojave emergjente deri në datën 15 prill 2017”, ku argumentohet se si ngjarje e paparashikuar dhe ese kryerja e procedurës normale (procedurë e hapur) kërkon kohë të gjatë. Ngjarja mund të dëmtojë interesat e përgjithshme të një komuniteti të gjerë.

Sa më lart është vepruar në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 36, “Procedura me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës” pika c) Në rastin e një nevojë ekstreme, të shkaktuar nga ngjarje të paparashikuara, që nuk i ngarkohen autoritetit kontraktor. pasi nuk është e argumentuar nevoja ekstreme për materialet mjekësore dhe se neglizhenca apo vonesat në fillimin e procedurave normale të prokurimit nuk janë shkaqe, që argumentojnë zbatimin e kësaj procedure.

Njësia e prokurimit ka vepruar në kundërshtim me VKM nr. 135, datë 20.2.2013 “Për lejimin e Ministrisë së Shëndetësisë për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të institucioneve të varësisë, për disa mallra e shërbime” ku është vendosur: Lejimi i Ministrisë së Shëndetësisë, si organ qendror blerës, për kryerjen e procedurave të prokurimit, në



emër dhe për llogari të spitaleve publike në varësi të saj, për blerjen e medikamenteve dhe materialeve mjekësore.

Pika 4. Organi qendror blerës ka këto detyra dhe përgjegjësi:

a) të zhvillojë procedurat për prokurimin e përqendruar të medikamenteve dhe materialeve mjekësore, për nevojat spitalore, përfshirë procedurat e prokurimit me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit.

Nga Njësia e Prokurimit është mbajtur procesverbali nr. 1, datës 30.01.2017 për hartimin e dokumenteve të tenderit referuar urdhrit të prokurimit nr. 37/3, dt. 30.01.2017 ku janë përcaktuar procedura e prokurimit, data e zhvillimit të tenderit (dt. 01.02.2017), kriteret e kualifikimit, kapacitetet ekonomike financiare, kriteri i vlerësimit dhe kapacitetet teknike e kriteret profesionale, operatorët e ftuar (tetë) (specifikimet teknike si dhe kriteret teknike janë përcaktuar nga grupi i punës i ngritur me urdhrin nr. 37/1, dt. 30.01.2017) në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 27 “Kontratat e mallrave”, neni 61 pika 2 “Në çdo rast, hartimi i kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre”.

Në dosjen e prokurimeve ndodhen Dokumentet Standarte të Procedurës me negociim të firmosur nga antarët e njësisë së prokurimit në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pika 6. “Në rastin e procedurës së prokurimit me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, sipas kushteve të parashikuara në këtë nen, autoriteti kontraktor përdor dokumentet standarde të procedurës me negociim me shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, për sa është e mundur”.

- Nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në datën 10.03.2017 është mbajtur procesverbali nr. 2 për hapjen e procedurës së prokurimit dhe ai nr. 3 për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave të procedurës së prokurimit “Procedurë me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit me objekt “Për blerjen e medikamenteve mjekësore për nevojat emergjente të SUT deri 15 prill 2017” me fondin limit 57,935,468.63 lekë. Ku KVO citon se ka shqyrtuar dokumentacionin kualifikues ligjor dhe administrativ (për kërkesat e përgjithshme) dhe kërkesat e veçanta për kualifikim, të paraqitura nga operatorët ekonomikë dhe vendosi të pranojë ofertat si të vlefshme dhe të kualifikojë përfundimisht operatorët:

1. “F” shpk me ofertën 6,690,763 lekë pa tvsh.
 2. “I” shpk me ofertën 10,069,204.3 lekë pa tvsh.
 3. “C” shpk me ofertën 145,005 lekë pa tvsh.
 4. “R” shpk me ofertën 2,795,100 lekë pa tvsh.
 5. “L” shpk me ofertën 2,346,063,6 lekë pa tvsh.
 6. “F” shpk me ofertën 29,384,295 lekë pa tvsh.
 7. “M” shpk me ofertën 4,637,720 lekë pa tvsh.
- TOTALI = **56,068,151** lekë pa tvsh.

Me nr. 37/7, dt. 03.02.2017 nga KVO është hartuar raporti përmbledhës i firmosur nga komisioni i vlerësimit, i miratuar nga titullari i autoritetit kontraktor z. Gj.B në mbi ecurinë e procedurës së tenderit, informacionin mbi kualifikimin e operatorëve në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 68 “Komisioni i vlerësimit të ofertave, pas përfundimit të afateve të ankimit, përgatit një raport përmbledhës dhe ia dërgon për miratim titullarit të autoritetit kontraktor...” dhe 69 “Pas miratimit të raportit përmbledhës autoriteti kontraktor”, si më poshtë:

Kanë paraqitur ofertat dhe janë kualifikuar 7 operatorët:

1. “F” shpk me ofertën 6,690,763 lekë pa tvsh.
2. “I” shpk me ofertën 10,069,204.3 lekë pa tvsh.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN UNIVERSITAR TË TRAUMËS”

3. “C” shpk me ofertën 145,005 lekë pa tvsh.
4. “R” shpk me ofertën 2,795,100 lekë pa tvsh.
5. “L” shpk me ofertën 2,346,063,6 lekë pa tvsh.
6. “F” shpk me ofertën 29,384,295 lekë pa tvsh.
7. “M” shpk me ofertën 4,637,720 lekë pa tvsh.
- TOTALI = 56,068,151 lekë pa tvsh.**

Midis operatorëve fitues dhe autoritetit kontraktor janë hartuar dhe firmosur kontratat përkatëse për furnizimin me medikamente mjekësore për plotësimin e nevojave emergjente të SUT deri në datën 15.04.2017 me vlerën totale 56,068,151 lekë pa t.v.sh. me afat kontrate deri 15.04.2017.

Nga auditimi i zbatimit të kontratave rezultoi se:

Operatori “F” shpk me ofertën 29,384,295 lekë pa tvsh. Ka lidhur kontratën nr. 37/10, dt. 06.02.2017 me vlerën 29,384,295 lekë pa tvsh. me afat deri 15.04.2017.

Në DST në specifikimet teknike kërkohet që gjatë dorëzimit të mallit në depot e blerësit (SUT), barnat të shoqërohen me leje përdorimi nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe pajisjeve Mjekësore në Tiranë, me raport analize dhe certifikatë origjine. Barnat të jenë në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9323, dt. 25.11.2004 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik” të ndryshuar. Medikamentet të kenë të shënuar mbishkrimin e shtetit ku janë prodhuar. Form/doza për secilin medikament është detyruese dhe e përcaktuar në tabelën e barnave. Barnat duhet të kenë të shënuara saktësisht dozën, njësinë e matjes, rrugën e aplikimit, shoqërinë prodhuese dhe shtetin e origjinës. Afati i skadencës: data e skadencës në ditën e livrimit të mallit duhet të jetë më e vogël se $\frac{1}{2}$ e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës/ose/ jo më pakë se 1 vit nga data e livrimit të mallit. Afatin e skadencës duhet ta kenë të shënuar jo vetëm në ambalazhe (kutitë). Mbi çdo njësi (kuti, flakon ose ampulë) duhet të jetë shënuar emri i barit. Kodi i barit, përqindja dhe përmbajtja, data e prodhimit dhe e skadimit, nr. Serie dhe pulla “Për përdorim spitalor”. Ambalazhi do të jetë i përshtatshëm sipas llojit të mallit të shoqëruar me etiketat përkatëse.

Nga auditimi i zbatimit të kësaj kontrate rezultoi se janë likuiduar si më poshtë:

Urdhër shpenzimi nr. 83, dt. 23.02.2017 për vlerën 2,678,726 lekë pa tvsh.

- Faturat tatimore nr. 5084, dt. 07.02.2017 për vlerën 405,350 lekë pa tvsh me fletë hyrjen e SUT nr. 42, dt. 07.02.2017. Proces verbalin e pritjes, kontrollit dhe administrimit të mallit.

- Faturat tatimore nr. 5094, dt. 09.02.2017 për vlerën 1,984,176 lekë pa tvsh me fletë hyrjen e SUT nr. 49, dt. 09.02.2017. Proces verbalin e pritjes, kontrollit dhe administrimit të mallit.

Faturat tatimore nr. 5098, dt. 03.02.2017 për vlerën 289,100 lekë pa tvsh me fletë hyrjen e SUT nr. 51, dt. 13.02.2017. Proces verbalin e pritjes, kontrollit dhe administrimit të mallit.

Urdhër shpenzimet e mësipërme nuk kanë bashkëngjitur dokumentet sipas specifikimeve teknike ku kërkohet që gjatë dorëzimit të mallit në depot e blerësit (SUT), barnat të shoqërohen me leje përdorimi nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore në Tiranë, me raport analize dhe certifikatë origjine.

Procesverbalet e komisionit nuk shprehen për sa kërkohet në specifikimet teknike po mjaftohen me “*materialet u kontrolluan nga komisioni dhe janë sipas standarteve të kërkuara dhe specifikimeve teknike të kërkuara*”

-Konstatohet se për zbatimin e kontratës me subjektin e mësipërm nga autoriteti kontraktor janë ngritur komisione për marrjen në dorëzim dhe ka procesverbale të marrjes në dorëzim të mallit sipas kontratës ku shprehen për cilësinë dhe plotësimin e specifikimeve teknike të kërkuara, sipas VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 77, pika 3, “Për t’u siguruar nëse cilësia e punëve, shërbimeve ose e mallrave është e njëjtë me cilësinë për të cilën është shpallur fitues kontraktori, autoriteti kontraktor duhet të monitorojë



zbatimin e kontratës dhe në rast të shkëlqes së kushteve të kërkuara zbaton penaltitetet e parashikuara në kontratë. Autoriteti kontraktor, gjatë kryerjes së kontrolleve, mban procesverbal me shkrim në prani të kontraktorit. Në rast se kontraktori nuk është i pranishëm, autoriteti kontraktor ia komunikon me shkrim përmbajtjen e këtij procesverbali”.

Nga autoriteti kontraktor nuk ka një raport përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 77, pika 4. “Në përfundim të kontratës, autoriteti kontraktor përgatit një raport përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës. Një kopje e këtij raporti i jepet edhe kontraktorit, me kërkesë të tij..”

9-Në tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje materiale mjekësore në SUT për plotësimin e nevojave emergjente” deri 15.04.2017 (në dy lote) Tiranë”:

U konstatuan:

Sipas raportit përmbledhës të datës 06.02.2017 mbajtur nga KVO kanë paraqitur ofertat për konkurrim një operator, i kualifikuar dhe shpallur fitues me të cilin është lidhur kontrata me vlerën **13,118,831.20** lekë pa tvsh.

Me urdhrin e prokurimit nr. 36/3, datë 30.01.2017 nxjerrë nga z. Gj.B është përcaktuar fondi limit prej 13,240,031.20 lekë pa t.v.sh ose 15,888,037.44 lekë me tvsh forma e procedurës e tenderit “Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit” ku është përcaktuar Njësia e Prokurimit dhe me urdhrin nr. 36/4, datë 30.01.2017, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” kreu VII, neni 58 “Komisioni i vlerësimit të ofertave, i cili emërohet me urdhër të veçantë të titullarit të autoritetit kontraktor” dhe neni 60 pika 1 “... titullari i autoritetit kontraktor apo zyrtari i autorizuar nxjerr menjëherë urdhrin e prokurimit.....i cili duhet të përmbajë llojin e procedurës së prokurimit dhe arsyet e përdorimit të saj.....”.

Urdhri i prokurimit është në kundërshtim me VKM nr. 135, datë 20.2.2013 “Për lejimin e Ministrisë së Shëndetësisë për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të institucioneve të varësisë, për disa mallra e shërbime” ku është vendosur: Lejimi i Ministrisë së Shëndetësisë, si organ qendror blerës, për kryerjen e procedurave të prokurimit, në emër dhe për llogari të spitaleve publike në varësi të saj, për blerjen e medikamenteve dhe materialeve mjekësore.

Pika 4. Organi qendror blerës ka këto detyra dhe përgjegjësi:

g) të zhvillojë procedurat për prokurimin e përqendruar të medikamenteve dhe materialeve mjekësore, për nevojat spitalore, përfshirë procedurat e prokurimit me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit.

Në kundërshtim me këtë VKM është edhe urdhri i Ministrit të Shëndetësisë nr. 27, dt. 20.01.2017, (Prot. 256/1, dt. 20.01.2017) ku urdhëron që “institucionet spitalore në pritje të përfundimit të procedurave të përqendruara të prokurimit për barna dhe materiale mjekësore, lejohen të zhvillojnë vetë procedurën e prokurimit me negocim për sasi të artikujve të sipërcituar, planifikuar për mbulimin e nevojave deri në 15 prill 2017.....”

- Me urdhrin nr. 36, dt. 27.01.2017 Drejtori z. Gj.B urdhëron të ngrihet grupi i punës për specifikimet teknike “Për blerjen e materialeve mjekësore për nevojat e SUT”.

Bazuar në urdhrin e mësipërm grupi i punës me shkesën nr. 36/1, dt. 30.01.2017 ka përgatitur specifikimet teknike për materialet mjekësore të kërkuar me shkresën nr. 23, dt. 27.01.2017.

Me shkresën nr. 23, dt. 27.01.2017 nga përgjegjësi i sektorit të planifikimit znj. E.O drejtuar sektorit të prokurimeve në SUT është kërkuar prokurimi i materialeve dhe medikamenteve të SUT deri me 15 prill 2017 shoqëruar me listën e kategorizuar për materiale dhe medikamente ku janë përcaktuar llojet e artikujve, specifikimet njësitë çmimet nevojat dhe vlerat. Në këtë shkresë nuk argumentohet se ku janë referuar ose bazuar në hartimin e çmimeve dhe dozave për



përlllogaritjen e fondit limit, pra për të bërë përlllogaritjet e fondit limit nuk janë mbështetur tek specifikimet teknike të hartuara nga grupi i punës, sasitë që nevojiten dhe çmimit për njësi të mara nga kontratat e ngjashme apo testimi i tregut për ato materiale për të cilat nuk kanë qenë të prokuruar më parë ose listave të çmimeve të medikamenteve.

Nga autoriteti kontraktor nuk është ngritur grup pune për argumentimin e fondit limit “Blerje materiale mjekësore për SUT deri 15 prill 2017”,

- Me shkresën nr. 36/2, dt. 30.01.2017 njësia e prokurimit (kur urdhri prokurimit është nr. 36/3, datë 30.01.2017) ka hartuar relacionin drejtuar drejtorit të spitalit “Për përzgjedhjen e procedurës së prokurimit “Procedurë me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit me objekt “Për blerjen e materialeve mjekësore për plotësimin e nevojave emergjente deri në datën 15 prill 2017”, ku argumentohet se si ngjarje e paparashikuar dhe se kryerja e procedurës normale (procedurë e hapur) kërkon kohë të gjatë. Ngjarja mund të dëmtojë interesat e përgjithshme të një komuniteti të gjerë.

Sa më lart është vepruar në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 36, “Procedura me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës” pika c) Në rastin e një nevojë ekstreme, të shkaktuar nga ngjarje të paparashikuara, që nuk i ngarkohen autoritetit kontraktor. pasi nuk është e argumentuar nevoja ekstreme për materialet mjekësore dhe se neglizhenca apo vonesat në fillimin e procedurave normale të prokurimit nuk janë shkaqe, që argumentojnë zbatimin e kësaj procedure.

Njësia e prokurimit ka vepruar në kundërshtim me VKM nr. 135, datë 20.2.2013 “Për lejimin e Ministrisë së Shëndetësisë për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të institucioneve të varësisë, për disa mallra e shërbime” ku është vendosur: Lejimi i Ministrisë së Shëndetësisë, si organ qendror blerës, për kryerjen e procedurave të prokurimit, në emër dhe për llogari të spitaleve publike në varësi të saj, për blerjen e medikamenteve dhe materialeve mjekësore.

Pika 4. Organi qendror blerës ka këto detyra dhe përgjegjësi:

a) të zhvillojë procedurat për prokurimin e përqendruar të medikamenteve dhe materialeve mjekësore, për nevojat spitalore, përfshirë procedurat e prokurimit me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit.

Nga Njësia e Prokurimit është mbajtur procesverbali nr. 1, datës 30.01.2017 për hartimin e dokumenteve të tenderit referuar urdhrin të prokurimit nr. 36/3, dt. 30.01.2017 ku janë përcaktuar procedura e prokurimit, data e zhvillimit të tenderit (dt. 02.02.2017), kriteret e kualifikimit, kapacitetet ekonomike financiare, kriteri i vlerësimit dhe kapacitetet teknike e kriteret profesionale, operatorët e ftuar (tre) (specifikimet teknike si dhe kriteret teknike janë përcaktuar nga grupi i punës i ngritur me urdhrin nr. 36, dt. 27.01.2017) në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 27 “Kontratat e mallrave”, neni 61 pika 2 “Në çdo rast, hartimi i kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre”.

Nga njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit për artikujt e ofruar nuk u janë kërkuar operatorëve ekonomikë katalogët ku të përfshihen edhe specifikimet teknike për secilin artikull.

Në dosjen e prokurimeve ndodhen Dokumentet Standarte të Procedurës me negociim të firmosur nga antarët e njësisë së prokurimit në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pika 6. “Në rastin e procedurës së prokurimit me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, sipas kushteve të parashikuara në këtë nen, autoriteti kontraktor përdor dokumentet standarde të procedurës me negociim me shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, për sa është e mundur”.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN UNIVERSITAR TË TRAUMËS”

- Nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në datën 02.02.2017 është mbajtur procesverbali nr. 2 për hapjen e procedurës së prokurimit dhe ai nr. 3 në datën 03.02.2017 për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave të procedurës së prokurimit “Procedurë me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit me objekt *“Për blerjen e materialeve mjekësore për nevojat emergjente të SUT deri 15 prill 2017” me fondin limit 13,240,031.2 lekë.* Ku KVO citon se ka shqyrtuar dokumentacionin kualifikues ligjor dhe administrativ (për kërkesat e përgjithshme) dhe kërkesat e veçanta për kualifikim, të paraqitura nga operatori ekonomik dhe vendosi të pranojë ofertën si të vlefshme dhe të kualifikojë përfundimisht operatorin:

1. “O” shpk me ofertën ndarë në dy lote në vlerën 13,118,831.2 lekë pa tvsh.

Me nr. 36/7, dt. 06.02.2017 nga KVO është hartuar raporti përmbledhës i firmosur nga komisioni i vlerësimit, i miratuar nga titullari i autoritetit kontraktor z. Gj.B në mbi ecurinë e procedurës së tenderit, informacionin mbi kualifikimin e operatorëve në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, neni 68 *“Komisioni i vlerësimit të ofertave, pas përfundimit të afateve të ankimit, përgatit një raport përmbledhës dhe ia dërgon për miratim titullarit të autoritetit kontraktor...”* dhe 69 *“Pas miratimit të raportit përmbledhës autoriteti kontraktor”,* si më poshtë:

Ka paraqitur ofertën dhe është kualifikuar një operator:

1. “O” shpk me ofertën ndarë në dy lote në vlerën 13,118,831.2 lekë pa tvsh.

Midis operatorit fitues “O” shpk dhe autoritetit kontraktor është hartuar dhe firmosur kontrata nr. 36/8, dt. 06.02.2017 për furnizimin me materiale mjekësore ndarë në dy lote për plotësimin e nevojave emergjente të SUT deri në datën 15.04.2017 me vlerën 13,118,831.20 lekë pa t.v.sh. ose 15,742,597.44 lekë me tvsh me afat kontrate deri 15.04.2017.

Nga auditimi i zbatimit të kësaj kontrate rezultoi se janë likuiduar si më poshtë:

Urdhër shpenzimi nr. 85, dt. 23.02.2017 për vlerën 4,076,220 lekë me tvsh.

- Faturat tatimore nr. 259, dt. 07.02.2017 për vlerën 4,014,660 lekë me tvsh me fletë hyrjen e SUT nr. 43, dt. 07.02.2017. Lista me artikujt shoqëruar, Proces verbalin e pritjes, kontrollit dhe administrimit të mallit.

- Faturat tatimore nr. 265, dt. 09.02.2017 për vlerën 61,560 lekë pa tvsh me fletë hyrjen e SUT nr. 47, dt. 09.02.2017. Proces verbalin e pritjes, kontrollit dhe administrimit të mallit.

-Konstatohet se për zbatimin e kontratës me subjektin e mësipërm nga autoriteti kontraktor janë ngritur komisione për marrjen në dorëzim dhe ka procesverbale të marrjes në dorëzim të mallit sipas kontratës ku shprehen për cilësinë dhe plotësimin e specifikimeve teknike të kërkuara, sipas VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, neni 77, pika 3, *“Për t’u siguruar nëse cilësia e punëve, shërbimeve ose e mallrave është e njëjtë me cilësinë për të cilën është shpallur fitues kontraktori, autoriteti kontraktor duhet të monitorojë zbatimin e kontratës dhe në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara zbaton penaltetet e parashikuara në kontratë. Autoriteti kontraktor, gjatë kryerjes së kontrolleve, mban procesverbal me shkrim në prani të kontraktorit. Në rast se kontraktori nuk është i pranishëm, autoriteti kontraktor ia komunikon me shkrim përmbajtjen e këtij procesverbali”.*

Nga autoriteti kontraktor nuk ka një raport përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, neni 77, pika 4. *“Në përfundim të kontratës, autoriteti kontraktor përgatit një raport përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës. Një kopje e këtij raporti i jepet edhe kontraktorit, me kërkesë të tij..”*

10- Në tenderin e zhvilluar me objekt *“Blerje materiale mjekësore ndarë në tre lote për SUT për vitin 2017” Tiranë*”:

U konstatuan:

Sipas raportit përmbledhës të datës 13.04.2017 mbajtur nga KVO kanë paraqitur ofertat për konkurrim për tre lotët tre operatorë, kualifikuar dhe shpallur fitues operatori ekonomik “O.D”



sh.p.k dhe “S.M” shpk me të cilat janë lidhur kontratat nr. 44/23, datë 26.04.2017 dhe nr. 44/24, dt. 26.04.2017.

Me urdhrin e prokurimit nr. 44/9, datë 23.02.2017 nxjerrë nga z. Gj.B është përcaktuar fondi limit prej 13,412,078 lekë pa t.v.sh. (15,209,281.67 lekë me t.v.sh.) forma e procedurës e tenderit “procedurë e hapur” ku është përcaktuar Njësia e Prokurimit dhe me urdhrin nr. 44/10, datë 23.02.2017, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” kreu VII, neni 58 “Komisioni i vlerësimit të ofertave, i cili emërohet me urdhër të veçantë të titullarit të autoritetit kontraktor” dhe neni 60 pika 1 “... titullari i autoritetit kontraktor apo zyrtari i autorizuar nxjerr menjëherë urdhrin e prokurimit.....i cili duhet të përmbajë llojin e procedurës së prokurimit dhe arsyet e përdorimit të saj,.....”.

Gjithashtu urdhri i prokurimit është në kundërshtim me VKM nr. 135, datë 20.2.2013 “Për lejimin e Ministrisë së Shëndetësisë për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të institucioneve të varësisë, për disa mallra e shërbime” ku është vendosur: Lejimi i Ministrisë së Shëndetësisë, si organ qendror blerës, për kryerjen e procedurave të prokurimit, në emër dhe për llogari të spitaleve publike në varësi të saj, për blerjen e medikamenteve dhe materialeve mjekësore.

Pika 4. Organi qendror blerës ka këto detyra dhe përgjegjësi:

h) të zhvillojë procedurat për prokurimin e përqendruar të medikamenteve dhe materialeve mjekësore, për nevojat spitalore, përfshirë procedurat e prokurimit me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit.

Në kundërshtim me këtë VKM është edhe urdhri i Ministrit të Shëndetësisë nr. 570, dt. 23.12.2016, ku urdhëron që institucionet spitalore të cilat në aktivitetin e tyre përdorin materialet e mëposhtme mjekësore të konsumit të zhvillojnë vetë për vitin 2017, procedurat e prokurimit për nevojat vjetore për objektet si më poshtë:

.....Materiale mjekësore për shërbimin e imazherisë (Filma dhe solucione).

.....Materiale mjekësore specifike për kirurgjinë vaskulare .

- Procedura e mësipërme janë përgjegjësi dhe detyrë e organit qendror blerës në këtë rast Ministria e Shëndetësisë e cila ndër të tjera duhet të shqyrtojë dhe të miratojë specifikimet teknike, të dërguara nga autoritetet kontraktore.

d) të unifikojë specifikimet teknike për mallra dhe shërbime të të njëjtit lloj, në përputhje me standardet e miratuara, në bashkëpunim me specialistët e fushave, të institucioneve përgjegjëse ose specialistë të jashtëm, vendas a të huaj.

dh) të bashkërendojë punën për testimin e tregut për përlllogaritjet e të dhënave sasiore për mallrat, që do të prokurohen, para publikimit të tenderit.

- Me urdhrin nr. 44, dt. 15.02.2017 Drejtori z. Gj.B urdhëron të ngrihet grupi i punës për specifikimet teknike “Për blerjen e materialeve mjekësore të ndara në lote për nevojat e SUT për vitin 2017”.

Bazuar në urdhrin e mësipërm grupi i punës me shkesën nr. 44/1, 44/2, 44/3, dt. 16.02.2017 ka përgatitur specifikimet teknike për materialin mjekësor të kërkuar nga përgjegjësi i sektorit të planifikimit znj. E.O me shkesën nr. 51, dt. 14.02.2017.

- Me urdhrin nr. 44/4, dt. 17.02.2017 Drejtori z. Gj.B urdhëron të ngrihet grupi i punës për argumentimin e fondit limit “Për blerjen e materialeve mjekësore të ndarë në lote (tre) për nevojat e SUT për vitin 2017”, ku citohet se “grupi i punës për të bërë përlllogaritjet duhet të mbështetet tek specifikimet teknike të hartuara nga grupi i punës, sasitë që nevojiten dhe çmimit



për njësi të mara nga kontratat aktuale apo testimi i tregut për ato materiale për të cilat nuk kanë qenë të prokuruar më parë.....”

Nga SUT janë nisur tre kërkesa me shkresat 44/5, dt. 17.02.2017 për dhënie çmimi të konfirmuara nga operatorët përkatës;

4. “E” shpk,
5. “G” shpk,
6. “O.D” shpk.

- Operatorët e mësipërm kanë paraqitur ofertat për studim tregut me shkresën 44/6, 44/7, dt. 20.02.2017,

- Grupi i punës për argumentimin e fondit limit mbi bazën e çmimeve mesatare dhe ato të kontratave të mëparshme me prot nr. 44/8, dt. 23.02.2017 ka përllogaritur fondin limit për periudhën e vitit 2017 “Për materialet për kirurgjinë vaskulare” në vlerën 8,237,628.33 lekë pa tvsh dhe 8,999,942 lekë me tvsh, “Për materialet për neurokirurgjinë” në vlerën 4,666,950 lekë pa tvsh dhe 5,600,340 lekë me tvsh, “Për materialet për imazherinë” në vlerën 507,500 lekë pa tvsh dhe 609,000 lekë me tvsh, në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 9; pika 1. *Vlera limit e kontratës publike, e llogaritur nga autoriteti kontraktor përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit..*

Nga Njësia e Prokurimit është mbajtur procesverbali nr. 1, datës 23.02.2017 për hartimin e dokumenteve të tenderit referuar urdhrin të prokurimit nr. 44/9, dt. 23.02.2017 ku janë përcaktuar procedura e prokurimit, data e zhvillimit të tenderit (dt. 23.03.2017), kriteret e kualifikimit, kapacitetet ekonomike financiare, kriteri i vlerësimit dhe kapacitetet teknike e kriteret profesionale, (specifikimet teknike si dhe kriteret teknike janë përcaktuar nga grupi i punës i ngritur me urdhrin nr. 44, dt. 15.02.2017) në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 27 “Kontratat e mallrave”, neni 61 pika 2 “Në çdo rast, hartimi i kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre”.

Me nr. 44/17, dt. 13.04.2017 nga KVO është hartuar raporti përmbledhës i firmosur nga komisioni i vlerësimit dhe miratuar nga titullari i autoritetit kontraktor z. Gj.B mbi ecurinë e procedurës së tenderit, informacionin mbi kualifikimin e operatorit në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 68 “Komisioni i vlerësimit të ofertave, pas përfundimit të afateve të ankimit, përgatit një raport përmbledhës dhe ia dërgon për miratim titullarit të autoritetit kontraktor...” dhe 69 “Pas miratimit të raportit përmbledhës autoriteti kontraktor, si më poshtë:

Kanë paraqitur ofertat tre operatorët:

Loti I- “Për materialet për kirurgjinë vaskulare” me fondin limit në vlerën 8,237,628.33 lekë pa tvsh dhe 8,999,942 lekë me tvsh,

1. “O.D” shpk me ofertën 8,160,000 lekë pa tvsh.

Loti II- “Për materialet për neurokirurgjinë” me fondin limit në vlerën 4,666,950 lekë pa tvsh dhe 5,600,340 lekë me tvsh,

1. “O.D” shpk me ofertën 4,650,000 lekë pa tvsh.

Loti III- “Për materialet për imazherinë” në vlerën 507,500 lekë pa tvsh dhe 609,000 lekë me tvsh,

- 4- Operatori “S.M” shpk, me ofertën 414,400 lekë pa tvsh.

Nga auditimi i dokumente të paraqitura nga operatori “O.D” Loti I- “Për materialet për kirurgjinë vaskulare” rezultoi se janë paraqitur dokumentet standarte të kërkuara.

1. Midis operatorit “O.D” shpk dhe autoritetit kontraktor është hartuar dhe firmosur kontrata nr. 44/23, datë 26.04.2017 “Për furnizimin mallra e materiale specifike (jo ortopedike) për



neurokirurgjinë” për nevojat e SUT me vlerën 4,650,000 lekë pa t.v.sh. ose 5,580,000 lekë me tvsh me afat kontrate deri 15.12.2017.

2. Midis operatorit “O.D” shpk dhe autoritetit kontraktor është hartuar dhe firmosur kontrata nr. 44/24, datë 26.04.2017 “Për furnizimin mallra e materiale për kirurgjinë vaskulare” për nevojat e SUT me vlerën 8,160,000 lekë pa t.v.sh. ose 8,859,611 lekë me tvsh me afat kontrate deri 15.12.2017.

Nga autoriteti kontraktor nuk ka një raport përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 77, pika 4. “Në përfundim të kontratës, autoriteti kontraktor përgatit një raport përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës. Një kopje e këtij raporti i jepet edhe kontraktorit, me kërkesë të tij..”

11-Në tenderin e zhvilluar me objekt “Shërbimi i mirëmbajtjes së Pajisjeve Mjekësore në SUT për vitin 2016”:

U konstatuan:

Sipas raportit përmbledhës të datës 16.05.2016 mbajtur nga KVO kanë paraqitur ofertat për konkurrim një operator i kualifikuar dhe shpallur fitues operatori “F” sh.p.k. me të cilin është lidhur kontrata nr. 66/11, datë 23.05.2016.

Nga auditimi i dosjes elektronike së prokurimeve dhe dokumenteve të sjella nga operatori fitues rezultoi:

Me urdhrin e prokurimit nr. 66/6, datë 19.04.2016 nxjerrë nga z. Gj.B është përcaktuar fondi limit prej 4,166,666,67 lekë pa t.v.sh. (5,000,000 lekë me t.v.sh.) forma e procedurës e tenderit “kërkesë për propozim” ku është përcaktuar Njësia e Prokurimit dhe me urdhrin nr. 66/7, datë 19.04.2016, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” kreu VII, neni 58 “Komisioni i vlerësimit të ofertave, i cili emërohet me urdhër të veçantë të titullarit të autoritetit kontraktor” dhe neni 60 pika 1 “...titullari i autoritetit kontraktor apo zyrtari i autorizuar nxjerr menjëherë urdhrin e prokurimit...”.

Me shkresën nr. 81, dt. 29.03.2016 nga Ing. A.T është hartuar lista e pajisjeve që janë në punë në SUT dhe që kërkojnë mirëmbajtje për vitin 2016.

Me urdhrin nr. 66, dt. 30.03.2016 nxjerrë nga z. Gj.B është ngritur grupi i punës për përgatitjen e specifikimeve teknike për procedurat e prokurimit për shërbimin e mirëmbajtjes së aparaturave mjekësore në SUT në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 61, pika 2 “Në rastet kur njësia e prokurimit nuk ka kapacitetet e duhura për hartimin e kërkesave për kualifikim dhe/ose specifikimet teknike dhe/ose kriteret e vlerësimit, këto përgatiten nga struktura të specializuara për objektin që prokurohet, brenda autoritetit kontraktor apo edhe jashtë tij, kur kjo ekspertizë mungon”.

Ky grup në me shkresën nr. 66/1, dt. 05.04.2016 ka përgatitur specifikimet teknike për shërbimin e mirëmbajtjes së aparaturave mjekësore për vitin 2016 ku janë përcaktuar kriteret teknike dhe financiare.

-Përcaktimi i vlerës limit të kontratës publike është kryer nga një komision (A.Z, G.H, M.S) i ngritur me urdhrin nr. 66/2, dt. 05.04.2016 të cilët me shkresën nr. 66/5, dt. 14.04.2016 kanë përllogaritur fondin limit për shërbimin e mirëmbajtjes së pajisjeve mjekësore për vitin 2016 në vlerën 4,166,667 lekë pa tvsh sipas VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” kreu II, neni 9 pika 1, “Vlera limit e kontratës publike është shuma totale,



pa TVSH, e llogaritur nga autoriteti kontraktor përpara nxjerrjes së urdhrin të prokurimit”, dhe neni 59 “Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrin të prokurimit, duhet të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës”.

Përllogaritja e fondit limit është e dokumentuar me shkresat e çmimeve mesatare sipas kërkesave operatorëve dhe të dërguara prej tyre me shkresat përkatës, në përputhje me nenin 59 “Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrin të prokurimit, duhet të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës”.

Nga Njësia e Prokurimit është mbajtur procesverbali datës 19.04.2016 për hartimin e dokumenteve të tenderit referuar urdhrin të prokurimit 66/6, datë 19.04.2016 ku janë përcaktuar procedura e prokurimit, data e zhvillimit të tenderit (dt. 03.05.2016), kriteret e kualifikimit, kapacitetet ekonomike financiare, kriteri i vlerësimit dhe kapacitetet teknike e kriteret profesionale, operatorët e ftuar (specifikimet teknike si dhe kriteret teknike janë përcaktuar nga grupi i punës i ngritur me urdhrin nr. 66/1, dt. 05.04.2016) në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 28 “Kontratat e shërbimeve”, neni 61 pika 2 “Në çdo rast, hartimi i kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre”.

Me nr. 66/10, dt. 16.05.2016 nga KVO është hartuar raporti përmbledhës i firmosur nga komisioni i vlerësimit, i miratuar nga titullari i autoritetit kontraktor z. Gj.B në mbi ecurinë e procedurës së tenderit, informacionin mbi kualifikimin e operatorit në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 68 “Komisioni i vlerësimit të ofertave, pas përfundimit të afatëve të ankimit, përgatit një raport përmbledhës dhe ia dërgon për miratim titullarit të autoritetit kontraktor...” dhe 69 “Pas miratimit të raportit përmbledhës autoriteti kontraktor”, si më poshtë:

Në raportin përmbledhës operatorët e ftuar nuk janë ato të cilët janë ftuar në formatin e elektronik por ata që janë cituar nga njësia e prokurimit

Ka paraqitur ofertat një operator:

b-Janë kualifikuar:

1. Operatori “F” sh.p.k me vlerën e ofertës 4,107,600 lekë pa tvsh pasi plotësonte kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit si dhe dokumentacionin e kërkuar sipas dokumenteve të tenderit të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor..

Nga auditimi i dokumenteve në dosjen e prokurimit dhe ato në formatin elektronik nga operatori i mësipërm rezulton se kualifikimi i operatorit të mësipërm është në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 66, pika 3. “Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit...”.

Midis operatorit “F” sh.p.k dhe autoritetit kontraktor është hartuar dhe firmosur kontrata nr. 66/11, datë 23.05.2016 për kryerjen e shërbimit të mirëmbajtjes së aparaturave mjekësore në SUT në vlerën 4,107,600 lekë pa t.v.sh. ose 4,929,120 lekë me tvsh me afat kontrate deri 31.12.2016.

Nga autoriteti kontraktor janë kryer likuidimet për operatorin “F” sh.p.k si më poshtë;

Me urdhër shpenzimin nr. 584/1, dt. 11.11.2016 në vlerën 4,147,920 lekë me tvsh,

Me urdhër shpenzimin nr. 698, dt. 21.12.2016 në vlerën 781,200 lekë me tvsh.

IV. Krijimi dhe përdorimi i të ardhurave të krijuara nga veprimtaritë dytësore të institucionit, qiratë dhe donacionet e ndryshme në përputhje me dispozitat ligjore.



a. Auditim mbi zbatimin e dispozitave ligjore për dhënien me qira subjekteve private të ambienteve, respektimi i tarifave të qirasë si dhe ndjekja e arkëtimit të të ardhurave nga qiratë.

a/1. “S.A”.

Midis SUT dhe subjektit “A.H” sh.a. është lidhur kontrata e qirasë dt. 30.08.2013 për përdorimin sipas nenit nr. 1, “objekti i kontratës” për sipërfaqen 496 m².

- Ky subjekt për periudhën objekt auditimi (01.10.2015 deri 31.03.2018) i detyrohet SUT qera e papaguar për sipërfaqen e përdorur okupuar prej 1200 m² ($1,696\text{ m}^2 - 496\text{ m}^2 = 1,200\text{ m}^2$) referuar kontratës së datës 28.08.2013 e cila rezulton si më poshtë.

Periudha 01.10.2015 deri 31.03.2018 gjithsej 30 muaj. Sipërfaqja e okupuar, përdorur 1,200 m² x 300 lekë/m² në muaj = 360,000 lekë x 30 muaj = **10,800,000** lekë.

- Ky subjekt përdor dhe një sipërfaqe prej 222.3 m², të cilën e ka ndërtuar mbi ambientet ekzistuese të spitalit, për të cilin institucioni nuk ka dokumentacion, si leja ndërtimore apo kontratë, po kështu ka ndërtuar dhe një urë lidhëse ndërmjet godinës së tij dhe spitalit, me sipërfaqe 45 m², ku edhe për të nuk ka dokumente në SUT.

Konstatimi ynë bazohet në kartelën e pasurisë bashkëlidhur Certifikatës së pasurisë së datës 07.04.2015, ku përshkruhen 3 objekte pa leje apo “ndërtime të paligjshme”.

Nëse do të përllogarisnim dhe përdorimin e sipërfaqes së ndërtuar nga vetë S.A për periudhën 01.10.2015 deri 31.03.2018 gjithsej 30 muaj për sipërfaqen e përdorur 267.3 m² x 300 lekë/m² në muaj = 80,190 lekë x 30 muaj = **2,405,700** lekë të ardhura të munguara për periudhën objekt auditimi.

-Gjithashtu për periudhën 01 dhjetor 2017 deri 31 mars 2018 subjekti ka përdorur sipërfaqe të ndërtuara mbi ambientet ekzistuese të spitalit, si platforma në nivelin e katit të parë me konstruksion çeliku në një sipërfaqe **160** m² dhe **42** m².

Nëse do të përllogarisnim përdorimin e sipërfaqes së ndërtuar nga vetë S.A për periudhën e mësipërme prej 4 muaj për sipërfaqen e përdorur 202 m² x 300 lekë/m² në muaj = 60,600 lekë 4 muaj = **242,400** lekë të ardhura të munguara..

Korrespondenca dhe disa shkresa për sipërfaqet shtesë të konstatuara:

Shkresa nr. 1054, dt. 12.09.2017 kërkesë për prononcim e ridërguar me nr. 1486, dt. 13.12.2017 e Drejtorit të SUT z. A.Z drejtuar Ministrit të Shëndetësisë, shkresa nr. 359, dt. 15.09. 2017 kërkesë për prononcim e Ministrit të shëndetësisë dhe për dijeni ministrit të MZHETTS ku kërkohet se në detyrat e KLSH-së kërkohet: Nga SUT, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë si ministria përgjegjëse për administrimin dhe me MZHETTS në cilësinë e pronarit të kërkohet:

- 4- Zgjidhja e statusit të sipërfaqeve të tepërta që administron subjekti “A.H” sha deri në lirim e ambienteve ose lidhjen e kontratave për ambientet e shfrytëzuara jashtë kontratës.
- 5- Zgjidhja e statusit të ndërtimeve pa leje dhe pa kontratë i sipërfaqeve të ndërtuara mbi objektet e SUT dhe pagesat për sipërfaqet shtesë dhe të përdorura pa kontratë.
- 6- Pagesa e qirasë nga ana e shoqërisë “A.H” sha për periudhën nga viti 2011 e vazhdim, periudhë në të cilën ka vazhduar aktivitetin e saj në ambientet e SUT pa kontratë dhe pa paguar qira.

Pas takimeve të realizuar mes palëve e MZHETTS, caktimit të topografit të licencuar me dakordësinë e të dy palëve, kemi arritur në konkluzionet mëposhtme :

S.A okupon ambientet e më poshtëm:

D. Sipërfaqe nën objekt- brenda godinës së SUT një sipërfaqe totale **1696.4** m².

E. Sipërfaqe të objekteve të ndërtuara pa leje ndërtimi mbi objektet e SUT-së. Në një sipërfaqe **222.3** m².



F. Sipërfaqe të objekteve të ndërtuara pa leje ndërtimi mbi territorin e SUT-se në një sipërfaqe 45 m2.

- Bashkëngjitur shkresave të mësipërme është dhe kërkesa e subjektit “A.H” sh.a. me nr. 199, dt. 07.02.2017 ku ndër të tjera citon; *Në zbatim të kontratave tëqiramarrësi ka marrë në posedim sipërfaqe me qira duke përmbushur të gjitha detyrimet kontraktore dhe duke respektuar në mënyrë të rregullt të gjitha dispozitat e parashikuara në to. Me qëllim përdorimin sa më optimal e të qetë të këtyre sipërfaqeve, janë vënë në përdorim nga Qiradhënësi sipërfaqe shtesë të cilat nuk përfshihen në sipërfaqen e përgjithshme të marrë me qira sipas kontratave më sipër dhe për këto arsye në bashkëpunim me SUT është rakorduar dhe ngritur grupi i punës me profesionistë të fushës për kryerjen e matjeve dhe përgatitjen e planimetrive përkatëse në lidhje me sipërfaqet e mara me qira sipas kontratave dhe sipërfaqeve shtesë”*

Kërkoj: “Fillimin e procedurave dhe lidhjen e kontratës së qirasë në lidhje me sipërfaqet shtesë të rezultuara nga matjet e përbashkëta.”

- Bashkëngjitur kësaj shkresë janë gjithashtu edhe planimetritë e ambienteve të SUT-së të okupuara nga S.A dhe planimetritë e ambienteve të ndërtuara pa leje nga S.A mbi objektet e SUT-së.

- Shkresa nr. 312, dt. 19.02.2018 e Drejtorit të SUT z. A.Z drejtuar Ministrit të Financave dhe Ekonomisë për udhëzime të mëtejshme pasi “nga vëzhgimet në terren mbi ndërtimet shtesë të kryera nga S.A në territorin e SUT-së rezulton se janë bërë në pjesën e pasme të spitalit, përkatësisht:

-platforma në nivelin e katit të parë me konstruksion çeliku në një sipërfaqe 160 m2 dhe 42 m2.

Nuk u konstatua ndonjë shkresë për drejtuar subjektit “A.H” për detyrimin që ai ka për sipërfaqet shtesë të okupuara për periudhën objekt auditimi të cilat nuk përfshihen në sipërfaqen e përgjithshme të marrë me qira sipas kontratave.

V. Auditimi i lidhjes dhe zbatimit të kontratave të shërbimeve dhe blerjeve të institucionit.

a. Auditim mbi rregullaritetin e lidhjes së kontratave me subjektet private për shërbimet e furnizimit me ushqime (shërbimet e kateringut), shërbimi i rojeve private, shërbimi i lavanterisë, mirëmbajtje gjelbërim, shërbimi i mirëmbajtjes së pajisjeve mjekësore, etj. Realizimi i kontratave në përputhje me kërkesat kontraktuale dhe dokumentet e tenderit.

a/1. Shërbimi me shtretër dhe kryerja e shërbimit të gatimit dhe shpërndarjen e ushqimit për SUT për periudhën tetor – dhjetor 2017.

Për kryerjen e shërbimit të gatimit dhe shpërndarjen e ushqimit për SUT është lidhur kontrata nr. 409, dt. 01.10.2010 me “S” shpk. Për një periudhë 7 vjeçare në vlerën 399,400,367.07 lekë pa tvsh ose 479,280,441 lekë me tvsh

Sipas nenit 3, “objekti i kontratës” është “.. ofrimi nga sipërmarrësi në favor dhe për llogari të porositësit i shërbimit të gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit për pacientët e shtruar në pavionet dhe personelit të SUT Tiranë, sipas çmimit sasisë, vlerës, specifikimet teknike e kriterëve të tjera të përcaktuar në këtë kontratë dhe dokumentet e tenderit”.

Neni 9 “Detyrimet e sipërmarrësit”; 9.1 “Sipërmarrësi merr përsipër të kryejë shërbimin e ushqimit të gatuar dhe shpërndarjen deri tek pacienti dhe në mensë në ambientet e SUT sipas kushteve të kontratës, “Specifikimeve teknike” të parashikuara në dokumentet e tenderit të cilat janë pjesë integrale e kësaj kontrate”.

Neni 15; “Forca e përditshme e ushqimit”; 15.1 “Forca e përditshme e ushqimit do të përbëhet nga numri i personave që do të trajtohen sipas dietave dhe normës së përcaktuar.....”, 15.2. “Strukturat përkatëse të SUT çdo ditë përgatisin përmbledhësen e forcës sipas dietave dhe normës për ditën pasardhëse dhe ia dorëzon sipërmarrësit brenda orës 13.00 e firmosur dhe të vulosur”.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN UNIVERSITAR TË TRAUMËS”

Për kryerjen e shërbimit të gatimit dhe shpërndarjen e ushqimit për SUT është lidhur shtesë kontrate nr. 130/5, dt. 30.0.201 me “S” shpk. për një periudhën 01.10.2017 deri 31.12.2017 në vlerën 11,982,011 lekë pa tvsh. në masën 3% të vlerës totale të kontratës bazë nr. 409, dt. 01.10.2010.

U audituan urdhër shpenzimet për periudhën tetor – dhjetor 2017 për shërbimin e gatimit dhe shpërndarjen e ushqimit ku rezultoi si më poshtë:

1. Urdhër shpenzimi nr. 568, dt. 09.11.2017 për vlerën 4,876,899 lekë sipas faturës tatimore nr. 205, dt. 31.10.2017 për shërbimin ushqimor i gatuar për **muajin tetor 2017** për 5342 racione = 4,064,082 lekë pa tvsh = 4,876,899 lekë me tvsh.

Akti i rakordimit dt. 31.10.2017 për 5342 racione = 4,876,899 lekë me tvsh.

Forca për periudhën 1 deri 31 tetor 2017 SUT për çdo ditë sipas pavioneve dhe shumat mujore.

Pasqyra e mësipërme plotësohet bazuar në dokumentet e mëposhtme;

Pasqyrat e gjendjes e lëvizjes së forcës së SUT-së për çdo datë e cila plotësohet mbi bazën e fletë forcës ditore dhe lëvizjes së forcës gjatë 24 orëve e plotësuar nga kryeinfermieri dhe shefi i shërbimit të çdo pavioni.

Nga auditimi i regjistrit të shërbimit me shtretër për muajin tetor i cili plotësohet mbi bazën e kartelave të shtrimit simbas pavioneve rezulton se për këtë muaj referuar numrit të pacientëve të shtruar dhe forcës së likuiduar në datën 30 shtator 2017 (124 pacientë të trajtuar me shërbimin e kateringut) numri i pacientëve të shtruar në SUT dhe të trajtuar me shërbimin e kateringut simbas fletë forcës ditore është si më poshtë:

datat	Shtrimi simbas regjistrit të kartelave	Kateringut sipas fletë forcës ditore	diferenca	%
1	124	123	1	
2	149	123	26	
3	164	143	21	
4	163	141	22	
5	167	140	27	
6	157	148	9	
7	153	140	13	
8	149	140	9	
9	171	140	31	
10	192	140	52	
11	190	160	30	
12	200	152	48	
13	211	147	64	
14	196	158	38	
15	195	157	38	
16	232	157	75	
17	240	169	71	
18	256	165	91	
19	242	177	65	
20	251	176	75	
21	236	174	62	
22	233	174	59	
23	262	174	88	
24	264	177	87	
25	268	170	98	
26	278	166	112	
27	276	167	109	
28	270	164	106	
29	267	162	105	
30	286	162	124	
31	278	160	118	
TOTALI	6720	4,846	1874	



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN UNIVERSITAR TË TRAUMËS”

2. Urdhër shpenzimi nr. 614, dt. 06.12.2017 për vlerën 5,083,170 lekë sipas faturës tatimore nr. 225, dt. 30.11.2017 për shërbimin ushqimor i gatuar për **muajin nëntor 2017** për 5,578 racione = 4,235,975 lekë pa tvsh = 5,083,170 lekë me tvsh. Akti i rakordimit dt. 30.11.2017 për 5,578 racione = 5,083,170lekë me tvsh. Forca për periudhën 1 deri 30 nëntor 2017 SUT për çdo ditë sipas pavioneve dhe shumat mujore.

Pasqyra e mësipërme plotësohet bazuar në dokumentet e mëposhtme:

Pasqyrat e gjendjes e lëvizjes së forcës së SUT-së për çdo datë e cila plotësohet mbi bazën e fletë forcës ditore dhe lëvizjes së forcës gjatë 24 orëve e plotësuar nga kryeinfermieri dhe shefi i shërbimit të çdo pavioni.

Nga auditimi i regjistrit të shërbimit me shtretër për muajin nëntor i cili plotësohet mbi bazën e kartelave të shtrimit simbas pavioneve rezulton se për këtë muaj referuar numrit të pacientëve të shtruar dhe forcës së likuiduar në datën 31 tetor 2017 (160 pacientë të trajtuar me shërbimin e kateringut) numri i pacientëve të shtruar në SUT dhe të trajtuar me shërbimin e kateringut simbas fletë forcës ditore është si më poshtë:

datat	Shtrimi simbas regjistrit të kartelave	Kateringut sipas fletë forcës ditore	diferenca	%
1	205	154	51	
2	235	157	78	
3	243	167	76	
4	235	163	72	
5	228	161	67	
6	288	161	127	
7	306	177	129	
8	326	185	141	
9	335	192	143	
10	346	190	156	
11	332	183	149	
12	331	178	153	
13	341	178	163	
14	369	171	198	
15	372	172	200	
16	367	178	189	
17	357	179	178	
18	339	154	185	
19	336	153	183	
20	401	153	248	
21	414	173	241	
22	430	175	255	
23	441	182	259	
24	419	188	231	
25	401	164	237	
26	396	162	234	
27	388	162	226	
28	388	162	226	
29	388	162	226	
30	462	162	300	
31	0	0	0	
TOTALI	10,419	5,098	5,321	

3. Urdhër shpenzimi nr. 710, dt. 27.12.2017 për vlerën 3,867,773 lekë sipas faturës tatimore nr. 239, dt. 26.12.2017 për shërbimin ushqimor i gatuar për **periudhën 01 deri 25 dhjetor 2017** për 4,235 racione = 3,223,144 lekë pa tvsh = 3,867,773 lekë me tvsh. Akti i rakordimit dt. 26.12.2017 për 4,235 racione = 3,867,773 lekë me tvsh. Forca për periudhën 1 deri 25 dhjetor 2017 SUT për çdo ditë sipas pavioneve dhe shumat mujore.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN UNIVERSITAR TË TRAUMËS”

4. Urdhër shpenzimi nr. 27, dt. 06.02.2018 për vlerën 411,376 lekë sipas faturës tatimore nr. 253, dt. 31.12.2017 për shërbimin ushqimor i gatuar për **periudhën 26 deri 28 dhjetor 2017** për 448 racione = 347,813 lekë pa tvsh = 411,376 lekë me tvsh. Akti i rakordimit dt. 28.12.2017 për 448 racione = 411,376 lekë me tvsh. Forca për periudhën 26 deri 28 dhjetor 2017 SUT për çdo ditë sipas pavioneve dhe shumat mujore.

Pasqyra e mësipërme plotësohet bazuar në dokumentet e mëposhtme:

Pasqyrat e gjendjes e lëvizjes së forcës së SUT-së për çdo datë e cila plotësohet mbi bazën e fletë forcës ditore dhe lëvizjes së forcës gjatë 24 orëve e plotësuar nga kryeinfermieri dhe shefi i shërbimit të çdo pavioni.

Nga auditimi i regjistrit të shërbimit me shtretër për muajin dhjetor i cili plotësohet mbi bazën e kartelave të shtrimit simbas pavioneve rezulton se për këtë muaj referuar numrit të pacientëve të shtruar dhe forcës së likuiduar në datën 30 nëntor 2017 (162 pacientë të trajtuar me shërbimin e kateringut) numri i pacientëve të shtruar në SUT dhe të trajtuar me shërbimin e kateringut simbas fletë forcës ditore është si më poshtë:

datat	Shtrimi simbas regjistrit të kartelave	Kateringut sipas fletë forcës ditore	diferenca	%
1	190	175	15	
2	186	166	20	
3	183	166	17	
4	220	166	54	
5	256	142	114	
6	274	152	122	
7	287	157	130	
8	271	149	122	
9	264	147	117	
10	264	147	117	
11	315	147	168	
12	321	165	156	
13	337	155	182	
14	348	160	188	
15	342	170	172	
16	343	159	184	
17	341	158	183	
18	362	158	204	
19	364	156	208	
20	365	153	212	
21	367	141	226	
22	353	147	206	
23	335	137	198	
24	331	131	200	
25	328	131	197	
26	367	131	236	
27	368	136	232	
28	365	133	232	
29	350	0	350	
30	330	0	330	
31	325	0	325	
TOTALI	9652	4235	5417	

Për sa më lart konstatohet se pasqyrat e gjendjes e lëvizjes së forcës së SUT-së për çdo datë e cila plotësohet mbi bazën e fletë forcës ditore dhe lëvizjes së forcës gjatë 24 orëve e plotësuar nga kryeinfermieri dhe shefi i shërbimit të çdo pavioni **nuk rakordon me numrin e pacientëve të shtruar në SUT referuar regjistrin të shërbimit me shtretër i cili plotësohet mbi bazën e kartelave të shtrimit simbas pavioneve dhe me forcën e shtruar e likuiduar çdo ditë për ushqimin të plotësuar nga kryeinfermierët dhe shefat e pavioneve.**



Bazuar në regjistrin e shërbimit me shtretër për muajin tetor nëntor dhjetor 2017 i cili plotësohet mbi bazën e kartelave të shtrimit simbas pavioneve rezulton se për këta muaj numri i pacientëve të shtruar gjendje çdo ditë është më i madh se kapacitetet e shtretërve simbas pavioneve (numri ditor i shtretërve spitalorë është 236) dhe dukshëm më i lartë se forca e shtruar e likuiduar çdo ditë për ushqimin të plotësuar nga kryeinfermierët dhe shefat e pavioneve.

1. Për muajin tetor 2017 duke marrë për bazë gjendjen e të shtruarve dt. 01.10.17 të trashëguar nga muaji i kaluar (simbas pasqyrës përmbledhëse të shërbimit të ushqimit të muajit shtator për datën 30.09.2017 është 124 pacientë të shtruar) pacientëve të shtruar dhe të dalë çdo ditë në SUT sipas kartelave rezulton se duke filluar nga data 17.10.2017 deri 31.10.2017 numri i pacientëve të shtruar gjendje çdo ditë bazuar në regjistrin e shërbimit me shtretër është nga 240 deri 286 pacientë në ditë (total 6,720 pacientë në muaj) kur kapaciteti ditor i shtretërve për SUT është 236 (total 7,316 shtretër në muaj).

Për këtë periudhë rezulton se janë shtruar në SUT më tepër se kapaciteti çdo ditë nga 4 deri 50 pacientë..

I krahasuar ky numër me forcën e shtruar e likuiduar çdo ditë për ushqimin të plotësuar nga kryeinfermierët dhe shefat e pavioneve i cili varion nga 123 deri 177 pacientë në ditë (total 4,846 pacientë në muaj) rezulton se nga 1 deri 124 pacientë të shtruar në ditë (total 1,874 pacientë në muaj) nuk janë trajtuar me shërbimin e ushqimit.
(pasqyra nr. 1 bashkëngjitur)

2. Për muajin nëntor 2017 duke marrë për bazë gjendjen e të shtruarve dt. 01.11.17 të trashëguar nga muaji i kaluar (160) (simbas pasqyrës përmbledhëse të shërbimit të ushqimit të muajit tetor për datën 31.10.2017 është 160 pacientë të shtruar kurse referuar gjendjes sipas regjistrit të shtrimit dhe kartelave është 378 pacientë) pacientëve të shtruar dhe të dalë çdo ditë në SUT sipas kartelave rezulton se duke filluar nga data 06.11.2017 deri 30.11.2017 numri i pacientëve të shtruar bazuar në regjistrin e shërbimit me shtretër është nga 288 deri 462 pacientë në ditë (total 10,419 pacientë në muaj) kur kapaciteti ditor i shtretërve për SUT është 236 (total 7,080 shtretër në muaj).

Për këtë periudhë rezulton se janë shtruar në SUT më tepër se kapaciteti çdo ditë nga 52 deri 226 pacientë (total 3,339 pacientë mbi kapacitetin në muaj).

I krahasuar ky numër me forcën e shtruar e likuiduar çdo ditë për ushqimin të plotësuar nga kryeinfermierët dhe shefat e pavioneve i cili varion nga 154 deri 192 pacientë në ditë (total 5,098 pacientë në muaj) rezulton se nga 51 deri 300 pacientë të shtruar në ditë (total 5,321 pacientë në muaj) nuk janë trajtuar me shërbimin e ushqimit.

Në rast se krahasimi do të bëhet me pacientët e shtruar referuar gjendjes sipas regjistrit të shtrimit dhe kartelave të datës 31.10.2017 për 378 pacientë treguesit e mësipërm janë shumë më të ndryshme.

(pasqyrat nr. 2 dhe 2/1, bashkëngjitur)

3. Për muajin dhjetor 2017 duke marrë për bazë gjendjen e të shtruarve dt. 01.12.17 të trashëguar nga muaji i kaluar (162) (simbas pasqyrës përmbledhëse të shërbimit të ushqimit të muajit nëntor për datën 30.11.2017 është 162 pacientë të shtruar, kurse referuar gjendjes sipas regjistrit të shtrimit dhe kartelave është 680 pacientë) pacientëve të shtruar dhe të dalë çdo ditë në SUT sipas kartelave rezulton se duke filluar nga data 05.12.2017 deri 30.12.2017 numri i pacientëve të shtruar bazuar në regjistrin e shërbimit me shtretër është nga 256 deri 368 pacientë në ditë (total 9,652 pacientë në muaj) kur kapaciteti ditor i shtretërve për SUT është 236 (total 7,316 shtretër në muaj).

Për këtë periudhë rezulton se janë shtruar në SUT më tepër se kapaciteti çdo ditë nga 20 deri 132 pacientë (total 2,336 pacientë mbi kapacitetin në muaj).



I krahasuar ky numër me forcën e shtruar e likuiduar çdo ditë për ushqimin të plotësuar nga kryeinfermierët dhe shefat e pavioneve i cili varion nga 131 deri 170 pacientë në ditë (total 4,235 pacientë në muaj) rezulton se nga 15 deri 236 pacientë të shtruar në ditë (total 5,417 pacientë në muaj) nuk janë trajtuar me shërbimin e ushqimit. Për datat 29, 30, 31 dhjetor 2017 pacientët e shtruar për këto data nuk janë trajtuar me shërbimin e ushqimit.

Në rast se krahasimi do të bëhet me pacientët e shtruar referuar gjendjes sipas regjistrimit të shtrimit dhe kartelave të datës 31.10.2017 për 680 pacientë treguesit e mësipërm janë shumë më të ndryshme.

(pasqyrat nr. 3 dhe 3/1, bashkëngjitur)

a/2. Mbi shërbimin e lavanderisë.

Nga auditimi i likuidimit të shërbimit të lavanderisë rezulton se:

Për periudhën e përzgjedhur 01.10. 2017 deri 31.12. 2017 janë likuiduar tre urdhër shpenzime:

Nr. 575, dt. 09.11.2017 për periudhën 01 deri 31 tetor 2017 në vleftën 5,624,640 lekë.

Bashkëngjitur është fatura tatimore nr. 16, dt. 31.10.2017 për tesh në sasinë 13,392 kg x 350 = 4,687,200 lekë = 5,624,640 lekë me tvsh.

Akti i rakordimit dt. 31.10.2017 ku citohet se “bazuar mbi fletëkërkesat dhe procesverbalin i pritjes së mallit dhe grafiku i shpërndarjes nga data 01.10.2017 deri 31.10.2017 rezulton se janë larë 13,392 kg”.

U kërkuar dokumentacioni përkatës dhe nga znj. M.P u paraqitën dokumentet si më poshtë:

Përmbledhëse mujore e shërbimit të lavanderisë për periudhën 01.10.2017 deri 31.10.2017 sipas datave dhe materialeve përkatëse për tu larë në kg në shumën 13,392 kg.

Gjithashtu në dosje janë edhe përmbledhësja e grafikut të kërkesave ditore për gjithë muajin tetor 2017.

Janë bashkëngjitur kërkesat sipas pavioneve për shërbimin e lavanderisë për çdo datë sipas artikujve që do të lahen në copë.

Sasitë e kërkesave nga pavionet nuk përputhen me sasitë e fletë daljeve të bëra për operatorin.

Bashkëngjitur janë fletë daljet për çdo datë nga çdo pavion në copë për operatorin “D” shpk të firmosur nga përfaqësuesi i operatorit dhe përfaqësuesi i SUT (kryeinfermieri i pavionit përkatës si dorëzues i materialit për tu trajtuar nga shërbimi i lavanderisë).

Mbi bazën e materialeve të dorëzuara nga kryeinfermierët e pavioneve, komisioni i marrjes në dorëzim të mallit për çdo datë ka hartuar procesverbalin përkatës “mbi pritjen, kontrollin dhe marrjen në dorëzim të materialeve të buta për shërbimin e lavanderisë dhe hotelerisë në SUT, pasi i numëroi, peshoi, kontrolloi cilësinë e materialeve të buta (sipas specifikimeve teknike të përcaktuara në kontratën nr. 132/14, dt. 07.12.2016)”. Ky procesverbal (akt akordimi) shoqërohet me përmbledhësen e shërbimit të lavanderisë “D” shpk për pavionet e SUT, për periudhat përkatëse mujore vetëm me sasitë ditore në kg për çdo artikull pa sasitë në copë dhe pa numrin e shtretërve për çdo ditë.

Nuk ka një dokument ku sasitë e trajtuara nga lavanderia të cilat janë marrë në copë të jenë shpërndarë nga sipërmarrësi sipas pavioneve të mara nga kryeinfermierët kjo sipas përcaktimit të kontratës “Specifikimet teknike të menaxhimit të procesit të lavanderisë”, “sipërmarrësi do të lajë dezinfektojë, thajë, paketojë, të transportojë dhe shpërndajë deri në pavion bazën e materialit të butë, si dhe të bëjë shërbimin e plotë deri te shtrati i pacientit. Rregullat e shtrimit të shtratit do të bëhen sipas protokolleve të kujdesit infermjeror, manualit të kujdesit spitalor, rregullave të higjienës me njoftimin e Hapjes së kartelës së re të shtrimit nga K/infermieri i shërbimit, si dhe sa herë të nevojitet nga shërbimi” dhe etapat e procesit: “.. shpërndarja e materialit të butë në pavione bëhet nga sipërmarrësi çdo ditë..... kryeinfermieri i pavionit dhe grupi i pritjes së mallit bën kontrollin e materialit të butë.....duke e pasqyruar në procesverbal i cili duhet të ketë të saktësuar numrin e materialit të butë të marrë në dorëzim nga kryeinfermieri i pavionit”.

Komisioni;

V.S, kryetar dhe anëtarët; N.M, E.X, M.P, A.R dhe përfaqësuesja e firmës “D” shpk z. B.M.



Nga krahasimi i fletë daljeve të sasisë së materialeve të trajtuara nga shërbimi i lavanderisë bërë dalje nga kryeinfermierët për datë 02.10.2017 rezulton se sasi të në copë të firmosura dhe të pranuar nga kryeinfermieret përkatës sipas pavioneve nuk është e njëjtë me sasi të në copë të pasqyruar në procesverbalin ditor të mbajtur nga komisioni. Megjithatë kërkesat dhe sasia e trajtuar për datën 02.10.2017 është 706.45 kg në fakt këtë ditë nga operatori është dorëzuar sasia e materialit të një dite të mëparshme dhe jo ajo sasi e kërkuar nga kryeinfermierët.

Në kërkesat për materialin që bëjnë pavionet i cili duhet ti nënshtrohet shërbimit të lavanderisë të firmosura nga kryeinfermieret nuk shënohet numri i shtretërve të zënë për atë datë, gjendja e pacientëve të rinj të shtruar atë datë ose arsyeja kur ndërrimi i shtratit bëhet i domosdoshëm për të ruajtur dhe mbrojtur shëndetin e pacientit. Sipas kontratës “Rregullat e shtrimit të shtratit do të bëhen sipas protokolleve të kujdesit infermjeror, manualit të kujdesit spitalor, rregullave të higjienës me njoftimin e Hapjes së kartelës së re të shtrimit nga K/infermieri i shërbimit, si dhe sa herë të nevojitet nga shërbimi”

Simbas numrit të shtretërve dhe kartelave të shtrimit në SUT për datën 02.10.2016 janë shtruar të rinj 57 pacientë Si rezultat sasia e pasqyruar në përmbledhësen e shërbimit të lavanderisë, Aktrakordimit mujor për likuidim dhe procesverbaleve ditore të mbajtura nga komisioni nuk përputhen me sasi të e parashikuara, pasqyruara dhe të dorëzuara nga kryeinfermieret e pavioneve.

Bazuar në parashikimet e kryeinfermierëve, sasi të në copë të mara nga operatori dhe pasqyrave përmbledhëse në kg të sasive të trajtuara me shërbimin e lavanderisë 2017 rezulton se disa materiale të parashikuara nuk janë trajtuar me shërbimin e lavanderisë si më poshtë:

1. “Çarçafë shtrati, i sipërm” i cili është planifikuar të trajtohej me shërbimin e lavanderisë (larë) 51 herë në vit ose rreth 4 herë në muaj dhe për shërbimin e urgjencës, reanimacionit, neurokirurgjisë çdo dy ditë nuk janë trajtuar me shërbimin e lavanderisë për muajt janar, shkurt, mars, prill, maj, qershor, tetor, nëntor, dhjetor. (Për periudhën 12 mujore, çdo muaj janë trajtuar me shërbimin e lavanderisë “çarçafët e shtratit, i poshtëm” kurse për muajt e cituar më sipër “çarçafët e shtratit, të sipërm” nuk janë trajtuar (larë). Ndërrimi i shtratit është i domosdoshëm për të ruajtur dhe mbrojtur shëndetin e pacientit dhe i detyrueshëm sipas kontratës.

2. “Çarçafë zarf” i cili është planifikuar të trajtohej me shërbimin e lavanderisë (larë) 51 herë në vit ose rreth 4 herë në muaj dhe për shërbimin e urgjencës (dy herë në ditë), reanimacionit, neurokirurgjisë çdo dy ditë nuk janë trajtuar me shërbimin e lavanderisë për muajin gusht. (Për periudhën 12 mujore, çdo muaj janë trajtuar me shërbimin e lavanderisë “çarçafët e shtratit, i poshtëm” kurse për muajt e cituar më sipër “çarçafët zarf” nuk janë trajtuar (larë). Ndërrimi i shtratit është i domosdoshëm për të ruajtur dhe mbrojtur shëndetin e pacientit dhe i detyrueshëm sipas kontratës.

3. “Jastëkë” i cili është planifikuar të trajtohej me shërbimin e lavanderisë (larë) 2 herë në vit dhe për shërbimin e reanimacionit (dy herë në muaj), dhe neurokirurgjisë (çdo muaj) nuk janë trajtuar me shërbimin e lavanderisë për muajt qershor, shtator. Ndërrimi i shtratit është i domosdoshëm për të ruajtur dhe mbrojtur shëndetin e pacientit dhe i detyrueshëm sipas kontratës.

4. “Mbulesë e gomuar” i cili është planifikuar të trajtohej me shërbimin e lavanderisë (larë) 12 herë në vit ose rreth një herë në muaj dhe për shërbimin e urgjencës, reanimacionit, neurokirurgjisë dy herë në muaj nuk janë trajtuar me shërbimin e lavanderisë për muajin korrik. Ndërrimi i shtratit është i domosdoshëm për të ruajtur dhe mbrojtur shëndetin e pacientit dhe i detyrueshëm sipas kontratës.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN UNIVERSITAR TË TRAUMËS”

5. “Pizhama pacienti” i cili është planifikuar të trajtohej me shërbimin e lavanderisë (larë) 102 herë në vit ose rreth 8.5 herë në muaj nuk janë trajtuar me shërbimin e lavanderisë për 12 muaj.

6. “kompresa operacioni” të bllokut operator të cilat janë planifikuar të trajtohej me shërbimin e lavanderisë (larë) çdo ditë nuk janë trajtuar me shërbimin e lavanderisë për muajt nëntor, dhjetor.

7 “Çarçafë operacioni (110-130) dhe Çarçafë operacioni (140-130)” të bllokut operator të cilat janë planifikuar të trajtohen me shërbimin e lavanderisë (larë) çdo ditë nuk janë trajtuar me shërbimin e lavanderisë për muajt nëntor, dhjetor.

8. “Kostume ekipi i sallës” të bllokut operator të cilat janë planifikuar të trajtohen me shërbimin e lavanderisë (larë) çdo ditë nuk janë trajtuar me shërbimin e lavanderisë për 12 muaj.

9. “Përparëse operacioni” të bllokut operator të cilat janë planifikuar të trajtohen me shërbimin e lavanderisë (larë) çdo ditë nuk janë trajtuar me shërbimin e lavanderisë për muajt nëntor, dhjetor.

10. “Kapuça operacioni” të bllokut operator të cilat janë planifikuar të trajtohen me shërbimin e lavanderisë (larë) çdo ditë nuk janë trajtuar me shërbimin e lavanderisë për 12 muaj.

11. “Pantofla personeli” të cilat janë planifikuar të trajtohen me shërbimin e lavanderisë (larë) 102 herë në vit ose 8.5 herë në muaj nuk janë trajtuar me shërbimin e lavanderisë për 12 muaj.

Për sa më lart mos kryerja e shërbimit të domosdoshëm dhe të detyrueshëm të lavanderisë për një sërë artikujsh të parashikuar në kontratë **ka cenuar ruajtjen dhe mbrojtjen e shëndetit të pacientëve.**

a/3. Mbi auditimin e ushtuar të dokumentacionit të zbatimit të kontratës nr. 416 prot. datë 19.10.2010 me objekt “**Kryerjen e shërbimit të pastrimit të ambienteve të brendshme dhe pastrim sistemim gjelbërim i ambienteve të jashtme të SUT**”.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua se:

Shërbimi i pastrimit është realizuar sipas kontratës nr. 416 prot. Datë 19.10.2010, midis Autoritetit Kontraktor SUT i përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm z. B.M dhe operatorit ekonomik “S” sh.p.k përfaqësuar nga znj. A.T. Vlera e kontratës është 242,285,782 lekë pa TVSH me kohëzgjatje 7 vjet, me të drejtë rivlerësimi çdo vit të çmimeve, lidhur me rezultatin e inflacionit në mënyrë progresive.

Kontrata për një vit sipas nenit 3 të saj, parashikon sasinë prej 14,467,000 m² sipërfaqe të brendshme, 11,228 m² pastrim të jashtme, 500 m² mbjellje lulesh stinës në dy sezona, 33,133 m² mirëmbajtje bari kultivuar, pemë dekorative dhe shërbime në bordura.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, i preventivit të kontratës, nuk gjenden planimetritë apo sipërfaqet e ambienteve të SUT në mënyrë që të përcaktoheshin që në fillim sipërfaqet e çdo ambienti që do të pastrohej.

Bazuar **nenit 7** të kontratës “Pastrimi, sistemimi dhe gjelbërimi i ambienteve të jashtme” përcaktohet:

7.1 Sipërmarrësi merr përsipër pastrimin e të gjitha sipërfaqeve të asfaltuara e të betonuara, rrugë dhe sheshe brenda territorit të SUQU. Shërbimi i pastrimit të sipërfaqeve të jashtme përfshin fshirjen dhe larjen e sipërfaqeve të asfaltuara.

7.2 Sipërmarrësi pastron çdo ditë të gjithë sipërfaqen e rrugëve brenda SUQU, pastron bordurat nga barërat dhe realizon lyerjen me gëlqere të bordurave një herë në muaj.

7.3 Sipërmarrësi kryen të gjitha shërbimet agroteknike në bimët shumë vjeçare ekzistuese dhe në sipërfaqet e gjelbëruara për mirëmbajtjen e tyre. Në mënyrë të veçantë sipërmarrësi përgjigjet për kryerjen e shërbimeve për:

- kultivimin me lule të stinës të mbjella në dy sezona;
- mirëmbajtjen e sipërfaqeve me bar të kultivuar;
- pastrimin e rrugëve e shesheve brenda sipërfaqes së gjelbër;



- mirëmbajtja e pemëve dekorative;
- mirëmbajtja e shkurreve dekorative;
- mirëmbajtjen e bordurave të gjelbërta (ligustra)

7.4 Sipërmarrësi merr përsipër mbjelljen e bimëve të reja sipas specifikimeve teknike.

Ndërkohë, sipas nenit 3 të kontratës, zëri nr. 2 i pastrimit të jashtëm është parashikuar “mirëmbajtje rrugësh” në sipërfaqen prej 11,228 m², cila duhet të mirëmbahet për 365 ditë dhe në total sipërfaqja e cila duhet të mirëmbahet është 4,098,220 m².

Në pikën B të specifikimeve teknike, të hartuara në vitin 2010 mbi pastrimin, sistemimin dhe gjelbërimin e ambienteve të jashtme citohet:

- Me pastrim të jashtëm do të kuptohet pastrimi i sipërfaqeve të rrugëve, trotuareve, shesheve dhe të gjithë territorit brenda murit rrethues të SUQU (SUT).
- Pastrimi i territorit do të kryhet jo më pak se dy herë në ditë dhe pjesët e asfaltuara dhe të betonuara do të lahen me ujë. Në sezonin e verës do të lahen dy herë në ditë.
- Territori i SUQU në çdo moment duhet të jetë i pastër nga mbeturinat e ndryshme si letra, shishe plastike ambalazhe të ndryshme etj.
- Mbeturinat që do të pastrohen të futen nëpër qese plastmase dhe të çohen në pikat e grumbullimit të mbeturinave.
- Në asnjë rast mbeturinat të mos digjen.
- Sipërfaqet e mbjella me lulishte duhet të sistemohen dhe të mirëmbahen në mënyrë të vazhdueshme gjatë të gjithë periudhës. Pemët dekorative dhe drusore frutore duhet tu kryhen shërbimet përkatëse sipas sezonit. Pemët frutore dhe drurët e ndryshëm duhet të spërkaten në periudha të ndryshme me dizifektantë. Të mirëmbahen sipërfaqet e mbjella me lule dhe gjatë vitit të shtohet sipërfaqja e tyre. Sipërfaqet e lulishteve të rrethohen në mënyrë që të mos shpërdorohen nga vizitorët.
- Ambientet e gjelbëruara duhet të vaditen sa herë që të jetë e nevojshme. Të krijohen ambiente me stola e tavolina për pushimin e të sëmurëve dhe të vizitorëve.
- Të vendosen kosha për hedhjen e mbeturinave në të gjithë territorin.
- E gjithë sipërfaqja e SUQU të pastrohet nga bimët e egra si shkurre, ferra, gjemba etj, që prishin estetikën dhe krijojnë rrezik për zjarr.
- Në sezonin e përshtatshëm të bëhet kositja e barërave në të gjithë territorin e spitalit.
- Të priten drurët të cilët janë të tharë, të vjetër, të cilët mund të paraqesin rrezik për jetën e njerëzve apo prishjen e godinave.
- Kontraktuesi duhet të ketë në pronësi ose me qira makineri e pajisje që kanë të bëjnë me kryerjen e këtij shërbimi si: karroca pastrimi, makina për larjen e pllakave, makina për thithjen e pluhurave, vinç me kosh për larjen e sipërfaqeve në lartësi (deri 4 kate), motosega, makinë korrëse bari, pompa dezifektimi.

Njësia matëse për vlerësimin e punës së kryer, do të jetë lekë për metër katror të kryer në fakt.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, referuar kontratës dhe specifikimeve teknike nuk citohet apo përmendet në asnjë rresht se çfarë përfshin apo se çfarë do të realizohet në zërin e mirëmbajtjes së rrugëve për sipërfaqen e plotë të gjithë territorit të SUT prej 11,228 m² çdo ditë.

Sipas kontratës së shërbimit të pastrimit, në preventiv parashikohet pastrimi i jashtëm si më poshtë:

Nr.	Përshkrimi i punimeve	Sasia ditore	Dite	Sasia vjetore	Çmimi për njësi (2010)	Vlera
1	Fshirje rrugësh 11,228 m ²	11,228	365	4,098,220	0.226	926,198
2	Mirëmbajtje rrugësh 11,228 m ³	11,228	365	4,098,220	0.136	557,358
3	Larje rrugësh 11,228 m ⁴	11,228	230	2,582,440	0.423	1,092,372
Shuma e pastrimit të jashtëm						2,575,928

Nga auditimi me zgjedhje i disa urdhër shpenzimeve, pagesave të kryera për shërbimin e pastrimit në vitin 2016 dhe 2017 (nr. 431 datë 05.09.2016, nr. 520 datë 06.10.2016, nr. 583 datë 08.11.2016, nr. 658 datë 07.12.2016, nr. 727 datë 29.12.2016, nr. 7 datë 16.01.2017, nr. 37 datë



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI "PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN UNIVERSITAR TË TRAUMËS"

06.02.2017, nr. 105 datë 06.03.2017, nr. 149 datë 05.04.2017, nr. 207 datë 05.05.2017, nr. 330 datë 05.07.2017), u konstatua se mirëmbajtja e rrugëve është likuiduar për çdo ditë në sipërfaqen e të gjithë territorit prej 11,228 m², me çmimin përkatës të indeksuar për çdo vit, e cila bie në kundërshtim me specifikimet teknike dhe kontratën e shërbimit. Në pagesat e shërbimit të pastrimit disponohen vetëm Akt-rakordimet e sipërfaqeve të pastrimit, procesverbale për realizimin e punimeve në sipërfaqet e gjelbërta bashkë me mirëmbajtjen e bordurave dhe nuk disponohet asnjë procesverbal apo dokumentacion justifikues mbi shërbimin e mirëmbajtjes së rrugëve.

Tabela e mëposhtme paraqet vlerat e likuiduara për vitet 2016 dhe 2017.

Nr	Përshkrimi i punimeve	Sasia ditore	Dite	Sasia vjetore	Çmimi për njësi (2016)	Vlera
2	Mirëmbajtje rrugësh 11,228 m ³	11,228	365	4,098,220	0.150	614,733
Shuma e pastrimit të jashtëm për vitin 2016						614,733

Nr	Përshkrimi i punimeve	Sasia ditore	Dite	Sasia vjetore	Çmimi për njësi (2017)	Vlera
2	Mirëmbajtje rrugësh 11,228 m ³	11,228	365	4,098,220	0.152	622,929
Shuma e pastrimit të jashtëm për vitin 2017						622,929

Theksohet gjithashtu se Autoriteti Kontraktor SUT, ka marrëdhënie kontraktuale, për shërbimin e mirëmbajtjes të objekteve të SUT, ku përfshihen zëra ndërtimor si trotuare me pllaka granili me bojë pa bordurë betoni, bordura trotuari 20x35 cm të parapërgatitura, nënshtresa zhavorri, nënshtresa rëre, shtresë betoni C 7/10, shtresë rëre në territorin e ndërtesave, sherbetisje e bojatisje me gëlqere, illustra çimento etj, në të cilat kontraktuesi ka likuiduar vlera të punimeve sipas akt-rakordimeve për çdo muaj.

Për sa më sipër, vërehet një risk i trashëguar, që nga termat e referencave të kontratës nga viti 2010 e në vazhdim gjatë zbatimit të shërbimit të pastrimit, ku sipërmarrësi ka përfutur proces pune të paargumentuar apo të pajustificuar, e cila për 2 vite (2016 + 2017) rezulton në vlerën 1,237,662 lekë pa TVSH (1,485,194 lekë me TVSH).

- Zëri i mirëmbajtjes së rrugëve, nga viti 2010 deri në 2015 është likuiduar në vazhdimësi i pa shoqëruar me dokumente argumentuese e justifikuese, me efekte financiare në vlerën **2,786,790 lekë**, duke marrë për bazë çmimin fillestar (të pa indeksuar), (557,358 lekë/vit x 5 vite = 2,786,790 lekë pa TVSH).

Referuar dokumentacioneve të mirëmbajtjeve të SUT dhe raportit përfundimtar të auditimit të KLSH në Ministrinë e Shëndetësisë në bazë të programit të auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 449/1, dt. 08.05.2017, ndryshuar me nr. 449/2, datë 30.05.2017, është konstatuar se në Spitalin Universitar të Traumës disa ambiente kanë qenë në proces zbatimi për rikonstruksion si më poshtë vijon:

1. Kontrata e parë është për "Rikonstruksionin e ambienteve ekzistuese dhe shtesë ambientesh të reja për kabinetin e fizioterapisë dhe rehabilitimit, si dhe, rikonstruksioni dhe përshtatje e hyrjes së godinës kryesore për reception si dhe disa magazinave për farmacinë".

Objektet janë kryer sipas kontratës për punë publike nr. 4858/6 prot. datë 11.11.2016 të realizuar nga Ministria e Shëndetësisë, me vlerë të kontratës 42,903,778 lekë pa TVSH, me afat zbatimi të kontratës bazë për periudhën kohore 6 mujore. Me shkresën nr. 131 prot. datë **23.11.2016** është njoftuar fillimi i punimeve nga mbikëqyrësi. Akti i dorëzimit të sheshit të ndërtimit është mbajtur më 23.11.2016 midis sipërmarrësit të punimeve dhe mbikëqyrësit. Me shkresën nr. 66 prot. datë 16.05.2017, të mbikëqyrësit të punimeve, drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë me objekt kërkesë për shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve. Kërkesa për shtyrje të afatit është e argumentuar me pengesa të ndryshme për mos lirimet e sheshit të magazinës për nën objektin e farmacisë, mos lrimi i ambientit të hollit, vonesa për mos vënie në dispozicion të sheshit të ndërtimit për nën/objektet e fizioterapisë, si dhe për shkak të temperaturave të ulëta nga data 10.12.2016 deri në 13.01.2017. Nga mbikëqyrësi kërkohet shtyrja e afatit të përfundimit edhe me 38 ditë ku përcaktohet data përfundimtare e përfundimit 22.06.2017. Me amendimin e kontratës nr. 1, nr.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN UNIVERSITAR TË TRAUMËS”

204/3 prot. datë 24.05.2017, miratohet zgjatja e afatit të përfundimit të punimeve deri më **22.06.2017**.

Me shkresën nr. 204/8 prot. Datë 07.06.2017 të kolaudatorit të punimeve “D”, drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë, dërgohet kolaudimi i pjesshëm i 2 objekteve. Sipas procesverbalit të kolaudit të pjesshëm deklarohet se objekti i Farmacisë dhe Fizioterapisë kanë filluar më datë 23.11.2016 dhe janë përfunduar më 15.05.2017.

Pra është konstatuar se hyrja e godinës kryesore për reception, është ende në proces zbatimi punimesh.

2. Kontrata e dytë është për “*Rikonstruksion i ambienteve ku do të instalohen pajisjet nga kredia Italiane e Traumës*”, e cila përfshin ambientet e imazherisë (morgu), ambientin e urgjencës, ambientin e bllokut operator, ambientin e reanimacionit dhe ambientin e laboratorit.

Objektet janë kryer sipas kontratës për punë publike nr. 3232/6 prot. datë 03.08.2016 të realizuar nga Ministria e Shëndetësisë, me vlerë të kontratës 55,166,487 lekë pa TVSH, me afat zbatimit të kontratës bazë është përcaktuar periudha kohore 6 muaj. Me shkresën nr. 86 prot. datë **24.08.2016** është njoftuar fillimi i punimeve nga mbikëqyrësi dhe procesverbali i fillimit të punimeve është mbajtur po më të njëjtën ditë. Me shkresën nr. 827 prot. datë 26.08.2016 është mbajtur akti i dorëzimit të sheshit të objektit më 24.08.2016 midis sipërmarrësit të punimeve dhe mbikëqyrësit. Me amendimin Nr. 1 të kontratës, nr. 969 prot. datë 20.02.2017, me objekt zgjatja e afatit të punimeve, miratohet shtyrja e afati deri më 30.04.2017. Me amendimin Nr. 2 të kontratës, pa protokoll, shtyrja e afatit të punimeve miratohet deri më 30.05.2017. Me amendimin Nr. 3 të kontratës, nr. 1958/2 prot. datë 01.06.2017, me objekt zgjatja e afatit, miratohet shtyrja e afati deri më **30.06.2017**.

Për periudhën e rikonstruksionit të 8 ambienteve sipas dy kontratave të mësipërme pagesa e shërbimit të pastrimit nuk është kryer për periudhën që këto ambiente ndodheshin në rikonstruksion, ku është zbritur sipërfaqe mujore e çdo ambienti përkatës për periudhën në rikonstruksion.

Ndërkohë nga verifikimi i pagesave për shërbimin e pastrimit u konstatua se:

-Mungojnë planimetritë e sipërfaqeve të ambienteve të cilat pastrohen c’do muaj.

- Nga ana e SUT, nuk janë mbajtur akte verifikime, akte kontrole mbi përfundimin e punimeve të rikonstruksioneve të sipërfaqeve të fizioterapisë, hyrjes së godinës kryesore, farmacisë, imazherisë (morgu), ambientin e urgjencës, ambientin e bllokut operator, ambientin e reanimacionit, ambientin e laboratorit me qëllim njoftimin e sipërmarrësit për fillimin e shërbimit të pastrimit të ambienteve, të cilat për periudhën në fjalë kanë qenë në rikonstruksion nga MSH.

a/4. Por nga auditimi nëpërmjet bankës konstatohet se SUT ka lidhur marrëveshje kuadër për periudhën 2016-2018 për furnizimin me pajisje ortopedike për operacionet që kryen në këtë spital.

Dinamika e realizimit të marrëveshjes kuadër për materialet ortopedike si më poshtë:

N r	Emertimi	Kontrata baze	Vlera e kontratës baze me dhe pa tvsh	likujduar			Vlera mbetur Viti 2018	Realizimi Viti 2018	Realizimi total	Gjendja viti 2018	Operator i
				Viti 2016	Viti 2017	Viti 2017 ne periudhen e fundvitit					
1	Sherbimi Ortopedi SUT	Nr 135 date 19/08/2016	79,034,064	39,513,856	29,997,395		9,522,813	9,518,688		4,125	TL
2	Sherbimi Ortopedi ish QSUT	Nr 41 date 13/02/2017	70,129,666	0	40,114,296	15,049,985	14,965,385				TL
3	N/Kirurgjia	Nr 5291/6 date 24.11.2016 (me tvsh)	60,749,956	9,240,443	21,265,518		30,243,995				O
					2 kontrata n/kirurgjia 2017						
	total		209,913,686	48,754,229	106,427,194			9,518,688	164,700,111		



Si dhe vihet re nga tabela, kemi një realizim të kësaj kontrate në shumën **164,700,111** lekë ose rreth 67% e vlerës totale të saj. Nga ana e grupit të auditimit për vitin 2016 u përzgjedhën disa komponentë të pajisjeve ortopedike dhe u verifikuan procedura e administrimit të tyre nga kërkesa që hartohet nga blloku operatore i ortopedisë, furnizimi nga operatori ekonomik, marrja në dorëzim nga Farmacia e SUT-s si dhe verifikimi me librin e Kryeinfermierit për operacionet e kryera dhe vendosjen e pajisjes në trupin e pacientit.

Nga kryqëzimi i këtyre dokumenteve konstatohet se pajisjet bëhen hyrje bazuar në Faturat e shitjes, në përmbajtje të të cilave ka përshkrimin e produktit, sasinë, çmimin, vlerën e faturës në total si dhe kodet përkatëse të këtyre pajisjeve, bazuar në këto kode u bë verifikimi i pajisjeve që bëheshin dalje nga farmacia drejt sallës operatore me fletë dalje përkatëse nënshkruar nga farmacistja si dhe nga marrësi i produktit kryeinfermieri i bllokut operator. Në prani të dy personave të lartpërmendur nga ana jonë u bë verifikimi i kodit të pajisjes të dalë dhe kodit të ruajtur në librin e K/infermierit ku konstatohet se këto kode nuk përputhen. Pra kodi i pajisjes i bërë hyrje në farmaci dhe për të cilin është paguar furnizuesi nuk korrespondon me kodin e pajisjes së vendosur në trupin e pacientit.

Lidhur me këtë fakt K/infermieri sqaroi se ka raste kur pajisjet nuk korrespondojnë me trupin e pacientit dhe në bazë të urdhrave të mjekut komunikohet me OE dhe kryhet shkëmbimi i pjesës ortopedike. Por që ky proces nuk vërtetohet dhe nuk dokumentohet në asnjë rast, nëse këto pajisje janë të njëjtës cilësi, janë të njëjtë çmim për të cilat Ministria e Shëndetësisë ka lidhur Marrëveshjen kuadër në të cilën janë të përcaktuara çmimet/sasinë e parashikuara, specifikimet teknike dhe llojshmëria e tyre me diametrat përkatës por brenda të njëjtë kod produkti.

Nga auditimi i vitit 2017 u përzgjedhën disa komponentë të pajisjeve ortopedike dhe u verifikuan procedura e administrimit të tyre nga kërkesa që hartohet nga blloku operator i ortopedisë, furnizimi nga operatori ekonomik, marrja në dorëzim nga Farmacia e SUT-s si dhe verifikimi me librin e Kryeinfermierit për operacionet e kryera dhe vendosjen e pajisjes në trupin e pacientit.

Nga kryqëzimi i këtyre dokumenteve konstatohet se pajisjet bëhen hyrje bazuar në Faturat e shitjes, në përmbajtje të të cilave ka përshkrimin e produktit, sasinë, çmimin, vlerën e faturës në total si dhe kodet përkatëse të këtyre pajisjeve, për vitin 2017 konstatohet se për **“Komponenti acetabular pa cement”**, me karakteristikat si: Shelli të ketë përbërje titanium alloy dhe të ketë të paktën 13 përmasa që fillojnë nga 40mm deri në 64mm. Të ketë të aplikuar plasma spray porus-coating e cila siguron fiksimin afatgjatë të komponentit me kockën. Të ketë tre vrima periferike dhe një qendrore në pjesën e brendshme të cilat shërbejnë për fiksimin e komponentit me kockën në sajë të vidave ku rrisin stabilitetin primar. të ketë 4 spica periferike të cilat rrisin gjithashtu stabilitetin primar, të ketë të paktën tre sisteme fiksimi. Polietileni përkatës i komponentit acetabular duhet të jetë tre llojesh: standart, antiluxim 10 grade dhe high ëall. Diametri i tij i jashtëm duhet të përshtatet diametrin të brendshëm të shellit kurse diametri i brendshëm i polietilenit duhet të jetë 28mm, Komponenti acetabular duhet të shoqërohet me vida përkatëse që fillojnë nga 15-50 mm, në asnjë rast ky produkt nuk ka ardhur i shoqëruar me kodet përkatëse për të bërë të mundur verifikimin i pajisjeve që bëheshin dalje nga farmacia drejt sallës operatore me fletë dalje përkatëse nënshkruar nga farmacistja si dhe nga marrësi i produktit kryeinfermieri i bllokut operator. Në prani të dy personave të lartpërmendur nga ana jonë u bë verifikimi i kodit të dalë të pajisjes dhe kodit të ruajtur në librin e K/infermierit ku konstatohet se këto kode nuk përputhen. Pra kodi i pajisjes i bërë hyrje në farmaci dhe për të cilin është paguar furnizuesi nuk korrespondon me kodin e pajisjes së vendosur në trupin e pacientit. **Për vitin 2017 identifikohen 53 artikuj në vlerën 14,900,485 leke.**

(tab.nr. 2 bashkëlidhur akt-konstatimit nr. 14, dt. 11.04.2018)

a/5. Nga auditimi i Shpenzimeve për karburant e lëndë djegëse, nga ana e SUT për vitin 2016 janë konsumuar gjithsej 24,260 litra naftë dhe 3030 litra benzinë, shpenzimi i kësaj sasie karburante shpërndahet kryesisht në lëvizjen e ambulancave 6330 litra, kaldaja 7500 litra, krematoriumi 9680 litra si dhe gjeneratorët të cilët duhet të jenë në gjendje gatishmërie rreth 450 litra naftë.



Për periudhën janar-dhjetor 2017 janë konsumuar 26 770 litra naftë si dhe 1240 litra benzinë. shpenzimi i kësaj sasive karburante shpërndahet kryesisht në lëvizjen e ambulancave 12 840 litra, kaldaja 4200 litra, krematoriumi 9000 litra si dhe gjeneratorët të cilët duhet të jenë në gjendje gatishmërie rreth 730 litra naftë .

Konsumi i karburantit kryhet sipas normativave të harxhimit të miratuara në vitin 2010, nga Brigada e Logjistikës e Ministrisë së Mbrojtjes e cila rezulton e pa rifreskuar me normativa të reja duke ju referuar dhe normave të amortizimit të tyre.

Për harxhimin e karburantit nga automjete janë mbajtur fletë udhëtimet të nënshkruara nga personat përgjegjës dhe punonjësit udhëtues, ndërsa për lëvizjet jashtë Tiranës janë bërë sipas urdhrat të Drejtorit, ndërsa për harxhimin e nga kaldajat, gjeneratorit dhe krematoriumi janë mbajtur procesverbalet përkatëse, duke përshkruar orët e punës së secilit agregat të miratuara, ndërsa për krematoriumin dhe sasinë e mbetjeve spitalore dhe nga cili repart, si dhe kartela klinike për mbetjet humane.

Theksojmë se me urdhrat përkatës për vitin 2016 dhe 2017 të drejtorit të SUT është vendosur që ngrohja e ambienteve të SUT (*Pavionet, Urgjenca e Politraumës dhe Poliklinika*) do të kryhet për 4 orë në ditë duke filluar nga data 15 e muajit nëntor deri në 15 mars të vitit respektiv, nëpërmjet ndezjes së kaldajës qendrore e cila funksionin me lëndë djegëse e llojit naftë, për këto dy muaj me orar të reduktuar prej dy orësh në mëngjes 06⁰⁰-08⁰⁰ dhe në mbrëmje nga ora 18⁰⁰-20⁰⁰, konstatohet se konsumi i lëndës djegëse arrin rreth 11,700 litra për të dy vitet.

Duke analizuar shpenzimet që kryen SUT nëpërmjet dy burimeve të energjisë si të karburantit dhe të energjisë elektrike të cilat janë në vlera të konsiderueshme mendojmë se ky shpenzim nga niveli menaxherial i SUT është menaxhuar pa efektivitet, ekonomikitet dhe efikasitet pasi edhe pse kryhet ky shpenzim, ai, nuk garanton ngrohjen e gjithë ambienteve të SUT duke cenuar sigurinë e shëndetit të pacientëve dhe ofruar kushte minimale të hospitalizimit të tyre.

a/6. Kontrata e sterilizimit.

Nga auditimi konstatohet se SUT me shkresë nr. 189/16, datë 16.08.2017 nga Ministria e Shëndetësisë i është dërguar për ndjekje Kontrata e koncesionit /PPP “Për ofrimin e shërbimeve të integruara të furnizimit të setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale sterile, furnizim me material mjekësor steril të një përdorimesh në sallat kirurgjikale, trajtimin e mbetjeve me rrezik biologjik dhe dizinfektimin e sallave kirurgjikale” me kompaninë “S” shp.k nënshkruar nga MSH në korrik 2015, ku bazuar kësaj kontrate SUT është një nga “Strukturat Spitalore”, sipas nenit 2 “Përkufizime” pika 2.12.

Nga auditimi konstatohet se futja në fuqi e kësaj kontrate ka rritur shpenzimet të konsumit të energjisë elektrike për vitin 2016 në shumën 20,974,442 lekë, dhe për vitin 2017 ky shpenzim është 25,021,955 lekë, respektivisht 4,047,513 lekë, kjo për arsyen se SUT-së bazuar në kontratën e koncesionit /PPP “Për ofrimin e shërbimeve të integruara të furnizimit të setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale sterile, furnizim me material mjekësor steril të një përdorimesh në sallat kirurgjikale, trajtimin e mbetjeve me rrezik biologjik dhe dizinfektimin e sallave kirurgjikale” neni 19 “Detyrimet e tjera të palëve” nën-pika 19.5 përcakton: “Në qendrat e BACK-up, përveç qendrës Back-up tek QSUT, Autoriteti i siguron Koncesionarit energji elektrike, uji, avull, vepra civile, impiante etj, me shpenzime në ngarkim të Autoritetit” i është shtuar dhe furnizimi me energji elektrike i koncesionarit të sterilizimit duke rënduar shpenzimet e SUT, e njëjta situatë dhe për furnizimin me ujë.

Lidhur me këtë kontratë konstatohet se bashkëlidhur saj në SUT nuk ka rezulton të jetë shoqëruar me anekset e saj si pjesë integrale dhe e domosdoshme për monitorimin e saj.

Me urdhrë nr. 922, datë 20.09.2017 të Drejtorit të SUT-s është ngritur grupi i monitorimit të shërbimeve që do përfitohen nga kjo kontratë, nga auditimi konstatohet se ky grup monitorimi nuk ka funksionuar.

Nuk ka dokumentacion nëse është kryer inventar lidhur me pajisjet Kirurgjikale në pronësi të SUT të cilat ndodhen në sallat operacionit.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN UNIVERSITAR TË TRAUMËS”

Nuk rezulton të ketë informacion ditor të përgatitur nga mjeku dhe infermieri ku të pasqyrohen të dhënat mbi numrin identifikues, tipin e ndërhyrjes, data klasifikimi i ndërhyrjes, konsumi i materialit integruar i verifikuar efektivisht në sallat e operacionit.

Nuk rezulton të jetë paraqitur për verifikim asnjë raport përmbledhës i cili duhet të paraqitet nga koncesionari një herë në muaj (në bazë të të cilit bëhet faturimi), ku SUT të paraqesë miratimin apo kundërshtimin brenda 10 ditëve nga paraqitja e tij, kjo sipas pikës 10.4 të kontratës së koncesionit.

Nga auditimi konstatohet se kontrata bazohet në çmime për njësi bazuar në shkallën e kompleksitetit të ndërhyrjeve kirurgjikale, i cili është i përcaktuar: kompleksiteti i Lartë;

Kompleksiteti i mesëm; Kompleksiteti i ulët. Sipas nenit 9 të kontratës “klasat e kompleksitetit ose intensiteti i ndërhyrjes kirurgjikale”, pika 9.3 shprehet “për përcaktimin dhe identifikimin e Klasës së Kompleksitetit të ndërhyrjeve kirurgjikale, palët bien dakord ti referohen klasifikimit të përcaktuar në Aneksin 4 “lista e seteve kirurgjikale dhe klasifikimi sipas shkallës” e cila duhet të ishte pjesë integrale e kontratës në SUT, por që në fakt nuk ekziston .

Bazuar në sa është përcaktuar më sipër koncesionari është paguar nga FSDKSH si më poshtë

Nr.	Pershkrimi i Kompleksitetit	Cmimi Paketes	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	Totali I nderhyrjeve	Vlera Vjetore 2017	tvsh	total
1	Kompleksiteti I Larte	37,700	14	102	154	161	431	16,248,700	3,249,740	19,498,440
2	Kompleksiteti I Mesem	22,300	18	98	176	178	470	10,481,000	2,096,200	12,577,200
3	Kompleksiteti I Ulet	13,900	453	872	811	803	2,939	40,852,100	8,170,420	49,022,520
4	Sterilizimi Instrumentave me Avull	266	0	0	0	0	0	0	0	0
	TOTALI		485	1,072	1,141	1,142	3,840	67,581,800	13,516,360	81,098,160

Nr.	Faturat Mujore	Vlefte pa Tvsh	Vlefte Me Tvsh	Totali
1	Fatura Muajit Janar	0	0	0
2	Fatura Muajit Shkurt	0	0	0
3	Fatura Muajit Mars	0	0	0
4	Fatura Muajit Prill	0	0	0
5	Fatura Muajit Maj	0	0	0
6	Fatura Muajit Qershor	0	0	0
7	Fatura e Muajit Korrik	0	0	0
8	Fatura e Muajit Gusht	0	0	0
9	Fatura e Muajit Shtator	7,225,900	1,445,180	8,671,080
10	Fatura e Muajit Tetor	18,151,600	3,630,320	21,781,920
11	Fatura e Muajit Nentor	21,003,500	4,200,700	25,204,200
12	Fatura e Muajit Dhjetor	21,200,800	4,240,160	25,440,960
	Totali Faturave Mujore 2017	67,581,800	13,516,360	81,098,160

Për pagesat e mësipërme nuk ka asnjë monitorim apo dhe konfirmim nga SUT të llojit të ndërhyrjes dhe numrit të operacioneve të kryera, për të cilat koncesionari paguhet nga FSDKSH. Në bllokun operator vetëm kryheshin rakordime mbi setet e përdorura për çdo ditë, i cili firmosej nga Kryeinfermieri i pavionit dhe personi i autorizuar i koncesionarit. Në kundërshtim kjo me Pikën 11 të kontratës “Raportime” e cila përcakton: “Palët bien dakord që Autoriteti nëpërmjet personelit që operon në Strukturat spitalore do të njoftojë Koncesionarin në lidhje me Shërbimet e përfutuara duke i dërguar këtij të fundit një informacion ditor”. Ky Informacion ditor do të bëhet nëpërmjet plotësimit të formularëve standard që do të përcaktohen nga palët. Struktura finale e formularëve standart për efekt të informacionit ditor dhe procedurat përkatëse do të përcaktohen nga Palët menjëherë pas nënshkrimit të Kontratës dhe para fillimit të ekzekutimit të Shërbimeve. Informacioni ditor do të përfshijë ndër të tjera, numrin identifikues, tipin e ndërhyrjes, datën klasifikimin e ndërhyrjes dhe të konsumit të materialit integruar të kryera nga Strukturat Spitalore. Kjo e dhënë do të verifikohet nga Palët në bazë të aktiviteteve që janë kryer efektivisht brenda çdo salle operate.”

VI. Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në përputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.



Mjedisi i kontrollit, menaxhimi i riskut, aktivitetet e kontrollit, informim komunikimi, monitorimi. Përmeshja e qëllimeve, objektivave të njësisë publike dhe caktimi i nëpunësit autorizues.

Hartimi i politikave, miratimi dhe monitorimi i objektivave të njësisë publike, të planeve strategjike e vjetore, përfshirë strategjinë e menaxhimit të riskut dhe të plan-veprimeve për arritjen e objektivave. Miratimi i rregullave specifike mbi procedurat për ruajtjen, mbrojtjen e nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë publike, bazuar në Manualin e menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Nëse është hartuar vetëvlerësimi, nëse është hartuar dhe depozituar te Ministri i Financave deklarata vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike që mbulon, duke respektuar afatet në përputhje me ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin.

Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Në zbatim të nenit 9 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015 “*Për disa shtesa dhe ndryshime*”, në bazë të këtij ligji do të bëhet vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në Spitalin Universitar të Traumës. Në kuptimin e këtij ligji, menaxhimi dhe kontrolli financiar përcaktojnë përgjegjshmërinë menaxheriale për planifikimin, zbatimin dhe kontrollin e buxhetit, kontabilitetin dhe raportimin, për të arritur objektivat dhe për të shmangur shpërdorimin dhe keqpërdorimin e pasurisë.

Objekti i veprimtarisë së Spitalit Universitar të Traumës është:

Spitali Universitar i Traumës shërben si Qendër Kombëtare e Traumës me funksion mjekësor, mësimor e kërkimor-shkencor dhe ka këto përgjegjësi kryesore:

- a) Ofrimin e shërbimit të urgjencës mjekësore në nivelin më të lartë të saj në rang kombëtar;
- b) Përkujdesjen shëndetësore për personelin e Forcave të Armatosura që ka statusin e ushtarakut;
- c) Dhënien e kontributit me kapacitete shëndetësore në përgjigje të detyrimeve të Shqipërisë, si vend anëtar në NATO.
- ç) Ofrimin e veprimtarisë akademike, mësimore e kërkimore-shkencore në funksion të realizimit të procesit mësimor dhe kërkimor në fushën e shëndetësisë.

Spitali Universitar i Traumës është person juridik, publik, buxhetor, në varësi administrative të Ministrisë së Shëndetësisë. Spitali Universitar i Traumës është pjesë e rrjetit të integruar të shërbimit mësimor e kërkimor-shkencor dhe spitalor në Republikën e Shqipërisë dhe ndjek e zbaton aktet ligjore e nënligjore në fushën e shëndetësisë. Planifikimi buxhetor për funksionimin normal të Spitalit Universitar të Traumës kryhet nga Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Mbrojtjes e cila vë në dispozicion fondin e akorduar për SUT.

Për periudhën objekt auditimi 2016 dhe 2017 rezultoi se:

-Në përputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*”, i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015 datë 15.10.2015 neni 9 “*Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit*”, pika 4, germa “b” i cili citon se “*Nëpunësi autorizues i të gjitha niveleve të njësisë publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë përgjegjësi kryesore hartimin e objektivave dhe zbatimin e planeve strategjike dhe vjetore, në përputhje me objektivat e miratuara nga titullari i njësisë*”, ky institucion nuk ka hartuar dhe propozuar tek nëpunësi autorizues i njësisë publike planin strategjik për periudhën objekt auditimi pra praktikisht plani strategjik 2016-2018 si dhe planin strategjik 2017-2019, i cili përmban objektivat strategjikë, prioritetet e institucionit dhe planet e veprimt, të cilat janë në zbatim të strategjisë ndër sektoriale.

-Në funksion të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar, në neni 12, nëpunësi zbatues (NZ), duhet të jetë niveli menaxherial në vartësi direkt të Drejtorit të Përgjithshëm. Gjithashtu në funksionet e tij, Përgjegjësi Sektorit të Financës duhet të mbulojë funksionin e planifikimit, monitorimit, zbatimit të buxhetit, kontabilitetin si dhe përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore



të konsoliduara të njësisë, në përputhje me kërkesat e ligjit në fuqi. Për periudhën objekt auditimi me shkresën nr.112/3 datë 02.02.2016 është konfirmuar nga Ministria e Mbrojtjes referuar shkresën së ardhur nga Ministri i Financës me nr. 52/3 datë 26.01.2016 “*Mbi caktimin e Nëpunësit Zbatues të përkohshëm për Spitalin Universitar të Traumës*” Znj. E.R me detyrë shefe e sektorit të Financës.

Nga auditimi u konstatua se nëpunësi zbatues është caktuar në kundërshtim me nenin 12 i ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar “*Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues*”, cilësohet se “*Nëpunës zbatues i njësisë publike është drejtuesi i strukturës përgjegjëse për financat e njësisë publike, në varësi direkte nga nëpunësi autorizues i njësisë dhe që ka përfunduar studimet e ciklit të dytë në shkencat ekonomike ose diplomë universitare të ekuivalentuar me të, me përvojë pune jo më pak se pesë vjet në profesion. Nëpunësi zbatues emërohet në njësi, sipas kuadrit ligjor në fuqi, duke respektuar plotësimin e kërkesave të kësaj pike*”. Referuar Strukturës së miratuar nga Kryeministri me urdhrin nr.30 date 13.03.2017 “*Për miratimin e Strukturës dhe Organikës së Spitalit Universitar të Traumës*” nëpunësi zbatues nuk është në varësi direkt nga nëpunësi autorizues i cili është drejtori i Spitalit por është në varësi nga Zv/ Drejtori zj. A.H.

-SUT sipas pikës 1, neni 18 i ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*”, i ndryshuar citon se “*Nëpunësi autorizues i çdo njësie të qeverisjes së përgjithshme, në bazë të vetëvlerësimit depoziton te titullari i njësisë publike dhe nëpunësi i parë autorizues deklaratën dhe raportin përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm të njësisë publike që mbulon, për vitin e mëparshëm, jo më vonë se fundi i muajit shkurt aktual*”. Grupi i auditimit konstatoi se për vitin 2016 referuar shkresën nr. 1311/1, datë 03.03.2017, SUT i ka dërguar Ministrisë së Mbrojtjes vetëm Pyetësorin e Vetëvlerësimit për funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Bashkëlidhur këtij pyetësori institucioni nuk ka përgatitur dhe për pasojë as nuk ka miratuar nga nëpunësi autorizues deklaratën mbi cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm në të cilën NA duhet të deklarojë se si sistemi i kontrollit të brendshëm mbështet arritjen e politikave të njësisë, qëllimeve dhe objektivave, ndërsa ruan fondet publike dhe pasurinë e njësisë ekonomike referuar manuali të MFK i miratuar me urdhrin nr. 108 datë 17.11.2016 nga Ministri i Financave. Në deklaratë, NA i njësisë publike duhet të përshkruajë dobësitë e sistemit të kontrollit dhe planet për trajtimin e tyre. Secili titullar njësie/NA do të nënshkruajë personalisht dhe vendosë datën në deklaratë. Gjithashtu nga auditimi u konstatua se institucioni nuk ka përgatitur raportin vjetor ku NA i çdo njësie publike duhet të kryejë një vetëvlerësim mbi gjendjen dhe cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm të njësisë. Kjo është një kërkesë e nenit 18 (paragrafi 1), të Ligjit për MFK-në. Informacioni i dhënë në raportin vjetor duhet të jetë në përputhje me deklaratën. Ky raport ofron një përmbledhje të konkluzioneve të raportit vjetor.

-SUT funksionon me ligjit nr. 9106, datë 17.7.2003, “*Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë*”, të ligjit nr. 147/2014, “*Për shërbimin e urgjencës mjekësore*”, të ligjit nr. 64/2014, “*Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë*”, të ligjit nr. 80/2015, “*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*”. Për vitin 2016 SUT ka funksionuar me strukturën e miratuar nga Kryeministri me urdhrin nr. 95 datë 07.06.2016 “*Miratimi i Strukturës dhe Organikës së Spitalit Universitar të Traumës*”. Në vitin 2017 kjo strukturë ka pasur ndryshime të cilat janë miratuar nga Kryeministri me urdhrin nr. 30.03.2017, ku praktikisht janë shtuar dy sektorë si dhe për vitin 2017 është shtuar shërbimi i receptionist si dhe janë shtuar një sërë shërbimesh.

Grupi i auditimit konstatoi se edhe pse struktura e SUT ka pasur ndryshime, hartimi dhe miratimi i rregullores së brendshme mbi ndryshimet e ndodhura në strukture për sa i përket funksioneve shtesë të SUT, funksionimit të tyre si dhe rregullat dhe procedurat për funksionimin e tij,



vazhdojnë të ngelen në kuadër të një drafti duke mos pasur akoma një finalizim të kësaj rregulloreje.

-Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS), sipas nenit 27 të ligjit nr. 10296, datë 07.08.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*” i ndryshuar dhe sipas pikës 2.2.6 të Manualit të Menaxhimit Financiar i miratuar me Urdhrin nr. 108, datë 17.11.2016 “*Për miratimin e manualit të menaxhimit Financiar*” nga Ministri i Financave ku citohet se “*Çdo Titullar i njësisë publike duhet të krijojë Grupin për Menaxhimin Strategjik me pjesëmarrjen e nivelit menaxherial ekzistues të njësisë...*” me urdhrin nr. 524/1 datë 11/10/2016 “*Për krijimin e Grupit Për Menaxhimin Strategjik*” i miratuar nga NA, është ngritur grupi i GMS, i cili përbëhet nga titullari i institucionit, nga sekretari i Përgjithshëm, Nëpunësi Zbatues si dhe Drejtorët e tjerë të nivelit të lartë. Grupi i auditimit konstatoi se ngritja e Grupit të GMS është kryer jashtë afateve (jo në fillim të vitit, por në muajin tetor), gjithashtu nuk ka asnjë proces verbal të mbajtur për takimet e kryera, apo për problematikat e trajtuara duke konkluduar se nuk është kryer asnjë mbledhje e GMS. GMS referuar pikës 2.2.4 të Udhëzimit nr.16 datë 16.07.2016 “*Për Përgjegjësitë dhe Detyrat e Koordinatorit të Menaxhimit Financiar.....*” i miratuar nga Ministri i Financave duhet të mbledhet të paktën tre herë në vit, ku vendimet duhet të jenë objektive dhe të merren në grup, duke vepruar në interes të publikut dhe në përputhje me standardet e etikes të institucionit. Për vitin 2017 grupi i auditimit konstatoi se Titullari i Njësisë nuk ka ngritur Grupin i Menaxhimit Strategjik në kundërshtim me pikën b, neni 8 i cili citon se Titullarët e njësive publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë kompetenca për ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik të njësisë publike, në përputhje me kërkesat e nenit 27 të këtij ligji. GMS luan një rol kyç për sa i takon integritetit të informacionit financiar të njësisë publike, sistemin e saj të kontrollit të brendshëm, si dhe sjelljen etike.

-Nuk janë hartuar **gjurmët e auditimit** të detajuara për procedurat kryesore, bazuar në gjurmët standarde të emërtuara nga Ministria e Financave. Sipas pikës 2 të nenit 16 të ligjit nr.10296 datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*” i ndryshuar si dhe mbështetur në shtojën V Manualit të Menaxhimit Financiar i miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr.8980 datë 15.07.2010 nuk ka miratim dhe arkivim të kësaj gjurme. Gjurma e auditimit është një instrument menaxhimi që mundëson nga njëra anë ndjekjen e ecures së një procesi nga fillimi në fund dhe në anën tjetër, ndjekjen e ecures së këtij procesi përgjatë strukturave të njësive, apo ndërmjet vetë njësive dhe institucioneve të jashtme. Përveç kësaj, gjurma e auditimit jep informacione për të rindërtuar transaksione dhe operacione të veçanta në kuadër të një procesi të caktuar si dhe për t’i verifikuar këto transaksione dhe operacione. Gjurmët e auditimit duhet të përgatiten nga menaxheret për proceset kryesore të punës së njësive (*nenin 16 i Ligjit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*). Është përgjegjësi e Nëpunësit Zbatues të njësive të sigurojë titullarin se këto procese janë identifikuar dhe janë përgatitur gjurmët e auditimit për to.

-Nuk janë përmbushur detyrimet në kuadër të përgjegjshmërisë menaxheriale, për identifikimin dhe **krijimin e Regjistrit të Rrisqeve**, monitorimin e kontrolleve të risqeve, që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive, sipas kërkesave të neneve 10, 11/2, 12/3, 9.4/c dhe 21, të ligjit nr.10296 “*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*”. Pra, nuk është hartuar një regjistër i identifikimit dhe kontrollit të risqeve dhe adresimi i personat përgjegjës për çdo risk, i cili duhet të plotësohet, përditësohet në vazhdimësi, si dhe të dërgohet ky regjistër në Kryeministri dhe në Ministrinë e Financave, konform përcaktimeve të kreut III “*Identifikimi i risqeve*” të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.

-Mos hartimi i **Strategjisë për Menaxhimin e Rrisqeve**, detyrim sipas nenit 8/a, 10, 11 dhe 21, të këtij ligji, i cili në mënyrë të detajuar, përcakton përgjegjshmërinë e hallkave të ndryshme në këtë njësi publike, si të **titullarit të institucionit**, i cili ka këto kompetenca për hartimin e politikave, miratimin dhe monitorimin e objektivave të njësive publike që ata drejtojnë, të planeve strategjike e vjetore, përfshirë strategjinë e menaxhimit të riskut dhe të plan-veprimeve



për arritjen e objektivave. Në kundërshtim me nenin 21, pika 2: “*Menaxhimi i riskut*”: ku citohet: “Për t’i zbatuar veprimtaritë e parashtruara në pikën 1 të këtij neni, titullari i njësisë publike, miraton një strategji e cila përditësohet çdo tre vjet, ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut. Nëpunësi autorizues, analizon dhe përditëson kontrollet që synojnë minimizimin e riskut, të paktën një herë në vit”, **nuk ka një strategji të riskut dhe për rrjedhojë, as është përditësuar ajo.**

-Nga auditimi mbi raportet e monitorimit, grupi i auditimit për periudhën objekt auditimi konstatoi se SUT nuk ka hartuar dhe për pasojë as nuk ka miratuar nga titullari i njësisë raportet e monitorimit lidhur me vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm si dhe raportet 4-mujore dhe vjetore në lidhje me zbatimin e buxhetit në kundërshtim me udhëzimin e MF nr. 22 datë 17.11.2016 “*Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore*” si dhe referuar nenit 24 “*Monitorimi*” i ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015 datë 15.10.2015 “*Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin*”.

-Politikat e burimeve njerëzore dhe praktikrat e ngjashme lidhen me rekrutimin, emërimin, trajnimin, vlerësimin e performancës, avancimin në detyrë dhe veprimet disiplinore. Për ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të punonjësve gjatë viteve të objekt auditimit, në SUT nuk janë organizuar trajnime për rritjen e kapaciteteve profesionale të punonjësve për tu njohur dhe shkëmbyer përvojë mbi praktikrat më të mira në fusha të ndryshme të cilat lidhen me veprimtarinë e punës së secilit sektor. Ky institucion nuk ka program specifike për trajnimin e punonjësve të administratës, në kundërshtim me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. II, pika 2.5.1 “*Mjedisi i kontrollit (ose mjedisi i brendshëm i njësisë)*”, paragrafët “*Politikat dhe praktikrat që lidhen me burimet njerëzore*” dhe “*Profesionalizmi i stafit*”.

Në kreun III “*Komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit*”, neni 19, citohet: “*Titullarët e njësive të sektorit publik, zbatojnë menaxhimin financiar dhe kontrollin nëpërmjet komponentëve të ndërlidhur me njëri-tjetrin, si: Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informacioni dhe komunikimi dhe Monitorimi*”. Grupi i auditimit pas bisedimit me nëpunësin zbatues për zbatimin e përgjegjësive menaxheriale sipas nenit 11 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*” i ndryshuar, posedoi disa informacione lidhur me përgjegjësitë dhe raportimin që nëpunësi zbatues ka si detyrim ndaj nëpunësit autorizues. Mbështetur në vetëvlerësimin e bërë nga ana e SUT për periudhën objekt auditimi, si dhe referuar përgjigjeve të pyetësorit, më poshtë rendisim punën e bërë nga ky institucion, si dhe mangësitë e konstatuara në plotësimin e kërkesave që kërkojnë komponentët në drejtim të funksionimit me përgjegjshmëri menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij.

1. Mjedisi i kontrollit.

Mjedisi i kontrollit është baza e menaxhimit të fondeve buxhetore dhe përbën themelin, ku ngrihen të gjithë komponentët e tjerë të kontrollit të brendshëm. Mjedisi i kontrollit përmban: Integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike; Politikrat menaxheriale dhe stilin e punës; Strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit; Politikrat dhe praktikrat e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe aftësitë profesionale të punonjësve.

a. Integriteti personal dhe etika profesionale e nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të kësaj njësie publike. Nëpunësit e këtij institucioni duhet të respektojnë rregullat dhe parimet e ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003 “*Për rregullat e etikës në administratën publike*”. Lidhur me respektimin e etikës nga punonjësit në rregulloren e brendshme të këtij institucioni, thuhet se, punonjësit duhet të respektojnë normat etike dhe profesionale të bashkëpunimit e të ndihmës së ndërsjellët, por ky institucion, në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “*Për*



Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, neni 20 “*Mjedisi i kontrollit*”, pika 2, germa a dhe në Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, të hartuar dhe miratuar nga Ministria e Financës, Kap II, pika 2.5.1 “*Mjedisi i Kontrollit (ose mjedisi i brendshëm i njësisë)*”, paragrafi “*Integriteti dhe vlerat etike*”, Institucioni nuk ka një Kod të Brendshëm Etik ose një Kod Sjellje, apo udhëzim për zbatimin e etikës, si dhe nuk ka procedurë për të raportuar shkeljet e legjislacionit mbi etikën dhe për marrjen e masave për shkeljet e konstatuara.

b. Struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrave, rregullat e qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit.

Njësia ka një program buxhetor me qëllim përdorimin me eficient dhe efektiv të burimeve njerëzore dhe financiare. Detyrat dhe përgjegjësitë e strukturave përkatëse të njësisë, janë të përcaktuar në rregulloren e vjetër të brendshme të institucionit e cila vazhdon të jete në fazë drafti.. Nëpërmjet përshkrimit të punës për çdo pozicion pune, është kryer ndarja e detyrave dhe e përgjegjësiave, e vartësisë funksionale dhe administrative si dhe linja e raportimit. Nga drejtuesi i institucionit, duhet të sigurohet mbikëqyrja e monitorimi i punës për secilin punonjës, në mënyrë që të sigurohet si duhet integriteti personal dhe etika profesionale, duke përjashtuar konflikt interesit në kryerjen e detyrave funksionale, në përputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*” i ndryshuar në lidhje me “*ndarjen e detyrave në fushën e dhënies së autorizimit në atë formë, në mënyrë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, kontabilitetin dhe kontrollin*”.

Në funksion të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar, në neni 12, nëpunësi zbatues (NZ), duhet të jetë niveli menaxherial në vartësi direkt të Drejtorit të Përgjithshëm. Gjithashtu në funksionet e tij, Përgjegjësi Sektorit të Financës duhet të mbulojë funksionin e planifikimit, monitorimit, zbatimit të buxhetit, kontabilitetin si dhe përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore të konsoliduara të njësisë, në përputhje me kërkesat e ligjit në fuqi.

Nga auditimi u konstatua se nëpunësi zbatues është caktuar në kundërshtim me nenin 12 i ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar “*Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues*”, cilësohet se “*Nëpunës zbatues i njësisë publike është drejtuesi i strukturës përgjegjëse për financat e njësisë publike, në vartësi direkte nga nëpunësi autorizues i njësisë dhe që ka përfunduar studimet e ciklit të dytë në shkencat ekonomike ose diplomë universitare të ekuivalentuar me të, me përvojë pune jo më pak se pesë vjet në profesion. Nëpunësi zbatues emërohet në njësi, sipas kuadrit ligjor në fuqi, duke respektuar plotësimin e kërkesave të kësaj pike*”. Referuar Strukturës së miratuar nga Kryeministri me urdhrin nr. 30, datë 13.03.2017 “*Për miratimin e Strukturës dhe Organikës së Spitalit Universitar të Traumës*” nëpunësi zbatues nuk është në varësi direkt nga nëpunësi autorizues i cili është drejtori i Spitalit por është në varësi nga Zv/ Drejtori zj. A.H.

Nëpunësi zbatues i njësisë publike është përgjegjës dhe i raporton nëpunësit autorizues të njësisë publike për garantimin e cilësisë së dokumentit përfundimtar të buxhetit dhe bashkërendimin e punës gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit të njësisë publike, në rolin e sekretarit të grupit të menaxhimit strategjik të njësisë publike dhe raportimit periodik për vendimmarrjen, në funksion të realizimit të objektivave, si dhe të pasqyrave financiare vjetore të njësisë publike, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe rregullat e miratuara nga Ministri i Financave.

c. Stili i të vepruarit dhe filozofia e menaxhimit. Në bazë ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, ligjit për menaxhimin e sistemit buxhetor, ligjit për prokurimin publik, ligjit për kontabilitetin, si dhe të dispozitave ligjore të kodit të punës etj. Titullari i i institucionit, në rast të shkeljes së normave ligjore apo, të rregullave ka të drejtë të ndërmarrë hapat e duhura, duke propozuar masa disiplinore dhe administrative për punonjësit, deri në largim nga puna. Lidhur me delegimin e kompetencave, nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues dhe menaxherë të tjerë të njësisë, kanë të drejtë të delegojnë disa nga të drejtat dhe detyrat e tyre, referuar ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*” i ndryshuar, neni 15 “*Rregulla të përgjithshme për delegimin e detyrave*”, si dhe Kapitulli III “*Delegimi i detyrave*”, të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, njësia, institucioni nuk ka rregulla të



brendshme të miratuara nga titullari, të cilat trajtojnë delegimin e detyrave dhe mënyrën e dokumentimit të tyre. Struktura dhe procedurat e brendshme garantojnë që të gjithë punonjësit të mbikëqyren në kryerjen e detyrave të tyre nga drejtuesit dhe struktura aktuale e këtij viti nuk është plotësisht e përshtatshme për realizimin e objektivave të caktuara.

d. Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore.

Në rregulloren e brendshme të institucionit, ky institucion ka përcaktuar rregullat e funksionimit të brendshëm lidhur me strukturën organike, të drejtat dhe detyrimet e punonjësve, marrëdhëniet ndërmjet strukturave të njësisë, shkeljet disiplinore, orarin dhe kohën e punës, etj., është bërë vlerësimi vjetor i punës për çdo punonjës, i cili është bashkëlidhur dosjeve personale të punonjësve.

Për ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të punonjësve gjatë viteve të objekt auditimit, në Spitalin Universitar të Traumës nuk janë organizuar trajnime për rritjen e kapaciteteve profesionale të punonjësve për tu njohur dhe shkëmbyer përvojë mbi praktikat më të mira në fushën e Informacionit. Ky institucion nuk ka program specifike për trajnimin e punonjësve të administratës, në kundërshtim me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. II, pika 2.5.1 “*Mjedisi i kontrollit (ose mjedisi i brendshëm i njësisë)*”, paragrafët “*Politikat dhe praktikat që lidhen me burimet njerëzore*” dhe “*Profesionalizmi i stafit*”.

2. Menaxhimi i riskut.

Menaxhimi i riskut është procesi i identifikimit, vlerësimit dhe monitorimit të riskut. Pas planifikimit të fondeve buxhetore, institucioni analizon dhe bën kontrollin e risqeve, të cilët mund të venë në rrezik realizimin e treguesve buxhetore. Në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*”, i ndryshuar neni 11 “*Përgjegjshmëria menaxheriale e menaxherëve të tjerë të njësisë*”, pika 2, si dhe në Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, kapitulli III, pika 2.5.2 “*Menaxhimi i Riskut*”, ky institucion për periudhën objekt auditimi nuk ka përcaktuar menaxherin e riskut gjithashtu nuk kanë hartuar Strategjinë e Menaxhimit të riskut si dhe regjistrin e riskut për PP i miratuar nga nëpunësi autorizues, duke mos bërë rivlerësim dhe ri kontrollin e risqeve, të cilat venë në rrezik arritjen e objektivave. Punonjësit e SUT për periudhën objekt auditimi, nuk kanë zhvilluar asnjë trajnim për menaxherët apo stafin të cilët janë përgjegjës për menaxhimin financiar dhe kontrollin, duke përfshirë trajnimin lidhur me aktivitetet e kontrollit të brendshëm hartimin e regjistrit të riskut si dhe të nxitjen ndaj parregullsive, t’i raportojnë ato si dhe hartimi mbi masat për parandalimin e këtyre risqeve.

3. Aktivitetet e kontrollit.

Aktivitetet e kontrollit janë rregullat, procedurat dhe veprimet që kanë si qëllim reduktimin e risqeve me synim arritjen e objektivave. Proceset kryesore të punës janë të shkruara në rregulloren e brendshme dhe në bazë të strukturës së miratuar ekziston dhe ndarja e detyrave. Nëpunësi autorizues në bazë të ligjit për buxhetin merr përsipër angazhimet për realizimin e programit buxhetor. Referuar ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*”, i ndryshuar neni 16, Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. III “*Procesi i implementimit të Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit*”, pika 3.2 “*Cikli i MFK-se*”, Hapi 5 “*Gjurmët e auditimit*”, “*Mbi gjurmën e auditimit*” nuk ka hartuar gjurmët e auditimit që ka si qëllim, të ndihmojë menaxhimin për të vlerësuar përshtatshmërinë e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, të identifikojë boshllëqet, etj.

Për të plotësuar nevojën për informacion, njësia ka instaluar sistemin e IT-së, ku kompjuterët janë të lidhur me serverin në brendësi të tij. Kontrolli i sistemit realizohet kryesisht për të siguruar mirëfunksionimin e këtyre elementeve kryesor dhe të gjithë elementeve të tjerë që lidhen me to.

4. Informim komunikimi.

Informimi është baza e komunikimit që nevojitet për kryerjen me cilësi të detyrave të ngarkuara. Komunikimi me titullarin dhe nëpunësit e tjerë duhet bërë në formën dhe kohën e duhur për ti ndihmuar ata në përmbushjen e detyrave dhe të përgjegjësi. Menaxherët e njësisë zotërojnë informacion por jo të mjaftueshëm për qëllimet dhe rëndësinë e menaxhimit financiar dhe të



kontrollit pasi, zbatimi i ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, *nuk është respektuar nga të gjithë hallkat e njësisë dhe se, institucioni nuk ka kryer trajnime për kuptimin dhe zbatimin e ligjit.*

Nëpërmjet raportimit tek eprori i drejtpërdrejtë, sigurohet dhe komunikimi mbi parregullsitë dhe problemet e mundshme por, njësia nuk ka hartuar një procedurë për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve dhe analizën e tyre.

Punonjësit brenda institucionit komunikojnë me postë elektronike dhe në mënyrë verbale ndërsa, jashtë institucionit komunikohet kryesisht në formë shkresore zyrtare dhe ka korrespondencë të rregullt me subjektet kryesore të jashtme, pa përjashtuar komunikimin elektronik dhe atë telefonik.

5. Monitorimi.

Monitorimi është tërësia e proceseve të rishikimit të aktivitetit të njësisë, i cili synon të afrojë garanci të arsyeshme se aktivitetet e kontrollit funksionojnë sipas qëllimit për të cilin janë ngritur. Titullarët e njësisë publike (Na), janë përgjegjës për ngritjen dhe zbatimin e një sistemi për monitorimin e MFK-së, me qëllim vlerësimin e funksionimit të tij në mënyrën e duhur, si dhe rifreskimin e tij në kohën e duhur kur ndryshojnë rrethanat. Monitorimi i kontrollit të brendshëm duhet të garantojë se të gjitha problemet e identifikuar, trajtohen që në momentin në të cilin zbulohen, por edhe se rezultatet dhe rekomandimet e AB apo vetëvlerësimit merren në konsideratë dhe analizohen nga ana e titullarit. Për të mbështetur monitorimin e rregullt, drejtuesit e njësisë duhet të ngrenë një sistem të raportimit të brendshëm të risqeve të identifikuar, nën drejtimin e KR duke garantuar një raportim në afat, të shpeshtë (*p.sh. në bazë tremujore*) dhe gjithëpërfshirës. Nga auditimi mbi hartimin dhe zbatimin e raporteve të monitorimit si mbi vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, vlerësimit të risku apo raportet 4-mujore të dhe raporti vjetor i monitorimit lidhur me zbatimin e buxhetit, grupi i auditimit konstatoi institucioni nuk ka hartuar, miratuar dhe dorëzuar tek Ministria e Mbrojtjes e cila ka si funksion planifikimin dhe akordimin e fondit për SUT.

Menaxherët dhe punonjësit e njësisë, duke mos pasur njohuritë e duhura për ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin, si dhe duke mos kryer trajnime për kuptimin dhe zbatimin e ligjit, nuk mund të bëjnë siç duhet vlerësimin e efektivitetit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

VII. Auditimi mbi funksionimin e Auditimit të brendshëm.

Në zbatim të pikës **mbi vlerësimin e auditit të brendshëm** të programit të Auditimit, Grupi i Auditimit u fokusua në çështjet e mëposhtme:

- a) *Organizimi dhe funksionimi i Njësisë së Auditit të Brendshëm. Niveli profesional i audituesve, certifikimi i tyre dhe trajnimet e detyrueshme.*
- b) *Bashkëpunimi me Drejtorinë e Harmonizimit të Auditit të Brendshëm në Ministrinë e Financave, niveli i raportimit në këtë drejtori.*
- c) *Realizimi i treguesve të planifikuar nga NJAB.*
- d) *Auditim me zgjedhje mbi praktika të auditimeve të kryera nga NJAB, Zbatimi i akteve ligjore dhe nënligjore në fushën e auditimit të brendshëm, standardet dhe manualët dala në zbatim të tyre.*

Veprimtaria e NJAB gjatë vitit 2016, është vlerësuar mbështetur në ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, Manualin e Auditit të Brendshëm miratuar me Urdhrin e Ministrit nr. 100, datë 25.10.2016, ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Urdhër i Ministrit të Financave nr. 8980, datë 15.07.2010 “Manual për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

Njësia e Auditimit të Brendshëm është ngritur si strukturë në shtator të vitit 2016 në bazë të strukturës organike të miratuar të SUT-s për vitin 2016, nga Kryeministri me urdhrin nr. 95, datë 07.06.2016, financimi i pagave kryhet nga dy Ministrinë, nga Ministria e Mbrojtjes dhe nga Ministria e Shëndetësisë (FSDKSH) ka funksionuar me 3 punonjës, nga të cilët një drejtues i NJAB dhe 2 specialistë.

Planifikimi vjetor 2017 për Auditin e Brendshëm

- Njësia e Auditimit të Brendshëm, ka hartuar Planin strategjik të auditimit. “për periudhën 2017-2021”, pika 2.2 “Plani vjetor i auditimit” dhe pika 2.3 Afati i përgatitjes dhe miratimit të planit strategjik dhe planit vjetor i miratuar nga drejtori i SUT -s, por nuk identifikohet afati i dërgimit në NJQHAB, që është jo më vonë se data 15 tetor të çdo viti ,bazuar në ligjin nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, neni 14 germa c, “Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kap. II, pika 2.1 “Plani strategjik i auditimit”, pika 2.2 “Plani vjetor i auditimit” dhe pika 2.3 “Afati i përgatitjes dhe miratimit të planit strategjik dhe planit vjetor”, për vitin 2017 miratuar nga drejtori i SUT -s me shkresën nr. 48//1, datë 09.02.2018 dhe dërguar një kopje e raportit vjetor të veprimtarisë së vitit 2017 në Njësine Qendrore të Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm në Ministrinë e Financave, Përgatitja e dokumenteve të mësipërm nga Audituesit e Brendshëm dhe hartimi i një plan strategjik të Auditimit të Brendshëm bën të mundur mbulimin e risqeve kryesore gjatë periudhës disa vjeçare (zakonisht pesë vjeçar).

Ky programi strategjik ka përfshirë: Qëllimin dhe objektivat kryesore; Prioritetet dhe fokusimi i veprimtarisë audituese; Llogaritja e burimeve të kërkuara për auditimin e brendshëm; Kufizimet e auditimit; Plani i zhvillimit profesional për auditet dhe trajnimet shtesë.

Plani vjetor i auditimit përfshin; Objektivat Vjetore.; Përmbledhja e veprimtarisë për vitin 2017; Programimi i veprimtarive; Rreziqet e mundshme në kushtet e realizimit të programit vjetor; Burimet e auditimit; Kufizimet e mundshme të qëllimit të auditit; Kostot e auditimit

Për hartimin e planit strategjik, njësia nuk ka plotësuar formatet standard si:

- Pyetësor për planin strategjik (Të kuptosh procedurat e auditimit të brendshëm.)
- Përmbledhje e risqeve të identifikuar.
- Identifikimi i sistemit për subjektet.
- Lidhja midis riskut dhe punës së planifikuar të auditimit.
- Pyetësor vlerësimi për kontrollin e brendshëm

Në raportimin vjetor këto formate standart rezultojnë të plotësuara dhe dërguara në Njësine e Harmonizimit të Auditit të Brendshëm.

Në planin punës për vitin 2017 njësia e Auditimit të Brendshëm nuk ka një vlerësim të thelluar të fushave me risk të lartë për të cilat duhet të parashikohej dhe auditimi i tyre, si dhe frekuenca e tyre bazuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm, pika 2.6. Faza E Tretë – Konsolidimi i Punës së Planifikimit “Frekuenca”, ku citohet: “...Për sisteme të cilat vlerësohen me një nivel të lartë risku plani strategjik i auditimit duhet të parashikojë auditimin me një frekuencë më të shpeshtë –zakonisht një vit, ndërkohë që sistemet me nivel të ulët të riskut mund të parashikohen për tu audituar me rrallë”.

Në planin vjetor, njësia ka hartuar planin e subjekteve për tu audituar në vitin 2017, planifikimin e kostove të njësise, etj. Në Planin Vjetore të Njësise së auditimit të brendshëm janë bërë përpjekje nga ana e audituesve të brendshëm për të identifikuar dhe vlerësuar risqet kryesore për veprimtarinë e SUT-s. Por theksojmë se Plani i auditimit duhet të përgatitet mbi bazë risku – e thënë ndryshe Auditimi i Brendshëm fokusohet në ato sisteme/fusha ku gjërat kanë të ngjarë të mos bëhen siç duhen ose siç janë parashikuar.

Më poshtë po paraqesim numrin e auditimeve të planifikuara, krahasuar me ato të realizuara:

Periudha	Të planifikuara	Të realizuara gjithsej në 2017	Auditime Përputhshmërie	Auditime të Kombinuara
2017	15	13	1	-

Nga treguesit e mësipërm rezulton se, për periudhën objekt auditimi, për Aparatin e institucionit, është planifikuar gjithsej 1 mision auditimi i përputhshmërisë që përfshin 15 fusha auditimi. Në fakt janë realizuar është realizuar ky mision auditimi, por janë lënë janë jashtë fushës së auditimit çështje lidhur me Auditimin mbi administrimin e pronës së SUT-s .



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN UNIVERSITAR TË TRAUMËS”

- Në bazë të ligjit dhe manualit për auditimin e brendshëm në sektorin publik, për periudhën objekt auditimi, Njësia e Auditimit të Brendshëm ka hartuar planin e auditimit dhe mbi bazën e tij ka realizuar auditimin. Për kryerjen e auditimit në zbatim të manualit të auditimit, janë hartuar programet e auditimit për çdo fushë të audituar. Programi i Auditimit përmban: Llojin e auditimit, metodën, teknikën e kryerjes së auditimit, grupin e auditimit, afatin e auditimit, periudhën e audituar, qëllimin e auditimit, objektivi i auditimit, sistemet të cilat do të auditohen, bazën ligjore Për periudhën objekt auditimi, Drejtoria e Auditimit të Brendshëm ka konstatuar 2 gjetje me dëm ekonomik, në fushën e prokurimit publik organizimi i konferencës së Traumës si dhe në realizimin e kontratës së vitit 2010.

Gjatë vitit 2017 NJAB, për përmirësim të mangësive të konstatuara ka rekomanduar gjithsej 10 rekomandime për përmirësimin dhe korrigjimin e mangësive të konstatuara. Shkalla e zbatimit të rekomandimeve deri në mbyllje të periudhës së raportimit, paraqitet si më poshtë:

Realizimi i rekomandimeve 2017

Nr	Viti	Të rekomanduara	Të pranuar	Të zbatuara	Në proces	Realizimi %
1	2017	10	10	-	10	-

- Nga analiza e raportit të auditimit konstatohet se sistemet dhe fushat që auditimi i brendshëm ka vlerësuar një nivel të lartë/mesëm risku përfshijnë sistemet e prokurimeve, sistemet e menaxhimit të burimeve njerëzore, sisteme të tjera sipas qëllimit dhe misionit të njësive publike, të cilat shfaqen me dobësi të theksuara në sistemin e kontrollit të brendshëm si dhe me mangësi në kuadrin rregullator e procedural brenda vetë subjektit publik.

- Nga verifikimi i dosjes së auditimit për vitin 2017 e cila është një por që përfshin 15 fusha të veprimtarisë së SUT rezultoi:

Auditimi është kryer në baze të plan-veprimit të auditimit të miratuar nga Drejtori i Spitalit të Traumës Nr. 438/2, datë 06.06.2017, me objekt Shqyrtimi dhe vlerësimi i aktiveve të operacioneve, proceseve, politikave dhe sistemeve për të siguruar përdorim ekonomik dhe efikas të burimeve, zbatimi i ligjshmërisë dhe rregullave, përdorimi ekonomik dhe efikas i burimeve. Ky lloj auditimi është i përfshirë në planin vjetor të njësisë së auditimit të brendshëm të SUT.

Njësia e auditimit të SUT auditoi aktivitetin e SUT për periudhën e vitit 2017, duke i kushtuar vëmendje çështjeve që kane të bëjnë me zbatimin e kuadrit ligjor në fushën e planifikimit dhe të realizimit të buxhetit, si prokurimet me fondet publike, Vlerësimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, sistemimin e kontabilitetit, ruajtja dhe administrimi i aseteve.

Auditimi është kryer nga: M.R Shefe e sek. Auditimit; H.A Specialist ne sektorin e auditimit; A.S Specialist në sektorin e auditimit. Auditimi ka filluar në dt. 10.04.2017 dhe ka përfunduar me, 30.10.2017.

Projekt raporti është hartuar dhe protokolluar me nr. 532 datë 15.11.2017. për të cilin janë paraqitur observacionet nga personat dhe drejtoritë e sektorët e atakuar në të.

Përgjithësisht observacionet kanë gjetur pasqyrim dhe janë reflektuar në raportin përfundimtar. Rekomandimet e lëna në Raportin Përfundimtar janë përmirësuar nga rekomandimet e lëna në Projekt raportin e Auditimit. Në raportin përfundimtar janë marrë parasysh observacionet e dërguara nga punonjësit e institucionit i audituar dhe janë dhënë sqarimet se pse është marrë parasysh ky kundërshtim nga NJAB.

Nga shqyrtimi i dosjes së auditimit vërehet se përgjithësisht nga NJAB janë respektuar procedurat e auditimit sipas Manualit të Auditimit të Brendshëm.

Por duhet të theksojmë se në planifikimin e angazhimit të auditimit, NJAB për çdo njësi objekt auditimi duhet të hartojë një program dhe kohë të caktuar auditimi.

Programimi dhe realizimi i një misioni të vetëm për gjithë njësitë që operojnë brenda SUT, kërkon kohë shumë të gjatë për auditim si dhe faktikisht ka ndodhur ku nga muaji mars që ky mision është parashikuar dhe ka përfunduar në muajin dhjetor 2017, dhe nuk sjell efektivitetin e pritshëm për parandalimin në kohë dhe përmirësimin e punës së kryer nga administrimi i SUT-s.



IV. Gjetjet nga Auditimi dhe rekomandimet.

B. MASA ORGANIZATIVE:

B/1. Gjetje nga auditimi aktual kryer në bazë të programit të auditimit nr. 68/1, datë 23.01.2018.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi inventarizimin e aktiveve, konstatohet se në SUT bazuar në kontratat e lidhura nga Ministria e Shëndetësisë referuar Marrëveshjes së kredisë nr. 8098.6 “*Fuqizimi i Qendrës së Traumës*” mes Qeverisë Shqiptare dhe asaj Italiane ka vijuar zbatimi i kontratave të furnizimit me pajisje mjekësore në shumën 613,415,047 lekë si dhe pajisje hotelerie në shumën 93,662,526 lekë. Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga SUT, procesverbaleve të marrjes në dorëzim, kolauditimit dhe instalimit të tyre, rezulton se këto pajisje kanë ardhur dhe qëndruar në ambientet e SUT nga muaji mars i vitit 2017 deri në muajin qershor 2017 dhe nuk kanë qenë në përgjegjësinë e asnjë personi të SUT. (procesverbali i parë i marrjes në dorëzim datë 09.06.2017)

- Këto pajisje janë bërë hyrje në magazinë pa çmime dhe pa fature shitje etj. Administrimi i tyre në librat e magazinës kryhej pa përshkruar asnjë të dhënë specifike, kod ose prodhues të pajisjes me qëllim identifikimin dhe shmangien e tjetërsimit të tyre.

- Pajisjet e Hotelerisë janë marrë në dorëzim në muajin gusht nga komisioni i ngritur për marrjen në dorëzim të tyre, këto pajisje janë bërë hyrje në magazinë vetëm në muajin tetor 2017, deri në këtë periudhë këto pajisje nuk kanë qenë në përgjegjësinë e askujt dhe nuk është kryer asnjë nga procedurat e parashikuara në Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”.

Rekomandojmë:

Nga ana e SUT, të merren masa të menjëhershme që pajisjet mjekësore dhe pajisjet e hotelerisë të ardhura nga kontrata e furnizimit të Marrëveshjes së kredisë nr. 8098.6 “*Fuqizimi i Qendrës së Traumës*” mes Qeverisë Shqiptare dhe asaj Italiane me qëllim mirë administrimin, identifikimin dhe shmangien e tjetërsimit të tyre, të pajisen me barcode të identifikueshëm me shënimin “*pajisje pronë e SUT*”.

Regjistrimi i tyre në librat e magazinës të kryhet duke përshkruar të dhënat specifike, kodet dhe prodhuesi i pajisjes, gjithashtu në çdo pavion të SUT të afishohen pasqyrat e inventarit me pajisjet, materialet në ngarkim të çdo punonjësi përgjegjës për administrimin e tyre.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet nga SUT gjatë vitit 2017 janë nxjerrë jashtë përdorimit aktive në vlerën **49,854,683** lekë. Referuar procedurës dhe procesverbaleve të nxjerrjes jashtë përdorimi dhe asgjësimit nga ana e SUT për asgjësimin e këtyre materialeve nuk ka asnjë dokumentacion lidhur me procedurën e kryer nga komisioni i asgjësimit, si vlerësimi dhe ndarja e materialeve sipas destinacionit të tyre, materiale për ankand ose materialeve që duhet të groposen, mjetin e transportit i cili ka kryer transportin e tyre, si dhe vend ndodhjen e groposjes së tyre, djegien etj. të shoqëruar me fotot përkatëse, duke mos e faktuar nxjerrjen jashtë përdorimi dhe asgjësimin e materialeve në vlerën 49,854,683 lekë në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”.

Komisionet e Vlerësimit të Aktiveve dhe nxjerrjen jashtë përdorimit, në përfundim të procesit të inventarizimit të aktiveve të SUT, nuk kanë përpiluar një raport përmbledhës mbi rezultatin e inventarëve duke krahasuar gjendjen kontabël me atë fizike të raportuar nga komisionet e inventarizimit të aktiveve në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”.

Rekomandojmë:



- Nga SUT të merren masa që kryerja e inventarëve të aktiveve, nxjerrja jashtë përdorimit dhe asgjësimi i tyre, duhet të shoqërohen me procesverbalet e nxjerrjes jashtë përdorimit dhe asgjësimit të aktiveve, bashkëlidhur me dokumentacionin mbi procedurën e kryer për vlerësimin dhe ndarjen e materialeve sipas destinacionit të tyre, për ankand, gruposje, vend ndodhjen e gruposjes së tyre, djegien etj, shoqëruar me fotot përkatëse, mjetin e transportit i cili ka kryer transportin e tyre, duke e dokumentuar nxjerrjen jashtë përdorimit dhe asgjësimin e materialeve në përputhje me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

- Komisionet e Vlerësimit të Aktiveve dhe nxjerrjen jashtë përdorimit, në përfundim të procesit të inventarizimit të aktiveve të përpilojnë një raport përmbledhës mbi procedurën e ndjekur për vlerësimin e aktiveve për nxjerrje nga përdorimi, arsyet, efektin ekonomik të masave për riaftësimin e tyre dhe propozimin përkatës.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i Shpenzimeve për karburant e lëndë djegëse, rezulton se konsumi i tyre kryhet sipas normativave të harxhimit të miratuara në vitin 2010, nga Brigada e Logjistikës e Ministrisë së Mbrojtjes pa u rifreskuar me normativa të reja referuar dhe amortizimit. Me urdhrat përkatës të drejtorit të SUT për vitin 2016 dhe 2017 është vendosur që për ambientet e SUT (*Pavionet, Urgjenca e Politraumës dhe Poliklinika*) duke filluar nga data 15 e muajit nëntor deri në 15 mars të vitit respektiv, **ngrohja të kryhet për 4 orë në ditë** nëpërmjet ndezjes së kaldajës qendrore e cila funksionin me lëndë djegëse e llojit naftë, me orar të reduktuar prej dy orësh në mëngjes 06⁰⁰-08⁰⁰ dhe në mbrëmje nga ora 18⁰⁰-20⁰⁰. Për të dy vitet konsumi i lëndës djegëse arrin rreth 11700 litra, shpenzim që nuk garanton ngrohjen e gjithë ambienteve dhe ofron kushte minimale hospitalizimi duke cenuar sigurinë e shëndetit të pacientëve.

Rekomandojmë:

Nga SUT të merren masat për rifreskimin e normativave të harxhimit të karburanteve dhe lëndëve djegëse referuar dhe normave të amortizimit. Gjithashtu të merren masat për sigurimin e sasisë së mjaftueshme të lëndës djegëse për funksionimin e kaldajës me orar të plotë për të garantuar ngrohjen e gjithë ambienteve të SUT-së dhe ofruar kushte optimale hospitalizimi për të garantuar sigurinë e shëndetit të pacientëve.

Në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga FSDKSH janë likuiduar 81,098,160 lekë për shërbimin e periudhës shtator dhjetor 2017 në zbatim të kontratës e koncesionit/PPP nënshkruar nga MSH në korrik 2015 me kompaninë “S” sh.p.k “Për ofrimin e shërbimeve të integruara të furnizimit të setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale sterile, furnizim me material mjekësor steril të një përdorimesh në sallat kirurgjikale, trajtimin e mbetjeve me rrezik biologjik dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikale” shërbim për të cilin nuk ka asnjë monitorim apo dhe konfirmim nga SUT, të llojit të ndërhyrjes, numrit të operacioneve të kryera, për të cilat koncesionari paguhet nga FSDKSH. Në bllokun operator vetëm kryheshin rakordime mbi setet e përdorura për çdo ditë, i cili firmosej nga Kryeinfermieri i pavionit dhe personi i autorizuar i koncesionarit. Mos kryerja e monitorimit dhe mos konfirmimi i shërbimit është në kundërshtim me Pikën 11 të kontratës “Raportime”.

Rekomandojmë:

Nga SUT të merren masat përkatëse për monitorimin, konfirmimin e shërbimit në zbatim të kontratës së koncesionit/PPP “Për ofrimin e shërbimeve të integruara të furnizimit të setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale sterile, furnizim me material mjekësor steril të një përdorimesh në sallat kirurgjikale, trajtimin e mbetjeve me rrezik biologjik dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikale” të llojit të ndërhyrjes, numrit të operacioneve të kryera. Të njoftojë koncesionarin në lidhje me shërbimet e përfituara me një informacion



ditor ku të përfshijë ndër të tjera, numrin identifikues, tipin e ndërhyrjes, datën, klasifikimin e ndërhyrjes, konsumin e materialit integruar të kryer nga Struktura Spitalore, e cila duhet të verifikohet nga palët në bazë të aktiviteteve që janë kryer efektivisht brenda çdo salle operatore sipas përcaktimeve në kontratë.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: SUT ka lidhur marrëveshje kuadër për “furnizimin me pajisje ortopedike për operacionet” që kryen në këtë spital për periudhën 2016-2018. Nga audituesit u përzgjedhën disa komponentë të pajisjeve ortopedike (të cilat janë dhe më të kushtueshme) për të cilat u verifikuan procedura e administrimit të tyre, kërkesa që hartohet nga blloku operator i ortopedisë, furnizimi nga operatori ekonomik, marrja në dorëzim nga Farmacia e SUT-së si dhe verifikimi me librin e Kryeinfermierit për operacionet e kryera dhe vendosjen e pajisjes në trupin e pacientit. Nga kryqëzimi i këtyre dokumenteve rezultoi se pajisjet janë bërë hyrje bazuar në faturat e shitjes, në përmbajtje të të cilave janë përshkrimi i produktit, sasi, çmimi, vlerën e faturës në total si dhe kodet përkatëse të këtyre pajisjeve. Bazuar në këto kode u bë verifikimi i pajisjeve që bëheshin dalje nga farmacia drejt sallës operatore me fletëdaljet përkatëse nënshkruar nga farmacistja si dhe nga marrësi i produktit kryeinfermieri i bllokut operator ku u konstatua se kodi i pajisjes i bërë hyrje në farmaci dhe për të cilin është paguar furnizuesi nuk korrespondon me kodin e pajisjes së vendosur në trupin e pacientit.

Rekomandojmë:

Nga SUT të merren masat për të ndjekur e zbatuar procedurat e administrimit të pajisjeve ortopedike për operacionet, duke filluar nga kërkesat që hartohen nga blloku operator i ortopedisë, furnizimi nga operatori ekonomik, marrja në dorëzim nga Farmacia e SUT-së, shënimet në librin e Kryeinfermierit për operacionet e kryera dhe vendosjen e pajisjes në trupin e pacientit duke respektuar përshkrimin e produktit, sasi, çmimin, vlerën si dhe kodin e pajisjeve të furnizuara me ato të vendosura në trupin e pacientëve.

Në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Për vlerën e furnitorëve nuk është dërguar letër konfirmimi për llogaritë e pagueshme, për të verifikuar nëse vlerat e tyre janë në përputhje me shënimet e kontabilitetit. Mosrakhordimi me furnitorët mundëson edhe pagesa të parregullta, si dhe prezantimin jo të saktë dhe të plotë të detyrimeve në pasqyrat financiare.

Rekomandojmë:

Drejtuesit SUT, në miratimin e pasqyrave financiare, duhet të rishikojnë nëse janë marrë masat e nevojshme për njohjen reale të detyrimeve sipas standardeve të kontabilitetit. Me qëllim të shmangies së gabimeve, duhet të bëhet harmonizimi i llogarisë së kontabilitetit me furnitorët duke trajtuar saktësinë dhe plotësinë e këtyre llogarive.

Në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare rezultoi se Format 12 “Pyetësor dhe shënime shpjeguese” është plotësuar, relacioni shpjegues për pasqyrat financiare, por nuk janë përfshirë të gjitha informacionet shpjeguese që kërkohen, në pajtim me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar ku të japin informacionet shpjeguese të nevojshme për të arritur paraqitjen e drejtë.

Rekomandojmë:

Të merren masat për plotësimin e pasqyrave financiare me pyetësorët dhe relacionin shpjegues për pasqyrat financiare ku të përfshihen të gjitha informacionet shpjeguese që kërkohen për të arritur paraqitjen e drejtë në pajtim me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar.

Në vijimësi



8. Gjetje nga auditimi: Nga SUT nuk janë hartuar raportet e monitorimit të shpenzimeve për vitin 2016 dhe 2017, me informacionin e plotë me shpjegimet përkatëse lidhur me ndryshimet e PBA, buxhetit nga plani fillestar deri në atë përfundimtar, në nivel programi dhe artikulli, lidhur me ndryshimet e planit të produkteve, si në sasi dhe në vlerë në përputhje me Udhëzimet e Ministrit të Financave për zbatimin e buxhetit të shtetit. Mungon një analizë me argumentet e plota në lidhje me mosrealizimin e produkteve dhe masat që parashikohen në të ardhmen për realizimin e tyre.

Nuk është e paraqitur Performanca e produkteve e lidhura me realizimin e objektivave dhe politikës së programit ku të shpjegohej cilat ishin objektivat sipas PBA, politikat e çdo programi si dhe sa janë realizuar këto objektiva në kundërshtim me udhëzimin e MF nr. 22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore” si dhe referuar nenit 24 “Monitorimi i ligji nr. 10296 datë 08.07.2010 i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 “Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin”.

Rekomandojmë:

Nga SUT të hartohen Raportet e Monitorimit për zbatimin e buxhetit, të cilat duhet të përmbajnë një informacionin të plotë me shpjegimet përkatëse lidhur me ndryshimet e PBA, e buxhetit, nga plani fillestar deri në atë përfundimtar, në nivel programi dhe artikulli, lidhur me ndryshimet e planit të produkteve, si në sasi dhe në vlerë në përputhje me Udhëzimet e Ministrit të Financave për zbatimin e buxhetit të shtetit.

Në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Midis SUT dhe subjektit “A.H” sh.a. është lidhur kontrata e qirasë dt. 30.08.2013 për përdorimin sipas nenit nr. 1, “objekti i kontratës” për sipërfaqen 496 m².

- Ky subjekt për periudhën objekt auditimi (01.10.2015 deri 31.03.2018 gjithsej 30 muaj) i detyrohet SUT qira e papaguar për sipërfaqen e përdorur, okupuar prej 1200 m² (1696 m²–496 m² = 1200 m²) referuar kontratës së datës 28.08.2013 e cila rezulton si më poshtë. Periudha 01.10.2015 deri 31.03.2018 gjithsej 30 muaj. Sipërfaqja e okupuar, përdorur 1200 m² x 300 lekë/m² në muaj = 360,000 lekë x 30 muaj = **10,800,000** lekë.

- Ky subjekt përdor dhe një sipërfaqe prej 222.3 m², të cilën e ka ndërtuar mbi ambientet ekzistuese të spitalit, për të cilin institucioni nuk ka dokumentacion, si leja ndërtimore apo kontratë, po kështu ka ndërtuar dhe një urë lidhëse ndërmjet godinës së tij dhe spitalit, me sipërfaqe 45 m², ku edhe për të nuk ka dokumente në SUT. Konstatimi ynë bazohet në kartelën e pasurisë bashkëlidhur Certifikatës së pasurisë së datës 07.04.2015, ku përshkruhen 3 objekte pa leje apo “ndërtime të paligjshme”. Nëse do të përllogarisnim dhe përdorimin e sipërfaqes së ndërtuar nga vetë “A.H” sha për periudhën 01.10.2015 deri 31.03.2018 gjithsej 30 muaj për sipërfaqen e përdorur 267.3 m² x 300 lekë/m² në muaj = 80,190 lekë x 30 muaj = **2,405,700** lekë të ardhura të munguara për periudhën objekt auditimi.

-Gjithashtu për periudhën 01 dhjetor 2017 deri 31 mars 2018 subjekti ka përdorur sipërfaqe të ndërtuara mbi ambientet ekzistuese të spitalit, si platforma në nivelin e katit të parë me konstruksion çeliku në një sipërfaqe **160** m² dhe **42** m². Nëse do të përllogarisnim përdorimin e sipërfaqes së ndërtuar nga vetë “A.H” sha për periudhën e mësipërme prej 4 muaj për sipërfaqen e përdorur 202 m² x 300 lekë/m² në muaj = 60,600 lekë 4 muaj = **242,400** lekë të ardhura të munguara..

Nga SUT edhe në zbatim të rekomandimit të auditimit të mëparshëm të KLSH-së është dërguar shkresa nr. 1054, dt. 12.09.2017 kërkesë për prononcim e ridërguar me nr. 1486, dt. 13.12.2017 drejtuar Ministrit të Shëndetësisë, shkresa nr. 359, dt. 15.09.2017 kërkesë për prononcim e Ministrit të shëndetësisë dhe për dijeni ministrit të MZHETTS ku kërkohet; *Zgjidhja e statusit të sipërfaqeve të tepërta që administron subjekti “A.H” sha deri në lirimin e ambienteve ose lidhjen e kontratave për ambientet e shfrytëzuara jashtë kontratës. Zgjidhja e statusit të ndërtimeve pa leje dhe pa kontratë i sipërfaqeve të ndërtuara mbi objektet e SUT dhe pagesat për sipërfaqet shtesë dhe të përdorura pa kontratë, Pagesa e qirasë nga ana e shoqërisë “A.H”*



sha për periudhën nga viti 2011 e vazhdim, periudhë në të cilën ka vazhduar aktivitetin e saj në ambientet e SUT pa kontratë dhe pa paguar qira.

Rekomandojmë:

- SUT, për sipërfaqet e okupuara dhe ndërtimet mbi ambientet ekzistuese të Spitalit Universitar të Traumës nga “A.H” sh.a., për të cilat nuk ka dokumentacion, si leja ndërtimore ose kontratë, me qëllim mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme, në rast se subjekti “A.H” sh.a. nuk ka aplikuar për legalizim mbështetur në kuadrin ligjor në fuqi, ti drejtohet Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit bazuar në ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, Neni 5, “Detyrat e inspektoratit të mbrojtjes së territorit të njësisë vendore.
- Nga Spitali Universitar i Traumës, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale përgjegjëse për administrimin, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë në cilësinë e pronarit, të kërkohet zgjidhja e statusit të sipërfaqeve të okupuara nga subjekti “A.H” sh.a., dhe lirim të ambienteve.
- Në çdo rast nga SUT duhet të kërkohet arkëtimi i vlerave për sipërfaqet e okupuara nga subjekti “A.H” sh.a..

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi menaxhimin financiar në Spitalin Universitar të Traumës, ka rezultuar se organizimi dhe veprimtaria administrative, mbështeten në një rregullore të brendshme të vitit 2010. Nga SUT është përgatitur draft rregullorja e re, e cila nuk është miratuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Rekomandojmë:

Të punohet për plotësimet në draftin e rregullores së re, të miratohet brenda një afati të shkurtër, me qëllim përputhjen e saj me strukturat aktuale të funksionimit të Spitalit Universitar të Traumës.

Në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Gjatë viti 2016 dhe 2017 nga SUT janë kryer 31 procedura prokurimi për blerje medikamente dhe materiale mjekësore me fondin limit në vlerën 211,984,364 lekë pa tvsh nga të cilat 7 procedura prokurimi “Procedurë e hapur” në vlerën 55,914,310 lekë, 10 procedura prokurimi “Kërkesë për propozim” në vlerën 39,363,549 lekë, 14 procedura prokurimi “Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës” në vlerën 116,706,403 lekë, të cilat duhet ti kryente Ministria e Shëndetësisë dhe urdhrat e prokurimit e nxjerra nga SUT dhe autorizimet e MSH janë në kundërshtim me VKM nr. 135, datë 20.2.2013 “Për lejimin e Ministrisë së Shëndetësisë për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të institucioneve të varësisë, për disa mallra e shërbime” ku është përcaktuar: Lejimi i Ministrisë së Shëndetësisë, si organ qendror blerës, për kryerjen e procedurave të prokurimit, në emër dhe për llogari të spitaleve publike në varësi të saj, për blerjen e medikamenteve dhe materialeve mjekësore. Pika 4. Organi qendror blerës ka këto detyra dhe përgjegjësi: të zhvillojë procedurat për prokurimin e përqendruar të medikamenteve dhe materialeve mjekësore, për nevojat spitalore, përfshirë procedurat e prokurimit me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit.

Rekomandojmë:

- Nga SUT të merren masat, që në vijimësi, të lejojë Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si organi qendror blerës, për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të spitaleve publike në varësi të saj, për blerjen e medikamenteve dhe materialeve mjekësore, përfshirë procedurat e prokurimit me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit, në përputhje me VKM nr. 135, datë 20.02.2013 “Për lejimin e Ministrisë së Shëndetësisë për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të institucioneve të varësisë, për disa mallra e shërbime”.



- SUT të analizojë shkeljet dhe të nxjerrë përgjegjësinë për kryerjen e procedurave për blerje medikamente dhe materiale mjekësore në kundërshtim me VKM nr. 135, dt. 20.02.2013.

Në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: SUT ka kryer procedura prokurimi “*Procedurë me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit*” me vlerën limit 37,236,153 lekë për vitin 2016 dhe 79,470,250 lekë për vitin 2017 ku Njësia e prokurimit kanë hartuar relacionin drejtuar drejtorit të SUT “*Për përzgjedhjen e procedurës së prokurimit “Procedurë me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit” në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 36, “Procedura me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës” pika c) pasi nuk është e argumentuar nevojat ekstreme për materialet mjekësore e medikamentet dhe se neglizhenca apo vonesat në fillimin e procedurave normale të prokurimit nuk janë shkaqe, që argumentojnë zbatimin e kësaj procedure.*

Rekomandojmë:

- Nga SUT, Njësia e Prokurimit të merren masat në vijimësi që në përzgjedhjen e procedurës së prokurimit “*Procedurë me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit*” të argumentohet nevojat ekstreme për mallra dhe shërbime dhe se neglizhenca apo vonesat në fillimin e procedurave normale të prokurimit nuk janë shkaqe, që argumentojnë zbatimin e kësaj procedure, në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”.
- SUT të analizojë shkeljet dhe të nxjerrë përgjegjësinë për kryerjen e procedurave *me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës* pa argumentuar nevojën ekstreme për materialet mjekësore e medikamentet, në kundërshtim me VKM nr. 914, dt. 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”.

Në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Në Spitalin Universitar të Traumës (SUT), në cilësinë e Autoritetit Kontraktor (AK), Njësia e Prokurimit (NJP) nuk ka funksionuar më vete në përbërje të strukturës organike, por gjatë vitit, si anëtar të NJP-ve, caktohen punonjës të ndryshëm. Në këtë AK, ka zhvillime tenderash në një numër të konsiderueshëm dhe me procedura të ndryshme. NJP-ja ka shumë përgjegjësi sipas legjislacionit të prokurimit publik në fuqi. Nga NJP-të këto detyra nuk janë realizuar të gjitha dhe mangësitë e shkeljet e konstatuara, mund të ishin shmangur, shumica prej tyre, nëse NJP-ja do të funksiononte si strukturë më vete, si dhe po të ishin kryer edhe trajnimet e nevojshme pranë APP-së.

Rekomandojmë:

SUT, në varësi të burimeve njerëzore, që ka në dispozicion të shikojë mundësinë, për të ngritur funksionimin e strukturës së posaçme të prokurimit publik, e kjo në zbatim të nenit 57 “*Njësia e Prokurimit*” të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, me qëllim edhe të sigurimit të mirë përdorimit të fondeve publike dhe të uljes së shpenzimeve procedurale duke rritur efikasitetin, ekonomikitetin dhe efektivitetin në procedurat e prokurimit publik.

Në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Formularët e Deklarimit të Konfliktit të Interesit, nuk janë plotësuar nga anëtarët e KVO-ve, në afatin kohorë të momentit të hapjes së ofertave nëpërmjet platformës elektronike të faqes së APP-së. Këto deklarata janë plotësuar dhe nënshkruar me datën e daljes së urdhër prokurimit, në një kohë, që ofertat hapen nga KVO-të mbas disa ditëve (*datat e caktuar për dorëzimin e ofertave*). Kështu që deklaratimet përkatëse nuk janë bërë për pjesëmarrësit në konkurrim, pasi këto pjesëmarrës në prokurim njihen vetëm në ditën e hapjes së ofertave nëpërmjet platformës elektronike të faqes së APP-së.

Rekomandojmë:



Anëtarët e KVO-ve të plotësojnë dhe nënshkruajnë deklaratën e konfliktit të interesit vetëm në datën e dorëzimit të ofertave (*hapjes së zhvillimit të procedurës së vlerësimit të dokumenteve të OE nëpërmjet faqes së APP-së*).

Në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Për të gjithë tenderat e audituar, NJP-të nuk kanë evidentuar marrjet në dorëzim të paketave të dokumenteve të fitueseve të tenderave, para se të lidhen kontratat përkatëse. Mos kryerja e këtij është në kundërshtim me LPP, Kreu II, neni 12 “*Përgjegjësia e autoritetit kontraktor*”, pika 3, si dhe VKM nr. 914, datë 29/12/2014, i ndryshuar, neni 64.

Rekomandojmë:

Titullari i AK, të marri të gjitha masat për të ardhmen, që para se të lidhen kontratat me fituesit e tenderave, të nxjerrë urdhrin për NJP për ti kontrolluar të gjitha praktikat dokumentare të paraqitur fizikisht me ato me ato të raportuara në platformën elektronike të faqes së APP-së dhe ti dokumentojnë marrjet e tyre në dorëzim nga OE fitues i tenderit, konform legjislacionit të prokurimeve.

Në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i regjistrit të shërbimit me shtretër për muajin tetor nëntor dhjetor 2017 i cili plotësohet mbi bazën e kartelave të shtrimit simbas pavioneve rezulton se për këta muaj numri i pacientëve të shtruar gjendje çdo mbi bazën e kartelave ditore të shtrimit për pacientët është më i madh se kapacitetet ditore të shtretërve (*numri ditor i shtretërve spitalorë është 236*). (*pasqyrat përkatëse nr. 1 dhe 1/1*), (*pasqyrat përkatëse nr. 2 dhe 2/1*), (*pasqyrat përkatëse nr. 3 dhe 3/1*) bashkëngjitur raportit të auditimit.

Rekomandojmë:

Nga SUT, mjekët, kryeinfermierët të merren masat që në plotësimin e kartelave të shtrimit të bazohen në numrin e pacientëve të shtruar gjendje çdo ditë, kapacitetet ditore të shtretërve simbas pavioneve dhe regjistrin e shërbimit me shtretër të plotësuar mbi bazën e kartelave të shtrimit.

Në vijimësi

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i urdhër shpenzimeve për periudhën tetor – dhjetor 2017 për shërbimin e gatimit dhe shpërndarjen e ushqimit rezultoi se pasqyrat e gjendjes e lëvizjes së forcës së SUT-së për çdo datë e cila plotësohet mbi bazën e fletë forcës ditore dhe lëvizjes së forcës gjatë 24 orëve e plotësuar nga kryeinfermieri dhe shefi i shërbimit të çdo pavioni, nuk rakordon me numrin e pacientëve të shtruar në SUT referuar regjistrin të shërbimit me shtretër i cili plotësohet mbi bazën e kartelave të shtrimit simbas pavioneve dhe me forcën e shtruar e likuiduar çdo ditë për ushqimin të plotësuar nga kryeinfermierët dhe shefat e pavioneve. Bazuar në regjistrin e shërbimit me shtretër për muajt tetor, nëntor, dhjetor 2017 i cili plotësohet mbi bazën e kartelave të shtrimit simbas pavioneve rezulton se, për këta muaj numri i pacientëve të shtruar gjendje çdo ditë është më i madh se kapacitetet e shtretërve simbas pavioneve (*numri ditor i shtretërve spitalorë është 236*) dhe dukshëm më i lartë se forca e shtruar e likuiduar çdo ditë për ushqimin të plotësuar nga kryeinfermierët dhe shefat e pavioneve. Bazuar në regjistrin e shërbimit me shtretër rezulton se një numër i konsiderueshëm pacientësh të shtruar nuk janë trajtuar me shërbimin e ushqimit.

Rekomandojmë:

Nga SUT, shefat e pavioneve, kryeinfermierët të merren masat që pasqyrat e gjendjes e lëvizjes së forcës ditore të SUT-së, për shërbimin e gatimit dhe shpërndarjen e ushqimit, të plotësohet mbi bazën e numrit të pacientëve të shtruar në SUT, referuar regjistrin të shërbimit me shtretër, i plotësuar mbi bazën e kartelave të shtrimit dhe kapacitetet e shtretërve simbas pavioneve.

Në vijimësi



18. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i likuidimit të shërbimit të lavanderisë për periudhën e përzgjedhur 01.10. 2017 deri 31.12. 2017 rezulton se:

- Sasitë e kërkesave nga pavionet nuk përputhen me sasitë e fletë daljeve të bëra për operatorin.
- Mbi bazën e materialeve të dorëzuara nga kryeinfermierët e pavioneve, komisioni i marrjes në dorëzim të mallit për çdo datë ka hartuar procesverbalin përkatës *“mbi pritjen, kontrollin dhe marrjen në dorëzim të materialeve të buta për shërbimin e lavanderisë dhe hotelerisë në SUT, pasi i numëroi, peshoi, kontrolloi cilësinë e materialeve të buta (sipas specifikimeve teknike të përcaktuara në kontratën nr. 132/14, dt. 07.12.2016)”*. Ky procesverbal (akt akordimi) shoqërohet me përmbledhësen e shërbimit të lavanderisë të “D” shpk për pavionet e SUT, për periudhat përkatëse mujore, vetëm me sasitë ditore në kg për çdo artikull, pa sasitë në copë dhe pa numrin e shtretërve për çdo ditë.

- Nuk ka një dokument ku sasitë e trajtuara nga lavanderia të cilat janë marrë në copë të jenë shpërndarë nga sipërmarrësi sipas pavioneve të mara nga kryeinfermierët kjo sipas përcaktimit të kontratës.

- Nga krahasimi i fletë daljeve të sasisë së materialeve të trajtuara nga shërbimi i lavanderisë bërë dalje nga kryeinfermierët për datë 02.10.2017 rezulton se sasitë në copë të firmosura dhe të pranuar nga kryeinfermieret përkatës sipas pavioneve nuk është e njëjtë me sasitë në copë të pasqyruar në procesverbalin ditor të mbajtur nga komisioni. Megjithatë kërkesat dhe sasia e trajtuar për datën 02.10.2017 është 706.45 kg në fakt këtë ditë nga operatori është dorëzuar sasia e materialit të një dite të mëparshme dhe jo ajo sasi e kërkuar nga kryeinfermierët.

- Në kërkesat që bëjnë pavionet për materialin i cili duhet ti nënshtrohet shërbimit të lavanderisë të firmosura nga kryeinfermieret nuk shënohet numri i shtretërve të zënë për atë datë, gjendja e pacientëve të rinj të shtruar atë datë ose arsyeja kur ndërrimi i shtratit bëhet i domosdoshëm për të ruajtur dhe mbrojtur shëndetin e pacientit.

Si rezultat sasia e pasqyruar në përmbledhësen e shërbimit të lavanderisë, Aktrakordimit mujor për likuidim dhe procesverbaleve ditore të mbajtura nga komisioni nuk përputhen me sasitë e parashikuara, pasqyruara dhe të dorëzuara nga kryeinfermieret e pavioneve.

Rekomandojmë:

Nga SUT, kryeinfermierët e pavioneve, komisioni i marrjes në dorëzim të mallit, të merren masat që në kërkesat që bëjnë pavionet për materialin i cili duhet ti nënshtrohet shërbimit të lavanderisë duhet të shënohet numri i shtretërve të zënë për çdo datë, gjendja e pacientëve të rinj të shtruar, arsyeja kur ndërrimi i shtratit bëhet i domosdoshëm për të ruajtur dhe mbrojtur shëndetin e pacientit. Gjithashtu të dokumentohen sasitë e trajtuara nga lavanderia të cilat janë marrë nga kryeinfermierët në copë të shpërndarë për çdo pavion nga sipërmarrësi sipas përcaktimit të kontratës.

Në vijimësi

19. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të shërbimit të lavanderisë, bazuar në parashikimet e kryeinfermierëve, sasitë në copë të mara nga operatori dhe pasqyruarë përmbledhëse në kg të sasive të trajtuara me shërbimin e lavanderisë 2017, rezulton se disa materiale të parashikuara nuk janë trajtuar me shërbimin e lavanderisë sipas afateve të përcaktuara në kontratë si: *“Çarçafë shtrati, i sipërm”, “Çarçafë zarf”, “Jastëkë”, “Mbulesë e gomuar”, “kompresa operacioni”, “Çarçafë operacioni (110-130) dhe Çarçafë operacioni (140-130)”, “Kostume ekipi i sallës”, “Përparëse operacioni”, “Kapuça operacioni”, “Pantofla personeli”*. Mos kryerja e shërbimit të domosdoshëm dhe të detyrueshëm të lavanderisë për një sërë artikujsh të parashikuar në kontratë ka cenuar ruajtjen dhe mbrojtjen e shëndetit të pacientëve.

Rekomandojmë:

Nga SUT, kryeinfermierët e pavioneve, të merren masat për zbatimin e shërbimit të lavanderisë sipas përcaktimeve dhe specifikimeve të përcaktuara, duke trajtuar me shërbimin e lavanderisë të gjitha materialet e parashikuara sipas afateve të përcaktuara në kontratë me qëllim ruajtjen dhe mbrojtjen e shëndetit të pacientëve.

*Në vijimësi*

20. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe të pagave u konstatua se organika mbi të cilën funksion SUT nuk ka qenë propozim i dalë nga një studim i mirëfilltë i kryer nga niveli menaxherial drejtues i SUT. VKM përkatëse për vitin 2016 dhe për vitin 2017 kanë qenë hartuar mbi bazën e propozimit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes dhe SUT ka zbatuar organikën e miratuar por të pa propozuar prej saj. SUT nuk ka një strategji rekrutimi të punonjësve dhe një organikë të studiuar. Në këndvështrimin e dinamikës së lëvizjeve të numrit të punonjësve, për vitin 2016 nuk ka pasur një studim të thelluar për çdo pozicion pune dhe nevojat reale të personelit që do ti mbulojë ato. Nga auditimi i kryer mbi organizimin e dosjeve të regjistrimit të personelit, rezultoi se fletët e inventarit, me listën e gjithë dokumentacionit që ndodhet në dosje nuk janë e firmosur nga nëpunësit dhe përgjegjësi i sektorit të Burimeve njerëzore. Mungojnë, fletët prezantuese të dosjeve teknike të nëpunësve, ku duhet të paraqiten të dhënat për nëpunësit. Mungon kërkesa me arsyet dhe motivimi i punonjësit për punësim pranë SUT-së. Dokumentacioni i punonjësve lidhur me të dhënat që përmban dosja janë fotokopje të pa noteruara duke i kthyer ato nga ana administrativo ligjore të pavlefshme.

Rekomandojmë:

Nga SUT, me qëllimin arritjen e objektivave për të cilën kjo qendër Spitalore është ngritur dhe funksion, të ndërmerren hapa konkretë për përmirësimin e organikës së SUT nëpërmjet një studimi të plotë dhe të mirëfilltë duke përcaktuar qartë pozicionet e punës që duhet të ketë efektivisht për çdo shërbim që ofrohet, pozicionet administrative si dhe numrin e punonjësve që nevojiten realisht për çdo pozicion pune.

Në vijimësi

21. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se NJAB ka hartuar planin vjetor 2017 me subjektet që do të auditohen, planifikimin e kostove të njësisë, etj. si dhe janë identifikuar dhe vlerësuar risqet kryesore për veprimtarinë e SUT-së. Për vitin 2017 është planifikuar dhe realizuar një mision auditimi përputhshmërie që përfshin 15 fusha auditimi duke lënë jashtë fushës së auditimit administrimin e pronës së SUT-së, mision i filluar në muajin mars dhe i përfunduar në muajin dhjetor 2017. Programimi dhe realizimi i një misioni të vetëm për gjithë njësitë që operojnë brenda SUT, kërkon kohë shumë të gjatë audituese duke mos sjellë efektivitetin e pritshëm për përmirësimin e punës së kryer nga menaxhimi i SUT-së.

Rekomandojmë:

Njësia e auditimit të brendshëm me qëllim rritjen e efektivitetit të auditimit dhe përmirësimin e menaxhimit të SUT-së duhet të hartojë dhe realizojë misione auditimi për njësi dhe fusha të veçanta auditimit me periudha dhe afate të përcaktuara.

Në vijimësi

22. Gjetje nga auditimi: Spitali Universitar i Traumës nuk ka përgatitur programin e transparencës ku të përcaktojë kornizën ligjore të veprimtarisë së tij, si një mënyrë konkrete përmes së cilës SUT ndërton dhe rrit transparencën në punën e tij institucionale, nën garancinë e ligjit për të drejtën e informimit duke e përditësuar herë pas here programin e transparencës. Mungon faqja zyrtare në web ku mund të publikohet informacioni i programit që synon të bëjë transparencën e veprimtarisë së punës së SUT-së, nëpërmjet pasqyrit të detajuar të tij në faqen zyrtare i cili duhet të pasqyrohet në rubrika, tekste/përmbajtje, afatet kohore për bërjen publike të tij, mënyrën e bërjes publike si dhe strukturën përkatëse e cila prodhon ose administron dokumentin, ku çdo dokument duhet të jetë i aksesueshëm edhe në skemë. Mungesa e faqes zyrtare të SUT-së nuk mundëson për publikun informacion pa kërkesë në format lehtësisht të kuptueshëm dhe informacione që karakterizohen nga kufizime të identifikimit të të dhënave personale për shkak të ruajtjes së privatësisë së individëve, subjekteve



të të dhënave, etj. Për sa më lart është vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 119/2014, dt. 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit”.

Rekomandojmë:

SUT të hartojë, miratojë programin e transparencës dhe në përputhje me të të ndërtojë faqen zyrtare në web duke vendosur në dispozicion të publikut në faqen e tij të internetit dhe në mjediset e pritjes së publikut, kategoritë e informacionit mbi:

Strukturën organizative të SUT; Tekstet e plota, të ligjeve, të akteve nënligjore, të kodeve të sjelljes, dokumente politikash, të manualit ose ndonjë dokument tjetër që ka lidhje me ushtrimin e funksioneve të tij; Informacionin për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike; Të dhëna për vendndodhjen e zyrave të SUT-së, orarin e punës; Të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë; Mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi SUT-në, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjerat; Të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit; Informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat; Informacion për shërbimet që SUT i ofron publikut, përfshirë standardet për cilësinë e shërbimit, çdo informacion tjetër që gjykohej i dobishëm; SUT-ja, gjithashtu, duhet të krijojë dhe arkivojë një kopje digjitale të faqes zyrtare të tij në internet, të plotësuar me informacionin që kërkohet në programin e miratuar të transparencës; Aktet që përmbajnë rregulla, norma apo kufizime të të drejtave dhe lirive themelore të individit, si dhe me efekt të drejtpërdrejtë për ta.

Menjëherë

B. II. Në zbatim të nenit 16, pika 3, të Ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”⁶, nga raporti i NJAB-së, janë konstatuar:

23. Gjetje nga auditimi: Nga NJAB janë audituar librat e llogarisë të SUT ku u konstatua se librat janë të protokolluar, dhe mbahen në dy modele të ndryshme. Në librin nr. 2 pasqyrohen vetëm veprimet e magazinës (*farmacia qendër*). Shkarkimet mujore në librat e financës për ilaçet, medikamentet dhe materialet e tjera rezultojnë se janë bërë në bazë të pasqyrave të farmacisë qendër, duke u bazuar në blloqet e tërheqjes nga pavionet, të firmosura nga shefat e pavioneve, kryeinfermieret dhe farmacia, të cilat nuk janë fletëdalje, por janë përdorur si të tilla. Në këtë rast vërtetohet vetëm lëvizja e materialeve nga magazina nëpër pavionet e ndryshme, por nuk tregohet konsumi nga pavionet për materialet e tërhequra. Në libra e llogarisë nuk janë bërë veprime për shkarkimet e ilaçeve dhe materialeve nga pavionet, gjithashtu nuk ka të dhëna mbi gjendjen e ilaçeve dhe materialeve që duhet të ketë nëpër pavione. Këto veprime janë në kundërshtim me UMF nr. 30, dt. 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Rekomandojmë:

Financa dhe specialistët e financës të SUT të marrin masat për të vendosur mbajtjen e librave përkatës ku të ngarkojnë pavionet me materialet që kanë në administrim dhe shkarkimet mujore të ilaçeve të behën nga pavionet duke pasqyruar më pas veprimet në librat e llogarisë në përputhje me UMF nr. 30, dt. 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Në vijimësi

24. Gjetje nga auditimi: Njësia e Auditimit të Brendshëm verifikoi dokumentacionin ditor që përdorej nga *farmacia e SUT* dhe konstatoi se në farmaci ndodheshin disa blloqe me emërtimin “*Blloqe tërheqjes së materialeve nga pavioni*” për të gjithë pavionet e SUT. Këto blloqe përdoreshin si dokument dalje ditore nga farmacia për mallrat, që i jepeshin pavioneve, gjë që

⁶Mbështetur në ISSAI 1610 “Përdorimi i punës së Audituesve të Brendshëm”.



vërtetohet nga praktikat e dokumentacioneve të verifikuara. Farmacia nuk përdor dokumentin fletëdalje për mallrat që nxirre nga magazinë, por bazohej në dokumentet e mësipërme pa numër rendor, ku firmosej nga shefi i pavionit kryeinfermieri dhe magazinierja. Sa më lart në kundërshtim me UMF nr. 30, dt. 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Rekomandojmë:

Farmacia e SUT, kryeinfermieret e pavioneve dhe të shërbimeve të marrin masa për plotësimin e fletë daljeve për daljet ditore nga farmacia për mallrat që i jepen pavioneve përkatës me qëllim që gjendja e tyre të pasqyrohet në librat e llogarisë materiale që mbahen nga sektori i financës në përputhje me UMF nr. 30, dt. 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Në vijimësi

25. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2016 janë realizuar 30 procedura prokurimi të pa planifikuara të pa pasqyruara në regjistrë, në kundërshtim me nenin 57, pika 2, e VKM nr. 914, dt. 29.12.2014 i ndryshuar, pika II/1 germa “i” e Manualit të “Prokurimit Publik” i ndryshuar.

- Nga Njësia e Prokurimit për vitin 2016 nuk janë dërguar në APP regjistrat e realizimit 4 mujor të prokurimeve për tremujorin e II, III, IV, janë dërguar vetëm për 4 mujorin parë me nr. 7/2 dt. 02.03.2016, që është në kundërshtim me nenin 12, pika 4, Kreu II, të Ligjit Nr. 9643, 20.11.2016 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 57, pika 2 e VKM nr. 914, dt. 29.12.2014 i ndryshuar, e cila ngarkon me përgjegjësi Njësinë e Prokurimit të SUT.

- Nuk janë pasqyruar vlerat e fondit limit të prokuruar dhe nuk janë pasqyruar burimi i fondeve për procedurat e prokurimit që nuk janë përfshirë në regjistrat e parashikimeve të prokurimeve për vitin 2016.

Rekomandojmë:

Njësia e Prokurimit për të ardhmen të marrë të gjitha masat, që në regjistrin e realizimit të tenderave të raportojë vlerën fondit limit të prokuruar, vlerën e të gjitha kontratave të realizuara. Gjithashtu në regjistrin e realizimit të tenderave të raportojë çdo tender të zhvilluar sipas procedurave përkatëse.

Në vijimësi

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Gjetje e konstatime me dëm ekonomik dhe/ose të ardhura të munguara në vlerën 20,755,387 lekë.

1. Gjetje nga auditimi: Nga SUT është hartuar kontrata e qirasë me “A.H” sh.a. dt. 30.08.2013 për përdorimin sipas nenit nr. 1, “objekti i kontratës” për 496 m² ambiente brenda godinës SUT. S.A okupon ambientet sipërfaqe nën objekt, brenda godinës së SUT një sipërfaqe totale prej 1696.4 m². Subjekti “A.H” sh.a. për periudhën objekt auditimi i detyrohet SUT qira e papaguar për sipërfaqen e okupuar prej 1200 m² ($1696\text{ m}^2 - 496\text{ m}^2 = 1200\text{ m}^2$) referuar kontratës së datës 28.08.2013 si më poshtë. Periudha 01.10.2015 deri 31.03.2018 gjithsej 30 muaj. Sipërfaqja e përdorur 1200 m² x 300 lekë/m² në muaj = 360,000 lekë x 30 muaj = 10,800,000 lekë vlerë e cila duhet të arkëtohet.

Rekomandojmë:

Nga SUT, të kontabilizohet dhe bashkë me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, shpërblimi i dëmit ekonomik nga subjekti “A.H” sh.a. në vlerën **10,800,000** lekë pasi ka okupuar ambientet sipërfaqe nën objekt, brenda godinës së SUT në një sipërfaqe prej 1200 m², sipërfaqe



tepër referuar kontratës së qirasë së datës 28.08.2013, të lidhur me ish Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Në tenderin e zhvilluar me objekt “*Mirëmbajtja e objekteve ndërtimore në SUT*”, KVO në rastin e operatorit “D.C” sh.p.k duhet të kishte pasur parasysh si kriter vlerësimi ofertën më çmimin më të ulët dhe ti kërkonte operatorit analizën e kostos për zërat e tjerë të munguar për të argumentuar çmimet e ofertës dhe të kualifikonte ofertën e këtij operatori në vlerën 2,416,735 lekë pa tvsh si oferta më e ulët. Skualifikimi i ofertuesit të mësipërm ka sjellë një dëm prej 820,265 lekë.

Rekomandojmë:

Nga SUT, të kontabilizohet dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykit, shpërblimi i dëmit ekonomik në vlerën **820,265** lekë nga personat përgjegjës pasi në tenderin e zhvilluar me objekt “*Mirëmbajtja e objekteve ndërtimore në SUT*”, kanë skualifikuar padrejtësisht operatorin “D.C” sh.p.k si oferta më e ulët.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Në tenderin e zhvilluar me objekt “*Blerje materiale mjekësore për Neurokirurgjinë në SUT për periudhën 2 muaj mars - prill 2016*” Tiranë” rezulton se në fondin e përllogaritur nga grupi i punës me shkresën nr. 53/8, dt. 02.03.2016 nuk janë përdorur çmimet e ofruara nga grupi i punës që ka përllogaritur çmimet mesatare më shkresën nr. 53/6, dt. 01.03.2016 si rezultat fondi limit është përllogaritur më tepër në vlerën 89,928 lekë pa tvsh shumë e cila duhet të arkëtohet.

Rekomandojmë:

Nga SUT, të kontabilizohet dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykit, shpërblimi i dëmit ekonomik në vlerën **89,928** lekë nga grupi i punës për përllogaritjen e fondit limit, pasi në fondin e përllogaritur për tenderin e zhvilluar me objekt “*Blerje materiale mjekësore për Neurokirurgjinë në SUT për periudhën 2 muaj mars - prill 2016*” Tiranë” nuk janë përdorur çmimet e ofruara nga grupi i punës që ka përllogaritur çmimet mesatare, si rezultat fondi limit është përllogaritur më tepër në vlerën 89,928 lekë pa tvsh, shumë e cila duhet të arkëtohet.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratës nr. 416, datë 19.10.2010 me objekt “*Kryerjen e shërbimit të pastrimit të ambienteve të brendshme dhe pastrim sistemim gjelbërim i ambienteve të jashtme të SUT*” rezultoi se vlerat e likuiduara për zërin “*Mirëmbajtje rrugësh 11228 m²*” për vitin 2016 dhe 2017 kanë një risk të trashëguar nga termat e referencave të kontratës nga viti 2010 e në vazhdim, gjatë zbatimit të shërbimit të pastrimit dhe sipërmarrësi “S-A” sh.p.k. për 2 vitet (2016 + 2017) e ka përfituar këtë proces pune të paargumentuar apo të pajustificuar me dokumentacion, në vlerën 1,237,662 lekë pa tvsh. (1,485,194 lekë me tvsh).

Rekomandojmë:

Nga SUT, të kontabilizohet dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykit, shpërblimi i dëmit ekonomik në vlerën **1,485,194** lekë nga subjekti “S-A” sh.p.k. pasi gjatë zbatimit të shërbimit të pastrimit për 2 vitet (2016 + 2017) e ka përfituar procesin e punës “*Mirëmbajtje rrugësh 11228 m²*” të situacionuar pa argumentuar apo të pajustificuar me dokumentacion, në vlerën 1,237,662 lekë pa tvsh (1,485,194 lekë me tvsh).

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të detyrave të lëna nga auditimet e mëparshme në SUT u konstatuan raste të mos zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH, me



vendimin e kryetarit nr. 192, datë 31.12.2016 të përcjella në SUT me shkresën nr. 1115/75, dt. 23.01.2017 ku është **rikërkuar** marrja e masave për zbatimin e rekomandimeve masave shpërblim dëmi e cila **rezulton e pa zbatuar**.

Rekomandojmë:

- Nga SUT, të kontabilizohet dhe të kërkohet në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit ekonomik, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, për rastet e mëposhtme:

1. Nga auditimi konstatohet se, nga subjekti “S.A”, ose “A.H” sh.a. janë përdorur *pa kontratë dhe pa pagesë sipërfaqja e tepërt prej 1200 m²*, referuar kontratës së qirasë së datës 28.08.2013, të lidhur me ish Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, duke i shkaktuar SUT dëm ekonomik në shumën **7,560,000 lekë**.

Menjëherë

D. GJETJE ME EFEKTE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN, MENAXHIMIN PA EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE:

Gjetje për fonde të trajtuara pa efektivitet dhe ekonomikitet në vlerën 9,482,403 lekë.

1. Gjetje nga auditimi: Subjekti “A.H” sh.a. ka përdorur një sipërfaqe prej 222.3 m², të cilën e ka ndërtuar mbi ambientet ekzistuese të spitalit, për të cilin institucioni nuk ka dokumentacion, si leja ndërtimore apo kontratë, po kështu ka ndërtuar dhe një urë lidhëse ndërmjet godinës së tij dhe spitalit, me sipërfaqe 45 m², ku edhe për të nuk ka dokumente në SUT. Nëse do të përllogarisnim dhe përdorimin e sipërfaqes së ndërtuar nga vetë Spitali Amerikan për periudhën 01.10.2015 deri 31.03.2018 gjithsej 30 muaj për sipërfaqen e përdorur 267.3 m² x 300 lekë/m² në muaj = 80,190 lekë x 30 muaj = **2,405,700 lekë** të ardhura të munguara për periudhën objekt auditimi,

Rekomandojmë:

SUT, të marrin masa, të analizojë, shkaktohet, arsyet dhe përgjegjësitë për lejimin e ndërtimeve pa leje ndërtimore dhe mos arkëtimin e të ardhurave të munguara për periudhën objekt auditimi në vlerën 2,405,700 lekë.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Gjithashtu për periudhën 01 dhjetor 2017 deri 31 mars 2018 subjekti “A.H” sh.a. ka përdorur sipërfaqe të ndërtuara mbi ambientet ekzistuese të spitalit, për të cilin institucioni nuk ka dokumentacion, si leja ndërtimore apo kontratë, si platforma në nivelin e katit të parë me konstruksion çeliku në një sipërfaqe **160 m²** dhe **42 m²**.

Nëse do të përllogarisnim përdorimin e sipërfaqes së ndërtuar nga vetë “A.H” sh.a për periudhën e mësipërme prej 4 muaj për sipërfaqen e përdorur 202 m² x 300 lekë/m² në muaj = 60,600 lekë x 4 muaj = **242,400 lekë** të ardhura të munguara.

Rekomandojmë:

SUT, të marrin masa, të analizojë, shkaktohet, arsyet dhe përgjegjësitë për lejimin e ndërtimeve pa leje ndërtimore dhe mos arkëtimin e të ardhurave të munguara për periudhën objekt auditimi në vlerën 242,400 lekë.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratës nr. 416, datë 19.10.2010 me objekt “Kryerjen e shërbimit të pastrimit të ambienteve të brendshme dhe pastrim sistemim gjelbërim i ambienteve të jashtme të SUT” rezultoi se vlerat e likuiduara për zërin “Mirëmbajtje rrugësh 11228 m²” për vitin 2010 deri 2015 është likuiduar në vazhdimësi nga subjekti “S-A” sh.p.k i pa shoqëruar me dokumente argumentuese e justifikuese, me efekte financiare në vlerën **2,786,790 lekë**, duke marrë për bazë çmimin fillestar. (të pa indeksuar), (557,358 lekë/vit x 5 vite = 2,786,790 lekë pa TVSH).\\



Rekomandojmë:

SUT, të marrin masa, të analizojë shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorimin me eficensë, ekonomikitet dhe efektivitet të fondet buxhetore në vlerën 2,786,790 lekë.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi në SUT konstatohen rritje të shpenzimeve të konsumit të energjisë elektrike për vitin 2016 në vlerën 20,974,442 lekë dhe për vitin 2017 në vlerën 25,021,955 lekë, respektivisht më tepër **4,047,513** lekë. Kjo për arsyen se SUT-së bazuar në kontratën e koncesionit/PPP nënshkruar nga MSH në korrik 2015 me kompaninë “S” shp.k “Për ofrimin e shërbimeve të integruara të furnizimit të setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale sterile, furnizim me material mjekësor steril të një përdorimesh në sallat kirurgjikale, trajtimin e mbetjeve me rrezik biologjik dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikale” neni 19 “Detyrimet e tjera të palëve” nënpika 19.5 përcakton: “Në qendrat e BACK-up, përveç qendrës Back-up tek QSUT, Autoriteti i siguron Koncesionarit energji elektrike, uji, avull, vepra civile, impiante etj, me shpenzime në ngarkim të Autoritetit” i është shtuar dhe furnizimi me energji elektrike i koncesionarit të sterilizimit duke rënduar shpenzimet e SUT.

Rekomandojmë:

SUT, të marrin masa, të analizojë shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorimin me eficensë, ekonomikitet dhe efektivitet të fondet buxhetore në vlerën 4,047,513 lekë si dhe të kërkojë nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale rinegocimin e kontratës për nënpikën 19.5.

Menjëherë

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi”.



Pasqyra nr. 1

Gjendia e të shtruarve dt. 01.10.17	Kartelat	
-------------------------------------	----------	--

Urdhër shpenzimi ushqimi nr. 568, dt. 09.11.2017 për vlerën 4,876,899 lekë

Pasqyra nr. 2

Urdhër shpenzimi ushqimi nr. 614, dt. 06.12.2017 për vlerën 5,083,170 lekë



Pasqyra nr. 2/1

(kartelat 6200 deri 7046)

Urdhër shpenzimi ushqimi nr. 614, dt. 06.12.2017 për vlerën 5,083,170 lekë

Pasqyra nr. 3

(kartelat 7047 deri 7782)

Urdhër shpenzimi ushqimi nr. 710, dt. 27.12.2017 për vlerën 3,867,773 lekë

Urdhër shpenzimi ushqimi nr. 27, dt. 06.02.2018 për vlerën 411,376 lekë



Muaji dhjetor 2017 (Numri i shtretërve spitalorë 236)

Pasqyra nr. 3/1

[illegible]

Urdhër shpenzimi ushqimi nr. 710, dt. 27.12.2017 për vlerën 3,867,773 lekë

Urdhër shpenzimi ushqimi nr. 27, dt. 06.02.2018 për vlerën 411,376 lekë